



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
Fakuleti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit - Pejë

# **Administrim Biznesi**

Revistë shkencore shoqërore - ekonomike

## **Administriranje Biznisa**

Ekonomsko - društvena znanstvena revija

## **Business Administration**

Economic and social scientific journal

Nr. 1  
Pejë  
2010



**ADMINISTRIM BINESI**

**Revistë shkencore shoqërore – ekonomike**

**ADMINISTRIRANJE BIZNISA**

**Ekonomsko – društvena znanestvena revija**

**BUSINESS ADMINISTRATION**

**Economic and social scienetific journal**

**Nr. 1**

**Pejë**

**2010**

**Botues**  
**Universiteti i Prishtinës**  
**Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit - Pejë**

**Këshilli botues**

Dr. Sc. Selman Selmanaj, Dr. Sc. Halid Kurtović, Dr. Sc. Ali Sylqa,  
Dr. Sc. Muhamet Sadiku, Mr. Sc. Mehrije Hoti

**Këshilli Redaktues**

Dr. Sc. Fadil Govori, Dr. Sc. Edmond Beqiri, Dr. Sc. Husnija Bibuljica,  
Dr. Sc. Fatos Ukaj, Dr.Sc. Artan Nimani, Dr. Sc. Adem Zogjani,  
Mr.Sc. Drita Shoshi

**Kryeredaktor:** Dr. Sc. Xhavit Aliçkaj

**Zv/kryeredaktor:** M.sc. Jahja Lataj

**Sekretari i redaksisë:** Mr. Sc. Shqipe Husaj

**Asistente teknike:** M.sc. Shqiponja Nallbani

**Koopertina dhe përgatitja kompjuterike:** Adnan Lataj

**E drejta autoriale mbrohet në bazë të ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës**

## **PËRMBAJTJA**

|                                                                                                                                                                                                                                 |            |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| <b>KRIZA GLOBALE DHE REFLEKTIMI I SAJ NË EKONOMINË E KOSOVËS .....</b>                                                                                                                                                          | <b>8</b>   |
| <b>EKONOMIA E KOSOVES DHE INTEGRIMI I SAJ NE UE.....</b>                                                                                                                                                                        | <b>16</b>  |
| <b>PËRGJEGJËSITË LIGJORE PËR MJEDISIN NË BAZË TË KONVENTAVE<br/>EVROPIANE .....</b>                                                                                                                                             | <b>22</b>  |
| <b>MENAXHIMI I DREJTË I POLITIKAVE FISKALE - ÇELËS I SUKSESIT<br/>EKONOMIK.....</b>                                                                                                                                             | <b>31</b>  |
| <b>MUNDËSITË E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT PËRMES AKTIVITETEVE<br/>REKREATIVO SPORTIVE.....</b>                                                                                                                                      | <b>47</b>  |
| <b>NDIKIMI DHE PJESEMARRJA E EKONOMISË INFORMALE NË EKONOMINË<br/>E NJË VENDI, ME THEKS TË VEÇANTË NË EKONOMINË E KOSOVËS .....</b>                                                                                             | <b>53</b>  |
| <b>KOMPLEKSITETI I PRONËS SHOQËRORE, TRANSFORMIMI DHE<br/>PRIVATIZIMI I SAJ .....</b>                                                                                                                                           | <b>59</b>  |
| <b>BAZA E TË DHËNAVE (DATABAZA) E KRIJUAR NË ANALIZËN E GJENDJES<br/>SË SHFRYTËZIMIT TË ECTS SISTEMIT NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS,<br/>UNIVERSITETIN SHTETËROR TË TETOVËS DHE UNIVERSITETIN E<br/>EVROPËS JUGLINDORE.....</b> | <b>71</b>  |
| <b>ZNAČAJ I NEOPHODNOST ORGANIZACIONIH PROMJENA .....</b>                                                                                                                                                                       | <b>83</b>  |
| <b>OBRAZOVNE TEORIJE I NJIHOVA IMPLIKACIJA NA E-LEARNING .....</b>                                                                                                                                                              | <b>91</b>  |
| <b>HAPËSIRA MONETARE OPTIMALE: UNIONI MONETAR EVROPIAN.....</b>                                                                                                                                                                 | <b>101</b> |
| <b>ORGANIZIMI I VEPRIMTARISË SË MARKETINGUT NË NVM-VE NË KOSOVË<br/>.....</b>                                                                                                                                                   | <b>116</b> |
| <b>MARKETIGNU I QËNDRUESHËM - KUPTIMET E PËGJITHSHME .....</b>                                                                                                                                                                  | <b>122</b> |
| <b>KRIZAT FINANCIARE .....</b>                                                                                                                                                                                                  | <b>130</b> |
| <b>TRAJNIMI I RESURSEVE HUMANE – RESURSEVE DOGANORE .....</b>                                                                                                                                                                   | <b>140</b> |
| <b>UTVRĐIVANJE PRAVNOG OSNOVA ZA NAKNADU ŠTETE PO OSNOVU<br/>UGOVORA O OSIGURANJU IMOVINE.....</b>                                                                                                                              | <b>148</b> |
| <b>MOGUĆNOST OTVARANJA BERZE NA PROSTORIMA KOSOVA.....</b>                                                                                                                                                                      | <b>159</b> |
| <b>DOMOSDOSHMERIA E MARKETINGUT NË INTERNET .....</b>                                                                                                                                                                           | <b>171</b> |
| <b>NDËRVARSHMERIA NË MES MASES MONETARE, ÇMIMEVE DHE<br/>AKTIVITETIT EKONOMIK. ....</b>                                                                                                                                         | <b>181</b> |
| <b>MODELET E MUNDSHME BASHKËKOHORE PËR FINANCIMIN E BIZNESIT<br/>NË KUSHTET E EKONOMISË SË KOSOVËS.....</b>                                                                                                                     | <b>193</b> |
| <b>UPRAVLJANJE LJUDSKIM POTENCIJALIMA U SLUŽBAMA DRŽAVNE<br/>UPRAVE POMOĆU EKSPERTNIH SISTEMA .....</b>                                                                                                                         | <b>203</b> |

|                                                                                                                                                                                |            |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| <b>VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË PËRSONELIT NË NDËRMARRJET KOSOVARE .....</b>                                                                                                    | <b>211</b> |
| <b>INTERAKCIJA MENADŽMENTA I INFORMACIONOG SISTEMA .....</b>                                                                                                                   | <b>217</b> |
| <b>SIVA EKONOMIJA I NEFORMALNI RAD U REPUBLICI KOSOVO U TRANZICIONOM PERIODU .....</b>                                                                                         | <b>234</b> |
| <b>EQUIVALENCE AND EQUIVALENT EFFECTS IN TRANSLATION.....</b>                                                                                                                  | <b>244</b> |
| <b>MENAXHIMI I STRESIT NË NDËRMARRJET KOSOVARE.....</b>                                                                                                                        | <b>250</b> |
| <b>ROLI DHE NDIKIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIKE NË PRODHIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E INFORMATAVE, NË FAVOR TË RRITJES SË EFIÇENCËS DHE EFEKTIVITETIT TË BIZNESEVE KOSOVARE .....</b> | <b>258</b> |
| <b>TË KUPTUARIT E PAGESËS – SHPËRBLIMIT NË BAZË TË PËRFORMANCËS NE SEKTORIN PUBLIK E PRIVAT .....</b>                                                                          | <b>266</b> |
| <b>NEVOJA E MËSIMIT TË LËNDËS „SHKRIMI AKADEMIK“ .....</b>                                                                                                                     | <b>278</b> |
| <b>MENAXHIMI I OBJEKTEVE HOTELIERE NË BAZË TË PLANIT TË ASETVEVE .....</b>                                                                                                     | <b>284</b> |

## KRIZA GLOBALE DHE REFLEKTIMI I SAJ NË EKONOMINË E KOSOVËS

*Dr. Ali Sylqa, prof. ord.  
alisylqa@yahoo.com*

### **Abstrakt**

Pasiguria e tanishme e ekonomisë ndërkombëtare përfaqëson një nga krizat më destruktive në shekullin e fundit, ndoshta me efekte aq shkatërruese sa asnjëherë më parë. Sistemi ekonomik i përgjithshëm ndërkombëtar, pothuajse të gjitha ekonomitë individuale kombëtare dhe ekonomitë në tranzicion të Evropës Juglindore janë ndikuar nga kjo krizë. Ekonomia e Kosovës, edhe pse e brishtë dhe jo e qëndrueshme sigurisht që do të ndikohet nga kriza globale. Shikuar nga prizmi metaforik, efekti do të jetë ai i valëve të detit, që d.m.th. pa marrë parasysh sa do të vonojë përplasja e saj me bregun, ajo gjithsesi se do të ndodh por intensiteti i saj do të jetë vështirë i parashikueshëm. Është e kuptueshme që nga rrethanat ekonomike të krijuara rishtas, posaçërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë të prekura nga trazirat aktuale të tregjeve ndërkombëtare. Përderisa argumentohet se kriza globale financiare nuk ka goditur Kosovën drejtpërdrejtë, ekonomia e saj ka ndjerë efektet e saj indirekte. Vendet donatore kanë hezituat të rrisin ndihmën e tyre për Kosovën për shkak të problemeve të brendshme; rritja dramatike e papunësisë si në Evropë ashtu edhe në SHBA, ka prekur diasporën kosovare. Rënia pasuese e dërgesave nga kosovarët të cilët punojnë jashtë vendit ka mundësi të ketë ndikim negativ në ekonominë e Kosovës në përgjithësi.

**Fjalët kyçe:** Kriza globale ekonomike, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, konkurrenca, varfëria, remitanca.

**JEL klasifikimi:** O11, L26, M16

### **Hyrje**

Nëse ka pasur ndonjë situatë kur duhej qenë në depresion për shkak të qëndrueshmërisë së euros, ajo ishte shënuar në vitin 2010, gjithsesi duke iu referuar krizës ekonomike botërore. Në tërë botën, lidhja në mes të globalizimit dhe integritit më të madh ekonomik, përveç përfitimeve, po ashtu ka shtuar edhe ekspozimin ndaj rrezikshmërisë, kështuqë si rezultat i kësaj dështimi ekonomik në një vend mund të prek shumë shpejt ekonomitë tjera kombëtare. Shembulli më i dalluar është ai që jemi duke përjetuar sot, pra kriza e cila i ka filltet e saj në sistemin bankar amerikan dhe shumë shpejt u shndërrua në recesionin më të thellë në historinë bashkëkohore të SHBA-ve dhe përfundoi në krizë globale ekonomike dhe financiare. Shkalla e papunësisë sot është më e larta në tridhjetë vitet e fundit, bursat kanë filluar të shënojnë rënie, ndërsa rënia e shpejtë e kërkesës së konsumatorëve ka bërë që ekonomia të fillojë të çalojë dhe ka kthyer mbrapshtë



trendet pozitive të rritjes ekonomike në shumë vende. Pako të ndryshme të ndihmave financiare në shumë prej miliarda euro janë futur në funksion nga shumë vende, si një masë emergjence për të parandaluar përhapjen e krizës në shumë ekonomi kombëtare.

### **1. Kriza globale vs ekonomia e Kosovës**

BE-ja pas shumë debatesh miratoi një pako të jashtëzakonshme shpëtimi për Greqinë prej 110 miliardë eurosh. Nën presion të madh janë edhe vendet anëtare të Eurozonës dhe veçanërisht Irlanda dhe Portugalia. Aksionet në bursa në gjithë botën kanë shënuar rënie, ndërsa investitorët janë të shqetësuar për stabilitetin financiar të rajonit, që bën gati një të katërtën e ekonomisë botërore. Shumë evropianë druajnë se kanë parë vetëm një fragment të së ardhmes së tyre: një sëmundje ngjitëse që përhapet nga një vend pa borxhe te tjetri, trazira sociale për shkak të shkurtimit të numrit të vendeve të punës, vite të pavendosmërisë politike dhe dëbim ose tërheqje të vendeve nga Eurozona. Evropa po ballafaqohet me të gjitha format e problemeve sociale dhe politike, që mbase mund ose jo të manifestohen, por dilema kryesore qëndron te ekonomia. Nga perspektiva e tashme, as dhuna dhe as ankthi në tregjet financiare nuk janë dëshmi se plani i shpëtimit për Greqinë dhe strategjia më e gjerë evropiane në ballafaqimin me krizën e borxheve, kanë dështuar.

Trazirat, madje edhe ato të dhunshmet, janë pjesë e shpeshtë e jetës politike greke. Tregjet financiare nganjëherë reagojnë me shumë skepticizëm ndaj planeve shpëtuese ekonomike. Megjithatë, autori i shkrimit pohon se investitorët nuk janë të bindur në suksesin e pakos së ndihmës financiare, sepse fillimisht dyshojnë nëse premtimi prej 110 miliardë eurosh do të materializohet për shkak të vazhdimit të kundërshtimit politik në Gjermani ose nga frika se grekët do të heqin dorë nga kursimet e premtuara. Brenga tjetër e tyre ka të bëjë me Irlandën, Portugalinë dhe Spanjën, që ballafaqohen me stagnimin ekonomik dhe spiralen e borxheve. Tash është shumë e rëndësishme që Portugalia, Spanja dhe vendet tjera të dëshmojnë se ato nuk janë në pozitën e Greqisë.

Një hap tjetër do të ishte sigurimi i mekanizmit nga Bashkimi Evropian që t'i furnizojë me mjete të gatshme financiare ekonomitë më të dobëta të Eurozonës, nëse ato do të përfshihen nga paniku. Ankthi i Athinës nuk bën të përsëritet përgjatë kontinentit, por për ta evituar atë duhet guxim dhe ndershmëri më e madhe e liderëve evropianë.

Edhe pse deri më tani nuk ka ndonjë shenjë se Kosova është zhytur në ndonjë krizë financiare, ekspertët nuk e mënjanojnë mundësinë që kjo të ndodhë për arsye se shumica e vendeve evropiane janë përfshirë në krizën globale financiare. Kosova do të mund të ndikohej nga kriza botërore financiare vetëm nëpërmjet emigrantëve të cilët jetojnë në shtetet që janë të përfshira në këtë krizë.

Kosova është një vend mjaft i ri dhe natyrisht e ka një Bankë Qendrore që është shumë konservative në politikën e saj të mbikëqyrjes dhe natyrisht nuk e ka atë politikën monetare për shkak se vendi ynë e shfrytëzojmë valutën euro. Edhe pse deri më tani nuk ka ndonjë shenjë serioze se Kosova është zhytur në ndonjë

krizë financiare, ekspertët nuk e mënjanojnë mundësinë që kjo të ndodhë për arsye se shumica e vendeve evropiane janë përfshirë në krizën globale financiare.

## **2. Kushtet konkrete ekonomike të Kosovës**

Në përgjithësi, ekonomitë e shteteve në tranzicion kanë qenë të mbrojtura nga ndikimi i tregjeve botërore përmes centralizimit të organizimit dhe shpërndarjes së prodhimit, si dhe nga dominimi i prodhuesve në tregun vendor. Për më tepër, tregjet e punës gjithashtu ishin fuqishëm të rregulluara ashtu që punëtorët gëzonin një shkallë të lartë të sigurisë dhe stabilitetit në punësim. Ndryshimet politike bënë të mundur reformat e vonuara ekonomike dhe sociale, të cilat hapen tregjet vendore për të importuar konkurrencën e jashtme gjersa në anën tjetër sfiduan destinimet tradicionale të eksportit. Kështu që, ndërmarrjet befasisht u ndeshën me një konkurrencë të rreptë që i shtyri ato të ristrukturojnë prodhimin dhe fuqinë punëtore brenda një kohe shumë të shkurtër.

Tani shoqëria kosovare si një shtet i pavarur do duhej të gjenerojë angazhime serioze institucionale për sistemin e pavarur ekonomik të Kosovës, të bazuar në ekonominë e hapur të tregut. Ajo duhet të krijojë mekanizmat nëpërmjet të cilëve bëhet rregullimi makroekonomik në kushtet e veprimit të tregut integral. Prona, pluralizmi i pronës, me dominim të pronës private, siguria e pronës dhe mbrojtja e saj është po ashtu një segment i rëndësishëm që sigurohet në këtë sistem. Tregu është rregullatori kryesor i aktivitetit ekonomik. Kosova, si një vend i vogël dhe ballkanik, duhet të orientohet për ndërtimin e sistemit të ekonomisë sipas kërkesave të një ekonomie të hapur ndaj tregut evropian dhe botëror, politikë të matur rregullative, sistem përkrahës fiskal, politika ekonomike-financiare favorizuese, si dhe liberalizim ekonomik. Andaj, preokupimet tona duhet të orientohen mbi të gjitha në: krijimin e kornizës ligjore dhe institucionale, zhvillimin e politikave integruese evropiane, hartimin e strategjive të njëmendta të zhvillimit ekonomik të vendit, privatizimin e plotë e të suksesshëm të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike.

### **2.1 Kriza dhe çmimet**

Çmimet e konsumit në Kosovë janë ngritur për 7.8 për qind përgjatë periudhës shtator 2008 – shtator 2009. Kjo situatë shpjegohet për shkak të rritjes së çmimeve në tregun botëror. Ekspertët për çështje ekonomike japin mendime të ndryshme rreth ndikimit të krizës financiare në ngritjen e çmimeve të produkteve ushqimore në tregun kosovar. Kriza financiare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në disa vende të Bashkimit Evropian ka ndikuar në ngritjen e çmimeve edhe në tregun kosovar, pasi komuniteti i biznesit kosovar kryesisht varet nga kreditë e bankave komerciale.

Tani, për momentin, po shohim se ardhja deri te kreditë nga bankat komerciale është vështirësuar, për shkak të një kontrolli më të rreptë nga bankat me rastin e dhënies së kredive. Ngritja e çmimeve të huave ndikon po ashtu edhe në afarizmin e subjekteve ekonomike, që shprehet në çmimin në treg. Ngritja e

çmimeve në tregun kosovar nuk është pasojë e drejtpërdrejtë e krizës financiare, pasi Kosova ende nuk ka qasje në tregjet financiare ndërkombëtare. Ngritja e çmimeve më tepër ka të bëjë më ngritjen e inflacionit në Kosovë. Cikli i ngritjeve dhe i rënies në bursën ndërkombëtare është aq i shpejtë e në mënyrë pragmatike lë pasojë edhe në Kosovë. Kosova nuk ka qasje në tregjet financiare ndërkombëtare dhe Kosova është në atë periferinë e ndryshimeve edhe të ngjarjeve të përditshme që ndodhin.

Shkak tjetër për ngritjen e çmimeve në Kosovë është edhe importi i lartë, pasi që shumica e prodhimeve në tregun kosovar importohen nga vende të ndryshme të Evropës. Me moszhvillimin dhe prodhimin e produkteve vendore, Kosova është shumë e pafuqishme që të ndikojë në këto lëvizje të çmimeve në bursat botërore. Sikur Kosova të kishte një ekonomi më të zhvilluar dhe të kishte një prodhimtari më të zhvilluar, normalisht se në disa produkte Kosova nuk do të ishte e varur aq shumë nga importi.

### **2.3 Efekti i remitancës / dërgesat nga jashtë**

Rëniet e remitancave dhe kthimi i emigrantëve në shkallë të madhe mund të shtojë presionin i cili, edhe në kontekst të rënies së rëndë ekonomike, nuk është ndjerë, bile as në masën më të vogël në rajon në tërësi. Në praktikë, trendi i remitancave mund të marrë pak kohë për t'u bërë i qartë. Ndërkohë që ka gjasa për presionet në rënie, ka edhe dëshmi se në tërë botën, remitancat kanë tendencë që të jenë elastike dhe të bien më butë sesa që pritet te rënia ekonomike. Kjo është pjesërisht sepse shumë që dërgohen në shtëpi janë shpesh të vogla (zakonisht rreth 5 për qind e të ardhurave) ashtu që pagesat shpeshherë mund të sigurohen edhe kur bien të ardhurat. Më tej, rrjedhat e remitancave dominohen nga pagesat nga emigrantët që kanë emigruar prej shumë kohësh të cilët, për shkak se shpeshherë janë përshtatur mirë në vendin e tyre të migrimit, mund të jenë në pozitë më të mirë për të gjetur burime alternative të të ardhurave në qoftë se humbin punën e tyre.

Rritja e normës së papunësisë në vendet e Evropës perëndimore ka goditur edhe emigrantët Kosovarë, duke zvogëluar kështu nivelin e dërgesave të emigrantëve drejt Kosovës, të cilat paraqesin një ndër burimet kryesore të financimit për ekonominë e vendit. Remitancat nga diaspora, kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra llogaritet të jenë rreth 30% e bruto produktit kombëtar (GDP). Po ashtu, rënia e kërkesës në sektorin e jashtëm, si rezultat i recesionit, është reflektuar negativisht edhe në nivelin e eksporteve, duke goditur industrinë kryesore eksportuese. Nën këto rrethana, shtrëngimi i kredithënies drejt sektorit real të ekonomisë mund të kontribuojë në thellimin e mëtejshëm të ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në vend. Andaj, vazhdimi i kreditimit edhe në këtë kohë, duke respektuar parimet e kreditimit të shëndoshë, paraqet një faktor shumë të rëndësishëm për të stimuluar aktivitetin ekonomik në vend dhe për të mënjnuar në një masë efektet negative nga kriza.

### **2.4 Papunësia**

Kosova edhe sivjet do të përballet me një gjendje të rëndë sociale, si pasojë e rritjes së vazhdueshme të papunësisë. Premtimet për hapjen e vendeve të reja të punës, që janë dhënë gjatë gjithë fushatës parazgjedhore, tashmë kanë mbetur në letër dhe i takojnë së kaluarës. Qeveria nëpërmjet të Ministrisë të Punës dhe Mirëqenies Sociale pohon se në të ardhmen nuk pritet ndonjë përmirësim i gjendjes sociale në Kosovë e as që do të ketë vende të reja të punës. Çdo vit në Kosovë janë të aftë për punë më shumë se 40 mijë të rinj, 25 deri në 30 mijë të rinj gjejnë punë të ndryshme në ekonomi familjare, apo bëjnë zgjidhje. Ndërkaq, 8 mijë deri në 10 mijë të rinj mbesin pa punë në vit. Këto parametra janë me të vërtetë shqetësuese dhe një alarm i kuq që fatkeqësisht vazhdon të mos e ndërrojë ngjyrën tash e një dekadë.

Sipas të dhënave më të reja të zyrave shtetërore të statistikave nëpër rajon, Kosova prinë për nga papunësia në rajonin e Ballkanit Perëndimor me mbi 40% të papunësisë. Maqedonia vjen menjëherë pas me 33%. Bosnja e Hercegovina është e treta me 23,4 %. Shqipëria me kuotën prej 13,7% është në një pozitë më të mirë në krahasim me shtetet e rajonit. Kosova dhe Maqedonia kanë shkallën më të lartë të papunësisë në Evropë. Paga më e lartë mesatare është në Slloveni dhe ajo arrin në 935, 11 Euro, përderisa për Kosovë nuk ka vlerësim të saktë të pagës mesatare. Bruto produkti kombëtar më i larti është në Slloveni dhe ai arrin në 18,367 euro për kokë banori, në Kroaci 14, 222 Euro, Mal të Zi 4,908 Euro, Serbi 4,651 dhe në Maqedoni e Bosnjë ai sillet rreth 3,200 Euro. Qytetarët e Kosovës janë më të varfërit në Evropë me një mesatare prej rreth 1700 € të ardhura për kokë banori, që është 1/3 e nivelit të Shqipërisë.

### **3. Ndërtimi i një sektori privat të shëndoshë**

Tranzicioni mund të shihet si një element në procesin e gjerë të globalizimit, ashtu që analiza peshohet në atë nëse kjo do të ndalohej përkohësisht ose përjetësisht nga rënia ekonomike. Ndikimi dhe implikimet e recesionit për ekonominë në tranzicion është divers për shtetet e Evropës. Kjo është pasojë e shtegut të caktuar të tranzicionit që ato zgjedhin, për shembull në lidhje me shpejtësinë e privatizimit, çiltërsinë ndaj investimeve të huaja direkte, dhe shkallën e integritit me BE, si dhe ndikimi i rëndë në kushtet fillestare, natyrisht reformat e tregut para tranzicionit dhe ndihmat në resurse natyrore. Konvergjenca në mes të ekonomive të zhvilluara dhe në tranzicion me siguri se do të rifillojë, edhe pse performanca mund të jetë më heterogjene, për shembull në mes të anëtarëve të BE-së dhe ata jashtë BE-së.

Ndërtimi i një sektori të tillë privat të shëndoshë kërkon një bazë të fortë në mjediset globale dhe vendase, në infrastrukturën, në sundimin e ligjit, etj. Themelet për rritje në sektorin privat fillojnë me makro biznes global që funksionon mirë duke përfshirë një ekonomi globale dinamike që siguron tregjet si dhe rregullat e përshtatshme të tregut që mundësojnë qasjen konkurruese ndaj mundësive të tregut. Shkëmbimi i hapur i mallrave, kapitalit dhe informacionit – dhe transferimi i teknologjisë, ideve stimulon zhvillimin e sektorit privat. Kjo ndodh nëpërmjet shumë mekanizmave; tregjeve të hapura, investimeve të huaja të cilësisë së mirë,

përkrahje efektive drejt zhvillimit, si dhe transferimi efikas i teknologjive dhe njohurive. Ajo kërkon ato reforma si p.sh. heqja e subvencioneve bujqësore dhe formave të tjera të mbrojtjes që në mënyrë kaq evidente pengojnë zhvillimin e sektorit privat të orientuar drejt eksportit në zonat rurale të vendeve në zhvillim.

Ekziston një marrëveshje e gjerë që tregjet e hapura kanë mbështetur rritjen ekonomike. Përparësitë, ndonëse të ruajtura mirë, e meritojnë të përsëriten. Një politikë e tregtisë së hapur nxit rritjen e prodhimit duke hapur sektorin privat ndaj konkurrencës. Tregtia e lirë i ndihmon vendet të alokojnë burimet e tyre drejt fushave të tyre më efektive me përparësi krahasuese. Importet më të lira rrisin standardin vendor të jetesës dhe lejojnë përdorimin e inputeve me kosto më të ulët ndërkohë që sektori privat prodhon për konsumatorët e vendit dhe të huaj. Një regjim i tillë siguron qasje ndaj tregut të hapur nëpërmjet tarifave më të ulëta dhe barierrave të tjera.

Elementet qendrore të një makro-mjedisi të fuqishëm për biznesin përfshijnë paqen dhe stabilitetin politik, qeverisjen e mirë me hartimin e politikave të qëlluara, transparencën, si dhe politikat makroekonomike të shëndosha. Për bizneset konflikti i brendshëm ose i jashtëm rrit koston dhe pasigurinë, duke penguar investimet e brendshme dhe ato të jashtme. Duke u thelluar, konflikti pengon edhe zhvillimin e sektorit privat sepse çon në një shkatërrim tragjik të kapitalit njerëzor, keq-alokimin e burimeve të mangëta publike, shkatërrimin e resurseve të llojeve të ndryshme, pushtimin e burimeve natyrore, eliminimin e qasjes ndaj tregut, etj.

Lidhur me infrastrukturën, këtu përfshihen rrugët, energjia, uji, telekomunikacioni, portet, arsimin, shëndetësinë, etj. Ndërtimi i këtyre shërbimeve bazë ka një përfitim të dyfishtë, përmirësimi i jetës së popullsisë dhe mundësia e rritjes së biznesit. Infrastruktura e dobët e rrugëve, hekurudhave, energjia elektrike, etj mund të shkaktojnë humbje të ndjeshme për vendet në zhvillim. Në anën tjetër, infrastruktura e mbajtur mirë përmirëson tregtinë duke shpejtuar transportin e mallrave dhe lëndëve të para, duke ruajtur prodhimin intensiv të energjisë dhe duke e bërë informacionin lehtësisht të kapshëm dhe komunikimin në kohën e duhur. Rruga e kombit, e titulluar kështu për arsyen se simbolizon një kryevepër të paparë deri më tani, do të shërbejë si një gjenerator i fuqishëm i zhvillimit ekonomik të vendit tonë dhe rajonit. Ky projekti kombëtar infrastrukturor do të kompletohet me finalizimin e autoudhës Merdarë – Morinë.

Investimet në arsim dhe shëndetësi përfshijnë sektorin privat dhe publik. Në kundërshtim me besimin konvencional shumë nga shërbimet arsimore dhe shëndetësore në vendet në zhvillim sigurohen nga iniciative private, përfshirë kooperativat dhe organizatat reciproke të sigurimeve shëndetësore. Ligjet formojnë një shtresë esenciale të themelit për një sektor të shëndetshëm privat. Pa një kuadër ligjor transparent dhe një sistem administrativ të drejtë gjyqësor, përpjekje të tjera për të nxitur zhvillimin e sektorit privat nuk mund të funksionojnë ashtu siç është planifikuar. Qeveritë duhet të përcaktojnë 'rregullat e lojës', një sistem që redukton kostot e transaksionit duke i bërë ato të parashikueshme dhe të zbatueshme. Sistemet ligjore kontradiktore dhe hutuese i bëjnë praktikën e biznesit të vështirë për t'u realizuar. Legjislacioni i dobët mbron firmat oligarkike dhe bizneset e

korruptuara kundrejt forcave konkurruese, e që shpesh bien në kurriz të NVM-me. Marrëdhëniet e këndshme midis biznesit dhe rregullatorit dëmtojnë zhvillimin e konkurrencës së hapur të tregut të lirë. Shtresat më të ulta të shoqërisë goditen më së fort në këto raste.

Korrupsioni dhe konfuzioni mbi detyrimin për të zbatuar rregullat janë shpesh për tu fajësuar për çmimin e lartë të përputhshmërisë. Burokracia, pengesat, vendim-marrjet arbitrare dhe kërkesa të tjera të dëmshme dëmtojnë aktivitetin privat. Praktikrat e korrupsionit shkatërrojnë çmimet dhe tregjet, si dhe pengojnë konkurrencën e hapur dhe të ndershme.

### **3.1 Rimëkëmbja dhe perspektiva ekonomike**

Cilësia e menaxhimit të krizës do të përcaktojë kohëzgjatjen dhe seriozitetin, si dhe perspektivat ekonomike pas krizës. Përderisa askush nuk mund të parashikojë me saktësi kohëzgjatjen, thellësinë dhe pasojat e krizës, studimi i cikleve të biznesit tregojnë se do të përfundojë dikur, dhe ekonomia do të fillojë të rritet. Të shpresojmë se vendet më të mëdha do t'i shmangen joshjeve të proteksionizmit dhe se qeverisja globale ekonomike do të forcohet. Sidoqoftë ka gjasa të vogla që ekonomia botërore të rritet në ritmin e vërejtur më herët gjatë kësaj dekade. Politikrat makroekonomike në ekonomitë më të mëdha duhet të jenë më pak akomoduese, dhe sektori financiar më pak i ndikuar dhe më rezistues nga rreziku. Në horizont nuk ka burime të mëdha të fitimeve nga produktiviteti. Është gjithashtu e qartë se ekonomitë do të përballen me pengesa më të fuqishme fiskale të cilat do të kërkojnë përshtatje serioze në politikën e shpenzimeve publike. Kthimi në reformat ekonomike dhe institucionale, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, mund të jetë rasti më i mirë për të rritur potencialin e rritjes globale.

### **Konkluzion**

Deri tani ka një konsensus se efektet e krizës globale ekonomike në Kosovë kanë qenë modeste në rastin më të mirë. Megjithatë, pasi që Kosova kërkon më tej integrimin ekonomik, ajo nuk mund të mbetet e mbrojtur prej tronditjeve në të ardhmen, prandaj do të duhet të zhvillojë një politikë largpamëse të menaxhimit fiskal. Çfarë del si një implikim i rëndësishëm për Kosovën është se politika fiskale, si instrument i vetëm kur ka edhe presione të mëdha për shpenzime që tendosin financat e qeverisë, mund të jetë e rrezikshme sidomos kur deficitet financiare në rritje bëhen më të vështira.

Për shumicën e ekonomive në tranzicion, procesi i tranzicionit, sikurse vet globalizimi, ka gjasa që të rifillojë pasi që të kalohet kjo krizë në ekonomitë e zhvilluara. Sidoqoftë përkohësisht, disa ekonomi në tranzicion ka gjasa që të vuajnë më shumë sesa ekonomitë e zhvilluara, që do të thotë se për disa vite procesi i konvergjencës mund të shkojë mbrapsht. Këto vende ka gjasa që të jenë ato të Ballkanit dhe ish Bashkimit Sovjetik, natyrisht duke përfshirë këtu edhe Kosovën.

### **Referencat**

1. Konferenca Ndërkombëtare “Ndikimi i krizës financiare në Ballkan dhe në Kosovë”, Prishtinë, 2009;
2. Megginson, “The financial Economics of Privatization”, 2005;
3. Raporti për vitin 2009 i Entit të Statistikave të Kosovës;
4. Revista kroate “Banka”, maj 2010;
5. Selmanaj Selman, “Globalizimi dhe Tranzicioni – dilemat dhe sfidat”, 2006;
6. Tatjana Soubotina, “Beyond Economic Growth”, 2000;
7. Transparency International, “Transparency International Corruption Perceptions Index”, Berlin 2003;
8. United Nations DESA, “World Economic Situation and Prospects”, 2009;
9. Zhvillimi dhe Tranzicioni, UNDP, 2009;
10. World Economic Forum, “Globalisation of Alternative Investments”, 2008;

## EKONOMIA E KOSOVES DHE INTEGRIMI I SAJ NE UE

Msc.Ariana Xhemajli,ass.  
arianaxhemajli@gmail.com

### Abstrakti

Punimi përmban nevojën e integritit të ekonomisë së Republikës së Kosovës në Unionin Evropian. Në këtë funksion qëllimet dhe veprimtaritë e institucioneve të vendit tonë nuk janë kompatible. Tranzicioni i tejzgjatur i përcjellë me shumë probleme shoqërore, politike, juridike, sociale dhe mos trajtimi adekuat i tyre nga ana e institucioneve kompetente procesin e synuar e vështirëson në masë të madhe. Andaj, mobilizimi i të gjitha segemneteve institucionale dhe jointucionale nëpërmjet një palni të detajuar dhe konkret zhvillimor duke forcuar shtetin ligjor të përshpejtojë veprimtarinë për t'u integruar në UE. Përveç kësaj shoqëria kosovare duhet të vetëdijësohet për nevojën e integritit. Në këtë plan duhen të identifikohen burimet potenciale specifike me të cilat ndërmarrjet kosovare do të konkurrojnë me sukses në tregun evropian dhe njëkohësisht do të arrijnë që ta ruajnë identitetin e produkteve vendore dhe dinjitetin e shiqerisë kosovare.

**Fjalët Kyçe;** Integrim, konvergencë, BE, politikë ekonomike, institucione

**Jel klasifikimi:** F, F02, F13

### Hyrja

Qëllimi thelbësor i politikës ekonomike të Kosovës duhet të jetë sjellja e një procesi substancial të *konvergjencës* drejt standardeve evropiane të jetesës, jo me larg se gjeneratën e ardhshme. Për të arritur këtë qëllim, të gjitha ministratë qeveritare, institucionet publike dhe agjencitë e përfshira në hartimin dhe zbatimin e politikës së zhvillimit ekonomik – në nivel qendror dhe lokal – kanë nevojë për një fokus të përbashkët strategjik. Roli i Bashkimit Evropian dhe donatorëve ndërkombëtarë është të përkrahin këtë fokus në konvergencën ekonomike dhe sociale, të asistojnë më këshilla dhe – si pjesë e procesit të integritit evropian – të asistojnë me resurse ekonomike.

Konvergjencia e suksesshme përfshin hiç më pak se një revolucion të heshtur strukturor. Për këtë kërkohet një transformim sistematik i sektorit prodhues dhe bujqësor kosovar si dhe kalimi nga një shoqëri në të cilën një pjesë e madhe e popullatës mbështetet në të hyrat nga jashtë ose në bujqësi për mbijetesë, në shoqëri në të cilën një forca punëtore e shkolluar ofron prodhime dhe shërbime konkurruese që mund të shiten e plasohen në tregun evropian. Kjo përfshin ndryshime të thella në mënyrën në të cilën qytetarët e Kosovës mësojnë, punojnë, prodhojnë dhe bashkëveprojnë me ekonominë globale. Si rezultat, konvergjencia kërkon nga cilado



qeveri e Kosovës që të komunikojë në mënyrë efektive me të gjithë qytetarët, tëi përfshijë ndërmarrësit dhe tëi qaset talenteve nga të gjithë sektorët e shoqërisë. Sfidat me të cilat sot ballafaqohen institucionet e Kosovës, ndërmarrësit dhe qytetarët janë tepër të mëdha. Secili qytetar i Kosovës është i vetëdijshëm për gjendjen e rëndë ekonomike. Pas krizës ekonomike të viteve të tetëdhjeta dhe dekadës shkatërruese në vijim (viteve të nëntëdhjeta), zhvillimi ekonomik në periudhën e pasluftës gjithashtu është varur me të madhe në trasfere, prej të hyrave nga diaspora dhe ndihmës ndërkombëtare. Baza e të hyrave vendore mbetet e ultë dhe shërbimet publike paguhen shumë pak. Rënia e vazhdueshme e ndihmës ndërkombëtare do të thotë se nevojat urgjente për investime publike në resurse njerëzore dhe infrastrukturë publike janë nën presion. Jemi të vetëdijshëm për ndikimin që zgjerimi i Bashkimit Evropian së fundi, dhe atij në të ardhmen, ka gjasa të ketë në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Këtë vit Bashkimi Evropian i janë bashkangjitur dhjetë shtete të reja, shumica e të cilave kanë pasur një tranzicion të shpejtë e të suksesshëm në regjim të politikave liberale. Ndihma e BE-së për zhvillim u vihet në dispozicion këtyre shteteve që tëiu ndihmohet që të ecin në hap me pjesën tjetër të Bashkimit Evropian. Këto vende po bëhen lokacione tepër tërheqëse për investime të brendshme. Në këtë ambient ku gara sa vjen e rritet, do të jetë kualiteti i të menduarit strategjik po aq sa edhe efikasiteti i ndërmarrësve dhe biznesmenëve kosovar ai që do të përcaktojë performansën e ardhshme.

### **1. Nevoja për planin kombëtar të zhvillimit dhe integritetit**

Vendimarrësit kosovarë nuk duhet të presin që procesi i Evropianizimit të fillojë zyrtarisht para se të hartojnë një strategji të tillë zhvillimi. “anëtarësimi në Bashkim kërkon praninë e një ekonomie funksionale të tregut dhe të kapacitetit për t’u ballafaquar me presionin konkurrues dhe forcat e tregut përbrenda Bashkimit”<sup>1</sup>. Si shenjë zotimi ndaj procesit të kongjencës dhe të reformës strukturore, ne propozojmë të adaptohen konceptet dhe modalitetet e llojit të BE-së Plan Kombëtar i Zhvillimit për procesin e politikave në Kosovë. Ky proces në fakt është dizajnuar nga Komisioni Evropian që të përshpejtojë zhvillimin dhe konvergjencën në shtetet më të varfëra anëtare të BE-së, si dhe në vendet konkurruese. Nuk është natyra e sfidës së zhvillimit të Kosovës ajo që është unike. Më shumë është thellësia e tij, sa i përket pikës fillestare tepër të pafavorshme. Dokumentet strategjik e të hartuara vitet e fundit brenda ministrive qeveritare në Kosovë, së bashku me analizën dhe ndihmën investuese të agjencivë ndërkombëtare, paraqesin stadin e parë të këtij procesi.

Plani Kombëtar i Zhvillimit përfshin fazat në vijim:

- Një vlerësim i plotë dhe realist i kërkesave të zhvillimit strategjik të një ekonomie që ecën drejt integritetit në BE;
- Hartimi dhe shpenzimet e hollësishme e koherente të strategjive ministrore, për të hequr barrierat për një zhvillim më të shpejtë, me

---

<sup>1</sup> Dokumenti Punues i Stafit të Komisionit, Kosova nën RKSOKB 1244, Raporti mbi progresin, Komisioni Evropian, 2007

fokus në nevojat për investim në fushat kyçe të resurseve njerëzore, infrastrukturë publike dhe ndihma e alokuar me kujdes në sektorët produktive të ekonomisë;

- Vlerësimi rigoroz paraprak i pasojave të mundshme të një programi të tillë zhvillimor në sajë të gjenerimit të një ngritjeje të qëndrueshme të përsheptuar dhe konvergjencës drejt standardeve të jetës në BE.

## **2. Kordinimi institucional Kombëtar**

Zhvillimi i strategjive ekonomike për “motorët” kyç zhvillimor në sektore do të kërkojë koordinim të ngushtë në mes të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Tregëtisë dhe Industrisë. Strategjitë e tjera ministrore duhet të shihen në përkrahje të qëllimit për zhvillim industrial rural, duke ofruar inpute që janë absolutisht më të rëndësishmet për këtë proces. Duke siguruar se forca punëtore e ardhshme e Kosovës do t’i ketë kualifikimet arsimore të nevojshme për të qenë e aftë që të garojë me ekonominë evropiane e globale në rritje, do je jetë imperative, dhe gati sigurisht do të kërkojë alokim resursesh dukshëm më tepër këtij sektori sesa që merr për momentin. Në një strategji për rritje duhet të marrë parasysh faktin se resurset e Kosovës janë shumë të limituara dhe duhet të përdoren në mënyrë efektive në fushat ku kthimet janë më të larta. Shumë strategji të zhvillimit ekonomik apo të rritjes bëjnë një punë të mirë në vlerësimin e dobësive në një ekonomi, por jo edhe aq të mire në vlerësimin e rrënjëve të dobësive dhe zgjidhjet e rekomanduara<sup>2</sup>

Në shumicën e shteteve anëtare të BE-së, përgjegjësia për menaxhim të Planit Kombëtar për Zhvillim (procesi PKZH) i ipet një njësie për strategji të vecanta ekonomike, të vendosur brenda Ministrisë së Financave. Kjo njësi zakonisht është e ndarë nga ana buxhetore e Ministrisë, mirëpo aktivitetet e saja duhet të jenë në përputhje me strategjinë e përgjithshme buxhetore. Ajo kontrollon hartimin e Planit Kombëtar për Zhvillim, ndërlihet me ministritë e tjera ekonomike dhe sociale përdërisa këto të fundit kontribuojnë me strategjitë e tyre sektoriale në PKZH më gjërë, dhe është poashtu përgjegjëse për zgjedhjen e konflikteve që mund të lindin mes ministrive.

Është e qartë se një njësi strategjike ekuivalente është urgjentisht e nevojshme në Kosovë. Pa të, planet strategjike të ministrive të ndryshme mbase nuk mund të integrohen në një plan strategjik kombëtar koherent, kryesisht të përgaditur sipas parimeve të BE-së si më lart. Gjithashtu nuk duhet të ketë dyshim në atë se egziston nevoja që të aplikojnë sunstancialisht një bashkëpunim ndër- ministror në të gjitha nivelet, dhe se në këtë përpjekje Kosova mund të marrë nga përvoja e konsiderueshme e të gjitha shteteve të reja anëtare të BE-së, të cilat kanë vënë në jetë sistme të tilla të shëndosha të koordinimit të politikave. Zbatimi i njëjtë i kushteve për zgjerim të vendosura nga BE andaj të gjitha shteteve aplikante shpesh

---

<sup>2</sup> “Diagnoza e rritjes (ngritjes)”, Dani Rodrik, Ricardo Hausmann dhe Andres Velasco, Universiteti i Harvardit

herë është lëndë e kritikave, prandaj për to thuhet edhe se paraqesin “standarde të dyfishta” të cilat duhet të plotësohen<sup>3</sup>

Madje edhe para ndonjë marrëdhënieje me BE-në, planifikimi zhvillimor në Kosovë nuk duhet ndjekur në një vakum evropian. Realiteti është se ekonomia e Kosovës është e thellë ngulitur brenda ekonomisë gjithpërfshirëse të Bashkimit Evropian në zgjerim e sipër. Ky lloj i procesit strategjik tanimë zbatohet në *të gjitha* shtetet e reja anëtare. Plani Kombëtar Zhvillimor ofron procesin më të shëndoshë e logjik si:

- **Një vizion për integrimin e Kosovës në strukturat evropiane**, duke u bazuar në një vlerësim realist të gjendjes së tanishme të ekonomisë së Kosovës dhe në atë që nevojitet për të ecur drejt integritit Evropian.
- **Qëllimi për të zhvilluar ndërmarrje konkurruese industriale dhe bujqësore**, për të tejkaluar barrierat ndaj zhvillimit dhe për të drejtuar fondet e rralla publike në resurse njerëzore dhe infrastrukturë publike që janë thelbësore për arritjen e këtij qëllimi.
- **Instrumenti i Planit Kosovar të Zhvillimit**, i cili është mirë i themeluar në vendet evropiane për aktivitetet e planifikimit dhe caktimit të prioriteteve.

### 3. Plani Zhvillimor për Kosovën

Në fazën e tanishme të zhvillimit, procesi i planifikimit është duke zënë vend përbrenda minstrive të qeverisë së Kosovës, kryesisht në bazat e departamenteve. Fatkeqësisht, duket se është vetëm një numër i kufizuar i informatave të mundshme që koncentrohen në pefromancën e Ndërmarrjeve Publike (NP-ve-) dhe Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH- ve) si dhe pothuajse asnjë informata mbi sektorin privat të ndërmarrjeve.

Në rastin e Kosovës është zhvilluar një situatë ku një pjesë e madhe e së cilës mund të quhet “program publik investues” është udhëhequr në bashkëpunim të dyanshëm me një varg të agjncioneve të mëdha ndërkombëtare dhe donatorve. Ajo që do duhej të largohet nga kjo situatë drejt një plani Zhvillimor Kombëtar për Kosovës? Dhe si mund të velësohej ai?

Vendet me prosperitet zhvillimor mund të gëzojnë një varg luksoz të themelimit të qëllimeve socio -ekonomike pasi që ato kanë për qëllim të kenë burime adekuate. Vendet në zhvillim siç është Kosova në një anë duhet të përqendrohen në qëllimin e rritjes e shkallëzore të zhvillimit të të hyrave për kokë banori. Për shkak të kujdesit të duhur me ndikim në shpërndarjen e të hyrave në vend qëllime tjera të dhurshme socio-ekonomike, kanë për qëllim të vinë në linjë si një pasojë drejtpërdrejtë zhvillimit dhe rritjes së ekonomisë në përgjithësi (p.sh. ndihmesa në përmirësimin e kushteve sociale në fushat e shëndetësisë dhe shkollimit, përmirësimi i mbrojtjes së ambientit, etj).

---

<sup>3</sup> Wiener, Antje (2002) Finality vs. Enlargement: Constitutive Practices and Opposing Rationales in the Reconstruction of Europe, Jean Monnet Working Paper 08/02.

Për secilin shtet të varfër detyrimet janë më së bollshme. Në rastin e Kosovës, është i lokalizuar në një fushë periferike apo gjeografikisht-ekonomikisht të pafavorshme, afër zonave së konfliktit dhe dizorientimit të performances ekonomike. Ekziston një varg strukturash joadekuate institucionale. Niveli fillestar i zhvillimit është pranueshëm i ulët, duke vënë detyrimet në mundësi të burimeve (p.sh. krijuesit e politikave ballafaqohen me detyrime financiare nga bilanci i pagesave dhe duke financuar kërkesat për borxhe të sektorit publik). Kjo ka një strukturë fillestare të jofavorshme ekonomikisht me një sektor të gjërë të bujqësisë dhe një konfigurim të papërshtatshëm të sektoreve industriale dhe një sektor të nënzhvilluar të tregut të shërbimeve. Niveli i kapitalit njerëzor si dhe i teknologjisë është shumë i ulët, duke i vënë detyrimet në strategjitë e realizueshme zhvillimore. Nevoja për të reduktuar eksploatimin e burimeve të papërtëritshme mund të vë detyrime të tjera në zhvillim. Pavarësisht nga mënyra e sfidimit të detyrimeve ata duhet të identifikohen qartazi dhe më përkushtim finsikëror. Qeveria e Kosovës duhet t'i identifikojë projektet e veta bazuar në një vlerësim të sinqertë të sifdës shoqërore dhe ekonomike. Nëse Qeveria e Kosovës nuk i bën ato me specifikat e prioritetëve politike, atëherë agjencitë ndërkombëtare do t'i bëjnë ato me specifikat e tyre!

### **Përfundimi**

Qëndrim i përbashkët i të gjithë akterëve në procesin e privatizimit, institucioneve relevante, qeverisë së Kosovës, Bashkësisë ndërkombëtare është se privatizimi është domosdoshmëri për integrimin e Kosovës në UE dhe gëzon përkrahjen e plotë nga të gjithë.

Modeli i privatizimit në Kosovë duhet shikuar si modeli më i mirë i mundshëm brenda rrethanave në të cilat gjendet Kosova. Statusi politik i papërcaktuar ishte elementi kryesor që në një mënyrë ka imponuar këtë model. Privatizimi ishte ndal për një periudhë mjaft të ndjeshme kohore për shkaqe të mirënjohura gjeopolitike. Konsensusi përfundimtar qëndroi në intencën e dizajnit të mekanizmit të tillë që do të lejonte vazhdimin e papenguar të procesit të privatizimit dhe të gjitha ankesat dhe pretendimet të zgjidhen nëpërmjet Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës. Pra me fjalë të tjera, modeli i përzgjedhur kishte për qëllim anashkalimin e vështirësive të cilat mund të mbajnë peng në një mënyrë apo tjetrën procesin në tërësi.

Nuk duhet të harrojmë të gjithë ne ekspertët e ekonomisë se rezultatet e para makroekonomike pas përfundimit të privatizimit mund të priten vetëm pas një periudhe 5-10 vjeçare. Deri atëherë, institucionet qeveritare dhe joqeveritare duke përfshirë të gjithë aktorët kontribuues në zhvillimin ekonomik, duhet të përpilojnë plane dhe hartojnë projekte në funksion të stimulimit dhe përkrahjes së iniciativës private që është në lindje e sipër. Vështruar nga prizmi i ekonomisë së tregut, me rëndësi kapitale është transformimi sa më i shpejtë i pronës shoqërore në atë private. Iniciativa private mbetet i vetmi gjenerator i pakontestueshëm i zhvillimit ekonomik në botën moderne të biznesit.

Do të ishte iluzion nëse themi se gjithçka vajti në rregull dhe se nuk kishte gabime. Me siguri se në procese të tilla komplekse gabime ka dhe se ato zbulohen

vetëm me kalimin e kohës përmes kryerjes së punëve dhe detyrave. Tek e fundit, mësimi zë vend atëherë kur detektohen gabimet e së kaluarës dhe më pastaj ndërmerren masa për të përmirësuar sjelljet apo mënyrat e kryerjes së punëve.

Të gjithë ata që mendojnë ndryshe, përgjigjen mund ta gjejnë në pyetjen hipotetike: vallë, çka nëse privatizimi do mbetej i bllokuar?

### Referencat

1. Amin A., The globalization of the economy: an erosion of regional networks., London 2000
2. Blackhurst R & Anderson K., Inegration and the Global System, New Yor
3. Francis F., "Pas fundit të historisë", 2006.
4. Hana L. & Telo I., Tranzicioni në Shqipëri – arritjet dhe sfidat, Tiranë 2005
5. Ilić G., Reforme Evropske Unije – Institucionalni aspekti., Beograd 2004
6. Jovanović M., Evropska Ekonomska integracija, Beograd 2004
7. Lakër U., Europa në kohën tonë 1945 – 1992, Përkthyer nga kush eshte perkthyer??? dhe botuar në Tiranë 2006
8. Limani M., Integrimet ekonomike evropiane, Prishtinë 2004
9. Mario B. & Marko Sh., Transition-the first decade, Washington 2001
10. Sadiku M., Transicioni dhe Reformat Institucionale në Kosovë, Riinvest, Prishtinë 2007
11. Selmanaj S. Globalizimi dhe Tranzicioni – dilemat dhe sfidat, Riinvest Prishtinë 2006
12. Selmanaj S. Sistemet ekonomike bashkëkohore, Prishtinë 2006
13. Selmanaj B., Globalizimi, Lubljanë 2006
14. UNDP, Regional Centre Bratislava and World Bank Global Network Development of Learning, "Establishment and application of politics and initiatives on SME support", 2004.
15. Uvalic Milica, "Privatisation and Corporate Governance in Serbia (FRY)", dhjetor 2001;
16. World Bank, "World Development Report 2000/01: Attacking poverty", NY, 2001;
17. World Bank report, "Supporting the Economic Growth and Sustainable Development", in cooperation with Ministry of Agriculture and Food, Albania, November, 2002;

## **PËRGJEGJËSITË LIGJORE PËR MJEDISIN NË BAZË TË KONVENTAVE EVROPIANE**

*Dr.sc. Armand Krasniqi, prof. ass.<sup>4</sup>  
mandikrasniqi@gmail.com*

### **Abstrakti**

Punimi pretendon që të faktojë rreziqet me të cilat po ballafaqohet me dekada mjedisi në suaza globale dhe njëkohësisht reagimin e shoqërisë njerëzore që me mjete të forta juridike të ndikojë në mbrojtjen e këtij sistemi. Sot kur zhvillimi shoqëror – ekonomik global ka shënuar një rritje të paparë ndonjëherë, në heshtje kemi konstatuar se paralelisht në këtë avancim seriozisht është degraduar dhe shkatërruar mjedisin në të cilin po jetojmë duke mos menduar fare se e drejta për të jetuar normalisht është edhe e brezave që do të vinë pas nesh. Vitet e shtatëdhjeta të Shekullit XX shënojnë intensifikimin dhe mobilizimin e qeverive të përgjegjshme për programe mbrojtëse mjedisore. Gradualisht çështja ka kaluar dhe në instanca dhe institucione ndërkombëtare të cilat kanë nxjerrë një sërë deklaratash, direktivash dhe konventash me të cilat rekomandojmë dhe i detyrojnë qeveritë e vendeve që legjislacionin nacional ta përafrojnë me parimet dhe standardet që ofrojnë këto dokumente të rëndësishme. Përveç kësaj, për shkak të rritjes së rreziqut të lartë shoqëror dhe dinamikës së shkatërrimit të mjedisit janë nxjerrë edhe dy konventat të cilat i detyrojnë vendet që përgjegjësia për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit të rregullohet dhe të mbrohet edhe me Ligjin Civil dhe Ligjin Penal të vendeve duke i kualifikuar e konsideruar kështu veprimet e dëmshme të subjekteve ndaj mjedisit krime.

**Fjalët kyçe:** Legjislacion, mjedis, ambient, përgjegjësi civile dhe penale, konventë, direktivë.

**JEL klasifikimi:** K, K0, K3, K32.

### **Hyrja**

---

<sup>4</sup> Autori është pedagog i grup lëndëve nga e drejta biznesore në FSHAB Pejë edhe në Fakultetin Ekonomik të UP.

Zhvillimi teknik dhe teknologjik viteve të fundit të shekullit të kaluar kanë krijuar vatra të shumta të rrezikut për mjedisin. Gjendja e këtillë e shkaktuar nga vet njeriu, duke e keqadministruar jo vetëm natyrën dhe burimet e saja dhe vetë ambientin të punës, kanë sjell dëme të mëdha për jetën e tyre, integritetin fizik, shëndetin, pasurinë dhe vlerave të tjera. Në të njëjtën kohë me veprime të këtilla hapur në mënyrë ekstrem dhe serioze po rrezikohet baza e mbijetesës së njerëzve. Për shkak të shkallës së lartë që paraqet ky rrezik komuniteti ndërkombëtar ka ndërmarr një sërë masa, procedura dhe burime në mënyrë që të eliminojnë, parandalojnë ose minimizojnë këto vatra kërcënimesh për mjedisin dhe për vetë jetën e njerëzve.

Është e pakontestueshme se rreziku për shkatërrimin e ekuilibrave mjedisorë është shndërruar në problem global që kërcënon tërë ambientin global jetësor. Nisur nga këto shqetësime komunitetit ndërkombëtar ka filluar që të reflektojë angazhim me serioz në planin preventiv dhe mbrojtës në këtë fushë. Edhe vendi ynë është në fazën e reformave shoqëror, ekonomike, politike dhe legjislative. Në këtë plan rëndësi të veçantë është duke i kushtuar çështjes së harmonizimit respektivisht përafrimit të legjislacionit vendas me rregulloret, aktet dhe dokumentet e rëndësishme ndërkombëtare që pretendojnë balancat mjedisore. Në këtë kuptim, aspekti i mbrojtjes së mjedisit dhe eliminimi i dëmeve të shkaktuara nga vatrat e mundshme të rrezikut ekzistues ose potencial, vlerësohen i një rëndësie të veçantë gjë që parashton nevojën urgjente për të harmonizuar shumë me thellë dhe me më kujdes bazën legjislative konform me dy konventat: Konventës mbi përgjegjësinë civile për dëmet e shkaktuara nga aktivitetet që janë të rrezikshme për mjedisin nga viti 1993 dhe Konventës mbi mbrojtjen e mjedisit jetësor nëpërmjet Ligjit penal në vitin 1998. Jo vetëm kaq, për shkak të rëndësisë që ka sot mbrojtja e mjedisit ekzistojnë një tërësi dokumentesh dhe rekomandimesh që i detyrojnë vendet të veprojnë në planin legjislativ, ekonomik, social dhe së fundmi humanitarë. Qëllimi i këtyre elementeve është kompozimi i bazës legjislative dhe masave ekonomike të cilat duhet çdo herë të jenë të zhvilluara në baza të qëndrueshme në drejtim të ruajtjes së ambientit.

### **Përgjegjësia civile**

Në përputhje me Deklaratën e Rios mbi Mjedisin të vitit 1992,<sup>5</sup> Këshilli i Evropës me qëllim të rregullimit dhe sigurimit të një kompensim adekuat për dëmet eventuale të shkaktuara nga aktivitetet që janë të rrezikshme për mjedisin, me 21 Qershor 1993 në Llugano nxjerr Konventën mbi përgjegjësinë civile të subjekteve për dëmet e shkaktuara nga aktivitetet që janë të rrezikshme për mjedisin.<sup>6</sup>

---

<sup>5</sup> Rio Declaration on Environment and Development, Having met at Rio de Janeiro from 3 to 14 June 1992, për shumë shih ne <http://www.unep.org/Documents.Multilingual/Default.asp?documentid=78&articleid=1163>

<sup>6</sup> Convention on Civil Liability for Damage Resulting from Activities Dangerous to the Environment Lugano, 21.VI.1993, për më shumë shih ne <http://conventions.coe.int/treaty/en/treaties/html/150.htm>

Dispozitat hyrëse të kësaj Konvente kanë krijuar konceptet themelore e të qarta në mënyrë që përmbajtja e tyre të interpretohet njëjtë nga secili anëtar i kësaj organizate të vjetër evropiane. Kjo konventë në sferën e mjedisit dhe përgjegjësisë për te me vlerë të veçantë i konsideron: burimet e jetës si abiotikë dhe biotikë, ajrin, ujin, tokën, florën, faunën dhe elementet që janë në bashkëveprim në mes të këtyre faktorëve. Konventa në fjalë pretendon që rregullojë mbrojtjen e ambienti specifik e cila mund t'i ekspozohet ose ndikohet nga burime të ndryshme të rrezikut. Përveç kësaj rregullohen edhe aspektet e pronës, veçanërisht ato të cila është pjesë e trashëgimisë kulturore si dhe aspekte të veçanta të peizazhit.<sup>7</sup>

Sipas dispozitave të kësaj konvente si të rrezikshme do të konsideroheshin: prodhimin, trajtimin, magazinimin, përdorimin apo shkarkimin e një ose më shumë substancave të rrezikshme ose ndonjë aktivitet i cili është i natyrës të ngjashme në lidhje me këto substanca, prodhuese, bujqësore, trajtimin, magazinimin, përdorimin, shkatërrim, hedhjen, lirim, ose ndonjë aktivitet tjetër në lidhje me një ose më shumë e organizmave të modifikuar gjenetikut ose mikroorganizmave që përfaqësojnë një rrezik i rëndësishëm për njeriun, mjedisin ose pronën, punën ose instalimin e pajisjeve për djegie, të përpunimit, trajtimit apo riciklimit të mbeturinave, me kusht që ata përfaqësojnë një rrezik i rëndësishëm për njeriun dhe mjedisin.<sup>8</sup>

Me rastin e interpretimit të konventës në fjalë potencohet se si një substancë apo substanca të rrezikshme paraprakisht të përgatitura që kanë aftësinë të emitojnë një rrezik për mjedisin dhe njeriun ose për pronë e tij (p.sh. mjetet shpërthyes, oksidative, djegëse, helmuese, të dëmshme, korrozive, irrituese, etj) lindin përgjegjësinë për demin eventual deliktor ose kontraktual i cili në rast se shkaktohet duhet të kompensohet. Incidentet në drejtim të shkaktimit apo dëmtimit të mjedisit mund të jenë ndonjë dukuri apo ngjarje të papritura e të vazhdueshme që i kanë të njëjtën origjinë, që shkaktojnë dëme apo krijojnë rreziqe serioze dhe të përhershëm me krijimin e dëmit. Për shkak të efekteve të aktiviteteve të rrezikshme, substancat ose produktet e dëmtuara e rrezikojnë ose mund të rrezikojnë mjedisin gjendjen e cila manifestohet në shfaqjen e dëmeve të caktuara. Si dëm i shkaktuar nga ana e subjektit të caktuar që gjithsesi duhet kompensuar konform rregullave të parashikuara në konventë janë: Humbja e jetës ose plagosje personale, humbje ose dëmtim të pronës në fushën e aktiviteteve të rrezikshme, humbje ose dëmtim që kryhet dëme mjedisore, kostot e masave parandaluese dhe çdo dëm të shkaktuar nga zbatimit të këtyre masave.

Përgjegjësia eventuale për dëmin e shkaktuar është e rregulluar qartë me dispozitat e Konventës Evropiane dhe nëse ky dëm është shkaktuar pas hyrjes në fuqi të këtij akti ndërkombëtar ligjor apo nëse incidenti ka ndodhur në territorin e një pale kontraktuale pavarësisht se ku ndodhin pasojat e dëmit subjektet çdo herë ngarkohen me përgjegjësi. Kjo përgjegjësi mund të ndodhë në dy forma dhe atë si: Përgjegjësi sa i përket substancave, organizmave dhe instalimeve të caktuara të

---

<sup>7</sup> Po aty

<sup>8</sup> Po aty



mbeturinave ose vende; dhe Përgjegjësinë e një vend të përhershëm për asgjësimin e mbeturinave.

Në rastin e parë mbajtësi lëndëve i cili kryen një aktivitet të rrezikshëm është përgjegjës për dëmin e shkaktuar për shkak se operimi me këto lëndë kanë qenë rezultat i aksidentit ose gjatë periudhës kur ai mbanë në kontroll aktivitetet e veta. Në një rast tjetër mbajtësi respektivisht operatori është përgjegjës për rregullsinë e vazhdueshme të depozitimit të mbeturinave dhe nëse gjatë kësaj kohe shkaktohet dëmi nga depozitimi i tyre në atë vend lind përgjegjësinë civile dhe së bashku me te edhe detyrimin për kompensimin e dëmit. Nga rregullat për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar konventa ka paraparë disa përjashtime në rastet në të cilat e lirojnë operatorin nga detyrim. Këto janë rastet ku dëmi ishte shkaktuar nga ngjarje si armiqësia, lufta civile, rebelimi, fenomen natyror me karakter jashtëzakonshme që nuk mund të evitohet as nuk mund të kundërshtojnë veprimtarinë e një pale të tretë ose nivele të pranueshme të ndotjes (dhe cilat janë nivelet e pranueshme është një çështje faktike që duhet të zgjidhen në çdo rast duke marrë parasysh të gjitha rrethanat objektive dhe karakterit subjektiv), ose aktivitetet e rrezikshme të cilat janë kryer në përputhje me ligjin në interes të një personi i cili ka pësuar dëmtime.

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga ndotja është reduktuar praktikisht vetëm në kompensim të dëmit material dhe jo material. Kërkesë për kompensim inicohet para autoriteteve gjyqësore kombëtare dhe në vendin ku është shkaktuar humbja, apo në vendin ku janë zhvilluar aktiviteti të rrezikshme ose në bazë të vendbanimit të përhershëm të palës së paditur (i ashtuquajtur i juridiksionin alternative). Megjithatë, kjo konventë ka dhënë mundësi që kërkesave të subjekteve të caktuara, organeve dhe organizatave që kanë të bëjnë me mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit t'u sigurohet një mbrojtje civile – juridike cilësore. Andaj me këtë akt juridik arrihet që të:

- Ndalohej i aktivitetit e rrezikshme që janë të paligjshme dhe që përbëjnë një kërcënim serioz për dëmtimin e mjedisit,
- Llogaridhënies së operatorëve për të marrë masa të caktuara të specifikuara saktësisht për të parandaluar incidentet apo ngjarje të dëmtimit të tilla në të ardhmen,
- Llogaridhënies së operatorëve për të marrë veprime pas incidentit për të parandaluar dëme edhe të ardhmen,
- Llogaridhënies së operatorëve për të marrë masa për t'u kthyer në gjendjen e mëparshme vendet ose sendet e dëmtuara.

Në mënyrë që të forcohet më tej përgjegjësia e individëve personave fizikë e juridikë, kompanive, institucioneve ose organizatave të tjera me karakter shumëkombëshe shumë vende dhe organizata ndërkombëtare kjo konventë i ka detyruar që të ndërmarin fushata në lëmin e redaktimit, ruajtjes, promovimit dhe mbrojtjes e mjedisit jetësor në kornizat ndërkombëtare. Megjithatë shpejt konstatohet se për një reagim efikas shoqërore – juridik i tillë nuk mjafton vetëm mundësia e krijimit të përgjegjësisë civile për dëmet e shkaktuara në mjedis. Pas pesë vjet të përpjekjeve intensive të shumë shkencëtarëve dhe ekspertëve arrihet që

të miratohet Konventa së re evropiane e cila vendos bazë të rëndësishme dhe në kuadrin e përgjegjësisë penale për dëme të tilla të shkaktuara nga mjedisi.

### **Përgjegjësia penale**

Për herë të parë në Republikën e Kosovës mjedisit ju ka siguruar mbrojtje ligjore penal konform kornizave të Konventës ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet Ligjit penal.<sup>9</sup> Në kuadër të këtij ligji vendi ynë ka respektuar parimet dhe kërkesat e Konventës ndërkombëtare mbi mbrojtjen e mjedisit jetësor nëpërmjet Ligjit penal. Kjo konventë është miratuar nga Këshilli i Evropës në Strasburg 4 Nëntor të vitit 1998.<sup>10</sup> Në këtë mënyrë ky akt i rëndësishëm ndërkombëtar kishte për qëllim rritjen efikasitetit dhe cilësisë së planin e mbrojtjes së mjedisit në rajon dhe detyrën për t'i kualifikuar veprimet apo veprat e caktuara të subjekteve ndaj mjedisit si vepra të dënueshme kur ato të kenë shkaktuar dëme apo përçarje serioze në mjedis. Praktikisht këto zgjidhje kanë arritur që të krijojnë bazë efektive për mbrojtje penale – juridike unike për mjedisin brenda territorit Evropian dhe të unifikojnë përgjegjësitë bazë të subjekteve fizikë dhe juridikë për shkaktimin eventual të këtyre veprave penale.<sup>11</sup> Duhet pasur parasysh se konventa në fjalë rekomandon që në planin e mbrojtjes së mjedisit duhet nxjerrë edhe fuqizuar edhe aktet të tjera ligjore të cilat veprimet e dëmshme ndaj mjedisit, jashtë zonës penale (kundërvajtje administrative etj) që veprimet e këtilla, pavarësisht nga shkalla e rrezikshmërisë shoqërore, të janë të dënueshme dhe gjithsesi të rregulluara me legjislacionin adekuat.

Të gjitha vendet që kanë nënshkruar këtë Konventë kanë detyrim për të marrë masa dhe aktivitetet të caktuara. Këto aktivitete janë të karakterit të dyfishtë: nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në nivel kombëtar kjo konventë vënë themelet për të parashikuar sjelljet e caktuara, veprat penale dhe përshkrimin e sanksioneve penale për autorët e saj në legjislacionin penal. Në nivel ndërkombëtar reflekton angazhimet për përsosjen e rregullave për bashkëpunim ndërkombëtar – juridik midis shteteve kundër aktivitete kriminale që mund të kërcënojnë mjedisin në rajon më të gjerë.

Dispozitat e kësaj konvente në mënyrë specifike në nenin 2 e përcaktojnë objektin e mbrojtjes mjedisore. Objekte të këtilla konsiderohen: njerëzit ose vlera të caktuara të jetës njerëzore, integriteti fizik apo shëndetësor, ajri, uji, toka, monumente të mbrojtura, objekte tjera të mbrojtura, pronë, bimët dhe kafshët. Si forma të kërcënimeve për këto vlera të mbrojtura janë përcaktuar veprimet e veçanta (një veprim ose mosveprimet, dështimi) që janë të lidhura me substanca të caktuara të rrezatimit jonizues, mbeturinave të rrezikshme, aktivitete të rrezikshme,

---

<sup>9</sup> Këshilli i Evropës, Komisioni për Mjedisin, Planifikimin Rajonal dhe Autoritetet Lokale, Strasbourg, viti 1998

<sup>10</sup> Convention on the Protection of Environment through Criminal Law CETS No.: 172 për më shumë shih në <http://conventions.coe.int/treaty/Commun/QueVoulezVous.asp?NT=172&CL=ENG>

<sup>11</sup> Kodi Penal i Kosovës në Kapitullin XXIV, për shkak të rëndësisë që ka mjedisi, kafshët, bimët dhe objektet kulturore, në përputhje edhe me Konventën mbi mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal u ka siguruar mbrojtjen juridike – penale veprave të caktuara me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

materiale bërthamore dhe substancave të tjera të rrezikshme radioaktive që kërcënojnë mjedisin ose përbërësit e tij individuale. Këto aktivitete mund të jenë bërë qëllimisht ose nga pakujdesia. Në Evropë nga aspekti i të drejtës penale dhe harmonizimit të saj ne mbrojtjen e mjedisit është veçanërisht e rëndësishme të përcaktohet saktësisht mënyrat dhe format për t'u marrë me aktivitete të rrezikshme.

Kryerja e veprimeve të caktuara siç janë vepra penale që cenojnë, kufizojnë ose rrezikojnë mjedisin sipas dispozitave të kësaj Konvente për dënim penal janë vendosur nga veprimtaritë e mëposhtme:

- Shkarkimi, emetimi apo futja e një sasi e substancave ose rrezatim jonizues në ajër, ujë apo tokë,
- Posedimi i paligjshëm, trajtimin, magazinimin, transportin, eksportin, importin e mbeturinave të rrezikshme

Operimet ilegale bimore kryhen nga aktivitetet e rrezikshme të cilën shkaktojnë ngjarje të vdekjes ose të plagosjes të rëndë trupore ose të dëmtojë shëndetin e një personi duke krijuar një rrezik të rënda të dëmtimit të ndërtesave të mbrojtura ose monumenteve apo pronave të tjera apo të dëmtimit të cilësisë së ajrit, ujit, tokës e kafshëve ose bimëve. Përveç këtyre veprimeve dhe aktiviteteve të kualifikuara si kriminale nxisin ose të ndihmojnë në zbatimin e aktiviteteve që shkelin apo kërcënojnë mjedisin janë parashikuar dënohet adekuate. Kjo do të thotë qartë se dispozitat e konventës në fjalë parashikojnë përgjegjësitë për bashkëpunim në formën e nxitjes dhe përkrahjes së luftës parandaluese dhe represive kundër veprave penale të kësaj natyre. Për këto vepra dhe aktivitete të ndaluara e paligjshme të individëve dhe subjekteve ligjore, konventa parashikon për lloje të caktuara të masave dhe sanksioneve penale. Këto sanksione janë të ndryshme. Këto janë: Dënim me burgim dhe konfiskimi i pronës (në formën e pasurive, të ardhurave ose aseteve të tjera).

Përveç gjobave dhe detyrimeve që sanksionojnë një vepre penale për të ruajtur zhvillimin e qëndrueshëm dhe të balancuar mjedisor ne kuadër të legjislacionit sekondar ekzistojnë edhe masa tjera të karakterit ndëshkues. Kjo konventë nuk ka aplikim të drejtpërdrejtë në raste të veçanta të mjedisit. Dispozitat e saj do të zbatohen në jetën vetëm nëse vendet janë përcaktuar individualisht për këtë. Kjo nënkupton që anëtarët e Këshillit të Evropës apo të tjerët që në mënyrë unilaterale<sup>12</sup> e njohin dhe e zbatojnë këtë konventë kanë detyrimin që në legjislacionin e tyre kombëtar penal të përfshijnë sistemin e dënimeve duke i parashikuar ato sipas llojit të veçantë dhe sipas masës së dënimit konform konventës kornizë.

## **Përfundimi**

Është e qartë se e fundit të shekullit të kaluar kanë provokuar pozitivisht vetëdëdijën dhe perceptimi e njerëzve dhe qeverive për mbrojtjen e mjedisit si në

---

<sup>12</sup> Republika e Kosovës edhe pse nuk është anëtare e Këshillit të Evropës me Kushtetutën e vet ka marrë detyrim që për interesin e vendit t'i njoh dhe zbatojë të gjitha konventat e rëndësishme ndërkombëtare. Nisur nga ky parim i tërë legjislacioni nacional është në përputhje me konventat e rëndësishme ndërkombëtare siç është edhe rasti me konventat në fjalë.

nivel nacional ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Ky shqetësim po shihet edhe në programet shtetërore dhe mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm po konsiderohet çështjet me prioritet. Nuk ka dilemë që njerëzit kanë nevojë për ruajtjen, promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Megjithatë dëmi që iu ka shkaktuar mjedisit dhe rreziku i cili po i kanoset në vazhdimësi tani më për shkak të zhvillimit ekonomik nuk janë problem i kufizuar në territorin e një vendi. Andaj është logjike që komuniteti ndërkombëtar t'i analizojë këto rreziqe dhe të mobilizojë vendet për alarmin e rrezikun nga ndotjes e mjedisit në nivel global dhe nevojën për cilësinë e duhur dhe mbrojtje efikase. Këshilli i Evropës si një nga organizatat më të vjetra ndërkombëtar është i bashkuar për kodifikimin që përcaktojnë rregullat bazë të përgjegjësisë civile dhe penale për dëme të shkaktuara. Këto konventa kanë përcaktuar përgjegjësinë e personave fizik dhe juridik si dhe ngjarjet e dëmshme eventuale në mjedisin . Në kuadër të kësaj organizate ndërkombëtare në vitet e nëntëdhjetë të Shekullit XX janë nxjerrë dy konventat me qëllim të ngritjes të një sistemin të llogaridhënies, rregullave për përcaktimin e përgjegjësisë, përgjegjësitë e subjekteve dhe sistemin e sanksioneve me kushtin që detyrimet e vendeve anëtare për të integruar këto rregullore në legjislacionin e tyre kombëtar. Duke pasur parasysh se vendi ynë është në fazë e reformave thelbësore të sistemit politikë, social, ekonomik dhe ligjor në drejtim të harmonizimit të rregulloreve të brendshme me rregulloret apo ligjin e Bashkimit Evropian e një rëndësi të veçantë konsiderohet dhe shpejtësia me të cilën këto rregulla të mjedisit (ligji mjedisor) harmonizohen me ligjin Evropian. Prandaj, këto konventa paraqesin një kontribut në përpjekje për harmonizimin e shpejtë dhe efikas të sistemit tonë ligjor me ligjin evropian sidomos kur e kemi parasysh rrezikun mjedisor në vendin tonë.

### Referencat

1. Krasniqi A., E drejta në turizëm dhe hotelieri, Pejë 2004
2. Ligji i përkohshëm penal i Kosovës
3. Declaration of the United Nations Conference on the Human Environment, Stockholm from 5 to 16 June 1972, *për më shumë shi në* <http://www.unep.org/Documents.Multilingual/Default.asp?documentid=97&articleid=1503>
4. Convention on the Protection of Environment through Criminal Law CETS No.: 172 Place: Strasbourg, Date 4/11/1998, *për më shumë shih në* <http://conventions.coe.int/treaty/Commun/QueVoulezVous.asp?NT=172&CL=ENG>
5. Convention on Civil Liability for Damage Resulting from Activities Dangerous to the Environment Lugano, 21.VI.1993, *për më shumë shih ne* <http://conventions.coe.int/treaty/en/treaties/html/150.htm>
6. Rio Declaration on Environment and Development, Having met at Rio de Janeiro from 3 to 14 June 1992, *për shumë shih ne*

<http://www.unep.org/Documents.Multilingual/Default.asp?documentid=78&articleid=1163>

7. Rio De Janeiro Platform for action on the road to Johannesburg 2002.  
<http://www.eclac.org/dmaah/noticias/paginas/5/8435/platform1.pdf>
8. REPORT OF THE UNITED NATIONS CONFERENCE ON THE HUMAN ENVIRONMENT **Stockholm 1972**
9. Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr. 03/ L – 025
10. Ligji për vlerësimin strategjik Nr. 03/ L – 015
11. Ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes Ligji Nr. 03/L – 043
12. Ligji për mbeturina Ligji Nr. 02/ L – 30
13. Ligji për kimikate Nr. 02/ L – 116
14. Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 2004 / 30
15. Ligji për mbrojtjen e natyrës nr. Nr. 2004



## **MENAXHIMI I DREJTË I POLITIKAVE FISKALE - ÇELËS I SUKSESIT EKONOMIK**

*Dr. Artan Nimani, ass.  
artannimani@gmail.com*

### **Abstrakti**

Objekti, kuptimi, rëndësia dhe përkufizimi i tatimeve dhe veçmas i tatimit në vlerën e shtuar në teorinë dhe praktikën tatimore si dhe domosdoshmëria e shkallëzimit të saj është synim im në këtë punim. Nisur nga fakti se sistemi tatimor nuk zhvillohet në kushte të njëjta në të gjitha vendet, atëherë në këtë punim do të shtjellohen elemente të veçanta të shteteve në BE dhe do të behët krahasimi i tyre me Kosovën, duke i kushtuar rëndësi të veçantë shkallës tatimore dhe vet TVSH që nga momenti i aplikimit të saj dhe deri të nevojja imediate për shkallëzim. Arsyeja ynë kryesore për t'iu qasur kësaj problematike është se tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSh) është risia e katër dekadave të fundit në sistemin tatimor të shumë shteteve të zhvilluar dhe atyre në zhvillim. Kosova është një ndër shtetet me të reja që e aplikon një sistem të moderuar tatimor duke u bazuar në modele të sistemeve më të avancuara botërore dhe kjo siguron që është duke ecur drejt sistemit në radhët e sistemeve tatimore të BE-së. Rëndësia dhe roli që kanë të hyrat publike në zhvillimin ekonomik të çdo shteti është edhe shkaku kryesor për njohjen e problematikës të sistemit të hyrave dhe funksionimin e organeve shtetërore krahas grumbullimit të këtyre të hyrave. Kjo problematikë është njëra ndër vështirësitë më të mëdha që paraqiten në shumë shtete si për obliguesit tatimor ashtu edhe për organet që i administrojnë të hyrat, këto vështirësi theksohen sidomos në shtetet që janë në zhvillim siç është rasti i Kosovës.

**Fjalë kyç:** TVSH, Taksa, Politika fiskale, evazioni, BE

**JEL klasifikimi:** G,G1,G18.

### **Hyrje**

Menaxhimi i Politikave fiskale - çelës i suksesit ekonomik, kjo ishte fjalja e parë që më asocoj në momentin e fillimit të këtij punim sepse të gjitha analizat me shpinin në këtë përfundim.

Shpesh herë politikat fiskale janë ato që e ngritin një “perandori” dhe zhdukin pastaj si pasojë e gabimeve të vogla brenda sistemit të madh që ne po e quajmë Politik fiskale. Menaxhim i drejtë i tyre është obligim qytetar dhe kombëtar i secilit që në duar ka paratë e popullit, që i a ka besuar për të qeverisur. Sot kur bota kryesisht është e orientuar në ekonominë e hapur të tregut edhe financat publike duhet të operojnë në këtë vijë perderisa menaxhimi i tyre e përcakton ardhmërinë e atij vendi.

Në kushtet e ekonomisë së hapur ndaj rrjedhave të kapitalit, menaxhmenti i politikës fiskale bëhet më i vështirë. Vendet që i nënshtrohen procesit të globalizimit ballafaqohen me pasiguri të shumta që lidhen me madhësinë, shpejtësinë dhe kohen e mundshme të rrjedhave të kapitalit. Masa e efekteve negative në rrjedhat ekonomike të vendit varet nga madhësia e ekonomisë dhe roli që u është dhënë instrumenteve të politikave makroekonomike për kontrollimin e kapitalit<sup>13</sup>.

Komponentët e politikës fiskale, taksat dhe programet e shpenzimeve publike, u shërbejnë qëllimeve të rëndësishme ekonomike dhe shoqërore të cilat mund të vihen në rrezik po qe se janë të nevojshme përshtatjet kuantitativisht të gjera për afate të shkurtra. Me disa variabla fiskale është vështirë të manipulohet në mënyrë fleksibile për periudha afatshkurtra, meqë kjo mund të rezultojë me kosto të lartë të transaksionit dhe krijon shtrembërime në alokacionin dhe rishpërndarjen e resurseve.

Nëse vlerësimet shpijnë në përfundim se reagimi fiskal është i pashmangshëm, atëherë duhet vënë në përdorim komponentët e politikës fiskale të cilat mendohen të jenë më fleksibile, më efektive, dhe krijojnë më pak shtrembërime se të tjerat. Në këto kushte, rëndësi të veçantë ka identifikimi dhe ndarja e funksioneve bërthamore në strukturën fiskale, proces i cili vështirësohet nga fakti i definimit të kësaj “bërthame”<sup>14</sup>.

Në vazhdim do të paraqesim TVSH si kampionin politikës fiskale dhe të gjitha përparësitë, mangësitë dhe efektet që reflekton ky lloj tatimi në efikasitetin dhe menaxhimin real dhe efikas të një koncepti transparent dhe mirësiillshëm për qytetarin

E kjo na shpie në drejtimin e hapjes ndaj rrjedhave të kapitalit që kushtëzohet paraprakisht me ndërtimin e një disipline të brendshme për drejtimin e politikës fiskale, disiplinë kjo që sigurohet me vënien e rregullave të cilat mbështeten në principet e politikës fiskale e që konsistonte me rregullat e ndërtuara për menaxhim të një politike të matur fiskale.

### **Tatimi dhe historiku i tij**

*“Ekziston një lidhje natyrale ndërmjet të mirës së përbashkët nga njëra anë dhe strukturës e funksionimit të autoritetit publik në anën tjetër. Rregulli moral, i cili ka nevojë për autoritetin publik për të promovuar të mirën e përbashkët në shoqërinë njerëzore, kërkon gjithashtu që autoriteti të jetë efektiv në sigurimin e rezultatit” Papa Johan XIII*

Që në kohët e hershme, në kohën kur organizimin shoqëror ishte i paorganizuar, njerëzimi jetonte në fise dhe shumica e fiseve jetonin pa mbikëqyrje të ndonjë sundimtari apo mbreti u paraqit nevoja e organizimit dhe e mbrojtjes së

---

<sup>13</sup> Florije Govori, 2005. “Menaxhmenti i politikës fiskale në ekonomitë e hapura,” Finance 0505019, EconWPA.

<sup>14</sup> Po aty



banorëve dhe pasurive të tyre, pra u paraqit nevoja e krijimit të shtetit dhe qeverisë së tyre<sup>15</sup>.

Që nga viti 1030 para Krishti, kur fiset Izraeli jetonin pa qeveri, Bibla tregon se si njerëzit i kërkuar profetit Samuel që të “na bëjë një mbret që të na gjykojë si të gjitha kombet”. *Samueli u përpoq të ua kthente mendjen Izraelitëve duke u treguar se si ishte jeta në një monarki, ku ai përmendi se si Mbreti do të marrë, djemtë për shërbim dhe luftë, vajzat për punë në kuzhina dhe furrat e bukës së tij, fushat, ullishtat dhe të dhjetat e kopeve dhe do të vijë dita që ju do të qani për shkak të mbretit tuaj, të cilin ju vetë e zgjodhët, përfundon citati i Samuelit*<sup>16</sup>. Fragmenti nga Bibla ilustron nevojën e vjetër mbi qeverinë me funksion të dyfishtë. Qeveria është një domosdoshmëri – në fund të fundit “ të gjitha kombet e kanë atë-por në të njëjtën kohë ekzistenca e saj ka aspekte të padëshirueshme. Këto ndjenja të kundërta mbi qeverinë janë të lidhura pazgjidhshmërisht me aktivitetin e saj mbi mënyrën e të tatuarit dhe atë të shpenzimeve.

Tatimet kanë një histori të lashtë që nga koha e Egjiptit të Lashtë. Faraonet me anë të skribeve siç i quanin ata targambledhësit kishin vendosur një taksë mbi vaj gatimi. Në kohë lufte athinasit kishin vendosur një taksë të referuara si eisphora. Askush nuk ishte i përjashtuar nga taksa e cila ishte përdorur për të paguar për shpenzime të veçanta të kohës së luftës.

Kur burimet e tjera janë fituar nga përpjekjet e luftës burimet janë përdorur për rimbursim tatimor. Athinasit vendosën një taksë mujore sondazh mbi të huajt, njerëzit të cilët nuk kanë si një Nënë athinas dhe Atit, nga një dhrahmi për burrat dhe një gjysmë dhrahmi për gratë.

### **Tatimi mbi Vlerën e Shtuar – TVSH**

Tatimi mbi vlerën e shtuar apo TVSH-ja është një tatim mbi konsumin. TVSh e vërtetë gërthen një rang të lirimeve (përfashtimeve) dhe diçka të ngjashme që do të minonte produktivitetin e të hyrave nga tatimi

Është e vërtetë që TVSh krijon shpenzime substanciale në inkasim por mbetet shumë e suksesshme në të gjitha vendet ku aplikohet, dhe është një pajtim i përgjithshëm se shpenzimet e vjeljes janë me të ulëta në vende ku TVSh është e thjeshtë me një shkallë të vetme dhe prag të lartë.

Praktikat e vendeve të zhvilluara tregojnë se TVSh kushton me pak se tatimet në të ardhura, por vihet në dilemë fakti se a kushton me pak se format tjera të tatimit në shitje dhe në veçanti sesa tatimet që i ka zëvendësuar dhe për këtë çështje është bërë një krahasim për gjashtë vendet Frankofone dhe gjashtë vendet Anglofone të Afrikës dhe bëhet e qartë se paraardhësit e TVSh-së ishin shumë larg asaj që të mblidhen lehtë.

Duhet përmendur suksesin e dallueshëm të tatimit, me shembullin se vetëm pese vende kanë hequr ndonjëherë TVSh-në ekzistuese.

---

<sup>15</sup> Menaxhimi i Financave Publike, Artan Nimani/ ISRN/ Prishtinë 2007

<sup>16</sup> Financa Publike ( Public Finance) Harvey S. Rosen, Department of Economics Princeton University

Natyrisht rezultatet e funksionimit do të reflektojnë në faktin se ato janë të bazuara në TVSh-në që është implementuar në praktikë sesa ndonjë TVSh ideale. TVSh e vërtetë ngërthen një rang të lirimeve (përrjashtimeve) dhe diçka të ngjashme që do të minonte produktivitetin e të hyrave nga tatimi.

### **TVSH armiku i Ekonomisë se Zezë**

Po, është e vërtetë! TVSH-ja është e thjeshtë, me kosto të lirë për t'u mbledhur, pasi nuk ka kompleksitet në funksionimin e saj. Ajo e paraqet strukturën e çmimit me një transparencë të lartë, gjë që inkurajon efektivitetin ekonomik.

Vlera e Shtuar në vetvete nuk është tjetër veçse shuma e gjithë pagave, interesave të paguara për kapitalin e vënë në punë, qiratë e ndryshme të paguara për pronën e shfrytëzuar, si dhe fitimi që rezulton nga aktiviteti. Të katër këto elemente, të shpërndara në mënyrë jouniforme te tatimpaguesit, përbëjnë atë që quhet Vlerë e Shtuar. Informacioni prej shumë administratave ka treguar se ky lloj tatimi garanton më shumë të ardhura tatimore në buxhetin e shtetit dhe ndikon më pak në zinxhirin e aktiviteteve ekonomike.

### **Karakteristikat dhe elementet e TVSh-së**

Karakteristikat kryesore të TVSh-së janë :

- TVSh-ja është futur në pajtueshmëri me llogaritjen e tatimit në të gjitha fazat e qarkullimit sipas metodës së zbritjes, kështu që tatimi i llogaritur paguhet në çdo fazë të ciklit çarkullues d.m.th çdoherë që të mirat ose shërbimi kalojnë prej një faze në fazën tjetër të qarkullimit paguhet vetëm tatimi mbi shumën e vlerës së shtuar në fazën e fundit.
- Obliguesi tatimor i TVSh-së e cakton obligimin për pagesën e tatimit duke e zvogëluar obligimin tatimor për shumën e tatimit të llogaritur mbi vlerën e shtuar gjatë furnizimit të prodhimeve dhe të shërbimeve ose gjatë importimit të mirave domethënë se TVSh-ja bazohet në mekanizmin e faturave tatimore dhe kjo i lejon biznesit që ta zbresin TVSh-në e paguar në blerje.
- TVSh-ja hyn në tatimet në të cilat është shumë e vështirë mundësia e evazionit fiskal.
- TVSh-ja nuk favorizon përqendrimin vertikal midis ndërmarrjeve, d.m.th konsumi final te TVSh-ja gjithmonë është i ngarkuar njësoj pa marre parasysh se në sa faza të qarkullimit ka kaluar prodhimi ose shërbimi.
- Mekanizmi i faturës tatimore inkurajon blerësit për të kërkuar faturë nga shitësi, duke parandaluar mos raportimin ose raportimin e ulët të shitjeve. Kjo siguron një sistem me efektiv dhe vetëm mbikëqyrës si dhe një raportim me të mirë të regjistrimeve kontabël për verifikim.

- Karakteristike tjetër është se numri i normave tatimore është i vogël dhe me shkallë normale tatimore.<sup>17</sup>

Ekzistojnë shumë elemente të tatimit mbi vlerën e shtuar, por kryesore janë këto: Objekti tatimor; Obliguesi tatimor ;Vendi i te tatuarit ; Baza tatimore; Normat tatimore dhe Përjashtimet tatimore

### **Rezultatet e aplikimit të TVSH-së**

Analizat ekonometrike të kësaj çështjeje çojnë në disa rezultate :

- Ka evidence se prania e TVSh-së është shoqëruar me një përpjesëtim të lartë të të hyrave të përgjithshme të shtetit dhe grandeve në PPV (GDP), megjithatë efekti pozitiv i të hyrave është i shoqëruar me praninë e TVSh-së.
- Rezultatet e TVSh – janë po ashtu të lidhura ngushtë edhe me atë sesi funksionon ky tatim , cilët janë faktorët qysh nga kushtet e dizajnit të tatimit p. sh. definicioni preciz i bazës tatimore, shkalla standarde tatimore është një ndikim i madh në të hyra sepse çdo 1% rritje në shkallen standarde ngrit raportin e të hyrave të TVSh-së me konsumin privat në rreth 0, 6% në mesatare.<sup>18</sup>
- Rëndësia e tregtisë në një ekonomi po ashtu ka një shoqërim të madh pozitiv në rendimentin e TVSh-së, sa me e rëndësishme të jetë tregtia aq me tepër të hyra mund të mblidhen nga TVSh ekzistuese.
- Moshja e TVSh-së ka një efekt të madh pozitiv, atributet të konstruktit të TVSh-së përmirësohen me kohën.
- Arsimi po ashtu ka një shoqërim të fuqishëm pozitiv në rendimentet e TVSh- së.
- Shpesh është debatuar se TVSh është një tatim kompleks dhe kushton që të përmbushet dhe administrohet dhe si rrjedhojë nuk ka qene i përshtatshëm në vendet në zhvillim ose me nivele të ulëta të zhvillimit.

### **Tatimi mbi vlerën e shtuar në Kosovë**

Tatimi mbi vlerën e shtuar apo TVSH-ja është një tatim mbi konsumin. Zbatohet në mallrat dhe shërbimet të kryera nga personi i tatueshëm në Kosovë dhe në importet dhe hyrjet nga ish-RFJ-ja.

Shkalla tatimore (përqindja) normale e TVSH-së është caktuar 16% (deri me 1 janar të 2009 ishte (15%) e vlerës së mallrave dhe shërbimeve të furnizuara dhe të sjella në Kosovë.

Po ashtu ekziston TVSH-ja me 0% në eksportet, Daljet drejt ish-RFJ-së dhe transportin ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve<sup>19</sup>.

---

<sup>17</sup> Vladimir Sliejepeceviq, prof. – PDV prirucnik za svakoga, Dival, Zagreb, 1997,fq, 35

<sup>18</sup> Desai, M. A & J. R. Hines, VAT and Internacional trade, The Evidence 2002, fq, 88

<sup>19</sup> [www.mfe-ks.org/old/Shqip/.../atatimore/.../lltatimeve/.../dorativsh.pdf](http://www.mfe-ks.org/old/Shqip/.../atatimore/.../lltatimeve/.../dorativsh.pdf)

## **Funksioni i TVSH-së**

Një pohim unik i bërë nga përkrahësit e TVSh-së është se ky tatim është një formë veçanërisht e suksesshme e tatimit. Për t'iu bindur këtij pohimi janë ofruar analiza të mjaftueshme dhe shpjegime për rezultatet e të hyrave të vendeve që aplikojnë TVSh dhe vendeve që nuk e aplikojnë TVSh?

Te ne në Kosovë Ju do të paguani 16% TVSH- në të gjitha blerjet tuaja të mallrave dhe shërbimeve nga furnizuesit e regjistruar. Ju po ashtu do të paguani 16% TVSH-në në të gjitha importet tuaja dhe hyrjet nga RFJ-ja .Si person i regjistruar i TVSH-së , i cili kërkohet të deklarojë, ju duhet të arkëtoni 16% TVSH nga konsumatorët tuaj në furnizimin e shumicës së mallrave dhe shërbimeve.

Këto quhen fuqizime të tatueshme. Eksportet dhe daljet nëpërmjet ish-RFJ-së janë, po ashtu furnizime të tatueshme , por tatimi mbi vlerën e shtuar në eksportet dhe daljet drejt RFJ-së është 0% dhe si pasojë shuma e tatimit në eksportet dhe daljet drejt RFJ-së do të jenë zero.

Në fund të çdo muaji ju do të plotësoni deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar. Deklarata i ka dy blloqe kryesore, njëra quhet tatimi i llogaritur dhe tjetra quhet **tatimi i zbritshëm**.

Ju nuk do të lejoheni të zbrisni TVSH-në e paguar në mallrat dhe shërbimet e marra për përdorim personal. Ju do të lejoheni të zbrisni tatimin e zbritshëm në mallra dhe shërbime të shfrytëzuara për qëllime biznesi. Furnizimet për biznese përfshijnë mallrat , sikurse janë makineria, mobiljet, ndërtesat apo shërbimet sikurse janë sigurimi, ndërtimi, pastrimi, kontabiliteti, ruajtja (mbrojtja)<sup>20</sup>.

Nëse shuma e kombinuar e importeve, hyrjeve nga ish-RFJ dhe blerjeve në Kosovë të mallrave dhe shërbimeve është më e lartë se shuma e shitjeve, ju mund të jeni në pozitë të tatimit të paguar tepër (pozitë kreditore) dhe të lejoheni për rimbursim sepse, në atë rast, tatimi i paguar do të jetë më i lartë se tatimi i arkëtuar. Ju poshtu mund të lejoheni për rimbursim nëse keni eksporte apo dalje drejt RFJ-së ku shkalla e TVSH-së në këto raste është zero por ju lejoheni të kreditoni tatimin e paguar në blerjet, importet dhe hyrjet nga RFJ-ja

## **Subjektet e TVSh-së**

Subjektet e TVSh-së janë :

- Importuesit dhe Eksportuesit
- Hyrjet nga ish-RFJ-së dhe daljet në ish-RFJ-së
- Bizneset me qarkullim mbi 50.000 € (Deklaruesit e TVSh-së)
- Deklaruesit Vullnetar të TVSh-së.

## **Regjistrimi për TVSh**

---

<sup>20</sup> [www.mfe-ks.org/old/Shqip/.../atatimore/files/.../Artikulli\\_Nr\\_9.doc](http://www.mfe-ks.org/old/Shqip/.../atatimore/files/.../Artikulli_Nr_9.doc) Departamenti për Ndihmë dhe Edukim të Tatimpaguesve

Në qoftë se jeni importues a eksportues apo kryeni import, eksport gjatë kryerjes së një aktiviteti ekonomik, nga ju kërkohet të regjistroheni për TVSh-në në Administratën Tatimore, si dhe të pajiseni me certifikatën e TVSh-së pa marrë parasysh qarkullimin tuaj vjetor. Nëse qarkullimi vjetor i biznesit tuaj është më i lartë se 50.000€ nga ju kërkohet gjithashtu të regjistroheni si deklarues i TVSh-së.

### ***Qarkullim për qëllime të regjistrimit për TVSh-së***

Me “Qarkullim” nënkuptohet të hyrat bruto të të gjitha furnizimeve (shitjeve) të kryera nga një person në Kosovë duke përfshirë furnizimet e tatueshme në përqindjen normale tatimore 15%, furnizimet e tatueshme me përqindje tatimore 0%, dhe furnizimet e përjashtuara. Qarkullimi që do të llogaritet për qëllime të regjistrimit do të jetë qarkullimi brenda vitit kalendarik.

### ***Tatimi i llogaritur***

Tatimi i llogaritur është TVSh-ja që duhet ta aplikoni e mblidhni nga klientët tuaj në furnizimet tuaja të tatueshme të mallrave dhe shërbimeve.

### ***Tatimi i Zbritshëm***

Tatimi i Zbritshëm është shuma e TVSh-së së paguar në blerjet tuaja të mallrave dhe shërbimeve, si dhe importet që do të shfrytëzohen për aktivitete të tatueshme.

### ***TVSh-ja e pagueshme***

Ndryshimi pozitiv në mes të tatimit të zbritshëm përbën TVSh-në e pagueshme.

### ***Regjistrimi për TVSh dhe pagesat***

Pasi të jeni regjistruar person i tatueshëm Deklarues i TVSh-së dhe pasi të keni marrë numrin Regjistruar të TVSh-së ju duhet të aplikoni (mblidhni) TVSh-në në shitjet e tatueshme vendore të mallrave dhe shërbimeve. Çdo herë që të kryeni ndonjë furnizim (shitje) qoftë e tatueshme apo e përjashtuar, ju duhet të lëshoni faturë tatimore dhe ta regjistroni atë në librin e shitjes. Në anën tjetër ju lejohet për kreditim të tatimit të zbritshëm vetëm nëse keni marrë faturën tatimore nga furnizuesi juaj apo nëse i keni dokumentet e importit që në mënyrë të qartë tregojnë shumën e TVSh-së së paguar në blerjet tuaja. Deklarata e TVSh-së duhet dorëzuar deri në ditën e fundit të muajit që pason periudhën tatimore. Kjo deklarata dorëzohet në llogarinë e caktuar nga Administrata Tatimore në një bankë të licencuar nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës së bashku me pagesën e TVSh-së.

### ***Kërkesa për regjistrimin e TVSh-së***

Për tu regjistruar për TVSh-në, ju duhet të vizitoni Zyrat Tatimore Regjionale dhe Lokalet e Administratës Tatimore të Kosovës në vendndodhjen tuaj ku do të merrni një formular aplikacioni. Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, Administrata Tatimore do t'ua jap një numër të Regjistrimit të TVSh-së dhe një certifikatë regjistrimi si dhe Rregullore dhe Udhëzime që kanë të bëjnë me TVSh-në.

### **Baza ligjore për aplikim e TVSH**

Politika tatimore në Kosovë është e orientuar drejt rregulloreve të thjeshta dhe të qarta me aspak ose pak përjashtime, të cilat sigurojnë një bazë të gjerë tatimore dhe parandalojnë evazionin tatimor.

Tatimi kryesor në Kosovë është TVSH-ja e cila është 16% për të gjitha mallrat, pa marrë parasysh origjinën e tyre dhe 0% për mallrat të cilat i dedikohen eksportit.

TVSH paguajnë ndërmarrjet të cilat kanë qarkullim vjetor mbi 50.000€ euro; ose kanë aset prej 50.000 €uro;.

Tendencat e Qeverisë së Kosovës janë që TVSH të aplikohet edhe për ndërmarrjet që kanë shkallë më të ulët të qarkullimit vjetor.

Për pajimet e importuara grace periudha (mundësia e pagesës) për pagesën e TVSH-së është 6 muaj. Është në përputhje me instruksionet e FMN, Direktivës së 6 te BE me të cilën rregullohet TVSH-ja ne UE. TVSH-ja ne Kosove aplikohet qe nga 1 korriku i vitit 2001. Për importet TVSH-ja mblidhet në kufijtë administrativë të Kosovës.

Brenda vendit TVSH-ja aplikohet për çdo furnizim të mallërave dhe shërbimeve, me përjashtim të atyre të cilat në bazë të ligjit konsiderohen si furnizime te përjashtuara. TVSH nuk aplikohet gjatë importimit të prodhimeve farmaceutike, instrumenteve kirurgjike dhe aparaturat mjekësore si dhe mallrat për qëllime humanitare. (Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/11 datë 31 maj, 2001, dhe Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/17 datë 01 gusht Ndryshimet në Ligjin e tatimit mbi Vlerën e Shtuar)

Më 31/05/2001 nxirret edhe Udhëzimin Administrativ për implementimin e rregullores 2001/11, më këtë udhëzim sqarohen në mënyrë të zgjeruar, aplikimi i TVSH-s si nga ana e biznesit ashtu edhe për Administratën tatimore. Në këtë udhëzim paraqitet ana praktike të ilustruar me tabela dhe udhëzime për mbushjen e këtyre tabelave, për të gjitha rastet e mundshme. Për më tepër shiko në udhëzimin administrativ Nr. 2001/01

Më 1 Gusht 2002, bëhet rishikimi i Rregullores 2001/11 dhe nxirret rregullorja e re mbi TVSH-ë, (Për më tepër shiko Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/17 mbi ndryshimin e tatimit të vlerë së shtuar)

Më 1/09/2004 nxirret edhe Udhëzimin Administrativ për implementimin e rregullores 2002/17, më këtë udhëzim sqarohen në mënyrë të zgjeruar, aplikimin e

TVSH- si nga ana e biznesit ashtu edhe për Administratën tatimore. Në këtë udhëzim paraqitet ana praktike të ilustruar me tabela dhe udhëzime për mbushjen e këtyre tabelave, për të gjitha rastet e mundshme. (për më tepër shiko në udhëzimin administrativ Nr. 2001/04Më 25 Gusht 2004 dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/35)

Më 8 Gushtë 2005 bëhet ndryshimi I Rregullores 2001/11, nenin 13.2 b shlyhet, që i dedikohet organizatave joqeveritare mbi të drejtën e kthimit të TVSH-së ku me këtë rregullore i merret kjo e drejtë. (shiko Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/40)

Aktualisht baza legale e menaxhimit dhe e administrimit të TVSH është e mbështetur në Ligji Nr. 03/L-114, Datë 18.12.2008 - PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR e miratuar nga Kuvendi i republikës së Kosovës.

### **Shkallët tatimore dhe lirimet**

Standard i njohur po thuaj se në të gjitha vendet e botës është që TVSh të ketë një shkallë (përveç shkallës zero vetëm për eksporte) por praktika tregon që sa me e vjetër që është TVSh-ja aq më shumë shkallë ka, dhe duke u varur nga vjetërsia numri i shkallëve është me i madh në Evropë.

TVSh është e dizajnuar të tatojë konsumin andaj lind pyetja pse një dëshire aq e fuqishme të tatohen komponentë të ndryshme të konsumit në shkallë të ndryshme e sidomos është e arsyeshëm që disa mallra jo elementare të tatohen në shkallë me të larta. Duke pasur parasysh rrethanat administrative në shumë vende të botës disa artikuj jo të domosdoshëm i nënshtrohen tatimeve më të larta si (alkooli, gazolina, prodhimet e duhanit).

Gjithashtu është e dëshirueshme që të tatohen me shumë ato mallra që llogariten si pjesë më e madhe e shpenzimeve për anëtarët me gjendje më të mirë në shoqëri. Ndryshe nga gjendja e vendeve të zhvilluara shumë vende në zhvillim nuk kanë të hyra të konsiderueshme nga tatimet në të ardhura që funksionojnë mirë si dhe program të shpenzimeve për të harmonizuar synimin e objektivave të barazisë në shoqëri p.sh edhe nëse popullata me standard të ultë në shoqëri harxhon proporcion me të madh të të ardhurave të tyre në disa artikuj të veçantë (ushqim) popullata me standard më të lartë zakonisht harxhon shuma më të mëdha absolute, kështu një ulje në shkallën tatimore në atë artikull në të vërtetë transferon më tepër para te të pasurit sesa te të varfërit. Shtrohet pyetja për politikën tatimore në shumë vende në zhvillim se a është politikë më e mirë që të shkallëzohet tatimimi i të mirave apo që të aplikohet vetëm një shkallë e TVSh-së.<sup>21</sup>

Duke pasur parasysh se shkallëzimi TVSh-së krijon shpenzime për administrim dhe përmbushje shumica e vendeve të Botës aplikojnë një shkallë tatimore përveç shkallës zero (duke përfshirë edhe Kosovën) pjesa tjetër dy shkallë ndërsa një numër shumë më i vogël tri e më shumë shkallë.

Të gjitha vendet që aplikojnë TVSh-në janë të kujdesshme që të konstruktojnë lirime të kufizuara vetëm në disa fusha si shëndetësia, arsimi,

---

<sup>21</sup> International Bureau of Fiscal Documentation (IBFD), Rome 2004, fq, 14 – 15.

shërbimet financiare por dokumentimi sistematik në fushë pothuajse në të gjitha vendet është i vështirë, shumëfishimi i lirimeve në TVSh në praktikë gjithnjë e më shumë është një brengë e përbashkët.

Lirimet në një mënyrë e shkelin logjiken e TVSh-së duke qenë në mes të vënies së shkallës pozitive të TVSh-së në mënyrë të zakonshme (duke tatuar shitjet dhe duke kredituar tatimin e zbritshëm) dhe shkallës zero (duke hequr krejt TVSh nga përfshirja në çmimin e produktit duke kredituar tatimin e zbritshëm, duke mos tatuar shitjet). Si rezultat, lirimet:

- 1) mund të paraqesin shkallëzimet të shoqëruara me shtrebbërime në prodhim - kur një mall i liruar ka hyrë si blerje në një mall tjetër TVSh-ja e përfshirë në mallin e liruar me herët në zinxhirin e prodhimit nuk mund të kërkohet si kreditim ;
- 2) bëjnë kompromis në parimin e destinacionit për artikujt e tregtuar ndërkombëtarisht – nëse një exportues porosit mallra të liruara në blerje exportet e atij exportuesi me shkallë zero do të përfshijnë TVSh-në qysh herët në zinxhirin e prodhimit ;
- 3) mund të krijojnë një avantazh konkurrues për importet mbi artikujt e liruar të prodhimit brenda vendit (meqë shkalla zero jashtë nënkupton se tatimi i zbritur është mbuluar në fillim) ;
- 4) në rastin e tregtarëve të liruar, krijon lehtësime për shmangien e detyrimit përmes integritit vertikal dhe në disa vende të zhvilluara ekziston një planifikim tatimor më agresiv dhe ;
- 5) nxit një dinamike përmes se cilës lirimet ushqejnë çdo rezultat tjetër që del nga lirimet - kur një sektor të marrë një lirim, ka një lehtësim të ndikojë që lirimet t'u jepen atyre nga të cilët i blejnë inputet ( ashtu që të mbulojnë - paguajnë, TVSh- në e paguar në fazat e hershme të prodhimit)

Realisht, lirimet mund të paraqesin probleme dhe duhet të zbatohen disa rregulla për administrim:

a) caktimi i rregullave për inputet e tatuara janë të nevojshme për tregtarët që shesin si outputet e tatuara ashtu edhe ato të liruara, dhe

b) probleme të tjera dalin nga dëftesa dhe skemat e tjera që përdoren për të liruar (nga tatimi) projektet e asistencës financiare nga jashtë.

Duke analizuar këto vështirësi, pakësimi i lirimeve me gjasë do të jetë temë e shpeshtë në reformën e TVSh-së gjatë viteve në vijim. Po ashtu në frontin intelektual është mësuar shumë rreth alternativave praktike të lirimet në lidhje me sektorin publik dhe shërbimet financiare. Kështu që është nxitur vëmendje për këto shërbime në të gjitha vendet që aplikohet TVSh-ja . Në vitet e fundit Zelanda e Re ka adoptuar një shkallë zero për furnizimet nga ofruesit e shërbimeve financiare ku konsumatori është person i tatueshëm me se paku 75 % e shitjeve të tyre janë të tatueshme.<sup>22</sup>

### **TVSH në vende të ndryshme dhe në Republikën e Kosovës**

---

<sup>22</sup> Konferenca e ITD-se mbi TVSh-në, Rome, Mars 2005,fq ,16 - 17



Vende të ndryshme në botë kanë shkallë të ndryshme dhe norma të ndryshme tatimore dhe atë secili vend në mënyre të pavarur duke ju përshtatur kushteve të tyre ekonomiko-sociale e përcakton kufiri dhe format e mbledhjes së takimeve përfshirë edhe TVSH-në.

Sot në Botë numërohen 140 shtete që e aplikojnë TVSH-në dhe si i tillë bëjnë që ky lloj tatimi të jetë tatimi më i popullarizuar në Botë.

Vlen të ceket se si tatim është shumë i ri dhe i takon dekadave të fundit dhe atë si vijon:

|                    |            |
|--------------------|------------|
| Deri në vitet 1970 | 28 shtete  |
| Deri në vitet 1980 | 48 shtete  |
| Deri në vitet 1990 | 100 shtete |
| Sot (mbi)          | 140 shtete |


Të gjitha vendet e zhvilluara dhe posaçërisht ato të BE së e shfrytëzojnë TVSH-në si tatimin kyç për mbushej e arkës shtetërore

Edhe shtete e rajonit tonë pra të Ballkanit e aplikojë TVSH si tatimin dhe atë duke filluar nga vitet e 90-ta.

| Shteti    | Viti i aplikimit të TVSH-se |
|-----------|-----------------------------|
| Shqipëria | 1995                        |
| Sllovenia | 1999                        |
| Kroacia   | 1998                        |
| Maqedonia | 2000                        |
| Kosova    | 2001                        |

Sot, pra vende të ndryshme aplikojnë norma të ndryshme dhe përqindje të ndryshëm, po ashtu po paraqesim disa vende dhe përqindjet e tyre të TVSH-së

| Nr | Shteti           | TVSH ne % |
|----|------------------|-----------|
| 1  | Kosova           | 16        |
| 2  | Bullgaria        | 20        |
| 3  | Danimarka        | 25        |
| 4  | Gjermani         | 19        |
| 5  | Finlandë         | 25        |
| 6  | Franca           | 19,6      |
| 7  | BM               | 17,5      |
| 8  | Italia           | 20        |
| 9  | Austria          | 20        |
| 10 | Suedia           | 25        |
| 11 | Mali I Zi        | 17        |
| 12 | IRJ e Maqedonisë | 18        |
| 13 | Shqipëria        | 20        |
| 14 | Kroacia          | 23        |
| 15 | Çeki             | 22        |
| 16 | Spanja           | 16        |
| 17 | Sllovakia        | 20        |
| 18 | Luksemburgu      | 15        |
| 19 | Malta            | 15        |
| 20 | Polonia          | 22        |
| 21 | Letonia          | 18        |



### **Krahasimi i shkallës së TVSH-së me vendet e tjera**

Nëse e shohim tabelën lart atëherë mund të konstatojmë se Republika e Kosovës është një ndër vendet me shkallë më të ultë të TVSH përveç Luksemburgut që e ka 15 %.

Të gjitha vendet e rajonit e siç shihet më lartë në tabele dhe në paraqitjen grafike TVSH është me e lartë se në Kosove. Në Shqipëri vlera e TVSH –se është 20 % për mallra dhe shërbime.

Republika e Shqipërisë ka kategorizim të tatimeve që e bën me atraktiv tatimin pasi që disa lëmenj janë të përjashtuar kurse shumë produkte specifike kanë një tatim shtese

Pos rajonit po e krahasojmë edhe me Gjermaninë ku Vlera e shtuar e taksave në Gjermani është e vënë në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve në vend. Gjitha subjektet e biznesit janë subjekt i pagesës së tatimit mbi kryerjen e proceseve të prodhimit në Gjermani. Norma aktuale e TVSH-së në Gjermani është 19%, në fuqi nga 1 janari 2007. Në Gjermani, një taksë të reduktuar prej 7% është mbledhur nga shitja e sendeve të veçanta të tilla si ushqime, revistat dhe librat.

Norma e TVSH-së është vendosur në bazë të parametrave të sistemit të Bashkimit Evropian. Vendet e Bashkimit evropian e kanë të rregulluar se cilat produkte të listuara janë të përjashtuara nga TVSH-ja. Ndërmarrjet e biznesit duhet të paraqesin raportet e taksimit mujor dhe janë të detyruar të paguajnë taksat në bazë mujore, tremujore apo vjetore. Raportet gjithashtu përbëhen nga llogaritjen e taksave për tremujorin. Periudha e pagesave të taksave është i varur nga qarkullimi vjetor i kompanisë. Shuma për taksa paguhet paraprakisht në zyrën e taksave. Shumica e prodhuesve kanë shkallë të madhe janë të detyruar të dorëzojnë deklaratat e tyre mbi një bazë mujore.

### **Përfundime**

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar si tatim indirekt edhe pse ka filluar të aplikohet relativisht vonë në sistemet tatimore, sot paraqet një prej formave më të rëndësishme tatimore në të gjitha shtetet bashkëkohore.

Dallimet kryesore të TVSh-së në krahasim me çdo lloj të tatimit mund të përmbliken në këtë mënyrë: **1)** TVSh gjeneron të hyra me të mëdha tatimore, të cilat i arkëton pothuajse çdo shtet, **2)** TVSh ka baze të gjerë tatimore dhe prodhimi përcillet në të gjitha fazat e qarkullimit, favorizon prodhuesit dhe investitorët, **3)** TVSh përfshin një numër me të madhe të tatimpaguesve, **4)** TVSh është e mbrojtur nga evazoni fiskal, **5)** TVSh funksionon me metodën e zbritjes dhe teknika e llogaritjes dhe arkëtimit ndikojnë në evitimin e të tatuarit të dyfishtë të qarkullimit të mirave dhe shërbimeve në të gjitha fazat e qarkullimit, **6)** TVSh stimulon eksportin, **7)** TVSh lehtëson funksionimin e suksesshëm të sistemit tatimor.

Qëllimi i tatimit mbi vlerën e shtuar është se me këtë tatim ngarkohet vetëm qarkullimi i cili i shërben konsumit final. Parimisht tatohet çdo qarkullim mirëpo baza tatimore zvogëlohet për shumën e tatimit të zbritshëm. Për këtë arsye TVSh

nuk ngarkon qarkullimin e tërësishme por vetëm vlerën e shtuar të cilin e paguan konsumatori i fundit që është konsumuesi privat (qytetari) dhe konsumuesi publike (shfrytëzuesit e buxhetit). Qëllimi i pagesës së këtij tatimi nga konsumatori i fundit është edhe i tatimit në qarkullim por ai qëllim nuk është çdoherë i suksesshëm si TVSh ngase tatimi në qarkullim shpesh herë futet në mënyrë të padukshme në çmimin e të mirave dhe shërbimeve dhe në mënyrë të pabarabartë i ngarkon ato, kjo nuk ndodh në tatimin mbi vlerën e shtuar.

Politikat fiskale apo direkt kufiri i TVSh-së është një ndër fazat kritike në konstruktin dhe implementimin e këtij tatimi pothuajse për çdo shtet. Kufiri i ulët për shumë vende nuk ka sjellë shumë vështirësi sidomos në fillim të aplikimit të TVSh-së.

Administrimit i TVSh -së është i lidhur ngushtë me një vendim të rëndësishëm se a duhet administrimi i TVSh-së të jetë përbrenda administratës tatimore apo të ndonjë autoriteti tjetër të të hyrave. Pothuajse në të gjitha vendet që bëjnë vjeljen e tatimeve në importe duke përfshirë edhe TVSh është përgjegjësi e departamentit të doganave. Por pavarësisht administrimit është e nevojshëm të ketë koordinim të ngushtë të përgatitjeve të TVSh-së në mes të administratës tatimore dhe departamentit të doganave.

Si rrjedhë logjike dhe shkencore janë tri mundësi të administrimit të TVSh-së;

- a) Administrimi i TVSh-së nga autoritete tatimore së bashku me administrimin e tatimeve të tjera,
- b) Administrimi nga një departament i ndare për TVSh dhe ,
- c) Administrimi nga departamenti i doganave.

Administrata tatimore e Kosovës merret me administrimin e TVSh-së së brendshme dhe administrimin e tatimeve qendrore qeveritare të cilat përfshijnë: Tatimi në të Ardhura e Korporata, Tatimin në të Ardhura Personale dhe Kontributet Personale , ndërsa Shërbimi doganor i Kosovës administron TVSh-në në importe .

Ky tatim (TVSh) në Kosovë është identifikuar si shtylla kryesore e të hyrave dhe do të jetë në të ardhmen, është shumë e rëndësishme për stabilitetin fiskal në Kosovë, dhe në masë të madhe është kompatible me BE, e lehtë për export dhe investime. Aplikimi i TVSh-së në Kosovë në vitin 2001 ka siguruar zvogëlimin e vartësisë së Kosovës nga donacionet, dhe ka paraqitur një burim të sigurt të të hyrave që njëkohësisht zvogëlon edhe vartësin nga tatimet kufitare. Momentalisht Kosova aplikon TVSH me masën 16 %.

Legjislacioni tatimor i Kosovës është i njohur si nga FMN-ja ashtu edhe Komisioni Evropian si legjislacion transparent dhe me standarde ndërkombëtare të mira. Legjislacioni i TVSh-së në masë të madhe plotëson kërkesat e Direktivës së Gjashtë të BE-së dhe ky fakt është një ndër përparësitë me të mëdha në këtë legjislacion.

Rendësinë ia shton kur e ke parasysh se TVSh pothuajse në të gjitha vendet që aplikohet ashtu edhe në Kosovë është një ndër tatimet me më peshë për arken shtetërore.

Disa nga përparuesit e TVSH-së në Kosovë janë:

1. Norma standarde 16% dhe zero përqindje, e cila është me funksionale për administrim sesa normat e shkallëzuar .
2. Exporti tatohet me shkallen zero përqindje që është përparësi për prodhimin e vendit.
3. TVSh është tatim që bartet dhe paguhet nga konsumatori, ndërsa personat e tatueshëm e mbledhin (agjentë) që është një nga faktorët kryesorë të mos stimulohet evazoni fiskal.
4. Faturimi sepse nëpërmes faturimit shfrytëzohet TVSh e zbritshme, nëpërmes dokumentacionit aprovohet kreditimi në raste të caktuar.
5. Listat e përjashtimeve gjithashtu janë përparësi, sepse mundësojnë që të lirohet buxheti i konsumatorit nga disa ngarkesa.

Mirëpo, ky tatim (TVSh) na paraqet edhe disa mangësi apo të meta që mbetet të ndryshohen në të ardhmen.

1. Kufiri prej 50,000.00€ i regjistrimit është shumë i lartë dhe mundëson që një numër shumë i madh i bizneseve të jetë jashtë këtij kriteri dhe ky limit e shpëput zinxhirin e TVSh, kjo mundëson evazion fiskal duke iu mundësuar shumë bizneseve lëshimin e faturave pa TVSh.
2. Përdorimi i arkave fiskale do të ishte një rregullator i furnizimeve të tatueshme, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi personat e tatueshëm janë të obliguar që transaksionet e tyre t'i regjistrojnë në makinat elektronike dhe konsideroj se mosaplikimi i këtij sistemi është një e metë shumë e madhe .
3. Kërkesa për rimbursim rikthim, shqyrtohet për një afat shumë të gjatë 60 ditor.
4. Procesi i regjistrimit për TVSh duhet të jetë me efektiv dhe të na ofrojë një siguri me të madhe për parandalimin e mashtrimeve në drejtim të TVSh-së
5. Listat e përjashtimeve duhet të jenë me të specifikuar
6. Borxhi i keq duhet të trajtohet në mënyre të kujdesshme dhe kërkon një kujdes me të veçantë nga institucionet e shtetit Gjykatat dhe ATK
7. Të gjitha transaksionet e personave të tatueshëm duhet të bëhen nëpërmes sistemit bankare.

## Referencat

1. Indirect Tax Evazion and Production Efficiency, JP Economics, vol 39,1989
2. Sabaudin Komani/ Financa Publike, Universiteti i Prishtinës 2008
3. Bozhidar Jelqiq /Finansisjko pravo i finansisjka znanost / Zagreb, 1997
4. Artan Nimani/Politikat financiare- me vështrim Kosova/ISRN-KUB Prishtinë 2010
5. Branko Svilar / VSE o DDV, Oziris, Lesce, 2001
6. David Williams/VALUE–Added TaxInternational Monetary Fund, Washington1996

7. Doracak për tatimin mbi vlerën e shtuar ne Kosove, Prishtine, 2007
8. Barbara Jelqiq / Javne financije , Informator, Zagreb, 1998
9. Kasem Seferi/ Kontrolli tatimor, Tiranë 2006
10. Konferenca e ITD-së mbi TVSH-ne , Romë, 2005
11. Ligji -1995, dhe udhëzimet, për zbatimin e tatimit mbi vlerën e shtuar në Shqipëri
12. Materiale nga Instituti Kosovar për të drejtën e OJQ-ve
13. Materiale nga Aplikimi i tatimeve te konsumit mbi tregtinë në shërbimet dhe gjerat e patrupëzuara ndërkombëtare (OECD), 2004
14. Materiale nga MEF & ATK, Instituti për hulumtime RIINVEST
15. Mario Leccisotti – Leksione të shkencës se financave, Tiranë, 2000
16. Artan Nimani/ Menaxhimi i Financave Publike/ ISBN Prishtinë 2007
17. Sabri Kadriu, Financimi publik ne Kosove, Sabrico, Prishtine 2002
18. Sotiraq Dharmo, Kontabiliteti. financiar, Grevis, Tirane, 2000
19. The modern VAT, Materiale nga FMN
20. Udhëzimi administrativ 05/200, Udhëzimi administrativ 01/2004
21. VAT and Internacional trade - The Evidence, 2002, Desai, M. A& J. R. Hines
22. Vladimir Slijepčević, prof – PDV priručnik za svakoga, Dival, Zagreb, 1997
23. Zakon za DDV, R. Makedonija
24. <http://www.itdweb.Org>. 2006/02
25. <http://www.atk-ks.org/Shqip/fillim/2010>
26. Rregullore nr 2005/40,për ndryshimin Rreg UNMIK nr.2001/11 mbi T Sh në Kosovë
27. Ligji Nr. 03/L-114, Datë 18.12.2008 - PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR
28. Rregullore nr. 2001/11 - Datë 31.V.2001 - për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar
29. Rregullore nr.2001/41-Ndryshimi rreg së UNMIK-ut nr 2001/11 për TVSh në Kosovë
30. Udhëzim Administrativ nr. 01/2004 - Datë 1 shtator 2004 -për zbatimin e TVSh
31. Udhëzim Administrativ nr. 01/2001 - Datë 05/31/2001-Për zbatimin e TVSh
32. Rregullore nr.2001/17- Ndryshimi i rregullores 2001/11 Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

## MUNDËSITË E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT PËRMES AKTIVITETEVE REKREATIVO SPORTIVE

*Dr.Bujar Turjaka, prof.asoc  
bujarturjaka@gmail.com*

### **Abstrakt**

Paraqitja e rekreacionit sportiv ka rrjedhë si pasojë e zhvillimit të shoqërisë dhe ekonomisë. Procesi i përsosur teknologjik ka ndikuar me të madhe në karakterin e punës, kushteve të punës, medisit punues dhe mënyrës së jetesës. Ndryshimet në karakterin e punës, llojin dhe intenzitetin e ngarkesave gjatë punës, janë të kushtëzuara para së gjithash me aplikimin e procesit bashkëkohor teknologjik, automatizimit dhe kibernetizimit të prodhimit. Në turizëm, rekreacioni sportiv ka një rendësi të madhe si në shoqëri që është i domosdoshëm po ashtu edhe në funksionin e argëtimit dhe dëfrimit dhe shpenzimit të kohës së lirë ku përmes këtyre rrugëve krijohen rezultate në arritjen e interesit të përfuturit nga ana financiare dhe turistike për shtetin që investon për këtë lami. Turizmi dhe rekreacioni sportiv janë përmbajtje të rëndësishme të kohës së lirë dhe si të tilla duhet trajtuar pasi ndikimi i tyre ka efekte shumë pozitive në jetesën bashkohore.

**Fjalët kyqe:** Rekreacioni, turizmi, koha e lirë, pushimi aktiv, sporti, stresi,

**JEL Klasifikimi:** L83

### **Hyrje**

Është e pakontestueshme se turizmi përbën dukurinë më të madhe sociale të këtij shekulli. Edhe pse e ka traditën e vetë, zhvillimi i tij qysh në shekullin e XX-të përjeton ekspansion të jashtëzakonshëm. Për çdo ditë turizmi bëhet “artikull i kërkesave masovike”.

Në faktorët të cilët kanë ndikuar në zhvillimin e hovshëm të turizmit, lajmërohet edhe fenomeni tjetër i quajtur “sport”, i cili në kuptimin e gjërë të fjalës mendohet në lëmin e rekreacionit sportiv e cila mbetet si nevojë e njeriut bashkëkohor për lëvizje si pasojë e industrializimit dhe urbanizimit.

Derisa sporti klasik përfaqëson turizmin, shtyrjen për udhëtim me qëllim të përcjelljes së shfaqjeve, rekreacioni sportiv paraqet angazhim aktiv të njerëzve në kryerjen e aktiviteteve rekreative dhe si i tillë mbetet gjithnjë e më shumë pjesë përbërëse e kërkesave turistike.

### **1. Faktorët të cilët ndikojnë në zhvillimin e rekreacionit sportiv në turizëm**

Në bazë të shumë hulumtimeve të realizuara deri me tani është konstatuar se këto dukuri janë në raporte shumë të ngushta dhe reciproke. Në bazë të hulumtimeve të shumta në sport dhe rekreacionin sportiv shumë lehtë mund të vertetohet dhe konstatohet mbi ndikimin dhe rolin e aktiviteteve rekreative sportive në kërkesat dhe ofertat turistike.

Egziston një numër i madh faktorësh të cilët ndikojnë dhe kushtëzojnë aktivitetet rekreative në turizëm, mirëpo ndër faktorët kryesor janë:

- Rritja e kërkesave rekreative – sportive, të cilat shfaqen si pasojë e mënyrës bashkohore të jetësës dhe punës
- Rritja e fondit të kohës së lirë si faktor i zhvillimit të rekreacionit sportiv në turizëm
- Rritja e standardit (të ardhurave) të popullatës si faktor i zhvillimit të rekreacionit sportiv në turizëm

## **2. Turizmi dhe rekreacioni sportiv**

Rekreacioni sportiv ne turizëm është një faktor i domosdoshëm dhe i nevojshëm në kënaqjen e dëshirave dhe nevojave të njeriut për loje, për dalje ne diell, ujë, borë si dhe ka rendësin e vet psiko-fiziologjike. Pra, sporti ne turizëm mund te definohet si aktivitet edukativ-mësimor në kënaqjen, dëfrimin e popullatës në aspektin e aktiviteteve lëvizore – rekreative – sportive, qe është pjese e shkollimit te gjeneratave te reja. Në aspektin rekreativ ka për qëllim përmbushjen e nevojave te kënaqjes se njeriut me lëvizje, loje, aktivitete, qe e bëjnë dhe e forcojnë apo mbajnë me tutje organizmin vital te njeriut si nga ana fizike po ashtu edhe ajo psikike e mentale. Sporti dhe turizmi janë të lidhura ngushtë si pasoj lëvizjes së njerëzve ne vende të ndryshme, janë motivet e mundshme që të përcillen ndodhitë e ndryshme sportive, garuese, manifestuese, si: lojërat olimpique, botërore, evropiane etj. Aktivitetet sportive kanë ndikim ne turizëm si në vend-pushime, ku njerëzit luajnë tenis, skijojnë, luajnë golf, kalërojnë etj.

Rekreacioni sportiv ne turizëm ka rendësin dhe efektin e çlodhjes së organizmit te njeriut, ku lëshon vendin e punës dhe te qëndrimit duke ndërruar një vend tjetër me pushim ne det apo vend malor për tu relaksuar çoftë për vikend apo pushim. Është konstatuar qe pushimi aktiv me shpejt e sjell njeriun ne procesin e pushim te organizmit, ne krahasim me pushimin pasiv apo te qetësisë. Personat që merren me rekreacion sportiv qoftë në moshën e re apo të vjetër mund te kenë shume interes për arsye se ndalojnë sëmundjet moderne si ato kardiovaskulare, nervore, te stërkeqjes se muskujve, organizmit etj.

Rekreacioni sportiv jo vetëm qe bën dukjen e mire dhe mbajtjen e drejt te trupit, por ndikon edhe ne mbarëvajtjen e mirë të aftësive funksionale në nivel të lart. Rekreacioni dhe njeriu gjithmonë është ne kontakt me ajrin, diellin, ujin, borën, pajisjet sportive duke mundësuar turizëm efikas dhe këto aktivitete mund te quhen ndryshe edhe "ilaç i njeriut".

Rekreacioni sportiv ka një rëndësi të madhe në marrëdhënie me zhvillimin e turizmit bashkëkohor. Mysafiret e shumtë qe vijnë ne qendra turistike që kanë



fusha golfi, futbollit, volejbollit, basketbollit, kalërimi, skijimi etj, rrisin edhe më shumë rendësinë e rekreacionit në turizëm.

Në turizëm përpos kënaqjes së mysafireve gjatë pushimeve, aktivitetet rekreative në turizëm kanë edhe rëndësinë ekonomike:

- efektin direkt financiar, pagesën e shërbimit në qendrat rekreative-sportive.
- rrugëve indirekte të lehta dhe të shpejta rreth shitjes së kapaciteteve, shitjes së pajisjeve, pijeve dhe rekuizitave, benzinës dhe gjërave tjera.

## **2. Mundësitë e zhvillimit të turizmit përmes formave stacionare të aktiviteteve rekreative**

Në kuadër të formave stacionare të aktiviteteve rekreative bëjnë pjesë:

### *Pushimi aktiv gjatë vikendit*

Janë forma të aktiviteteve jashtë vendbanimit të cilat kanë për qëllim largimin e lodhjes akute dhe kronike si pasojë e ngarkesave gjatë punës. Kjo formë e aktiviteteve realizohet gjatë ditëve jo pune (vikend) në ndonjë prej qendrave turistike të cilat ofrojnë qëndrim dhe përmbajtje rekreativo-sportive.

### *Pushimi aktiv gjatë pushimit vjetor*

Janë forma të aktiviteteve me qëndrim më të gjatë të pjesëmarrësve jashtë vendbanimit në ndonjë nga qendrat në të cilat gjatë kohës së qëndrimit realizohen programe rekreativo-sportive me qëllim të argëtimit, freskimit, këndelljes, dëfrimit etj. Në kuadër të pushimeve aktive gjatë pushimit vjetor mund të organizohen këto përmbajtje:

- Gara familjare (bowling, pikado, mini golf)
- Gara sportive (individuale ose kolektive)
- Mësim i fillestarëve (not, tenis, surfing, ski në ujë)
- Aktivitete tjera të cilat mund të organizohen jashtë qendrës turistike (shetitë, orientimet, kalërimi).

### *Aktivitetet shoqëroro-zbavitëse*

Segment i rëndësishëm në kuadër të realizimit të suksesshmëm dhe efekteve më të mëdha të pushimeve aktive janë aktivitetet shoqëroro-zbavitëse. Këto aktivitete realizohen çdo ditë në kuadër të këtyre pushimeve në kohëzgjatje 60-90 minuta dhe lëjnë gjurmë pozitive në aspektin emocional dhe argëtues. Këto aktivitete janë:

- Tombolla
- Kuizi
- Turniret
- Maskenballi
- Lojëra shoqërore
- Llotaria (lojëra fati).

Aplikimi i ketyre aktiviteteve të programuara rekreative ndikojnë në:

- rritjen e shkallës së shëndetit
- humanizimit të raporteve ndërnjerzore
- kalimit të kohës së lirë në mënyrë kualitative

### **3. Rekreacioni si mënyrë bashkohore e jetesës**

Njeriu bashkëkohor shumë shpesh përdor fjalën rekreacion, zakonisht për ndonjë aktivitet jo obligativ i cili ofron ndjenjën e kënaqësisë, relaksimit dhe zbavitjes. Vet termi ka kuptimin se bëhet fjalë për aktivitetet të cilat nuk janë të imponuara dhe të cilat pozitivisht ndikojnë në shëndetin psikofizik të njeriut, zhvillimin e kreativitetit, shoqërimit, edukimit etj. Rekreacioni sportiv në përmbytje të vet ka aktivitete sportive që përpos kënaqësisë mund të kenë edhe një varg të faktorëve pozitiv të cilët ndikojnë në gjendjen e përgjithshme shëndetësore të njeriut gjë që pasuron dhe begaton botën në të cilën jetojmë. Në rekreacionin sportiv nuk ka seleksionim si të sportet aktive-garuese dhe as rezultatet nuk janë primare si në sport (aktiv e garues). Rekreacioni zhvillon aftësitë psiko-fizike dhe shëndetin shpirtëror, ndërsa sporti (aktiv-garues) i cili jo vetëm që zhvillon dhe perfeksionon këto, por edhe aftësitë tjera specifiko-psiko-fizike me qëllim të arritjes së rezultateve sa më të mëdha në sport.

Pra, te sporti rezultati është primar për dallim me aktivitetet rekreative ku rezultati është sekondar dhe më e rëndësishme është mbajtja e aftësive të njëjta si dhe shëndrimi në aktivitete qetësuese-relaksuese-freskuese e shpirtërore duke eliminuar edhe stresin. Rekreacioni ose sporti për te gjithë (sports for all), mbledh dhe angazhon te gjithë ata qe kane dhe ndiejnë nevojë te merren me ushtrime, lojëra apo lëvizje trupore, pa dallim moshe dhe gjinie.

Me këtë aktivitet janë poashtu te organizuar dhe merren punëtorët ne organizatat punuese, qytetaret ne vendet e ndryshme sportive-rekreative. Rekreacioni nuk është i organizuar si federatat, por ka respektim të rregullave të lojës, këto rregulla nuk janë të ashpra si te sporti aktiv-garues dhe profesional.

### **Konkluzion**

Pushimi aktiv në kohën e lirë, në të vërtetë angazhimi me ndonjë sport dita ditës është nevojë e njeriut bashkëkohor. Vetëm përmes angazhimit dhe aktivitetit personal, qoftë nëse flasim për shetitë në natyrë, lundrim apo bjeshkatari, njeriu mund të realizoj përjetim të plotë dhe kontakt me natyrën e cila i mungon aq shumë. Të ushtruarit e drejtë dhe me rregull mund të ndikoj pozitivisht në shumë funksione të organizimit të cilat bazohen në veprimin e katër grupeve të karakterisitikave (aftësitë funksionale, aftësitë motorike, aftësitë morfologjike dhe karakteristikat psikosociale) të cilat në mënyrë të barabartë ndikojnë në shëndet. Si pasojë e moslëvizshmërisë dhe plakjes pason dobësimi i organizimit, rezistenca dhe aftësia e

tij i përshtatet kushteve të jetës dhe të punës, prandaj në këtë mënyrë keqësohet gjendja shëndetësore.

Duke pas parasysh gjitha këto të dhëna dhe ambientin e shkatëruar dhe të ndotur në masë të madhe (ajëri i papastër, prezenca e kemikalieve, zhurma) mund të themi se rekreacioni është produkt i nevojës së shoqërisë pasi që si pasojë e moslëvizshmërisë vërejtet deri te problemet shëndetësore dhe sëmundjet të cilat janë të kushtëzuara nga mënyra bashkohore e jetesës.

### **Referencat**

1. Grup autorësh (2002) Sportska rekreacija, Sarajevë
2. M. Andrijasevic (2000), Rekreacijom do zdravlja i ljepote, Zagreb
3. M. Andrijasevic (1996), Sportska rekreacija u mestu rada i stanovanja, Zagreb
4. Mrakovic, S i O. Mojzez: Trzisni aspekti sportske rekreacije u turizmu, Zagreb 1972



## **NDIKIMI DHE PJESEMARRJA E EKONOMISË INFORMALE NË EKONOMINË E NJË VENDI, ME THEKS TË VEÇANTË NË EKONOMINË E KOSOVËS**

*Drita M. Shoshi*  
*drita\_shoshi@hotmail.com*

### **Abstrakti**

Ndikimi i ekonomisë joformale në vendet e ndryshme të botës është prezent, e në veçanti në Kosovë është shumë i dukshëm. Ekonomia joformale ka ndikim negativ në vend, që nënkupton se dëmton stabilitetin ekonomik të një vendi. Në këtë punim do të ofrohen disa të dhëna në lidhje me se çka nënkuptojmë me ekonomi informate, cilat janë mënyrat e realizimit të aktiviteteve të saj, sa është prezente në disa vende të botës, dhe si duhet të luftohet ky fenomen negativ.

**Fjalët kyçe:** ekonomi, GDP, zhvillim, dëmtim, luftim, Kosovë.

**JEL Kualifikimi:** E20; E26;

### **Hyrje**

Ekonomia informale si fenomen haset sot kudo rreth nesh përmes aktiviteteve të ndryshme. Femrat dhe meshkujt, të pasurit apo të varfrit, të arsimuarit apo më pak të arsimuarit, me dëshirë apo pa dëshirë, të gjithë së bashku në mënyra dhe për arsye të ndryshme janë pjesë e ekonomisë informale të një vendi dhe njëkohësisht pjesë e pashmangshme e ekonomisë informale globale. Pse? Duke i konsideruar të parëndësishme shumë prej aktiviteteve ekonomike, ndoshta ndonjëherë dhe pa vetëdije të gjithë bëhemi pjesë e ekonomisë informale, duke kontribuar në trendin e rritjes së saj që nga familjet apo shtëpitë tona.

Në veçanti ekonomia informale është më e shprehur në vendet të cilat ndodhen në fazën e tranzicionit ku bën pjesë edhe Kosova. Funksionimi i një sistemi të këtillë jo ligjor fillimisht buron nga niveli i lartë i papunësisë dhe standardi i ulët jetësor. Më pastaj shfaqen arsyet tjera të cilat pothuajse janë karakteristike për të gjiha vendet në tranzicion. Dominimi i politikës në zhvillimet ekonomike, administrata shtetërore e korruptuar, mungesa e strategjisë dhe politikave shtetërore për zhvillim ekonomik, mos funksionimi dhe mos respektimi i ligjeve, përqindjet e larta tatimore, e shumë faktorë të tjerë të cilët në një apo tjetër mënyrë nxisin funksionimin e ekonomisë informale.

Duke u bazuar në zhvillimin dhe funksionimin e ekonomisë informale të shteteve të ndryshme gjatë fazës së tyre të tranzicionit, aspekt i veçantë duhet ti kushtohet arsyeve dhe efekteve nga zhvillimi dhe funksionimi i ekonomisë informale.

Në Kosovë, si vend i cili vuan pasojat e mëdha nga stagnimi dhe mos zhvillimi ekonomik për shkak të krizave politike jo shumë të largëta, edhe pse ekonomia informale konsiderohet si një fenomen negativ, efektet e saj sa janë negative për shtetin, janë po aq edhe “pozitive” për individët.

Prandaj në këtë punim rëndësi më e madhe i është kushtuar identifikimit të arsyeve dhe efekteve që pasojnë nga funksionimi i ekonomisë informale në vendet e tranzicionit.

## 1. Çka është ekonomia informale?

**Ekonomia informale** është aq komplekse sa që asnjëherë nuk mund të përkufizohet dhe definohet përgjithmonë. Shfaqet në forma të ndryshme përmes aktiviteteve ekonomike duke filluar nga shitjet ilegale të mallrave të ndaluara me ligj e deri tek krimi i organizuar.

Të gjitha këto aktivitete përfaqësohen qoftë nga individë apo nga ndërmarrje të cilat nuk i respektojnë ligjet dhe detyrimet për aktivitetin e tyre të zhvilluar, përkatësisht në mënyra dhe rrugë të ndryshme shmangen nga obligimet e tyre ligjore.

Ndikimi i faktorit njeri si individ dhe ndërmarrjes si subjekt, mund të analizohet përmes veprimeve të ndryshme, të cilat në analizë vetanake nuk duken edhe aq të rëndësishme, mirëpo në fakt paraqesin bazën për trendin pozitiv të rritjes së ekonomisë informale. Si pjesëmarrës bazë në ekonominë informale përmes aktiviteteve të ndryshme janë:

- **Individi** me ofrimin e shërbimeve të ndryshme individuale qofshin ato mjekësore, ndihmëse, apo të tjera të cilat zakonisht identifikohen me shprehjen puna në të zezë.
- **Familja** përmes aktiviteteve të cilat në të shumtën e rasteve nuk lajmërohen, psh. duke punësuar ndihmëse në shtëpi apo ndihmëse për kujdesje të fëmijëve, duke lëshuar objektin e banimit me qera, duke kërkuar shërbime tjera shtesë brenda shtëpisë, etj.
- **Ndërmarrjet** duke fshehur prodhimet e tyre me qëllim të zvogëlimit apo shmangjes së tërësishme të tatimit, paraqitja e numrit jo të saktë të të punësuarve, etj.

Duke pasur parasysh se ekonomia informale është koncept ekonomik e jo statistikor, në statistikat kombëtare nuk ekziston ndonjë argument ekonomik i cili është në përputhje me nocionin e ekonomisë informale. Prandaj, ekonomia informale asnjëherë nuk mund të analizohet nga aspekti statistikor në mënyrë precize dhe të saktë për vetë faktin se mungojnë të dhënat e duhura.

Me qëllim të analizës më të plotë, të gjitha aktivitetet e ekonomisë informale duhet të ndahen në dy kategori: aktivitete të pa deklaruar dhe aktivitete informale.

**Aktivitetet e pa deklaruar**, janë aktivitetet ekonomike të cilat në të vërtetë funksionojnë si legale, por për arsye të ndryshme (për tu shmangur nga tatimet, sigurimet sociale, etj.) fshehën nga administrata tatimore. Në këtë rast kemi të bëjmë me aktivitetet ekonomike të cilat në parim nuk janë të ndaluara me ligj mirëpo, nuk janë legale, dhe bëjnë pjesë në ekonominë informale.

**Aktivitetet jo formale**, përkatësisht aktivitetet të cilat bëjnë pjesë në ekonominë informale përmes familjes apo individit. Këto janë aktivitete legale të pa deklaruar për faktin se shërbimet e tilla nuk konsumohen në treg, prandaj nuk i nënshtrohen tatimeve.

## 2. Funksionimi i ekonomisë informale në Kosovë

**Arsyet** për shfaqjen e ekonomisë informale janë të ndryshme në vendet e zhvilluara, në vendet në tranzicion apo në vendet në zhvillim. Dihet se ekonomia informale është e prirur të rritet me shpejtësi në vendet ku ndodhin ndryshime të shpejta të situatës politike dhe ekonomike, e që në fakt është tipike për vendet në tranzicion. Pasojat nga lufta, sanksionet e ndryshme ekonomike, kanë për pasojë zhvillimet e dobëta ekonomike gjatë periudhës së tranzicionit, dhe me këtë rast bie prodhimtaria, rritet shkalla e papunësisë dhe njëkohësisht rritet shkalla e varfërisë.

Edhe pse në Kosovë nuk është bërë ndonjë hulumtim i detajizuar, supozohet se norma me të cilën identifikohet ekonomia informale është diku afër 40%, ndërsa sipas të dhënave statistikore shkalla e papunësisë është 47,5%<sup>23</sup>, ndërsa niveli ekstrem i varfërisë 45,1%<sup>24</sup>. Duke analizuar shkallën e papunësisë dhe nivelin e varfërisë, bazë për ekzistimin dhe rritjen e ekonomisë informale në Kosovë mund të konsiderohen arsyet ekonomike, sociale dhe psikologjike. Shkalla e lartë e papunësisë, niveli i pamjaftueshëm i të ardhurave ligjore, konkurrenca e lartë dhe e padrejtë, në një mënyrë i ka nxitur individët dhe ndërmarrjet për të zvogëluar shpenzimet përmes punës informale. Tranzicioni ekonomik në Kosovë ka sjellë papunësi dhe varfëri pothuajse në të gjitha shtresat e banorëve duke mos anashkaluar as shtresat e larta. Mungesa e zhvillimit ekonomik të vendit, procesi i privatizimit të objekteve të dikurshme shtetërore, si dhe arsye tjera kanë bërë që njerëzit të kërkojnë zgjidhje të problemeve të tyre sociale dhe ekonomike përmes ekonomisë informale. Me këtë rast, është nxitur në masë më të madhe ekonomia informale e cila ka sjellë përfitime të shpejta materiale. Në njërin anë, mos funksionimi i sistemit shtetëror për parandalimin e ekonomisë informale dhe në anën tjetër tradita e trashëguar për “mashtrimin e vendit” duke fshehur përfitimet nga aktivitetet e ndryshme ekonomike kanë lejuar zhvillimin e veprimtarive të paligjshme dhe punën në tregun e zi. Gjithashtu, mos besimi i individëve dhe ndërmarrjeve ndaj institucioneve dhe mos funksionimi efikas i tyre për zgjidhjen e problemeve ekonomike, është një nga arsyet psikologjike të cilat kanë kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë informale. **Efektet** nga funksionimi i ekonomisë informale për vendet në tranzicion janë të ndryshme dhe mund të klasifikohen në pozitive dhe negative. Efektet negative me dominim më të madh janë: ulja e të hyrave, mallërat e importuara dhe të eksportuara ilegalisht, shitja e mallërave të palejuara në tregun vendor, vështirësohet funksionimi i institucioneve publike, korrupsioni, keqpërdorimi i pozitës zyrtare, uzorpiet dhe përfitimet e paligjshme të pasurive, prostitucioni, etj. Ndërsa disa nga efektet pozitive që sjell ekonomia

---

<sup>23</sup> Burimi: Enti i Statistikës së Kosovës - Statistikat e tregut të punës 2008

<sup>24</sup> Burimi : <http://www.ks-gov.net/esk/index>

informale janë: rritja e numrit të të punësuarve ( e njohur si tregu i punës në të zezë), krijimi i përvojës së punës dhe aftësimi profesional për moshat e reja, rritja e të ardhurave për banorët vendës, ulja e nivelit të varfërisë, rritja e aktiviteteve të përgjithshme ekonomike, etj.

### **3. Pjesëmarrja e Ekonomisë informate në disa nga vendet e botës**

Siç u cek edhe më herët, pjesëmarrja e ekonomisë joformale dallon nga një vend në tjetrin, poashtu dallon edhe se ajo mund të shënojë rënie dhe ngritje, varësisht nga një periudhë kohore krahasuar me tjetrën.

Në vijim do i ofrojmë disa statistika të pjesëmarrjes së ekonomisë joformale në disa vende të botës<sup>25</sup>:

- mesatarja në shtetet e Afrikës, pjesëmarrja e ekonomisë joformale në bruto produktin e vendit (GDP) në vitin 2002 ka qenë rreth 42%.
- mesatarja në shtetet e Azisë, pjesëmarrja e ekonomisë joformale në bruto produktin e vendit (GDP) në vitin 2002 ka qenë rreth 26%.
- mesatarja në shtetet e Amerikës veriore dhe ato të Pacifikut, pjesëmarrja e ekonomisë joformale në vitin 2002 ka qenë rreth 15.9%.
- mesatarja në shtetet e Bashkimit Evropian, pjesëmarrja e ekonomisë joformale në bruto produktin e vendit (GDP) në vitin 2002 ka qenë rreth 16.7%.

Nëse e krahasojmë pjesëmarrjen e ekonomisë joformale në bruto produktin e vendit (GDP) me vendet e tjera të botës, e në veçanti me vendet e bashkimit evropian, atëherë pjesëmarrja e ekonomisë joformale në Kosovë mund të vlerësohet në rreth 30 deri në 40% të bruto produktit të vendit (GDP)<sup>26</sup>.

### **4. Diskutime dhe analizë**

Ekonomia joformale, siç vërehet edhe në bazë të mënyrës se si realizohet mirëpo edhe në bazë të pjesëmarrjes që e ka në bruto produktin e vendit, ka një ndikim shumë të madh në zhvillimin ekonomik dhe normal të një vendi, e në veçanti kur merret parasysh pjesëmarrja e saj në potencialin e një vendi. Secila qeveri e çdo vendi zhvillon përpjekje në mënyrë që të pamundësojë realizimin e aktiviteteve jolegale që nënkupton edhe zvogëlimin e pjesëmarrjes së ekonomisë joformale në vend<sup>27</sup>.

Në Kosovë, dëmet nga ekonomia joformale janë të dukshme, dhe se për këtë kërkohet që të ofrohet një efikasitet më i lartë nga ana e gjyqësisë së Kosovës, për ti hulumtuar dhe për ti dënuar krimet e tilla. Në anën tjetër, është edhe çështje e hartimit të politikave të favorshme fiskale që do të mundësonin zhvillimin e aktiviteteve biznesore në mënyrën legale, çka nënkupton se kostoja e realizimit të aktiviteteve legale do të ishte më e lirë sesa kostoja e realizimit të aktiviteteve jolegale. Në këtë mënyrë, së paku do të minimizohej pjesëmarrja e ekonomisë

---

<sup>25</sup> Burimi: [www.worldbankdata.com](http://www.worldbankdata.com), korrik 2002

<sup>26</sup> Sadiku Muhamet: “Tranzicioni dhe reformat institucionale në Kosovë”, fq. 143

<sup>27</sup> Shoshi Drita (2006): *Punim i magjistraturës*, fq. 77, Universiteti Shtetëror i Tetovës, 2006



joformale në Kosovë, që në këtë rast kjo do të kishte efekt jo vetëm në ruajtjen e stabilitetit ekonomik në vend dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, mirëpo në anën tjetër kjo do të ishte një veprim strategjik në synimet e anëtarësimit të Kosovës në instancat më të larta siç është Bashkimi Evropian. Sikurse të gjitha vendet, poashtu edhe Kosova duhet ti plotësojë kriteret e parapara për anëtarësim që janë ai politik, juridik dhe ekonomik, dhe si element i rëndësishëm në kuadër të kriterit ekonomik do të ishte luftimi i aktiviteteve jolegale, respektivisht minimizimi i ekonomisë joformale.

## 5. Konkluzione

Pjesëmarrja e lartë e ekonomisë joformale vjen nga shkaku i mbijetesës ekonomike, e sidomos kohëve të fundit në krizën financiare. Ndonëse veprimtaritë ekonomike joformale mund ta dëmtojnë buxhetin e shtetit, ato janë pjesë e ekonomisë së përgjithshme dhe burim i rëndësishëm i të ardhurave dhe punësimit për një pjesë të madhe të popullsisë. Derisa buxheti i shtetit humb nga veprimtaritë e tilla, një pjesë jo e vogël përfiton nga mospagesa e tatimeve dhe taksave.

Në bazë të dhënave të ofruara në këtë punim mund të konkludojmë se;

- ekonomia joformale zvogëlon të hyrat e shtetit
- ekonomia joformale ndikon në rritjen e recensionit ekonomik në vend
- ekonomia joformale dëmton materialisht një pjesë të individëve dhe bizneseve që nuk merren me aktivitete të ekonomisë joformale
- ekonomia joformale ndikon në zvogëlimin e gjasave për shfrytëzimin e potencial prodhues të vendit, respektivisht ndihmon rritjen e papunësisë.

## Referencat

1. Feige Edgar: *"The Underground Economies"*, Cambridge University Press, Cambridge, 1989
2. Sadiku Muhamet: *"Tranzicioni dhe reformat institucionale në Kosovë"*, Riinvest, Prishtinë, 2008
3. Smith, J.D: *"Market motives in the informal economy"*, Gartner, W. and Wenig, A., Heidelberg Springer Publishing Company, New York, 1994
4. Shoshi Drita: *"Roli i politikave fiskale në Kosovë"*, Punim i magistraturës, Fakulteti Ekonomik i Universitetit Shtetëror të Tetovës, 2006
5. Thomas, Jim J: *"Informal economic activity"*, LSE, Handbooks in Economics, London, 1992



## KOMPLEKSITETI I PRONËS SHOQËRORE, TRANSFORMIMI DHE PRIVATIZIMI I SAJ

*Mr. Driton Sylqa, ligj.  
dsylqa@gmail.com*

### Abstrakt

Njëra ndër sfidat më të rëndësishme të tranzicionit në shoqërinë tonë është edhe transformimi/privatizimi i pronës shoqërore i artikuluar si ndërmarrje shoqërore, respektivisht publike. Për konceptin e pronësisë shoqërore janë shfaqur dilema të shumta dhe janë dhënë mendime të numërta. Sipas dispozitave kushtetuese të viti 1974 e deri në vitin 1989, pronësia shoqërore ishte pronësi e të gjithë shoqërisë dhe askush nuk kishte të drejtë përvetësimi, as bashkësitë shoqërore politike, as organizatat punuese dhe as individ. Kjo pronësi e formuluar kështu në kushtetutë ishte pronësi specifike që dallonte nga pronësia shtetërore dhe shoqërore. Argumentet që flasin në favor të fakti se shteti ishte pronar i pronës shoqërore janë edhe transformimet e pronës shoqërore në pronë shtetërore nga shtetet e dala nga ish-Jugosllavia. Këtë zgjidhje në mënyrë të tërthortë e ka pranuar edhe Republika e Kosovës përmes Kushtetutës dhe Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Gjatë dhjetë viteve të fundit, në Kosovë janë shënuar hapa të rëndësishëm drejt krijimit të ekonomisë së tregut dhe institucioneve të qëndrueshme në përputhshmëri me një kornizë ligjore efikase dhe bashkëkohore. Transferimi i pronës shoqërore në pronë private është cilësuar si hap kyç i reformës për ta bërë Kosovën me një ekonomi të pavarur dhe dinamike. Zgjidhja është gjetur në atë se ndërmarrjet shoqërore iu jepën me qira investitorëve privat në kohëzgjatje prej 99 vjetësh.

**Fjalët kyçe:** prona shoqërore, ndërmarrjet shoqërore, ndërmarrjet publike, transformimi, privatizimi, tranzicioni.

**JEL klasifikimi:** B10, E20, I18

### Hyrje

Me fillimin e privatizimit të pronës shoqërore janë shfaqur shumë dilema rreth definimit të kësaj prone dhe gjetjes së pronarit të vërtetë, si dhe mënyrës së transformimit të kësaj prone në pronë private. Në fillim shumë ekspertë kanë pasur qëndrime të ndryshme se e kujt ishte kjo pronë dhe si duhej të transformohej në pronë private. Shumë prej tyre kishin qëndrimin se kjo pronë duhet trajtuar si pronë shtetërore por kishte edhe të atillë që mendonin se një pjesë e saj ju takon menaxhmentit të ndërmarrjeve dhe ish-pronarëve që iu kishte marrë prona nga regjimi komunist me anë të formave të ndryshme të shpronësimit.

Mos njohja e pronës shoqërore dhe formimit të saj përmes eksproprijimeve, nacionalizimeve, konfiskimeve, si dhe transformimi i saj nga viti 1945 e deri në vitin 1999, mund ta komplikojnë procesin e transformimit (privatizimit) të pronës

shoqërore në pronë private. Në vitin 1989, Serbia e pat suprimuar autonominë e Kosovës dhe shpërbërë tërë sistemin juridik të Kosovës. Legjislacioni i cili i rregullonte marrëdhëniet pronësore deri atëherë ishte shfuqizuar ndërsa Serbia me ligje diskriminuese kishte bërë transformime të pronës shoqërore në Kosovë pa miratimin e organeve legjitime të Kosovës.

Nga viti 1999 e deri më 15 qershor të vitit 2008, kur është hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës, UNMIK-u kishte kompetenca të rezervuara mbi pronën shoqërore dhe përmes Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), e udhëhoqi procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Deri në qershor të vitit 2008, përafërsisht rreth 80% e vlerës së ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë është privatizuar. Pas shpalljes së Kosovës shtet sovran dhe të pavarur u themelua Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), duke krijuar kështu një vazhdimësi të punës dhe proceseve të transformimit të pronës.

### **1. Kuptimi kronologjik i pronës shoqërore**

Pronësia shoqërore në ish-Jugosllavi ashtu edhe në Kosovë, nga viti 1945 e deri në vitin 1950 ishte formuar si pronësi socialiste shtetërore përmes reformave agrare, konfiskimeve, nacionalizimeve, eksproprijimeve, duke u marrë pronat pronarëve privat dhe duke e bartur atë në pronësi shtetërore. Deri në vitin 1950 kooperativat bujqësore dhe ndërmarrjet ekonomike konsideroheshin shtetërore dhe menaxhoheshin nga shteti. Ndërsa koncepti i pronësisë ishte pronësi shtetërore (gjithë-popullore). Me nxjerrjen e ligjit për qeverisjen e ndërmarrjeve nga kolektivitet punuese të vitit 1950, ishte një hap i riorganizimit të ndërmarrjeve dhe ndërtimi i sistemit vetëqeverisës dhe prona shtetërore e ndërmarrjeve konsiderohej pronë shoqërore. Kushtetuta e viti 1963 dhe aktet e tjera ligjore përcjellëse e forcuan sistemin e vetëqeverisjes dhe konceptin e pronësisë shoqërore.

Rregullimi kushtetues i vitit 1974 dhe legjislacioni deri në vitin 1989 e zhvilluan më tej konceptin e pronësisë shoqërore. Me nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1974 të RSFJ-së, vendosen themelet e konceptit të pronësisë shoqërore dhe sistemit vetëqeverisës në të gjitha fushat shoqërore. Sipas rregullimit kushtetutës të viti 1974, ekzistonte edhe prona private por vetëm në maksimumin e paraparë me ligj, dhe në krahasim me pronën shoqërore ishte në numër më të vogël. Pronësi shoqërore mund të ishin pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si: toka, ndërtesa, banesa, pjesë të veçanta të tokës, ndërtesave, dhe banesave.<sup>28</sup>

Koncepti i pronësisë shoqërore dhe i sistemit vetë-qeverisës u zhvillua deri në vitin 1989, kur Serbia e pat suprimuar autonominë e Kosovës dhe me ligje diskriminuese kishte bërë transformime të pronës shoqërore përmes aplikimit të masave të përkohshme, të mirënjohura si masa të dhunshme. Në vitin 1999, pas luftës në Kosovë dhe çlirimit të saj, Kosova vendoset nën administrimin e ndërkombëtar të UNMIK-ut. Me vendosjen e UNMIK-ut, si legjislacion në fuqi janë pranuar ligjet që ishin në fuqi deri më 22 mars të vitit 1989 kur është suprimuar autonomia e Kosovës. Ligjet e nxjerra nga Serbia pas vitit 1989 janë shpallur të pa

---

<sup>28</sup> Muharremi, 2001, p. 5.

vlefshme në territorin e Kosovës. Përfashtimisht janë shpallur si të zbatueshme vetëm ato ligje që nuk kanë qenë diskriminuese, me qëllim të plotësimit të zbrazëtirës juridike.<sup>29</sup>

### 1.1. Interpretime të ndryshme të konceptit të pronësisë shoqërore

Sado që ekzistojnë përkufizime të numërta për pronësinë shoqërore, ato janë diverse dhe ndryshojnë nga njëra tjetra. Sipas autorit Jovan Đ: *“pronësia shoqërore nuk është e drejtë pronësore por formë e jo-pronësisë e mënyrës së prodhimit dhe e bazës së marrëdhënieve shoqërore”*. Ai shton se pronësia shoqërore përfaqëson një mënyrë të re të prodhimit dhe ku prona dhe produktet prodhimit nuk mund të jenë objekt i përvetësimit privat dhe as shtetërorë përveç nëse ato janë përdorur për plotësimin e nevojave personale dhe të përgjithshme të njerëzve punonjës.<sup>30</sup>

Sipas Andria Gams, pronësia shoqërore më tepër nënkupton një kufizim për të gjitha subjektet që kanë të drejta për të disponuar me sendin dhe të drejtat mbi sendet. Këto të drejta duhet të përdoren në mënyrë sensible që shërben për të mbajtur dhe zhvilluar shoqërinë për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme. Gams, më tej thekson se *“pronësia shoqërore nuk ka titullar unik në formë të shtetit si pronësia shtetërore, madje kjo pronësi nuk ka fare titullar edhe nëse shoqëria konsiderohet si titullar, nuk e ka titullarin e trajtësuar juridikisht. Ndërsa në kuptimin pronësoro-juridik të pronësisë shoqërore, titullar janë vetëm organizatat punuese”*. Duke ju referuar bartësve të autorizimeve në pronësinë shoqërore ai është shprehur se: *“pronësinë shoqërore duhet ta konsiderojmë si pronësi të ashtuquajtur të pjesëtueshme”*.<sup>31</sup>

Autori Aliu, është shprehur se: *“pronësia shoqërore ishte një lloj forme e pronësisë kolektive, pronësi sui generis, ku titullar i pronësisë ishte një kolektiv njerëzish, që punonin me mjetet shoqërore për prodhimin dhe fitimin e të mirave të reja”*.<sup>32</sup>

Kurse autori Fetahu duke ju referuar Kushtetutës së Jugosllavisë të vitit 1974 thekson se: *“Mënyra e prodhimit dhe mënyrat tjera të punës së bashkuar, prodhimet nga puna e bashkuar dhe të hyrat tjera të realizuara nga puna e bashkuar, mënyrat e përmbushjes së nevojave të përbashkëta, burimet natyrore dhe pasuritë tjera për përdorim të përgjithshëm - të gjitha janë pronë shoqërore. Asnjë person nuk mund të fitoj të drejtën e pronësisë mbi pasuritë e pronës shoqërore”*.<sup>33</sup>

### 1.2 Definimi i ndërmarrjeve shoqërore

Ndërmarrjet shoqërore në formë të organizatave punuese (OPB) kishin kompetenca në shfrytëzimin dhe disponimin e mjeteve në pronësi shoqërore, mirëpo

---

<sup>29</sup> Raporti i OSBE-së, Privatizimi në Kosovë, Maj 2008

<sup>30</sup> Jovan Đ, 1965, p. 11, cit nga Grahovac, 2001, p. 28.

<sup>31</sup> A.Gams, 1978, p. 44, 82.

<sup>32</sup> Shih: Aliu, 2006, p. 276.

<sup>33</sup> Fetahu, 2002. p

bashkësia shoqërore politike (komuna ose niveli krahinor) nën kushtet e përcaktuara me ligj mund t'i shpërndanin këshillat e punëtorëve dhe organet tjera të organizatave punuese dhe organizatave vetëqeverisëse. Bashkësitë shoqërore politike kishin edhe kompetenca edhe në ndihmën ekonomike, dhe sanimin e humbjeve të organizatave punuese kur nuk mund t'i përmbushnin detyrimet e tyre.

Ndërmarrjet shoqërore, nuk kishin të drejtë pronësie mbi asetet e pronës shoqërore ndërsa shitja dhe blerja e aseteve të ndërmarrjes konsiderohej vetëm si transfer i të drejtës së shfrytëzimit por nuk kishin të drejtën e tjetërsimit ose të shkatërrimit të atyre aseteve.<sup>34</sup>

Koncepti, se pronësia shoqërore është më e afërt me pronësinë shtetërore ka gjetur edhe zbatim në praktikë. Shtetet që ishin pjesë e federatës jugosllave të gjitha me ligjet e tyre e kanë shpallur pronësinë shoqërore si pronësi shtetërore. Këtë zgjidhje në mënyrë të tërthortë e ka pranuar edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Në kreun IX, neni 119, pika 9 thuhet:

*“Republika e Kosovës ushtron të drejtën e pronësisë mbi çdo ndërmarrje që ajo kontrollon në pajtim me interesin publik, me qëllim që të maksimizojë vlerën afatgjate të ndërmarrjes”.*<sup>35</sup>

Në këtë nen të Kushtetutës nuk janë përmendur shprehimisht ndërmarrjet shoqërore, por sipas Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, shteti përmes kësaj Agjencie i kontrollon dhe administron edhe ndërmarrjet shoqërore dhe pronën e tyre. Andaj edhe prona shoqërore është në pronësi të shtetit sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.<sup>36</sup>

#### **1.4 Suprimimi i autonomisë**

Në fund të viteve ‘80 dhe në fillim të viteve ‘90, Jugosllavia i bënte reformat e fundit ekonomike si përpjekjet e fundit për të dalë nga kriza ekonomike që njihen si reformat e Ante Markoviçit. Në këtë kohë filluan urrejtjet nacionale të cilat quan edhe në luftërat në ish-Jugosllavisë dhe përfundimisht edhe shkatërrimin e Jugosllavisë. Kështu, përveç krizës ekonomike Jugosllavia ishte futur edhe në krizë politike.

Në vitin 1989 nën Regjimin e Millosheviqit me dhunë iu suprimua autonomia Kosovës. Ndërsa në vitin 1990 Serbia e miratoi kushtetutën e saj me të cilën e shtriu pushtetin në mënyrë të drejtpërdrejtë në territorin Kosovës duke i suprimuar të gjitha institucionet e saja. Me suprimimin autonomisë së Kosovës u shkatërrua sistemi juridik i Kosovës dhe marrëdhëniet pronësore u rregulluan me ligje të nxjerra nga Institucionet e Republikës së Serbisë.<sup>37</sup>

Regjimi i atëhershëm vendosi masa të dhunshme në të gjitha institucionet por edhe në ndërmarrje ekonomike. Në raportet pronësore kishte një ndikim të jashtëzakonshëm nxjerrja e Ligjit të Serbisë mbi pasuritë në pronësi të Republikës

---

<sup>34</sup> Muharremi, 2001

<sup>35</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008, [www.kuvendikosoves.org](http://www.kuvendikosoves.org).

<sup>36</sup> Ligji nr. 03/1 – 067 për AKP, 15 qershor 2008, [www.kuvendikosoves.org](http://www.kuvendikosoves.org).

<sup>37</sup> Kushtetuta e Serbisë, Gazeta Zyrtare e RS, nr.1/90, përmes së cilës organet dhe institucionet e Kosovës të dala nga Kushtetuta, 74 u suprimuan, 1990.

së Serbisë. Përmes këtij ligji Serbia në mënyrë arbitrare i ka definuar si pronësi shtetërore të saj të gjitha pasuritë publike dhe shoqërore të Kosovës duke përfshirë edhe ndërmarrjet. Ndërsa me një varg ligjesh tjera ka ndikuar në transformimin e pronës shoqërore. Në shumë ndërmarrje u vendos menaxhmenti i dhunshëm përmes ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve, ndërsa me ligje diskriminuese u bënë transformime pronësore përmes privatizimit me procedura jo-transparente dhe diskriminuese.<sup>38</sup>

## **2. Korniza ligjore e Privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore / publike**

Konform rezolutës 1244, Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 e ndryshuar me Rregulloren 2005/18 ka të bëjë me themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM). AKM-ja si organ i pavarur me identitet të plotë juridik kishte kompetenca që t'i Administrojë Ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore (N.Sh.) dhe Ndërmarrjet Publike (N.P.) të regjistruara ose që veprojnë në territorin e Kosovës, si dhe pasurinë e këtyre ndërmarrjeve në territorin e Kosovës. Agjencia dispononte me një kapital prej 10 milion eurosh. Objektivi kryesor i AKM-së është privatizimi i plotë i N.Sh.-ve në Kosovë.

Transformimin e pronës shoqërore në atë private e ka përqafuar edhe Republika e Kosovës përmes Kushtetutës dhe Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, e cila është themeluar në përputhshmëri me pakon e Ahtisarit dhe në bazë Ligjit të Kuvendit të Kosovës Nr. 03/L-067. AKP, si një organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, është trashëgimtare e AKM-së cila do të merret me privatizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore.<sup>39</sup>

Rrjedhimisht, administrimi me ndërmarrjet publike tani kalon nën mandatin e Qeverisë së Kosovës, e cila nuk mund të anuloi inkorporimin e këtyre ndërmarrjeve apo thënë ndryshe transformimin e tyre në shoqëri aksionare. Aksionar i vetëm i këtyre ndërmarrjeve tanimë është Republika e Kosovës. Këtu përfshihen edhe ndërmarrje të tilla si KEK-u (Korporata Elektro energjetike e Kosovës), PTK-ja (Post/Telefonia e Kosovës), Hekurudhat e Kosovës, Aeroporti, etj., që mund të klasifikohen edhe si monopole natyrore dhe me siguri se janë të një rëndësie strategjike për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës. Prandaj, modalitetet e privatizimit të tyre duhet shqyrtuar me kujdes të veçantë për faktin e rëndësisë strategjike që kanë.<sup>40</sup>

### **2.1 Privatizimi i pronës shoqërore**

Rezultatet nga privatizimi i deritashëm i ndërmarrjeve shoqërore tregojnë se privatizimi ka funksionuar me një dinamikë të theksuar me gjithë të metat e procesit. Në kuadër të procesit të privatizimit në Kosovë, që nga viti 2002 e deri në prill të vitit 2010 janë tenderuar 263 ndërmarrje shoqërore. Prej tyre, 467 tashmë i

---

<sup>38</sup> Tigani & Hysa, 1999

<sup>39</sup> Përmbledhje ekzekutive nga “Pako e Ahtisarit”, përkthim në gjuhën shqipe

<sup>40</sup> Ibid

kanë nënshkruar kontratat e shitblerjes dhe në pritje janë 65. Rrjedhat tjera karakteristike të privatizimit, duke përfshirë edhe të metat e procesit, jepen si më poshtë:

- Deri tani janë privatizuar 545 ndërmarrje të reja, prej të cilave 521 janë privatizuar përmes metodës së "spin off"-it të rregullt, ndërsa 24 prej tyre janë privatizuar përmes metodës së "spin off"-it special;
- Nga privatizimi janë grumbulluar rreth 500 milionë euro. Rreth 100 milion euro nga këto u takojnë punëtorëve, përderisa vetëm 22 milionë u janë shpërndarë punëtorëve. Procesi i shpërndarjes së 20% është cilësuar si tepër i ngadaltë;
- Të hyrat nga privatizimi mbahet jashtë vendit të bllokuara në formë të depozitave. Edhe pse është çuar shumë pluhur për këtë çështje, arsyeshmëria e këtij fakti bazohet në ligjin e likuidimit që thotë se 80% nga të hyrat duhet t'i dedikohet të gjithë kreditorëve të NSh-së që pretendojnë se ndërmarrja në fjalë iu ka mbet borxh;
- Metoda spin-off special është në prag për t'u quajtur e dështuar për shkak të dështimit të pronarëve të rinj për t'i përmbush obligimet e premtuara. Vlerësohet se rreth 196 milionë euro janë premtuar se do të investohen në ndërmarrjet e privatizuara me spin-off special, mirëpo kohëve të fundit është dokumentuar se vetëm një numër i vogël i ndërmarrjeve të privatizuara ka bërë investimet e domosdoshme. Rreth 1000 punëtorë nuk janë punësuar asnjëherë në ndërmarrjet e privatizuara me spin-off special edhe pse ishin premtuar nga pronarët e rinj. Për tetë ndërmarrje, pasi që auditimi ka konstatuar mospërmbushje të zotimeve, aktualisht janë duke u ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me marrëveshjen për zotime dhe strategjinë e monitorimit të ndërmarrjeve;
- Vala e 5-të e privatizimit ka qenë më e suksesshme me rreth 44 milionë euro të hyra nga shitja e ndërmarrjeve të reja. Më e dobëta ka qenë vala e 33-të e privatizimit që solli më pak se 1 milionë euro të ardhura;
- Gjatë procesit të privatizimit në kohën e AKM-së janë privatizuar 21 mijë hektarë tokë bujqësore, ndërsa AKP-ja prej se qeverisë me këtë proces ka privatizuar 2 mijë hektarë. Në proces të privatizimit do të përfshihen edhe 20 mijë hektarë të tjera, kryesisht sipërfaqe me tokë bujqësore;
- Pak investime nga jashtë, vlerësohet se vetëm 9% e investimeve totale vijnë nga jashtë;
- Në maj të vitit 2010, bordi i AKP-së ka aprovuar statusin e 3 "ndërmarrjeve të Gjakovës" si ndërmarrje shoqërore. Rrjedhimisht, këto ndërmarrje do t'i nënshtrohen privatizimit;

Sipas praktikave në rajon, privatizimi zakonisht rezulton me zvogëlimin e vendeve të punës. Pasi që privatizimi dhe transformimi i pronës shoqërore është imperativ për çdo shoqëri në tranzicion, mund të thuhet se procesi i privatizimit në



Kosovë ka pas një tempo dinamike. Në vijim është paraqitur tabela kronologjike lidhur me numrin e ndërmarrjeve nën administrim të AKP-së, sipas regjioneve,

| <b>NSH</b>                                                                   | <b>Gjithsej</b> | <b>Gjilan</b> | <b>Mitrovica</b> | <b>Prishtina</b> | <b>Prizren</b> | <b>Peja</b> |
|------------------------------------------------------------------------------|-----------------|---------------|------------------|------------------|----------------|-------------|
| Nr i NSH-ve                                                                  | <b>600</b>      | <b>141</b>    | <b>108</b>       | <b>155</b>       | <b>62</b>      | <b>134</b>  |
| Ndërmarrjet Private apo Publike                                              | <b>5</b>        | <b>0</b>      | <b>2</b>         | <b>1</b>         | <b>0</b>       | <b>2</b>    |
| Ndërmarrjet nën administrim të AKP                                           | <b>595</b>      | <b>141</b>    | <b>106</b>       | <b>154</b>       | <b>62</b>      | <b>132</b>  |
| Nr.i NSH-ve në Privatizim (nga të cilat):                                    | <b>263</b>      | <b>63</b>     | <b>27</b>        | <b>66</b>        | <b>40</b>      | <b>67</b>   |
| <i>Në Likuidim</i>                                                           | <b>105</b>      | <b>28</b>     | <b>12</b>        | <b>30</b>        | <b>17</b>      | <b>18</b>   |
| <i>Të privatizuara dhe jo në likuidim</i>                                    | <b>158</b>      | <b>35</b>     | <b>15</b>        | <b>36</b>        | <b>23</b>      | <b>49</b>   |
| Nr.i NSH-ve në likuidim të shpallura drejtëpërdrejtë                         | <b>15</b>       | <b>6</b>      | <b>2</b>         | <b>3</b>         | <b>3</b>       | <b>1</b>    |
| Nr.i NSH-ve ende të pa-privatizuara apo ende të palikuiduara: (nga të cilat) | <b>317</b>      | <b>72</b>     | <b>77</b>        | <b>85</b>        | <b>19</b>      | <b>64</b>   |
| <i>Trepca – kompleksi i ndërmarrjeve</i>                                     | <b>25</b>       | <b>1</b>      | <b>20</b>        | <b>0</b>         | <b>1</b>       | <b>3</b>    |
| <i>Administimi direkt</i>                                                    | <b>6</b>        | <b>1</b>      | <b>1</b>         | <b>3</b>         | <b>0</b>       | <b>1</b>    |
| <i>Departmenti i Bujqësisë</i>                                               | <b>26</b>       | <b>2</b>      | <b>0</b>         | <b>19</b>        | <b>0</b>       | <b>5</b>    |
| <i>Të komercializuara nën UNMIK</i>                                          | <b>11</b>       | <b>2</b>      | <b>1</b>         | <b>5</b>         | <b>3</b>       | <b>0</b>    |

ndërmarrjet e privatizuara / në likuidim, etj.

## 2.2 Metodat e privatizimit

|                                                                    |            |            |            |            |           |            |
|--------------------------------------------------------------------|------------|------------|------------|------------|-----------|------------|
| <i>Spin Off special</i>                                            | <b>6</b>   | <b>4</b>   | <b>0</b>   | <b>0</b>   | <b>0</b>  | <b>2</b>   |
| <i>Nr.i rasteve të asetëve</i>                                     | <b>91</b>  | <b>43</b>  | <b>7</b>   | <b>19</b>  | <b>2</b>  | <b>20</b>  |
| Nr. i NSH-ve në likuidim                                           | <b>120</b> | <b>34</b>  | <b>14</b>  | <b>33</b>  | <b>20</b> | <b>19</b>  |
| Nr. i NSH-ve në privatizim dhe likuidimi për t'u bërë              | <b>158</b> | <b>35</b>  | <b>15</b>  | <b>36</b>  | <b>23</b> | <b>49</b>  |
| Nr. i NSH-ve ende të pa-privatizuara e as të shpallura në likuidim | <b>317</b> | <b>72</b>  | <b>77</b>  | <b>85</b>  | <b>19</b> | <b>64</b>  |
| Numri total i portfolios së NSH-ve                                 | <b>595</b> | <b>141</b> | <b>106</b> | <b>154</b> | <b>62</b> | <b>132</b> |
| Numri total i likuidimeve për t'u shpallur                         | <b>475</b> | <b>107</b> | <b>92</b>  | <b>121</b> | <b>42</b> | <b>113</b> |

Në vijim prezantohen metodat e privatizimit të aplikuara nga agjencia, e që janë: metoda spin-off, spin-off special dhe likuidimi vullnetar.

**Spin-off** - Metoda e preferuar e AKM-së për të privatizuar N.Sh.-të që kanë afarizëm të qëndrueshëm ishte metoda “Spin-off”, përmes së cilës asetet dhe detyrimet e kufizuara të një N.Sh.-je barten në Ndërmarrjen e Re. “NewCo” i shitet një investitori dhe të hyrat nga shitja janë depozituar deri më tani në një llogari të mirëbesimit, me qëllim të përdorimit të tyre për përmbushjen e obligimeve kreditore dhe pronësore të mbetura të Ndërmarrjeve shoqërore. Më pastaj, N.Sh.-ja do të likuidohet. Ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar është fituesi i përkohshëm i tenderit. Udhëzimet në lidhje me transferimin e pasurive janë bërë kryesisht për të arritur objektivin për maksimizimin e suksesit komercial të Ndërmarrjes së Re. (p.sh. për ta bërë sa më tërheqëse ndërmarrjen për investues). Në disa raste pasuritë nga një NSH e vetme janë ndarë në disa ndërmarrje të reja”.<sup>41</sup>

**Spin-off Special** - Procedurat e Spin-off special janë aplikuar në N.Sh.-të të cilat përmbushin njërin prej kritereve në vijim:

- Më së paku 300 të punësuar (aktiv) ose,
- Të hyrat e përgjithshme prej së paku 10 milion Euro në vit.

Këtu çmimi i ofruar nuk është përcaktuesi kryesor. Për shkak të rëndësisë së veçantë që kanë ndërmarrjet ku aplikohet spin-off special vendosen edhe një mori kushtesh për ofertuesit. Këto kushte ndryshojnë në varësi të natyrës ekonomike të ndërmarrjes gjegjëse.<sup>42</sup>

**Likuidimi Vullnetar** - proces i cili udhëhiqet nga Rregullorja 2005/48 mbi riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre me autorizimin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe rregullat e likuidimit sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/6 për organizatat e biznesit. Procedura e likuidimit është pothuajse standarde, pra: themelimi i komisionit të likuidimit, lajmërimi i kreditorëve (të njohur me shkrim, të panjohur nëpërmjet mjeteve publike), shitja e asetëve të N.Sh.-së nëpërmjet tenderit, pagesa e kreditorëve, si dhe mjetet financiare të mbetura futen në fondin e mirëbesimit. Likuidimi është procedurë që iu jep mundësinë ndërmarrjeve me biznes të gjymtë që të shuhet dhe të pushojnë së ekzistuari tërësisht. Procedura për likuidimin e NSH-ve mundëson që të ardhurat nga shitja e pasurive të asaj ndërmarrje t'u ndahen në mënyrë të drejtë kreditorëve

<sup>41</sup> Politikat Operacionale të AKM-së, Nëntor 2006

<sup>42</sup> Ibid

të NSH-ve, në pajtim me prioritetet e themeluara me ligj, dhe çfarëdo teprice eventuale t'u ndahet pronarëve ligjor.<sup>43</sup>

### **2.3 Privatizimi i pronës publike**

Vitin e kaluar AKP-ja është eliminuar nga procedura e privatizimit të NP-ve, pa marrë parasysh përvojën e saj në privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha. Privatizimi i NP-ve është transferuar kështu te Qeveria, duke i dhënë kompetencat të ndjeshme Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Ligji mbi NP-të lejon formimin e Komisioneve Qeveritare për Privatizim, përmesës cilave mund të bëhet privatizimi i çdo ndërmarrje publike.

Janë dy mënyra për të transformuar një ndërmarrje publike në pronësi private. E para, një NP mund të kalojë nëpër procesin e privatizimit tradicional, ose më mirë të themi t'u nënshtrohet shitjes së aksioneve të NP-së një subjekti privat. Mirëpo, nga ana tjetër, një NP mund të kalojë në pronësi private përmes një partneriteti publiko-privat dhe/ose dhënies me koncesion për të ndërtuar, përdorur dhe/ose shfrytëzuar infrastrukturën në pronësi publike, si dhe për të ofruar shërbime publike. Këto dy metoda janë adresuar në mënyrë të veçantë, duke u thelluar më shumë në të parën.

Baza ligjore për privatizimin e plotë apo të pjesshëm të një NP-je në Republikën e Kosovës mund të gjendet në Ligjin për Ndërmarrjet Publike ("Ligji për NP"). Domethënë, Ligji për NP-të bën fjalë për "shitje të aksioneve," që mund të interpretohet se ky ligj lejon privatizim të pjesshëm ose të plotë të NP-së në fjalë, varësisht nga vendimi i Qeverisë.

Shitjen e aksioneve e mundëson Ligji mbi Ndërmarrjet Publike, sipas të cilit brenda një kohe të caktuar të gjitha NP-të duhet të organizohet si Shoqërive Aksionare ("SHA"). Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, një SHA "është një person juridik që zotërohet nga aksionarët e saj, por që legalisht është i ndarë dhe i veçuar nga aksionarët e saj. "Statusi i SHA sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare është i ngjashëm me statusin e korporatave të cilat mund t'i gjejnë në vendet anëtare të BE-së apo në Shtetet e Bashkuara, me ndryshime të vogla dhe më pak të ndërlikuara. Aksionari i vetëm i një NP-je qendrore është Republika e Kosovës, të drejtat aksionare të së cilës ushtrohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ligji mbi Shoqëritë Tregtare nuk e kufizon transferimin e aksioneve nga Qeveria e Republikës së Kosovës në ndonjë subjekt tjetër.<sup>44</sup>

Një ndër çështjet që duhet të merret parasysh gjatë privatizimit të ndërmarrjeve publike do të ishte vlerësimi i momentit më të përshtatshëm të privatizimit të tyre dhe cila nga ndërmarrjet duhet të privatizohet e para sipas radhës. Sa i përket momentit të privatizimit të ndërmarrjeve publike, për shkak të rrethanave ekzistuese do të duhej të pritej një moment më i volitshëm se ky i tanishmi. Shkaqet përmbledhen në tre pika, si në vijim:

---

<sup>43</sup> Rregullorja e UNMIK 2005/48, 2005

<sup>44</sup> Riinvest, "Dilema dhe ngecje në rrugën e shpejtë Privatizimi i ndërmarrjeve publike në Kosovë", 2009

- Kriza globale që po rikthehet dhe e cila do të ndikonte drejtpërsëdrejti në uljen e ndjeshme të vlerës së privatizimit dhe Kosova do të merrte qindra miliona Euro më pak;
- Përkeqësimi i klimës së biznesit në Kosovë. Shumë institucione relevante ndërkombëtare përfshirë këtu edhe Bankën Botërore kanë konstatuar se klima e biznesit në Kosovë është përkeqësuar dhe ju kanë bërë apel investitorëve të huaj që mos të investojnë në Kosovë. Edhe kjo do të ndikonte në uljen e vlerës së tregut të ndërmarrjeve publike;
- Performancë e dobësuar e ndërmarrjeve publike;

Çështje tjetër për t'u marrë në konsideratë nga qeveria është çështja e kërkesave të porealizuara të ndërmarrjeve publike që kanë ndaj konsumatorëve të papërgjegjshëm. Dihet se këto kërkesa janë mbi 300 milion euro. Pasi që këto mjete në një mënyrë janë të taksapaguesve kosovarë, realizimi i tyre do duhej të zgjidhet paraprakisht me privatizimin apo përzgjedhjes së modalitetit të privatizimit të tyre në mënyrë që ato të kthehen në Buxhetin e Kosovës.

### **Konkluzione**

*Privatizimi në Kosovë ka një histori të vështirë.* Rezultatet nga privatizimi i deritashëm i ndërmarrjeve shoqërore tregojnë se privatizimi me gjithë barrierat dhe vështirësitë e natyrave të ndryshme nëpër të cilat ka kaluar, ka funksionuar dhe se ai ka qenë mjaft ambicioz. Në opinionin publik, ky proces është karakterizuar me bllokim të mjeteve nga privatizimi, pak investitorë, shumë vonesa, çmime të lira, zvogëlim të numrit të punëtorëve, mospërmblidhje të premtimeve të blerësve, vonesa të shpërndarjes së 20-përqindëshit të punëtorëve, e shumë probleme të tjera.

Çështja e bllokimit të mjeteve nga privatizimi është një çështje që rregullisht kritikohet ashpër nga opinioni publik, e që është e drejtë shikuar nga prizmi ekonomik. Mirëpo, kjo është një çështje që rregullohet me ligj dhe çdo koment që bie ndesh me normat ligjore është i pabazë. Pjesa e 20% është për t'u ndarë për punëtorët, ndërsa 80% në parim mbahet në mirëbesim nga agjencia për të kënaqur kërkesat eventuale të kreditorëve potencial të ndërmarrjes përkatëse shoqërore, e të cilat do duhej të realizoheshin gjatë procesit të likuidimit. Vetëm pasi të bëhet shlyerja ligjore e ndërmarrjes shoqërore, përkatësisht likuidimi i saj, një teprice eventuale mund t'i bartet qeverise respektivisht buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Sa i përket shpërndarjes së 20% punëtorëve legjitimë të ndërmarrjes, ka pasur vonesa të ndjeshme e në disa raste ato nuk janë zgjidhur fare. Është e natyrshme që oda e veçantë ndodh shpesh të përballet me padi / kërkesa / ankesa të numërta e posaçërisht për ndërmarrjet e mëdha të cilët kishin me qindra apo mijëra punëtorë të punësuar. Shqyrtimi i tyre bëhet një nga një dhe natyrisht se çështjet e tilla procedurale konsumojnë kohë. Një rekomandim logjik për të shuar pakënaqësinë e sindikatës dhe revoltën e drejtë të punëtorëve, do të ishte që të gjithë punëtorëve që gjenden në listën e aprovuar nga AKP-ja (shkalla e I-rë) t'u shpërndahen mjetet në kuotën prej 75%, përderisa lista nuk ratifikohet përfundimisht nga oda e veçantë e Gjykatës Supreme.

Sido që të jetë, ekziston një konsensus i përbashkët i të gjithë akterëve në procesin e privatizimit, institucioneve relevante, qeverisë së Kosovës, bashkësisë ndërkombëtare etj, se privatizimi është domosdoshmëri për Kosovën dhe ai duhet të përkrahët nga të gjithë. Sa më parë të përfundojë një proces i tillë i vështirë, aq më tepër do të krijohen kushtet për zhvillimin e një ekonomie të tregut për të cilën tashmë është përcaktuar shoqëria jonë. Është e vërtetë që efektet pozitive të privatizimit ndikojnë në ekonominë kombëtare, mirëpo privatizimi nuk është gjithçka. Ambienti i mjedisit, siguria, investimet nga jashtë, politika fiskale, kreditore, etj janë faktorë makroekonomik me peshë të pakontestueshme për zhvillimin ekonomik, e që në rastin tonë nuk po tregojnë rezultate mbresëlënëse. Këta faktorë janë të lidhur ngushtë njëri me tjetrin, prandaj duhet të aplikohen masa uniforme për të siguruar një klimë atraktive dhe të shëndoshë për zhvillim e biznesit.

Një sfidë esenciale për qeverinë e Kosovës, padyshim se mbetet privatizimi i ndërmarrjeve publike. Modeli i privatizimit të tyre duhet të përzgjidhet me kujdesin më të madh për arsye se disa nga këto ndërmarrje kanë rëndësi të veçantë strategjike në zhvillimin ekonomik të vendit.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të ishte e udhës që së pari t'i privatizojë ato ndërmarrje publike që janë duke e ngarkuar buxhetin e shtetit siç janë: KEK-u, Hekurudhat e Kosovës dhe Termokos-in, e jo ato që operojnë me sukses dhe i kontribuojnë buxhetin të Kosovës siç ishte rasti i Aeroportit të Prishtinës. Me rastin e privatizimit të KEK-ut duhet të kihet kujdes që së pari të privatizohet rrjeti shpërndarës e më vonë pjesa e prodhimit.

Qeveria nuk ka një politikë funksionale sa i përket përdorimit të fondeve nga privatizimi i NP-ve. Aspekte kyçe të kësaj çështjeje duhet të debatohen në Kuvend, në mesin e akademikëve dhe të shoqërisë civile. Pasi që këto korporata janë për të shërbyer për interesin publik në përgjithësi, për gjeneratat aktuale dhe ato të ardhshmet, konsiderohet se një pjesë e madhe e këtyre fondeve, pas shlyerjes së kostos së transaksionit, do të duhej të përdoret për investime publike në infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi, grante për financimin e sektorëve deficitarë ekonomike, etj.

## Referencat

1. Andria Gams, "Osnovi Stvarnog Prava", 1978;
2. Aliu N, "Transformi i pronës", 2006
3. Buletini Ekonomik, qershor 2007;
4. Fetahu Adil, "Transformimi dhe Privatizimi i pronës shoqërore në Kosovë", Prishtinë, 2002
5. Jovan Đ, 1965, në Grahovac B, "Restrukturiranje i privatizacija javnog preduzeća", 2001
6. Management Information System (MIS), AKP, November, 2009;
7. Muharremi R, "Administrimi dhe Qeverisja ne Kosovë, 2005,
8. Pasqyra e përgjithshme a pakos së Ahtisarit, 2007;
9. Politikat Operacionale të AKM-së, Nëntor 2006;

10. Raporti i punës AKP, 2009
11. Raporti i OSBE-së, Privatizimi në Kosovë, Maj 2008;
12. Rregullorja e UNMIK-ut nr., 2002/12; Rregullorja e UNMIK-ut nr., 2005/18;
13. Riinvest, “Dilema dhe ngecje në rrugën e shpejtë, Privatizimi i ndërmarrjeve publike në Kosovë”, 2009
14. Selmanaj Selman, “Globalizimi dhe Tranzicioni – dilemat dhe sfidat”, 2006;
15. Statistikat e Tregtisë së Jashtme tetor 2008, Enti Statistikor i Kosovës;
16. Web Faqet: <http://www.ear.eu>; <http://www.pak-ks.org>;

## **Baza e të dhënave (databaza) e krijuar në analizën e gjendjes së shfrytëzimit të ECTS sistemit në Universitetin e Prishtinës, Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe Universitetin e Evropës Juglindore**

Dr. Edmond Beqiri  
ebeqiri@gmail.com

### **Abstrakt**

Autori këtë punim kërkimor e përgatiti i angazhuar në cilësinë e ekspertit nga Komisioni Evropian si pjesë të projektit "TEMPUS-project SM SCM-C013B04 KOSOVO, FYROM". Në kuadër të projektit "Promovimi i Bolonjës dhe implementimi i ECTS në Universitetin e Prishtinës, Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë", është organizuar një Anketë në të tri institucionet e arsimit të lartë duke i shfrytëzuar pyetësorët për vetëvlerësim "ECTS/DS programi për këshillim dhe vizita" të disenjuar nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane (AUE). Në pjesën kërkimore të punimit, gjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor është bërë një anketim i disa dekanëve të fakulteteve dhe i shefave të departamenteve në të tre universitetet. Nga 50 pyetësorë të plotësuar është ardhë deri te konstatimi i përdorimit të ECTS sistemit në të tre institucionet. Autori nga pyetësorët krijoi bazën e të dhënave dhe nga ajo përfitohet pasqyra e qartë krahasuese për implementimin e sistemit ECTS në këto tre Universitete. Analiza krahasuese e fituar bjen deri te përfundimet relevante mbi shfrytëzueshmërinë e ECTS sistemit në Universitetin e Prishtinës, Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë.

**Fjalët kyçe:** ECTS, teknologji, informacion, informatë, Bazë e të dhënave, Databazë,

**JEL Kualifikimi:** O030; O032;

**HYRJE**

Si pjesë e projektit "Promovimi i Bolonjës dhe implementimi i ECTS në Universitetin e Prishtinës, Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë", është organizuar një Anketë në të tri institucionet e arsimit të lartë duke i shfrytëzuar pyetësorët për vetëvlerësim "ECTS/DS programi për këshillim dhe vizita" të disenjuar nga AUE. Pyetësori për vetë-vlerësim përbëhet nga formulari i cili është logjikisht i ndarë në dy pjesë:

- ☐ Pjesa A e cila trajton perspektivën e Institucionit dhe
- ☐ Pjesa B e cila trajton perspektivën e Departamentit

Pjesa A, perspektiva e institucionit, më tutje përfshinë pyetjet në lidhje me:

I. ECTS

- II. Shtojcën e diplomës (DS)  
Pjesa B, perspektiva e departamentit, përfshinë pyetjet në lidhje me:
- I. Parimet e ECTS-së
- II. Informacionin
- III. Marrëveshjen e mësimit
- IV. Pasqyrën e notave (ToR)
- V. Njohjen Akademike

Krijimi i bazës së të dhënave dhe përpunimi i të dhënave nga pyetësorët është bërë nga ekipi në përbërje: Dr. Edmond Beqiri, Dr. Ferdije Zhushi dhe Dr. Avdulla Alija.

### **I. Përshkrim i shkurtër i Institucioneve të anketuara**

Institucionet e përfshira në projekt janë Universiteti i Prishtinës, Universiteti Shtetëror i Tetovës dhe Universiteti i Evropës Juglindore.

#### **Universiteti i Prishtinës**

Universiteti i Prishtinës është institucioni kryesor publik i arsimit të lartë në Kosovë. Ky është një Universitet i madh që është i përbërë nga njësitë akademike dhe njësitë organizative. Është i themeluar në vitin 1970.

Universiteti i Prishtinës i ka 17 njësi akademike, prej të cilëve 14 fakultete dhe 3 fakultete të shkencave të aplikuara. Të gjitha këto fakultete kanë më shumë departamente ose drejtime për studim. Poashtu në përbërje të tij janë edhe disa Institute shkencore si njësi organizative të Universitetit.

Nga viti akademik 2001/2002 ka filluar implementimin e reformimit sipas Deklaratës së Bolonjës, e me këtë edhe përdorimin e ECTS kreditimit si mënyrë e akumulimit të kredive mësimore.

Është një Universitet i cili ofron pothuaj se të gjitha degët e studimit që mund të studiohen në Kosovë. Ky Universitet ka të regjistruar rreth 30000 studentë dhe është anëtar i EUA.

Në Universitetin e Prishtinës momentalisht funksinojnë fakultetet vijuese:

1. Fakulteti Filozofik
2. Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore
3. Fakulteti i Filologjisë
4. Fakulteti Juridik
5. Fakulteti Ekonomik
6. Fakulteti i Ndrëtimtarisë dhe Arkitekturës
7. Fakulteti i inxhinierisë elektrike dhe kompjuterike
8. Fakulteti i inxhinierisë mekanike
9. Fakulteti i Mjekësisë
10. Fakulteti i Arteve
11. Fakulteti i Bujqësisë
12. Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë
13. Fakulteti i Kulturës Fizike



14. Fakulteti i Edukimit
15. Fakulteti i shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë
16. Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara në Mitrovicë
17. Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara në Ferizaj

### **Universiteti Shtetëror i Tetovës**

Universiteti Shtetëror i Tetovës është Universiteti i tretë publik në Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë. Ky Universitet është themeluar më 1994 dhe në fillim ka pas 10 Fakultete me drejtimet përkatëse. Në vitin akademik 2003/2004 është bërë një reformim i tërësishëm i Universitetit, me të cilin rast disa fakultete kanë pushuar që të funksionojnë për shkak të mosplotësimit të kushteve dhe disa fakultete tjera janë degraduar në drejtime të Fakulteteve më të mëdha. Në këtë mënyrë Universiteti tashti përbëhet nga pesë fakultete kryesore në të cilat studiojnë rreth 13000 studentë.

Universiteti ka filluar me implementimin e Deklaratës së Bolonjës dhe përdorimin e ECTS-së në vitin akademik 2004/2005.

Në Universitetin Shtetëror të Tetovës momentalisht funksinojnë fakultetet vijuese:

- ☐ Fakulteti Ekonomik
- ☐ Fakulteti Juridik
- ☐ Fakulteti Filozofik
- ☐ Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore
- ☐ Fakulteti i Mjekësisë dhe
- ☐ Fakulteti Politeknik.

### **Universiteti i Evropës juglindore**

Universiteti i Evropës Juglindore është një Universitet Bashkëkohor privat i themeluar në vitin 1999 me ndihmën e Bashkësisë Evropiane dhe të Departamentit të SHBA. Ky Universitet ka një infrastrukturë shumë funksionale dhe organizim bashkëkohor. Përbëhet nga 5 Departamente kryesore në të cilat studiojnë rreth 6000 studentë.

Universiteti i Evropës Juglindore në fillim më shumë është bazuar në modelin amerikan të organizimit të institucioneve të larta dhe programet janë mjaftë kompatible me universitetet amerikane. Nga viti 2004 i ka filluar reformat për t'u adaptuar në sistemin e studimit sipas Deklaratës së Bolonjës dhe sistemit të kreditimit ECTS.

Në Universitetin e Evropës Juglindore momentalisht funksinojnë Departamentet vijuese:

- ☐ Fakulteti Juridik
- ☐ Departamenti Administrim Biznesi
- ☐ Departamenti Administrim Publik
- ☐ Departamenti i shkencave dhe teknologjive të komunikimit
- ☐ Fakulteti Pedagogjik.

## **II. Analiza krahasuese e pyetësorëve**

Gjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor janë anketuar dhe plotësuar 50 pyetësorë të vetëvlerësimit në të tre Universitetet e përmendura. Sipas Universiteteve kemi pranuar dhe vlerësuar:

- ❑ Universiteti i Prishtinës 22 pyetësorë
- ❑ Universiteti Shtetëror i Tetovës 7 pyetësorë
- ❑ Universiteti i Evropës Juglindore 21 pyetësorë.

Udhëzimi ka qenë që pyetësorët në pjesën A e cila trajton perspektivën e Institucionit të plotësohen nga udhëheqësit e institucionit-Dekanët, ndërsa në pjesën B e cila trajton perspektivën e Departamentit nga udhëheqësit e Departamenteve-Shefat e Departamenteve.

Për shkak të organizimit qendror në UEJL, në shumë pyetësor përgjigjet kanë qenë shumë të ngjashme.


Në vazhdim do të mundohemi që të bëjmë një analizë krahasuese të pyetësorëve në fjalë.

### **Analiza krahasuese nga perspektiva e institucionit**


Në pjesën e pyetësorit e cila shqyrton perspektivën e institucionit përgjigjet në shumë pyetje kanë qenë pothuajse identike.

Nga përgjigjet e të anketuarve mund të konstatohet si e përbashkët për të 3 Universitetet në Kosovë dhe në Maqedoni është se:

- ❑ ECTS është sistem kombëtar i kredive,
- ❑ ECTS përdoret si sistem akumulimi dhe transferi,
  - në UEJL kemi 17 përgjigje që përdoret si sistem akumulimi dhe transferi dhe 5 përgjigje që përdret si si sistem transferi
  - në USHT kemi 4 përgjigje që përdoret si sistem akumulimi dhe transferi, 1 përgjigje si sistem transferi dhe 2 përgjigje si sistem akumulimi
  - Në UP kemi 14 përgjigje që përdoret si sistem akumulimi dhe transferi dhe 7 përgjigje që përdret si si sistem transferi dhe një përgjigje “JO”.




- ❑ Sistemi i kreditimit ECTS përdoret në të gjitha programet e studimit të institucionit,
- ❑ Në asnjë nga këto universitete nuk përdoret ndonjë sistem tjetër i kreditimit,
- ❑ Universiteti i Prishtinës dhe i Evropës Juglindore kanë njësi të veçantë edhe në nivelin qendror edhe në nivel të fakultetit/departamentit që merret me ECTS-në, ndërsa Universiteti Shtetëror i Tetovës është në themelimi të njësisë qendrore për ECTS.
- ❑ Sistemi i kreditimit ECTS përdoret në ciklin e parë dhe të dytë të studimit në të tri Universitetet dhe ende nuk ka filluar të përdoret në ciklin e tretë.
- ❑ ECTS sistemi i kreditimit ende nuk përdoret në ciklin tërë jetësor të studimit
- ❑ ECTS sistemi i kreditimit përdoret për programe intensive, kryesisht shpjegimi është për Universitetin Veror në Kosovë ose Universitetin Dimëror në Maqedoni.
- ❑ ECTS sistemi i kreditimit përdoret për akreditimin e mësimi të mëparshëm.
- në UEJL kemi 15 përgjigje që ECTS përdoret për akreditimin e mësimi të mëparshëm 2 përgjigje se nuk përdoret dhe 4 përgjigje “nuk e di”.
- në USHT kemi 5 përgjigje që ECTS përdoret për akreditimin e mësimi të mëparshëm dhe 2 përgjigje se nuk përdoret
- Në UP kemi 10 përgjigje që ECTS përdoret për akreditimin e mësimi të mëparshëm dhe 11 përgjigje se nuk përdoret.



- ❑ Në shumicën e përgjigjeve në lidhje me Kalendarin akademik është fituar rezultati i njëjtë 30 javë. Vetëm në 3 pyetësorë nga USHT është fituar përgjigja 38-40 javë.
- ❑ Në të tre institucionet vetëm disa programe janë të modularizuara dhe definohet arritja e mësimit në module.

| ISHL | Modularizim i pjesërishtëm | Modularizim i tërësishëm | Nuk e di |
|------|----------------------------|--------------------------|----------|
| UP   | 20%                        | 65%                      | 15%      |
| UEJL | 48%                        | 30%                      | 22%      |
| USHT | 100%                       |                          |          |



- ❑ Programet e të tre universiteteve janë të akredituara. Programi i Universitetit të Prishtinës ka qenë i akredituar deri më 2009 me anë të Ligjit mbi Arsimin e Lartë dhe nga ky vit është fituar Akreditimi institucional nga Agjencioni për Akreditim i Kosovës dhe programet e Universitetit Shtetëror të Tetovës dhe të Universitetit të Evropës Juglindore nga Këshilli për Akreditim i Republikës së Maqedonisë.

- ❑ Nuk ka në Kosovë as në Maqedoni koordinator kombëtar për ECTS.
- ❑ ECTS konsiderohet si element për reformimin e kurrikulës, meqenëse paraqitet një tendencë për unifikim të programeve, zhvillimin e planprogrameve, mobiliteti i studentëve mundëson reformën e lehtësuar etj.
- ❑ Zhvillimi i ECTS-së në të tre institucionet pritet që të shkojë kah krijimi i marrëveshjeve bilaterale, përdorimi i shtojcës së diplomës, transferi i kredive, njohja e studimeve etj.

Gjatë analizës së pyetësorëve është vërejtur një ngjashmëri e madhe e përgjigjeve nga të anketuarit e të 3 institucioneve.

Në përgjigjet në lidhje me fillimin e zbatimit të ECTS-së mund të vërehet se Universiteti i Prishtinës filloi ta zbatojë ECTS-në si sistem akumulimi dhe transferi nga viti 2001/2002, Universiteti i Evropës Juglindore nga viti akademik 2002/2003 dhe Universiteti Shtetëror i Tetovës nga viti akademik 2004/2005. Deri më tash transferi i kredive me marrëveshje bilaterale është realizuar kryesisht nga Universiteti veror i Prishtinës dhe Universiteti Dimëror në Maqedoni, kurse në shumë raste është realizuar pa marrëveshje bilaterale.

Të anketuarit nuk e kanë përfshirë edhe sesionin e provimeve dhe kohën e përgatitjeve për provim (një muaj gjatë dimrit dhe një muaj në verë) në vitin Akademik të studimeve.

Asnjë nga të tre universitetet e anketuara nuk e gjenerojnë në mënyrë automatike shtojcën e diplomës për studentët që diplomojnë. Sipas përgjigjeve ka disa raste individuale të Fakulteteve apo Departamenteve në Universitetin e Prishtinës dhe në UEJL që sipas kërkesës personale të studentëve që dëshirojnë t'i vazhdojnë studimet jashtë u gjenerohet një shtojcë e diplomës, por jo e standardizuar sipas udhëzimeve që ndiqen nga Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës dhe UNESCO/CEPES.


### **Analiza krahasuese nga perspektiva e departamentit**

Nga anketimi i përgjegjësve të departamenteve në Universitetin e Prishtinës, Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe Universitetin e Evropës Juglindore, kemi fituar përgjigje në lidhje me parimet e ECTS-së, Informacionin në lidhje me ECTS-në, Marrëveshjen e mësimit, Pasqyrën e notave, dhe njohjen akademike.

Nga të tre institucionet kemi marrë përgjigje të ngjashme dhe ato kryesisht janë si në vijim:


- ❑ ECTS kreditë alokohen në bazë të ngarkesës së studentit

|      | Alokohen në bazë të ngarkesës së studentit | Nuk alok. në bazë të ngarkesës së studentit | Nuk e di |
|------|--------------------------------------------|---------------------------------------------|----------|
| ISHL |                                            |                                             |          |
| UP   | 18                                         | 3                                           | 1        |
| UEJL | 19                                         | 0                                           | 3        |
| USHT | 7                                          |                                             |          |



- ☐ ECTS kreditë alokohen për të gjitha aktivitetet si pjesë e një programi të studimit

|      | Alokohen për të gjitha aktivitetet në program | Nuk alok. për të gjitha aktivitetet në program | Nuk e di |
|------|-----------------------------------------------|------------------------------------------------|----------|
| ISHL |                                               |                                                |          |
| UP   | 18                                            | 3                                              | 1        |
| UEJL | 18                                            | 0                                              | 3        |
| USHT | 7                                             |                                                |          |



- ☐ Alokimin e kredive e vendos Këshilli i Fakultetit/Departamentit përkatës.

- ❑ Përgjegjës për sigurimin se ECTS kreditë janë ndarë sipas parimeve të ECTS janë Dekanatet në UEJL, Komisioni për stuime i nëjsisë akademike në Universitetin e Prishtinës, Komisioni për ECTS në Universitetin Shtetëror të Tetovës.
- ❑ Ndryshimi i alokimit të kredive zakonisht bëhet në vijën: Komisioni përkatës (i studimeve) i propozon Këshillit të Fakultetit, ndërsa Këshilli i Fakultetit i propozon organit kompetent në Rektorat (Senatit të Universitetit) , i cili e merr vendimin.
- ❑ Disa nga programet e studimeve në të tre universitetet janë të modularizuara dhe janë të definuara arritjet e mësimit për modul. Modulet janë të kredituara me çfarëdo numri të kredive (p.sh. 2, 3, 4, 4.5, 6 etj.)
- ❑ Në kurrikulat e të tre universiteteve çdo vit është i barabartë me 60 ECTS kredi.
- ❑ Studenti kreditë i fiton pas dhënies së provimit i cili organizohet vetëm nëse ka marrë pjesë në mësim, teste, seminare, ushtrime dhe aktivitetet tjera sipas programit të lëndës mësimore.
- ❑ Studenti nuk mund të merr më shumë apo më pak kredi se sa që janë përcaktuar për modulin e caktuar.
- ❑ Studenti diplomon në UEJL në qoftë se ka arritur të mbledh të gjitha kreditë e parapara për programin që ka regjistruar, ndërsa në UP dhe USHT fiton të drejtën për mbrojtje publike të diplomës.

Në Universitetin e Prishtinës është botuar udhëzuesi për ECTS në vitin 2002. Në Universitetin e Prishtinës dhe në Universitetin e Evropës Juglindore shumica e fakulteteve kanë prodhuar pakon informative jo plotësisht të bazuar në udhëzimin për ECTS, në Universitetin Shtetëror të Tetovës ka filluar procesi i përpilimit të pakove informative.

Pakot informative kryesisht janë botuar në gjuhën shqipe, ndërsa në UEJL janë botuar edhe në gjuhën angleze dhe maqedone.

Pakot informative të Universitetit të Prishtinës dhe të Universitetit të Evropës Juglindore janë të botuara edhe në web në adresat:

- ❑ Universiteti i Prishtinës, [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)
- ❑ Universiteti i Evropës juglindore, [www.see-university.edu.mk](http://www.see-university.edu.mk)

Pakot informative në web, sipas përgjigjeve, zakonisht freskohen çdo vit në fillim të vitit akademik.

Në lidhje me marrëveshjen e mësimit, në më shumë se 80% të pyetjeve të anketuarit janë pëgjigjur me “nuk e di”, ose “nuk kam përgjigje”. Sipas përgjigjeve mund të konstatohet se këto universitete ende nuk kanë përvojë me marrëveshje bilaterale për transfer të studentëve.

Që të tri Universitetet e gjenerojnë Pasqyrën e notave, e cila në Universitetin e Prishtinës përdoret e standardizuar sipas ECTS-së, kurse në UEJL dhe USHT gjenerohet një dokument, i cili nuk i përfshinë të gjitha elementet sipas ECTS standardeve, p.sh. notat sipas ECTS.

Notat ECTS nuk përcaktohen në asnjërin nga të tre institucionet sipas të dhënave statistikore, por bazohen në ngjashmërinë e sistemit të notimit nacional me sistemin ECTS sipas formulës: 10=A; 9=B; 8=C; 7=D; 6=E; 5=F (dhe FX).

Zakonisht pasqyrën e notave e cila ruhet në bazën e të dhënave të Fakultetit, në të tre universitetet e nënshkruan referenti përkatës ose Sekretari i Fakultetit.

Në lidhje me njohje Akademike të pjesës së studimeve kur studentët kthehen nga jashtë, për të tre universitetet kemi përgjigjen se këtë e bën organi kompetent në Fakultet/Departament. Në qoftë se programi nuk përputhet së paku 50%, zakonisht organizohet përsëritja e provimit. Studenti mund të hyj në provim në sesionin e parë të paraparë të studimeve, i cili zakonisht në të tre universitetet organizohet përafërsisht çdo 2 muaj. Rregulloret nuk parashohin kompensim për dështim në provim. Kurset e ndjekura jasht zakonisht përfshihen si kurse zgjedhore apo opcionale. Zakonisht ECTS notat konvertohen në nota lokale në qoftë se pranohen.

### **III. Përfundimi me Rekomandime**

Në bazë të analizës së 50 pyetësorëve vetëvlersues në lidhje me implementimin e ECTS-së në Universitetin e Prishtinës në Kosovë, në Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë mund të konstatohet se që të tre këto universitete e përdorin ECTS si sistem për akumulim dhe transfer të kredive në dy cikle të studimit.

Universiteti i Prishtinës ka botuar në gjuhën nacionale edhe udhëzuesin për ECTS që nga viti 2002, të cilin e ka botuar edhe në Web. Poashtu ka botuar pakot informative në nivel të fakulteteve në gjuhën nacionale. Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë i ka reformuar programet dhe ka botuar pako informative të shtypura dhe në web në nivel departamentesh në gjuhën angleze dhe në të dy gjuhët nacionale: shqip dhe maqedonisht. Universiteti Shtetëror i Tetovës i ka reformuar programet dhe ka botuar një material informativ të shkurtër në lidhje me ECTS-në.

Që të tre këto Universitete e kanë aprovuar ECTS-në si sistem të vetëm të kreditimit. Programet e tyre janë të Akredituara nga organet gjegjëse Shtetërore.

Në Universitetin e Prishtinës prej vitit 2002 organizohet edhe Universiteti Veror i Prishtinës me lëndë mësimore (kurse) intensive të kredituara, të cilat pa problem transferohen në Universitetet tjera të rajonit. Universiteti i Evropës Juglindore ka pasë transfer të ngjashëm të kredive nga vitin 2005 nga Universiteti Dimëror në Maqedoni.

Në bazë të vlerësimeve tona rekomandojmë që të kushtohet më shumë vëmendje në:

- ❑ Krijimin dhe botimin e pakove informative të të gjitha niveleve në gjuhën nacionale dhe angleze, gjë që do të ndihmonte në standardizimin e silabuseve, të arriturave në mësim, ngarkesës së studentëve me theks të veçantë në atë që provimi përfundimtar është vetëm finalizimi i procesit të përfitimit të kredive.
- ❑ Krijimin e Marrëveshjeve Bilaterale zyrtare për transfer dhe mobilitet të studentëve.



- ❑ Gjenerimin në mënyrë automatike të Shtojcës së Diplomës në gjuhën angleze
- ❑ Organizimin e mësimit tërë-jetësor dhe kreditimin e këtij mësimi.
- ❑ Gjenerimin e Pasqyrës së notave sipas formularit standard
- ❑ Njohjës akademike më të thjeshtësuar të pjesës së studimeve të kryer jasht.
- ❑ Definimin e ngarkesës së studentëve
- ❑ Definimi më i qartë i modularizimit të programeve
- ❑ Interdisiplinariteti
- ❑ Harmonizimi i programeve me qëllim të transferit
- ❑ Rregulloret e studimeve në këto Universitete të harmonizohen me principet e ECTS.

### **Referencat**

1. Beqiri, Dr. Edmond, "ECTS në Universitetin e Prishtinës", Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2002
2. Monografia e Universitetit të Prishtinës, UP 2005
3. Deklarata e Bolonjës, 19.09.1999
4. Pyetësori për vetëvlerësim "ECTS/DS programi për këshillim dhe vizita" të disenjuar nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane (AUE).



## ZNAČAJ I NEOPHODNOST ORGANIZACIONIH PROMJENA

*Mr. Elida Ciriković*  
*c\_elida@hotmail.com*

### Abstrakt

Osnovni cilj ovog rada je da ukaže na značaj organizacionih promjena u savremenom poslovanju organizacija, a posebno imajući u vidu vrlo promjenljivo okruženje u kojem se obavlja privređivanje. Fleksibilnost na promjene je ključni faktor opstanka i razvoja organizacije. Dinamika u okruženju dovodi do toga da je sve manje vremena za adaptaciju, gdje do izražaja dolazi sposobnost menadžmenta da u vrlo kratkom roku donese prave odluke. Stepenu neizvjesnosti i stalnog praćenja promjena u okruženju, sve više doprinosi liberalizacija i globalizacija, koje pored pozitivnih, donose i uslovno rečeno poteškoće koje se ogledaju u sve većoj dinamici promjena. Zato je na menadžerima i personalu organizacije, odgovornost i zadatak stalnog praćenja promjena u okruženju, a u cilju blagovremene adaptiranosti, a koje su istovremeno i prijetnja i šansa za svaki poslovni subjekt. Neblagovremeni i neefikasan odgovor na promjene može dovesti do pada performansi poslovne organizacije.

**Ključne riječi:** Organizacija, struktura, promjena, faktori, okruženje, tehnologija, otpor, motivacija, kolektiv, efikasnost, fleksibilnost, performanse, globalizacija.

**JEL klasifikacija:** L2, L11,

### Uvod

Sa punim pravom se može reći da je XXI vijek, vijek promjena. Poslovne organizacije se moraju naučiti prilagođavati ili menjati vrlo brzo i lako, jer u suprotnom, neće moći opstati u promjenljivom i turbulentnom okruženju, kakvo srećemo danas i koje ima tendenciju ka sve većoj kompleksnosti. Ovdje se upravo vidi značaj i važnost menadžera, koji imaju za cilj i zadatak da uočavaju potrebe za promjenama, da ih definišu i uspješno vode zaposelne ka efikasnijoj promjeni istih. Zato, pored znanja, njima su potrebni još i vještina vođenja tokom sprovođenja organizacionih promjena, kao i vještina uključivanja zaposlenih.

U ovom radu će, na početku biti definisan pojam organizacionih promjena, sa akcentom na one komponente organizacije na koje se promjene najčešće odnose. Posebno treba stati na potrebu za fleksibilnošću, kao uslovom opstanka.

Nakon definisanja pojma promjena, dat je kratak osvrt na podjele promjena sa više aspekata, a suština je kod svake podjele, da promjena može imati dve strane, svoj pod i antipod..

Na svaku svjesnu ljudsku aktivnost, pa time i na poslovnu, utiču brojni faktori, koji u stvari iniciraju uvođenje promjena, a svi oni se mogu podijeliti na one koji djeluju unutar same organizacije i one koji spolja, eksterno utiču na proces iniciranja promjena. U svim slučajevima, pa i kod uvođenja promjena, lakše je djelovati na faktore unutar organizacije (interne) nego na one koji nam dolaze iz okruženja (eksterni). Pored onih koji će biti nabrojeni, u eksterne faktore možemo svrstati i institucionalne, pravne, političke.

Da bi efikasno realizovali promjene, potrebna je visoka stručnost i sposobnost top menadžmenta da upravlja, menadžira promjenama. Bez toga nije sigurno uspješno sprovođenje promjena, a time i opstanak poslovne organizacije. Upravljanje totalnim kvalitetom je upravo karakteristika savremenog preduzeća, kojem je krajnji cilj maksimalno zadovoljenje zahtjeva kupaca u pogledu kvaliteta ponuđenog proizvoda i usluge. To je ujedno i garancija uspješnosti i sigurne budućnosti poslovne organizacije.

I na kraju, dat je kratak osvrt, na otpor koje svaka promjena, manje ili više, izaziva kod svakog člana personala, na koje se uvedena promjena odnosi.

### **1. Definisanje organizacionih promjena**

Uslovi poslovanja su izloženi stalnim promjenama, što je narocito prisutno u ovom XXI vijeku. Ta činjenica navodi svaku organizaciju da se adaptira na promjene koje se desavaju u unutrašnjem i spoljasnjem okruženju. Međutim, sa druge strane svaka promjena, nosi sa sobom neizvjesnosti i rizik. Ono što razlikuje uspješne od neuspješnih menadžera je upravo odabrani trenutak i vrijeme kada se promjena mora izvršiti. Neuspjeh menadžera će usloviti krizu u firmi u slučaju kada nije odredio pravi trenutak i vrijeme za učinjenu promjenu, što sa druge strane dovodi firmu u krizu.

Abid Hodžić smatra, da se pod organizacionim promjenama podrazumjeva proces mijenjanja, odnosno modificiranja postojeće organizacije, proces prihvatanja novih ideja ili ponašanja organizacija.<sup>45</sup>

U svakoj organizaciji, promjene se najviše odnose upravo na one komponente, koje su tome najpodložnije, a to su prije svega: organizaciona struktura, tehnologija i kadrovska struktura preduzeća. Danasnja preduzeća posluju u vrlo dinamičnom, pa čak i u turbulentnom okruženju, gdje su promjene takoreći svakodnevnice. Proces globalizacije, pored svih pozitivnih efekata, dovodi i do oštrije globalne konkurencije, gdje mogu opstati samo ona preduzeća koja su dovoljno jaka i sposobna da se brzo adaptiraju na uslove koje diktira globalno tržište. Zato svako preduzeće treba tešiti što većoj fleksibilnosti, adaptaciji, jer je to uslov opstanka u uslovima globalnog poslovanja, u kojem je uticaj tehnologije sve veći i determinirajući faktor opstanka i ostvarenja profita.

Na menadžerima je da utvrde pravo vrijeme za uvođenje promjena, što uslovljava njihovo dobro poznavanje trenutnog stanja organizacije, kao i vizije o tome, gdje žele vidjeti organizaciju u budućnosti. Najteža faza u procesu mijenjanja

---

<sup>45</sup> Dr. Abid Hodžić "Organizaciono struktuiranje preduzeća", Zenica, 2007. str. 144

je upravo prelaz iz sadasnjeg u buduće željeno stanje i ono je ujedno i najkritičnije. Do promjena će doći onda kada menadžeri nisu zadovoljni stanjem u kojem se organizacija nalazi. Ali, to nije dovoljno. Vrlo je bitno da promjenu prihvati kolektiv, koji je uključen takođe, u proces promjena. I ovde se vidi značaj dobrog menadžera, koji treba da dobro poznaje zaposlene i njihov stepen prihvatanja promjena.

Mozemo slobodno reći da suštinske promjene mogu nastati samo kadrovskim promjenama, izmjenom svijesti ljudi, prihvatanjem svjetskih trendova, ali i uključivanjem u njihove tokove.

## 2. Vrste organizacionih promjena

Više je osnova za podjelu organizacijskih promjena. Po jednoj<sup>46</sup> teoriji, promjene se mogu podijeliti prema:

- Cilju (uzroku) – organizaciona adaptacija i organizacioni razvoj
- Karakteru procesa – diskontinuelne, sveobuhvatne, revolucionarne ili evolutivne itd.
- Sadržaju – promjene organizacije i promjene poslovnih procesa
- Ostalim kriterijumima

Podjela promjena se može izvršiti i na osnovu kriterija:<sup>47</sup>

- Širine promjena – mogu biti parcijalne i sveobuhvatne
- Dubine promjena – mogu biti plitke i duboke
- Vremenska dimenzija – mogu biti anticipativne, proaktivne i reaktivne
- Valjanost promjena – svjesne – planske i nesvjesne – neplanske

## 3. Faktori organizacionih promjena

Svaka organizacija posluje u jednom otvorenom sistemu, na koji utiču unutrašnji i spoljašnji faktori. Procenat njihovog uticaja na promjene u organizaciji se mijenjao. Tako, unutrašnji faktori su bili dominirajući do 60 – tih godina prošlog vijeka, kada primat preuzimaju spoljašnji, eksterni faktori, gde veliki uticaj imaju tehnološka revolucija i globalizacija.

Potreba za promjenom u organizaciji će se javiti kada dođe do pada performansi organizacije, a usled neravnoteže između organizacije i okruženja. Od sposobnosti top menadžera će zavisiti, da li će nastalu promjenu organizacija uspješno prevazići ili će nastala neuočena promjena sa neblagovremenom reakcijom usloviti bolnije pomake u organizaciji.

Za razliku od internih faktora, *eksterni faktori* vrše znatno veći uticaj na preduzeće, kod kojeg nema više tradicionalne organizacije sa centralizacijom.

---

<sup>46</sup> Mirjana Petković, Nebojša Janićijević, Biljana Bogićević Milkić "Organizacija" Beograd 2008. str. 508-518

<sup>47</sup> Dr. Abid Hodžić "Organizaciono struktuiranje preduzeća", Zenica, 2007. str. 147

Menadžment preduzeća je prinuđen<sup>48</sup> da globalno traga za mogućnostima i resursima, da maksimizira prinose na uložena sredstva itd. Bitni elementi eksternih faktora na organizacione promjene su, prije svega:

- Tržište i konkurencija
- Informaciona tehnologija
- Globalizacija
- Demografske promjene, imigracije stanovništva (jeftina radna snaga, višak zaposlenih)
- Nacionalna kultura i religija

Najbitniji *unutrašnji faktori* koji dovode do promjena su prije svega:

- Promjene razvojne i poslovne strategije
- Promjene starosti i veličine preduzeća
- Promjena lidera i organizacione strukture

#### **4. Menadžiranje organizacionim promjenama**

Realizacija organizacionih promjena je vrlo složen proces koji se vrši u nekoliko faza.

Prvi i osnovni, početni korak bi bio definisanje trenutnog stanja i zaključiti da su promjene neminovne.

Naredni korak bi bio upoznavanje zaposlenih sa neophodnošću uvođenja promjene, kao i da smanji otpor zaposlenih u realizaciji promjene, a što se može postići motivacijom zaposlenih (nagrađivanjem, npr.) i njihovim uključivanjem u sam proces promjena. Zaposleni će mnogo lakše prihvatiti promjenu ako znaju šta ih čeka u budućnosti nakon uvođenja promjene.

Uspjeh promjena zavisi od načina iskorišćavanja vođa za posticanje energije za promjene kod ostalih zaposlenih. Menadžer može svojim ponašanjem, odnosom prema promjenama, nagrađivanje saradnika, podstaknuti svoje saradnike da podrže promjene.

Tokom promjena dolazi do personalne tranzicije pojedinca, koji pomoć očekuje od top menadžmenta koji mu u tome mora pomoći.

#### **5. Menadžment totalnog kvaliteta (TQM)**

Menadžment totalnog kvaliteta spada u grupu radikalnih organizacionih promjena, jer za rezultat imaju radikalnu promjenu izgleda organizacije, promjenu kulturne forme organizacije i ponašanje zaposlenih. Ipak, najdramatičnija je svakako višak i otpuštanje zaposlenih.

Kao što mu naziv kaže, zasniva se na konceptu kvaliteta, koji je svoju afirmaciju dobio u japanskom menadžmentu i predstavlja tajnu japanskog

---

<sup>48</sup> M. Petković, M. Jovanović "organizaciono ponašanje – novi koncept vođenja preduzeća", Megatrend univerzitet primjenjenih nauka, Beograd 2002. str. 409

uspjeha. Ovdje je do izražaja došao odnos između tehnologije promjena i kvaliteta, gdje se posebno ističe veza između kvaliteta i ponašanja zaposlenih.

TQM je doveo do povećanja produktivnosti, sniženju troškova i povećanju profita. Glavni cilj ovog modela je maksimalno zadovoljenje potreba kupaca, a što se postiže uključivanjem svih zaposlenih da razmišljaju o kupcima, a što se vrši motivacijom i inspiracijom zaposlenih.

Menadžment totalnog kvaliteta se zasniva na činjenici da su troškovi lošeg kvaliteta mnogo veći nego troškovi koji će kao krajnju instancu imati kvalitet. Znači, akcenat je na kvalitetu. Čovjek je ovdje misleće, kreativno i stvaralačko biće, a organizacija se posmatra kao sistem međufunkcionalnih timova. Kvalitet se ovdje smatra najvažnijim zadatkom top menadžera, a kojim se može ostvariti samo maksimalnim zalaganjem i uključivanjem svakog pojedinca u organizaciji.

## **6. Otpor organizacijskim promjenama i razvoju i uticaj promjena na poslovanje preduzeća**

Logično je da postoje otpori kada dođe do organizacijskih promjena i razvoja. Svaki pojedinac, neki manje, a neki više, pruža otpor. Uzroci otpora mogu biti sledeći:

- Inercija koja nastaje kao posledica naružavanja postojeće formalizacije opisa poslova, pravila i postupaka koje zaposleni slijede. Radnici te poslove obavljaju rutinski, a promjene uslovljavaju više napora i koncentracije.
- Svi dijelovi organizacije nisu pripremljeni za promjene.
- Čest je slučaj da se pojedinac mijenja, ali ne i grupa kojoj on pripada.
- Otpor se može javiti iz razloga što ona može dovesti u pitanje stručnost obavljanja novih poslova.
- Može se desiti da pojedinac izgubi moć koju je imao prije promjena.
Pjesa më e madhe e vendeve të Unionit Monetar Evropian përmbushin dy nga tri parimet ekonomike që përcaktojnë një hapësirë monetare optimale. Ato përmbushin parimin e hapjes së ekonomisë kombëtare ndaj tregjeve ndërkombëtare, dhe parimin e shumëllojshmërisë/diversifikimit të prodhimit. Mirëpo, të gjitha ato kanë dështuar të përmbushin parimin e lëvizjes së lirë të fuqisë punëtore. Po ashtu, Evropa ka dështuar të përmbush parimin e transferëve fiskal (parim politik), ndërsa nuk është plotësisht e qartë përmbushja e dy kritereve të tjera politike (Parimi i homogjenitetit të preferencave, dhe Parimi i solidaritetit). Tabela 1 në mënyrë të përmbledhur ilustron shkallën e përmbushjes së parimeve ekonomike dhe politike të hapësirës monetare optimale, tani të zbatuara në Unionin Monetar Evropian.

| Tabela 1 Performansa e Unionit Monetar Evropian     |            |
|-----------------------------------------------------|------------|
| Parimi                                              | Përmbushja |
| Lëvizja e lirë e fuqisë punëtore                    | Jo         |
| Shumëllojshmëria e prodhimit                        | Po         |
| Hapja e ekonomisë kombëtare                         | Po         |
| Transferët fiskal                                   | Jo         |
| Homogjeniteti i preferencave                        | Me gjasë   |
| Solidariteti mes vendeve anëtare të unionit monetar | ?          |

Fillimisht Tabela 1 shpjegon se pse ishte aqë i diskutueshëm projekti i monedhës së përbashkët në Bashkimin Evropian. As përkrahësit e as oponentët e këtij projekti nuk kishin arritur të parashtronin argumente plotësisht të pranueshme. Madje, edhe me zbatimin e parimeve të teorisë së hapësirës monetare dhe krahasimin me arritjet brenda Unionit Monetar Evropian nuk mund të jepen vlerësime përfundimtare plotësisht të sakta. Kjo sepse, as dobitë e as kostot e krijimit të unionit monetar nuk mund të kuantifikohen në mënyrë të saktë, e as parimet e teorisë së hapësirës

monetare optimale nuk përmbushën në tërësi. Prandaj, nga aspekti ekonomik, ky rast mbetet i papërcaktuar, kurse vendimi për të krijuar një union monetar duhet të mbështetet më tepër në vlerësimet politike.

Së dyti, përmbushja e pjesërishme e parimeve të teorisë së hapësirës monetare optimale, lë të kuptohet se, me që vendimi për të zbatuar unionin monetar ishte marr, kjo do krijojë kostot të konsiderueshme për vendet anëtare. Teoria e hapësirës monetare optimale i identifikon ato kosto dhe sugjeron dy konkluzione kryesore: kostot kryesisht do të paraqiten në tregjet e punës, dhe se transferët fiskal duhet të rivlerësohen.

## **6. A do të bëhet Evropa një hapësirë monetare optimale?**

Karakteristikat e Unionit Monetar Evropian nuk janë statike. Niveli i përmbushjes së parimeve të teorisë së hapësirës monetare optimale kryesisht reflekton aspektin historik, ndërsa fakti se UME tani më ekziston, mund të ndryshojë gjërat dhe situatën në përgjithësi. Kjo sepse, ekzistojnë arsye për të besuar se niveli i përmbushjes së parimeve të teorisë së hapësirës monetare optimale është me karakter endogjen që do të thotë se, duke qenë brenda unionit monetar e bënë më të mundur përmbushjen e këtyre parimeve.

Është bërë e zakonshme të krahasohet Bashkimi Evropian me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe të konkludohet se Evropa është larg nga arritja e integritetit që është arritur përtej Atlantikut. Poashtu, dikush mund të shtron edhe pyetjen: Se si do funksionin sot Shtetet e Bashkuara të Amerikës sikur të kishin mbetur në përdorim monedhat e ndryshme që përdornin shtetet e SHBA në shekullin e 19.

Duke përmbledhur, mund të nxjerrim dy konstatime. Së pari, se Bashkimi Evropian nuk përbënë një hapësirë monetare plotësisht optimale. Ajo ka përmbushur në nivel të kënaqshëm disa parime, por ka dështuar të përmbush disa parime të tjera. Së dyti, nuk është e pamjaftueshme vetëm lëvizja e lirë e fuqisë punëtore, por në përgjithësi, tregjet e punës shfaqin ngurtësi të konsiderueshme. Për pasojë, unioni monetar mund të përkeqësojë edhe ashtu një situatë të dhimbshme të papunsisë së lartë, të paktën në disa nga vendet anëtare.

Prandaj është e natyrshme të shtrohet pyetja: pse drejtuesit e vendeve dhe qeverive Evropiane të tubuar në Maastricht në vitin 1991, kishin vendosur të merrnin riskun duke formuar unionin monetar. Përgjigja është: politika. Forca themelore shtytëse që kishte shtyrë përpara procesin e integrimi evropian që nga vitet e 1940ta ishte besimi se, luftërave që po zgjasnin për më tepër se 1000 vite duhej t'iu vinte fundi, dhe se, zgjidhja më e mirë për të ardhmën do ishte integrimi i thellë ekonomik. Kur Evropa të arrijë fazën e gërshtimit të interesave ekonomike të vendeve anëtare, atëherë më nuk do ekzistonte motivi për konkurrencë tjetër përveç asaj në tregje, për të mirën e të gjithëve. Dhe realisht, në çdo hap drejtë bashkimit, kur negociatat ishin të vështira, liderët politik gjithnjë bënin lëshime të nevojshme për të arritur marrëveshje të caktuara, madje shpesh jo plotësisht të kënaqshme, dhe ate gjithnjë me arsyetimin se po kontribuonin për forcimin e paqës në kontinent. Në këtë kuptim, Evropianët e ndjejnë si fatë të përbashkët unionin monetar.

## **Konkluzione**

1. Paraja është më e vlefshme sa më tepër njerëz që e përdorin atë. Mbi këtë bazë, bota do duhej të përdorte një monedhë të përbashkët. Mirëpo, përdorimi i monedhës së përbashkët mbart kosto të caktuara. Teoria e hapësirës monetare optimale balancon dobitë dhe kostot e përdorimit të monedhës së përbashkët.
2. Nëse çmimet dhe pagat janë fleksible, kursi i këmbimit ndihmon në zgjidhjen e situatave kur paraqiten tronditje asimetrike. Në unionin monetar janë me rëndësi tronditjet asimetrike të vendeve anëtare.
3. Teoria e hapësirës monetare optimale shtron çështjen se cilat karakteristika të unionit monetar ndikojnë në paraqitjen e tronditjeve asimetrike. Ajo më pas zhvillon parimet, të cilat nëse përmbushën, i bëjnë humbjet nga kursi i këmbimit më pak të dhimbshme.
4. Tri parime ekonomike klasike të teorisë së hapësirës monetare optimale janë: Lëvizja e lirë e fuqisë punëtore; Shumëllojshmëria e prodhimit; dhe Hapja e ekonomisë kombëtare. Tri parime politike të teorisë së hapësirës monetare optimale janë: Transferët fiskal; Homogjeniteti i preferencave; dhe Solidariteti mes vendeve anëtare të unionit monetar.
5. Unioni Monetar Evropian ka përmbushur tri parime të teorisë së hapësirës monetare optimale: Hapja e ekonomisë kombëtare, Shumëllojshmëria e prodhimit, dhe Homogjeniteti i preferencave. Por nuk ka përmbushur parimet tjera, siç janë: Lëvizja e lirë e fuqisë punëtore, Transferët fiskal, kurse parimi Solidariteti mes vendeve anëtare të unionit monetar, me gjasë është përmbushur.
6. Ekzistojnë arsye për të besuar se niveli i përmbushjes së parimeve të teorisë së hapësirës monetare optimale është me karakter endogjen: duke qenë brenda unionit monetar e bënë më të mundur përmbushjen e këtyre parimeve.
7. Në fund duhet theksuar se, vendimi për të formuar një union monetar nuk është i lehtë, nuk është bardhë e zi. Ai përfshinë risqet dhe mund të kërkojë masa të tjera bashkërenduese. Kjo është rasti edhe me Unionin Monetar Evropian.

## **Referenca**

1. Abed, G. T., Erbas, S. N., Guerami, B., "The GCC Monetary Union: Some considerations for the Exchange Rate Regime," IMF Working Paper, No 66. 2003.
2. Baldwin, Richard and Charles Wyplosz, The Economics of European Integration, McGraw-Hill. 2004.
3. Bayoumi, T. and Eichengreen, B., "Monetary and Exchange Rate Arrangements for NAFTA," Journal of Development Economics, 43, pp. 125-165. 1994.



4. Corsetti, P., and Pesenti, P., "Self-Validating Optimum Currency Areas," NBER Working Paper No. 8783, pp. 1-24. 2002.
5. De Grauwe, P., *The Economies of Monetary Integration*, Fifth Edition. Oxford. 2003.
6. De Grauwe, P. and Mongelli, F., "Endogeneities of Optimum currency Area: What Brings Countries Sharing a Single Currency Closer Together"? ECB Working Paper No. 468. 2005.
7. Eijffinger C.W. Sylvester and Jakob De Haan, *European Monetary and Fiscal Policy*, Oxford. 2000.
8. Fasano-Filho, U., and Schaechter, A., "Monetary Union among the Member Countries of the Gulf cooperation Council," IMF Occasional Paper, International Monetary Fund, Washington D.C. 2003.
9. Frankel, J., and Rose, A., "Is EMU More Justifiable EX Post than EX Ante?" *European Economic Review*, 41, pp735-760. 1997.
10. Frankel, J., and Rose, A., "The Endogeneity of the Optimum Currency Area Criteria," *Economic Journal*, 108, pp. 1009-1025. 1998.
11. Frankel, J., "Verifiability and the Vanishing Intermediate Exchange Rate Regime," NBER Working Paper No. 7901. 2002.
12. Frankel, J., "Proposed Monetary Regime for Small Commodity-Exporters: Peg the Export," Kennedy School of Government, January, RWP No. 03-003. 2003a.
13. Frankel, J., "Experience of and Lessons from Exchange Rate Regimes in Emerging Economies," NBER Working Paper No. 10032. 2003b.
14. Gudmundsson, M., "The Role of the Effective Exchange Rate in Monetary Frameworks: The International Experience," BIS Working Paper. 2005.
15. Hammoudeh, S., and Aleisa, E., "The dynamic linkage of the GCC Stock Markets," *Contemporary Economic Policy*, January, 22(1) pp 50-62. 2004.
16. Hansen, Drud Jorgen, *European Integration: An Economic Perspective*, Oxford. 2002.
17. Jadresic, E., "On a Currency for the GCC Countries," IMF Policy Discussion Paper (PDP/02/12), International Monetary Fund, Washington, D.C. 2002.
18. Kenen, P., "The Theory of Optimum Currency Areas: An Eclectic View." In: Mundel, R.A, Swooboda, A. K., ed., *Monetary Problems in the International Economy*, University of Chicago Press, Chicago. 1969.
19. McKinnon, R., "Optimum Currency Area," *American Economic Review*, (September), pp. 717-725. 1963.
20. Mongelli, Francesco Paolo, "European economic and monetary integration and the optimum currency area theory", EUROPEAN COMMISSION, Economic Papers 302, February 2008.

21. Moudell, R., "The Theory of Optimum Currency Area," American Economic Review, 51(4), pp. 657-665. 1961.
22. Nello, Senior Susan, The European Union: Economics, Policies and History, McGraw-Hill. 2005.



## ORGANIZIMI I VEPRIMTARISË SË MARKETINGUT NË NVM-ve NË KOSOVË

*Dr. Fatos Ukaj, prof. ass.  
fatos\_ukaj@yahoo.com*

### Abstrakti

Ndër ekonomistë është e përhapur bindja se NVMte janë forca motorike e rritjes ekonomike të Kosovës dhe më gjerë. Këto ndërmarrje janë promovuese të iniciativës private dhe të aftësive ndërmarrëse të njerëzve këtu. Fleksibiliteti i tyre dhe mundësit e adaptimit të shpejte ndaj ndryshimeve në rrethinë i sjellin përparësi këtij lloji organizimi të ndërmarrjeve. Kosova si vend me një mjedis flotat dhe ekonomi jo të zhvilluar, është në një kryqëzim, ku duhet zgjidhë rrugën e ecjes përpara, e orientimi i saj nga koncepti i marketingut do të bëjë që e ardhmja të jetë më e ndritshme. NVM kosovare hasin në vështirësi dhe ballafaqohen me sfida për të stabilizuar biznesin e vet dhe për të konkurruar me produktet dhe ndërmarrjet jashtë vendit. Strategjia e strukturimit të ndërmarrjeve do të jetë e nevojshme të bazohet në rrethanat specifike Kosovare por edhe në përvojën e vendeve Evropiane dhe më gjerë. Përkrahja e NVMve është esenciale për suksesin e tyre dhe ekonomisë kosovare në përgjithësi.

**Fjalët kyçe:** Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, mjedisi, marketingu, zhvillimi ekonomik.

**JEL klasifikimi:** M0, M3, M39.

### Hyrje

Është më se e qartë për biznesmenët kosovarë se kanë ndodhur ndryshime në mjedisin e biznesit dhe kjo e shtrën para ndërmarrjeve të tyre nevojën dhe detyrën për të rikonceptuar dhe përshtatur organizimin e marketingut .Duke i ditur kushtet në të cilat ndërmarrjet e kanë ushtruar veprimtarinë e vet dhe pengesat e llojllojshme në të cilat kanë hasur ato, ndoshta edhe mund të arsyetohet forma e organizimit dhe e veprimit deri tani. Por duke pasur parasysh momentin e ri, i cili gjithnjë e më shumë identifikohet nga rritja e konkurrencës në treg dhe nevoja që të mbahet hapi në përmbushjen e kërkesave të konsumatorëve, patjetër se do të duhej të bëhen hapa në drejtim të një organizimi shumë më të mirë të ndërmarrjeve tregtare.

Konkretisht NVM-të kosovare që merren me tregti, kanë një ndryshim esencial në mjedisin e gjerë dhe atë të ngushtë, sa që është i pashmangshëm fillimi i një riorganizimi në të gjitha NVM-të tregtare.

### Mjedisi në të cilin veprojnë NVM në Kosovë

**Mjedisi i gjerë**- për ndërmarrjet tregtare kosovare është një faktor i pakontrollueshëm, i cili bën ndikim të madh dhe përcakton rregullat e “lojës”, sipas të cilave këto ndërmarrje do të duhet të veprojnë tash por edhe në të ardhmen. Mund të thuhet se NVM-të tregtare në Kosovë nuk kanë pasur mundësi minimale për ndikim në mjedisin e gjerë gjatë periudhës së kaluar. Ndërsa në vitin e fundit “biznesi” nëpërmjet shoqatave dhe asociacioneve (p.sh. Aleanca Kosovare e Biznesit) mundohet që të bëjë një ndërhyrje tek institucionet vendimmarrëse, me qëllim të ndikimit në disa nga faktorët e mjedisit të gjerë, në të mirë të marrjes së vendimeve për mbrojtjen, zhvillimin dhe stimulimin e tyre.

**Tabela 1.** Numri i NVMve ne funde te viti 2009, struktura e NVMve për nga madhësia.

| Nr. | Klasifikimi                    | Numri i te punësuarve | Numri i bizneseve te regjistruara | %     |
|-----|--------------------------------|-----------------------|-----------------------------------|-------|
| 1   | Micro Ndërmarrje               | 1 - 9 punëtor         | 73138                             | 98.26 |
| 2   | Ndërmarrje te Vogla            | 10 - 49 punëtor       | 1096                              | 1.47  |
| 3   | Ndërmarrje te Mesme            | 50 - 249 punëtor      | 159                               | 0,21  |
| 4   | Ndërmarrje te Mëdha(Korporata) | 250 - ... punëtor     | 43                                | 0,06  |
|     | Total                          |                       | 74.436                            | 100   |

**Burimi:** Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)

Në princip, në raport me faktorët e mjedisit të gjerë marketingu ka mundësi të zgjidhjes së dy mënyrave të veprimit: të pranojë faktorët e mjedisit si të tillë, që nuk mund të kontrollohen, apo të kundërvihet veprimit të tyre dhe të mundohet t'i ndryshojë.

*-Mjedisi demografikë* – është element i rëndësishëm që ndikon në zhvillimin e NVM-ve, pra popullsia si burim i tregut të saj është faktor dominant që e shtyn ndërmarrjen drejt përpjekjeve për të përvetësuar një treg.

*-Mjedisi ekonomikë* - në të cilin veprojnë NVM-të tregtare në Kosovë ka pësuar ndryshime ,gjë që ndodh edhe në të gjitha vendet pasi që mjedisi ekonomik i nënshtrohet ndryshimeve .

Këto ndryshime të mjedisit ekonomik ndikojnë në nevojat, kërkesën dhe ofertën, fuqinë blerëse dhe nivelin e pjesës së të ardhurave të dedikuara për konsum, ndërsa të gjitha këto ndikojnë në ndryshimet e mjedisit ekonomikë. Edhe sa i përket fuqisë blerëse të popullsisë, fuqi kjo e lidhur me të ardhurat, çmimet, kursimin dhe kredinë konstatojmë se ka pësuar ndryshime, duke hyrë në fazën e recesionit. Këto ndryshime do të kenë ndikim në suksesin e strategjisë së marketingut të ndërmarrjes gjithsesi.

Papunësia e madhe në Kosovë (60% sipas statistikave zyrtare janë të papunë), kthimi i një numri të popullsisë nga shtetet perëndimore dhe zvogëlimi i dërgesave monetare nga jashtë e bëjnë ndikimin e mjedisit ekonomikë edhe më të theksuar në tregtinë kosovare.

*-Mjedisi teknologjik* - është një ngecje në përcjelljen e risive në tregtinë botërore dhe përshtatje ndaj kërkesave në rritje të konsumatorëve për shërbime tregtare më cilësore dhe përmbushje të nevojave të tyre . *-Mjedisi politiko-ligjor* – Veprimi apo mungesa e legjislacionit në një vend e pasqyron situatën aktuale politike në atë vend. Në Kosovë si pasojë e luftës, pas vitit 1999 ka ekzistuar një vakum në legjislacion i cili e rregullon lëmin e qarkullimit të mallrave dhe biznesit në përgjithësi. Kjo vazhdon duke u plotësuar në periudhën 2003-2004 me nxjerrjen e ligjeve përkatëse që krijojnë rregull e rend në qarkullim të mallrave dhe në biznes. Ka ndryshuar ambienti në të cilin ushtrohet veprimtaria tregtare, duke filluar nga liria e zgjedhjes dhe ushtrimit të veprimtarisë, por edhe duke u plotësuar gjithnjë e më shumë me bazën ligjore me të cilën rregullohet kjo veprimtari.

Faktorët politikë, juridikë dhe ligjorë të mjedisit të marketingut në mes vete janë shumë të ndërlidhur.


**Mjedisi i ngushtë** - ka pësuar ndryshime dhe lëvizje të mëdha si në vetë ndërmarrjet tregtare në Kosovë, ashtu edhe te faktorët e tjerë të mikromjedisit: furnizuesit, ndërmjetësuesit, konsumatorët dhe konkurrenca.

Ne do të ndalemi te ndryshimet në ndërmarrje:

*Ndërmarrja*- në rastet e shumicës së ndërmarrjeve tregtare në Kosovë kemi një nevojë të shprehur në drejtim të ristrukturimit dhe organizimit, ndryshe nga ky organizim që ekziston tani. Në ndikimin e faktorëve të ndryshëm, organizimi i ndërmarrjeve tregtare ka mbetur i pashtjelluar në atë masë që nuk e ka lënë të humbë kontrolli i pronarit mbi ndërmarrjen, por edhe në anën tjetër nuk është mundur penëtrimi e funksioneve të ndryshme në skemën organizative të ndërmarrjeve. Organizimi i ndërmarrjeve tregtare në Kosovë varet edhe nga tipi i pronës. Pjesa dominuese e ndërmarrjeve janë të tipit privat të formuara me kapital individual. Kjo i sjell ndërmarrjet edhe deri te situata kur nuk janë të ndara sfera e qeverisjes nga sfera e menaxhimit. Pronari në të shumtën e rasteve qeveris dhe menaxhon me ndërmarrjen . Mirëpo edhe strukturimi i ndërmarrjeve tregtare në Kosovë është i tillë që funksionet e ndryshme në ndërmarrje (shitja, furnizimi, etj) janë unifikuar, nga dy e më shumë funksione specifike në një funksion të përgjithësuar. Ndërsa ato funksione të unifikuara ekzekutohen nga i njëjti person, pra pa ndonjë profesionalizim dhe ndarje të përgjegjësisë, vetëm për një funksion apo pjesë të procesit të biznesit.

Ndërmarrjet kanë qenë të organizuara në këto funksione:

- Administrimi i kapitalit (financat),
- Rekrutimi dhe administrimi i personelit,
- Furnizimi dhe shitja,
- Regjistrimi i rezultatit (kontabilitetit),
- Përfaqësimi i ndërmarrjes,
- Depot-shitoret



*Fig.1. Organizimi i tanishëm në Kosovë i ndërmarrjeve tregtare*

Duhet sqaruar se organizimi i funksioneve të paraqitura ka vlerë për ato ndërmarrje të pakta, të cilat kanë bërë një hap në drejtim të profilizimit të shërbimeve në ndërmarrje. Kurse shumica e funksioneve, siç janë financat, personeli, përfaqësimi, furnizimi, kanë qenë të mbuluara nga një përmbarues, përkatësisht nga drejtori i ndërmarrjes. Funkcioni i furnizimit dhe shitjes, si dhe depot dhe shitoret kanë qenë të bashkuara në një njësi dhe të udhëhequra po ashtu nga një menaxher i vetëm. Natyrisht këtu ka edhe përjashtime, meqë në disa raste organizimi dhe shpërndarja e funksioneve dhe përgjegjësiive ka ecur përpara në drejtim të kryerjes profesionale të detyrave. Ajo çka na ka interesuar neve gjatë hulumtimit ka qenë niveli i integritetit dhe aplikimit të marketingut në ndërmarrjet tregtare kosovare dhe kemi arritur në përfundim se edhe pse është kuptuar rëndësia e marketingut në zhvillimin e biznesit në ndërmarrjet tregtare, ka pasur vetëm përpjekje që të bëjnë aplikimin e marketingut në veprimtarinë e tyre. Mirëpo, nuk duhet anashkaluar fakti se është bërë një përparim në fushën e aplikimit të promovimit, pikërisht propagandës ekonomike (reklamës) dhe në hapat fillestarë të drejtimit të nxitjes së shitjes.




Fig2. Paraqet nivelin e aplikimit të marketingut në ndërmarrjet tregtare deri më tani.

### **Përfundim**

Si detyrë para menaxhmentit të ndërmarrjeve parashtrohet analiza dhe përshtatja organizative nevojave të ndërmarrjes, si dhe rishikimi i caqeve dhe i strategjisë së tyre. Pra, ndërmarrjet do të duhej të rishikojnë dhe të ndërmarrin hapa në drejtim të gjetjes së zgjidhjes më të mirë për biznesin e tyre në të ardhmen dhe këtë ta bëjnë duke i përcaktuar caqet dhe strategjinë për arritjen e caqeve.

### **Përcaktimi i caqeve**

1. të rrisin shitjen në tregun ekzistues,
2. të bëjnë zgjerimin e asortimentit,
3. të zgjerojnë tregun e brendshëm,
4. të hulumtojnë mundësinë e penetrimit në tregjet e jashtme,

Caqet të cilat përcaktohen duhet të jenë:

- të definuara qartë,
- të arsyeshme,
- të matura,
- motivuese për personelin,
- të realizueshme,
- të harmonizuara me caqet e tjera të ndërmarrjes dhe
- të jenë të njohura për të gjithë që do të marrin pjesë në përmbushjen e tyre.

### **Përcaktimi i strategjisë për arritjen e caqeve**

Duke pasur parasysh caqet e përcaktuara mund të përdoret njëra nga këto strategji:



1. *Strategjia e rritjes* - rritja e shitjes në treg, duke u përqendruar në politikën e çmimit, promocionit dhe distribucionit,

2. *Strategjia e ruajtjes së tregut* - duke e bërë zgjerimin e asortimentit dhe duke u munduar që të bëhet specializimi për produkte të caktuara,

3. *Strategjia e zhvillimit* - duke bërë më shumë në zgjerimin në tregun e brendshëm me përmirësimin e aktiviteteve biznesore (natyrisht edhe të marketingut), dhe duke u fokusuar në praninë e produktit në tërë tregun,

Pas përcaktimit të caktut dhe strategjisë së ndërmarrjes, gjë shumë me rëndësi për ndërmarrjet tregtare do të jetë organizimi i ndërmarrjes sipas funksioneve dhe përfshirja e marketingut në këtë skemë organizative, me qëllim të udhëheqjes dhe mbikëqyrjes së operacioneve biznesore në ndërmarrje.

### Referencat

1. Ukaj Fatos, Aplikimi dhe Integrimi i Marketingut në Tregtinë e Kosovës “Disertacioni i doktoratës”, Prishtine, 2005.
2. Ukaj Fatos , “Support Of Small-Medium Size Enterprises (Sme) – Opportunity For Kosovo to Overcome Economic Crisis”, Proceedings of The First Online International Conference on “World’s Economies In and After Crisis: Challenges, Threats and Opportunities”, May 2010.
3. Krasniqi Armand, Ukaj Fatos , “Menaxhimi i Destinacionit ne Turizëm”, Peje, 2010.
4. Agjencioni për regjistrimin e Bizneseve, <http://www.arbk.org/arbk/>
5. Agjencioni Kosovar për mbështetjen e NVM, <http://www.sme-ks.org/?cid=2,1>
6. Central Bank of Kosovo(BQK), <http://bqk-kos.org/?cid=1,25>
7. Enti i Statistikave te Kosovës, [http://www.ks-gov.net/ESK/index.php?option=com\\_content&view=article&id=186&Itemid=68](http://www.ks-gov.net/ESK/index.php?option=com_content&view=article&id=186&Itemid=68)
8. Ukaj Fatos, “Promotion of Investment in Tourisem- use of the integrated marketing communications”. Konferenca ndërkombëtare “Investimet në Turizëm”, Ulqin, Prill 2010.

## MARKETIGNU I QËNDRUESHËM - KUPTIMET E PËGJITHSHME

Prof.dr. Fetah Reçica  
fetah.reqica@universitetiaab.com

### Abstrakt

Marketingu është fazë e udhëheqjes me anë të cilit mirren vendime të caceve, politikave, strategjisë, programimit dhe planeve të marketing aktiviteteve të kompanisë. Me anë të planit të marketingut arrihet që afarizmi i kompanisë të arrijë objektivat e veta në treg. Marketingu është shumë kompleks. Përfshinë SWOT analizën. Shfrytëzohet segmentimi, targetimi dhe pozicionimi (STP). Përfshinë të gjitha instrumentet e marketing miksit (4P) dhe i shfrytëzon instrumentet e veqanta sipas nevojës. Shfrytëzohen analizat dhe hulumtimet e ndryshme. Duhet të përmbajë planet e bashkëpunimeve me kompanitë tjera, si me shitësit, distributerët, bankat, transportin etj. Mirren parasysh gjithashtu planet e prodhimit, kapacitetet si dhe rezervat e produkteve dhe lëndës së parë. Mirëpo është esenciale të jetë real në vlerësimin e mundësive të kompanisë dhe në identifikimin e nevojave në treg. Kotleri konstaton se “ për çdo nivel të prodhimit duhet zhvilluar marketing planin për arritjen e qëllimeve të tyre ”. Në fund konstaton se “ marketing plani është njëri nga outputet më të rëndësishme të marketing procesit ”.

**Fjalët kyqe:** Marketing; Ekonomi, Menaxhim; Analizë; Ekosistem; Burime; Produkt.

**JEL klasifikimi:** Z0, Z1.

### Kuptimi i marketingut të qëndrueshëm

Biznesi dhe marketingu janë koncepte të pandashme, “Ka vetëm një përkufizim të vlefshëm të qëllimit të biznesit: të krijojë një blerës”? (Drucker 2001:61). Kjo do të thotë, funksioni marketing plotëson qëllimin e biznesit dhe të njeriut nëpërmjet sigurimit të përfitimeve tek blerësit nëpërmjet produkteve si ushqimi që hanë, makina që ngasin, rrobat që veshin dhe kompjuterat që përdorin. Me fjalë të tjera, vendimet që lidhen me **çfarë produkte të prodhojmë** dhe **si ti ofrojmë ato te blerësi** janë thelbi klasik i strategjisë marketing. Ato përfshijnë interpretimin e nevojave të blerësve të synuar, krijimi i koncepteve produkt në përgjigje të këtyre nevojave (shpesh të përshkruara si formë dhe funksione) si dhe i bën ato të vlefshme në treg nëpërmjet kanaleve të përshtatshme, komunikimit dhe vendimeve të çmimit.

Tradicionalisht suksesi marketing është përcaktuar si blerës të kënaqur dhe përfitime konkurruese për firmën, një rezultat që njihet si rezultati “fitim-fitim”. Por vendimet që lidhen me **çfarë produkti të prodhojmë** përcaktojnë gjithashtu **çfarë të marim** ( p.sh., burimet që kërkohen për të prodhuar dhe tregëtuar ato produkte) dhe

të dyja proceset e *prodhimit* dhe *marrjes* kanë efekte anësore eko-kostot në formën e humbjeve që ndiqen nga ndotja dhe dëmtimi i eko-sistemeve. Kjo ndodh për shkak se *përcaktimi* i attributeve të produkteve dhe sistemeve specifike nëpërmjet të cilave ato bëhen të vlefshme në tregje, gjithashtu *përcakton* modelet e përdorimit të burimeve / energjisë dhe krijimit të humbjeve, përparësitë e ndotjes dhe shkatërrimit të eko-sistemeve. Në lidhje me këtë, “problemi është produkti” (*The Economist* 2000:12).

Por kjo gjithashtu sugjeron në mënyrë të qartë një mundësi; e cila është, riinvestimi tek sistemet e produktit për të aritur rezultatin “humbje zero, shkarkime zero” ndërkohë që siguron përfitime të njëjtat apo të përmiresuara për blerësit në një zgjidhje logjike për ndotjen.

### 1.1.1 Një përkufizim menaxherial

“Marketingu i qëndrueshëm” (*Sheth dhe Parvatiyar* 2001), u adresohet “mënyrave dhe mjeteve” për të bashkërenduar faktorët ekonomik dhe ekologjik nëpërmjet rikrijimit të produktit dhe sistemeve të produktit. Një numër emërtimesh të tjera janë përdorur për të identifikuar këtë temë, duke përfshirë dhe “marketingu jeshil” (*Ottman* 1993; *Peattie* 1992), “marketingu mjedisor” (*Coddington* 1993), “marketingu ekologjik” (*Henion* 1976), dhe “eko-marketing” (*Fuller dhe Butler* 1994), të cilat rezultojnë në konfuzion dhe keq-kuptim. Duke mbartur një sens qëndrueshmërie me një konstrukt të gjerë të zhvillimit të qëndrueshëm, termi marketing i qëndrueshëm sjell standardizim shumë të kërkuar në këtë fushë të rëndësishme që po del në skenë.

**Marketingu i qëndrueshëm: procesi i palnifikimit, zbatimit dhe kontrollit të krijimit, tarifikimit, promovimit dhe shpërndarjes së produktit në një mënyrë e cila plotëson tre kriteret e mëposhtme: (1) plotësohen nevojat e blerësve, (2) arrihen qëllimet e organizatës dhe (3) procesi është në pajtueshmëri me ekosistemet.**

Ky përkufizim është një vazhdim i logjikshëm i orientimit kontemporan të drejtimit marketing, jo një nisje radikale prej tij. Ky përkufizim fokusohet në proceset manaxhuese aktive nëpërmjet të cilave klientët janë të kënaqur dhe organizatat arrijnë qëllimet e tyre. Faktori diferencues është kërkesa që i gjithë procesi të jetë në pajtueshmëri me ekosistemet për të reduktuar eko-kostot dhe shërbyer mirëqënies sociale afatgjatë.

### 1.1.2 Parandalimi i ndotjes dhe përtëritja e burimeve

Bërja e sistemeve të produktit “të pajtueshme me ekosistemet” kërkon integrimin e strategjisë së menaxhimit të humbjeve për parandalimin e ndotjes (P2) dhe rigjenerimin e burimeve (R2) në marrjen e vendimeve marketing dhe duke bërë këtë luftohen burimet bazë të eko-kostove.

Parandalimi i ndotjes (P2) arrihet nëpërmjet *veprimit të parandalimit*; mënyra është manaxhimi i humbjeve dhe të humburit nëpërmjet strategjive

marketing të cilat ndalojnë të ndodhin këto humbje qysh në momentin e parë, në këtë mënyrë duke reduktuar kostot e tashme dhe ato të ardhme.

Rekuperimi i burimeve (R2) arrihet nëpërmjet *veprimeve riparuese*; mënyra është manaxhimi i niveleve të humbjeve të pashmangshme nëpërmjet strategjive marketing të cilat përtërijnë vlerat ekonomike (burimet) për përdorim të ardhshëm dhe duke paraqitur çdo tepricë mbeturinash të dëmshme të shpërnadra në ekosistem. I dizenuar për mjedisin është procesi nëpërmjet të cilit strategjitë e marketingut të qëndrueshëm janë aktualizuar për të arritur parandalimin e ndotjes (P2) dhe rekuperimin e burimeve (R2).

## **1.2 Parimet bazë**

Marketingu i qëndrueshëm paraqet një model të ri, për të përkrahur idenë që sistemet e prodhimit- konsumit duhet të funksionojnë në mënyra të tilla që të imitojnë sistemet natyrore qarkulluese. Adaptimi i tij sugjeron njohjen e pesë parimeve.

### **1.2.1 Modeli i ri i marketingut të qëndrueshëm**

Sistemet marketing mund të krahasohen me ekosistemet natyrore të qarkullueshme të cilat bimët dhe organizmat konsumojnë minerale, ujë, dritën e diellit dhe njëri-tjetrin në proceset e ndërvarura të cilat prodhojnë në mënyrë të vazhdueshme humbje, i cili nga ana e vet bëhet ushqim apo karburant për një cikël tjetër.

Sistemet e marketingut të qëndrueshëm operojnë gati njësoj – duke konsumuar burimet dhe krijuar humbje – ndërkohë që sigurohen përfitime/vlera për blerësit dhe organizatat dhe gjithashtu duke ruajtur apo rritur funksionimin e ekosistemeve. Gjithësesi, për shkak të rritjes së madhe të popullsisë, burimet janë kufizuar shumë dhe mbetjetet janë bërë burime të cilat kërcënojnë mbijetesën afatgjatë të njerëzve. Prandaj, marketingu i qëndrueshëm adapton një model qarkullues “humbje zero, shkarkim zero”.

Parandalimi i mbetjeve, përtëritja dhe ripërdorimi i materialeve për të reduktuar eko-kostot janë strategji/qëllime vendimtare. Duke përdorur proceset të dizenuara për mjedisin, konsideratat mjedisore janë përfshirë në të gjitha aspektet e marrjes së vendimeve marketing përgjatë gjithë shtrirjes së gjerë të ciklit të jetës së sistemit.

***Parimi 1: Ekosistemet janë një faktor fizik i kufizuar në vendimet marketing.*** Ekosistemet imponojnë një urdhër të panegocueshëm të marrësit e vendimeve. Për këtë, egzaminimi i strategjive marketing për ndikime mjedisore dhe pagimin e plotë të eko-kostove duhet të bëhet procedurë veprimi standarte.

***Parimi 2: Cikli i jetës i sistemit është struktura e përshtatëshme për vendimin.*** Ndikimi mjedisor nuk është funksion i vetëm një organizate apo një blerësi në një vend dhe një kohë. Më sakte, ai është rezultati kolektiv i një numri të madh vendimesh të ndërlidhura nga shumë njerëz dhe organizata gjatë kohës. Cikli i jetës i sistemit të produktit (PSLC) përfaqëson strukturën e vendimeve holistike e

nevojshme për të kuptuar një ndikim ekologjike, të problemeve, dhe zgjidhjet e marketingut të qëndrueshëm.

**Parimi 3: Parandalimi i ndotjes dhe përtëritja e burimeve janë strategjitë e duhura për të arritur qëndrueshmërinë.** Duke zbatuar strategjitë e parandalimit të ndotjes (P2) dhe rekuperimit të burimeve (R2) do të mbrojnë dhe risë funksionimin e ekosistemeve nëpërmjet zhvillimit të sistemeve të produktit “mbeturina zero” dhe “shkarkime zero”.

**Parimi 4: Egziston një “efekt i shumfishtë” në të cilin përmirësime të vogla mjedisore (p.sh., kursime në eko-kosto) nga firmat dhe blerësit në nivele mikro përkthehet në përmirësime shumë të mëdha në nivele makro.** Biliona vendime marketing nga ana e organizatave dhe blerësve paraqesin burimet e mbeturinave shpërdorimit, ku secila prej tyre kontribon në një mënyrë të vogël tek një problem të një madhësie gjigande; nëpërmjet multiplikatorit, përmirësimeve individuale të vogla përmbledhen në përfitime të mëdha në cilësinë mjedisore. Pranimi i gjerë i praktiqave të marketingut të qëndrueshëm, nga ana e organizatave dhe blerësve, është një kusht paraprak për qëndrueshmërinë. Bashkëpunimi vetëm i një numri të vogël nuk do të ishte i mjaftueshëm; eliminimi total i “kalorësve të pavarur” është i domosdoshëm.

**Parimi 5: Marketingu i qëndrueshëm nuk është një ushtrim në altruizmin e korporatës.** Marketerët e qëndrueshëm nuk duhet të lënë në harresë faktin që kënaqja e blerësve dhe arritja e qëllimeve të organizatës, financiare dhe të tjera, mbeten kushte absolutisht të nevojshme të cilat duhet të arrihen ndërkohë që arrihet pajtueshmëria mjedisore. Gjithashtu duhet të vihet re që produkti “më i mirë” nga një këndvështrim i pastër i ndikimit mjedisor është *mungesë* produkti (p.sh., mungesë produkti = nuk ka marrje, nuk ka përpunim, nuk ka mbeturina), një gjendje e pa pranueshme e çështje. Kështu, sfida është të rikrijosh mënyrat dhe mjetet e dhënies së përfitimeve të dëshiruara të blerësve dhe arritjes së qëllimeve të organizatave duke mos lënë gjurmë mjedisore të dukshme në planet.

### 1.2.2 Çështja e pamjaftueshmërisë /shterimit të burimeve

Edhe pse parimet e marketingut të qëndrueshëm e vendosin qartë theksin tek manaxhimi proaktiv dhe aspektet dëmtuese të mbeturinave dhe shpërdorimit si çelës i pakësimit të ndotjes, problemi i pamjaftueshmërisë dhe shterimit të burimeve nuk po vihet re.

Padyshim, një nga problemet kryesore që nënvijëzon parandalimi i ndotjes (P2) është të përdorë apo jo në radhë të parë një burim të dhënë të pamjaftueshëm. Por duhet të vëmë re që bollëku relativ i shumë burimeve natyrore është funksion i teknologjisë më të mirë të vlefshme (BAT). Me përparimin e teknologjisë, kjo shpesh përkthehet e drejtë materiale në rritje, apo mënyra menaxhuese të përmirësuar, të cilat bëjnë të vlefshme sasi më të mëdha të burimeve të dhëna në një bazë ekonomike (Sagoff 2001; Simon 2005).

Në mënyrë të ngjashme, vlefshmëria e produkteve dhe proceseve zëvendësuese të bëra të mundura nga përparimet në teknologji mund të ndikojnë gjithashtu nxjerrjen e burimeve natyrore specifike në mënyra të cilat janë të mira

për mjedisin. Për shembull, zëvendësimi i kabllove prej bakri nga ato prej xhamit të fibrave optike në industrinë e telekomunikacionit ka rritur eficientën e trasmetimit të të dhënave më shumë se dhjetë herë ndërkohë që ka zvogëluar kërkesën për bakër dhe ndikimet mjedisore negative që shoqëronin nxjerrjen e bakrit. (Young 2002).

### 1.3 Ekuacioni udhëzues

Ehrlich dhe Ehrlich (2001) paraqesin një ekuacion për ndikimet mjedisore si një mënyrë për të vënë në dukje dhe për të izoluar forcat kryesore të cilat ushtrojnë presion në ekosisteme. Ekuacioni është  $I = PAT$ , ku  $I$  = ndikimi mjedisor,  $P$  = popullsia,  $A$  = bollëku, dhe  $T$  = teknologjia.

Popullsia ( $P$ ) është një drejtues kryesor i ndikimit mjedisoris ( $I$ ) sepse ajo paraqet numrin e blerësve të cilët kanë nevoja që duhet të plotësohen. Bollëku ( $A$ ), i përcaktuar si produkti i brendshëm bruto, reflekton aspiratat e njerëzve, në mënyrë të veçantë të atyre në vendet më pak të zhvilluara. Koeficienti i teknologjisë ( $T$ ) paraqet nivelin korrent të eficientës nëpërmjet të cilës burimet shndërohen në produkte dhe tregëtohen për të plotësuar nevojat e blerësve.

Rritja e madhe si e popullatës ( $P$ ) edhe e bollëkut ( $A$ ) paraqesin fenomene sociale që në mënyrë absolute janë jashtë kontrollit të manaxherëve marketing. Gjithësesi, vendimet e strategjisë marketing janë të kontrollueshme dhe mund të konsiderohen një aspekt i koeficientit të teknologjisë ( $T$ ) si më poshtë: aplikimet teknologjike, të cilat reflektojnë një prirje për të konsumuar burimet dhe për të krijuar mbeturina, influencojnë format e ofruara të produktit; sasinë dhe llojin e materialeve dhe energjinë e përdorur për të krijuar produkte; dhe eficientën relative me të cilën realizohen aktivitetet e prodhimit, tregtimit dhe konsumimit. Ato përcaktojnë porfilin e barrës mjedisore (eko-kostot) e shoqëruar me sistem shpërndarje produkti të dhënë – mbeturinat dhe shpërdorimi i cili shoqëron marrjen e burimeve dhe realizimin e produkteve.

Kështu, strategjitë e marketingut të qëndrueshëm të  $P2$  dhe  $R2$  mund të shihen si kontrolluese relative të vendime të teknologjisë ( $T$ ) të cilat mund të zvogëlojnë eko-kostot. Qëllimi afatshkurtër i kësaj strategjie është të zvogëlojë gradualisht përdorimin e teknologjive “të pista” dhe të rrisë përdorimin e teknologjive të pastra. Në periudhën afatgjatë, qëllimi është të zvogëlojë  $T$  në zero, e cila teorikisht zvogëlon  $I$  në zero për çdo sasi të dhënë  $PA$ .

#### 1.3.1 Urdhërues ekologjik

Në tekstin e tij, “*Marketing and the Ecological Crisis*“, Fisk (2004), formalizoi marrdhënien ndërmjet marketingut dhe ndikimit mjedisor ( $I$ ) si “urdhëruesi ekologjik” i cili detajohet në skenarin e mëposhtëm.

Ekosistemet shërbejnë si burimi i të gjithë burimeve dhe gjithashtu edhe si depozitues për mbeturinat. Funkzioni marketing lehtëson konsumin dhe, duke bërë këtë, vë në lëvizje shumë tipë të ndërlidhura aktiviteteve industriale, tregtare dhe të blerësve të cilat marrin burimet, krijojnë dhe shpërndajnë produktet, gjenerojnë mbetje/ndotje dhe degradojnë ekosistemet.

Me rritjen e popullsisë dhe bollëku lëviz drejt niveleve më të larta, kjo i korrespondon rritjeve në shkallën e aktiviteteve të nevojshme për të plotësuar nevojat e konsumit. Ajo gjithashtu shkakton një rritje në gjenerimin e mbeturinave/ndotjes dhe shkatërrimin e habitateve.




Figura 1.1. Urdhërues ekologjik. Lidhja e Marketingut me ndotjen/degradimin e mundshëm të ekosistemeve

Kjo ka nevojë për ndërhyrje në formën e praktikave të marketingut të qëndrueshëm (T) për të frenuar rrymën e eko-kostove. Fisk (2004) e përmbodhi:

Rritja e konsumit rrit ndotjen, e cila zvogëlon habitatet. Kështu që, pasojat e ndotjes në habitate krijojnë një miratim duke mbajtur nën kontroll në mënyrë relative nivelet e konsumit ndaj ndotjes.

Në mënyrë që të konsumojë në nivele të larta, është e detyrueshme të kujdesemi për përhapjen e mbetjeve (pp. 15-16). Në këtë kuadër, **ndotja** është përkufizuar si :

Çdo “**substancë që ndikon në mënyrë jo miqësore ndikon mjedisin material, kimik apo biologjik të tokës apo që akumulon në qeliza apo indet e organizmave në sasia që kërcënojnë shëndetin apo mbijetesën e këtyre organizmave**” (Kaufman dhe Franz 2003).

Hyrja e mbeturinave/ndotjes mund të dëmtojë funksionimin e ekosistemeve. Ky efekt mosfunksionues rezulton edhe prej metodave që nuk bëjnë dallim të marrjes së burimeve që rezutojnë në shpërdorim të drejtëpërdrejtë të ekosistemeve

në kuptimin e vërtetë të fjalës (p.sh., duke shkatërruar, rrënuar, harxhuar, dobësuar, eliminuar, zhdukur).

Urdhëresa ekologjike është një urdhëresë absolute, jo një sugjerim, duke qenë se ekonomitë nëpër botë vazhdojnë të rriten, ekosistemet nuk e bëjnë këtë gjë. Pavarësisht se janë ndërmarrë veprime të duhura për të kontrolluar dhe zvogëluar eko-kostot, konsumi në nivele të larta nuk do të jetë i qëndrueshëm. Ndalimi i ndotjes së ekosistemeve të tokës nuk është një gjë që *do të bëhet*; me tepër, ai *duhet* bërë.

#### **1.4 Natyra e zhvillimit/ konsumit të qëndrueshëm**

Shqetësime serioze në lidhje me rrënien e ekosistemeve të tokës, ashtu si dhe perspektiva e konsumit regresiv në të ardhmen, kanë çuar në konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm. Fillimisht i prezantuar prej Bruntland Commission, ky term i gjerë përshkruan nevojën për të harmonizuar ekonominë dhe ekologjinë në marrjen e vendimeve të biznesit (World Commission on Environment and Development). Në zhvillimin e qëndrueshëm, burimet e tokës shikohen si asete të cilat duhet të menaxhohen në mënyrë të përgjegjshme, jo si të mira “të lira” të cilat mund të merreshin pa keqardhje. Ashtu si shkruajnë Willums dhe Goluke (2002), [zhvillimi i qëndrueshëm] . . . është një frazë e thjeshtë me implikime të thella.

**Ajo nënkupton, së pari dhe mbi të gjitha, që ne duhet ta vendosim mënyrën e jetesës sonë në një bazë e cila bazohet në gjenerimin e të ardhurave, jo në prishjen e aseteve [ekologjike]. (p. 13)**

Nga një perspektivë e marketingut të qëndrueshëm, qëllimi i zhvillimit të qëndrueshëm është të krijojë sisteme të prodhimit – konsumit të cilat “vazhdojnë”, apo gjenerojnë vetveten, pa degraduar ekosistemet gjatë procesit. Duke patur parasysh këtë, termi *konsum i qëndrueshëm* po shfaqet si një etiketë për këto rezultate, i cili thekson lidhjen direkte të qëndrueshmërisë me vendimet e produktit/tregut të cilat nënvijëzojnë procesin e menaxhimit marketing (“Of Consuming Interest” 2001).

#### **Barazimi ndër breza**

“Fakti i thjeshtë është: duke plotësuar nevojat tona sot, ne jemi duke shkatërruar mundësitë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre” (Hart 2000:67). Në të kundërt, praktikat e zhvillimit të qëndrueshëm theksojnë proceset qarkulluese të cilat promovojnë konservimin e kapitalit dhe cilësisë së ekosistemeve në periudhën afatgjatë, duke zvogëluar kështu eko-kostot dhe duke u kujdesur për barazinë e brezave.

#### **Përfundim**

Marketingu i qëndrueshëm paraqet një model të ri, për të përkrahur idenë që sistemet e prodhimit-konsumit duhet të funksionojnë në mënyra të tilla që të



imitojnë sistemet natyrore qarkulluese. Adaptimi i tij sugjeron njohjen e pesë parimeve. Marketerët e qëndrueshëm nuk duhet të lënë në harresë faktin që kënaqja e blerësve dhe arritja e qëllimeve të organizatës, financiare dhe të tjera, mbeten kushte absolutisht të nevojshme të cilat duhet të arrihen ndërkohë që arrihet pajtueshmëria mjedisore.

### **Referencat**

1. Bakiu V (2006), Menaxhimi i turizmit, erik Botime, Tiranë , Albania.
2. Bakiu V, (2008), Sjellja konsumatore, “Erik”, Tiranë, Albania.
3. Burns C.A and Bush F.R. (2006), Marketing research, Pearson Education,Inc, Upper Saddle River, New Jersey,USA.
4. Elmazi L (2003), Marketingu i shërbimeve (koncepte dhe strategji), SHBLU, Tiranë, Albania.
5. Elmazi L (2007), Kërkimi Marketing, Botimet Ideart, Tiranë, Albania.
6. Elmazi L, Hysi V (2008), Bazat e marketingut, Botimet IDEART, Tiranë, Albania.
7. Elmazi L, Koja V, ( 2002), Disa veçori të marketingut të shërbimeve, Tiranë, Albania.
8. Elmazi L, Kruja D ( 2005), Menaxhimi e marketingu i shërbimeve, Botimet “Canaj-Pipa”, Shkodër, Albania.
9. Elmazi L. ( 2007), “Drejtimi marketing”, Tiranë, Albania.
10. Gilbert A. and Churchill, Jr. and J.Paul Peter ( 2000), Marketing ( Creating Value for customers), USA.
11. Karl E. Henion II, Ecological Marketing, GRID, France
12. Koja V (2002), Aspekte të drejtimt dhe organizimit të rajoneve turistike pritëse, Botimet albPAPER, Tiranë , Albania.
13. Kotler Ph. and Armstrong G. ( 2006), Principles of Marketing, Pearson Education,Inc, Upper Saddle River, New Jersey,USA.
14. Kristo I (2002), Biznesi ndërkombëtar,ShBLU, Tiranë, Albania.
15. Nedelea A & Elmazi L & Babu P.G & Banabahova K.V (2008), Tourism marketing, Derc Publishing House, Massachusetts, USA.
16. Peter J.P and Donnelly.J.H ( 2001), Marketing management – Knowledge and skills, Mc Grow Hill, USA.
17. Tisdell C (2001), Tourism ekonomiks, the emvironment and development. Analysis and policy, Edward Elgar Publishing Limited, Massachusetts, USA.
18. Wearing S & Neil J (2000), Ecotourism. Impacts, potentials and possibilities, Butterworth – Heinemann, Oxford.
19. Allen, L. R., and Long, P. T. and Perdue, R. R. and Kieselbach, S. (1988), “The impact of tourism development on residents’ perceptions of community life”, Journal of Travel Research, Vol. 27, pp.16-21.
20. Ap, J. (1990), “Residents’ perceptions research on the social impacts of tourism”, Annals of Tourism Research, Vol.17, pp. 610-616.

## KRIZAT FINANCIARE

*Fidane Spahija, ass.  
fidane.spahija@gmail.com*

### Abstrakti

Krizat financiare edhe sot vazhdojnë të mbesin fenomene të pazgjidhura. Numri i llojeve të krizave çdo ditë po shënon rritje nga faktorë të ndryshëm ekonomik, politik, social, klimatik, financiarë, etj. Varësisht nga identifikimi dhe madhësia e krizës, variojnë pasojat e saj. Nëse kriza vrehet më herët, atëherë gjasat për parandalimin e saj janë të mëdha, në të kundërtën pasojat e saj mund të jenë galopante, siç është kriza e sotme financiare globale. Në kushtet e sotme të globalizimit, efektet e krizave përhapen shumë shpejt, kjo si pasojë e aktiviteteve ndërlidhëse financiare e tregtare që kanë prej shtetit në shtet. Në raste krizash shpeshherë ndërhyjnë qeveritë, bankat qendrore dhe institucionet tjera, ku qëllimi i vetëm është dalja apo lehtësimi i krizës. Masat kryesore që i ndërmarrin janë ulja e normave të interesit, ulja e normave të politikave fiskale (*tatimeve, taksave,*) etj., nëse kriza është me përmasa më të mëdha, atëhere ndërhyjnë edhe FMN-ja, Banka Botërore, Banka Qendrore Europiane, qeveritë e vendeve më të zhvilluara duke i ndihmuar me donacione, hua, ndihma humanitare, etj. Krizat duhet paraprirë duke hartuar plane në parandalimin e saj, por, nëse ndodh që kriza ka arritur në vendin e juaj atëherë duhet hartuar plane urgjente për tejkalimin e saj dhe plane “postkrizë” sepse përndryshe pasojat e saj mund të kenë kohëzgjatje të paparashikueshme. Të mos reagojmë në kohë do të thotë ta pësosh dhe të vuash pasojat.

**Fjalët kyçe:** ekonomi, faktorët, globalizim, krizat, teknikat, pasojat, reagimet.

**JEL klasifikimi:** G, G0, G01.

### HYRJE

- Me këtë punim shkencor bëhen përpjekje të sqarohen: Njohuritë mbi definimin e krizave financiare, llojeve të krizave nëpër periudha dhe vende të ndryshme duke i harmonizuar me shkaqet e tyre, me shembuj konkret sqarohen disa nga faktorët kryesor dhe pasojat e krizave, dhe krejtësisht në fund flitet rreth masave parandaluese dhe reagimeve të qeverive me bankat qendrore për daljen apo tejkalimin e krizave financiare. Në kuadër të tekstit “Krizat financiare”, përfshihen edhe elemente të krizës së sotme financiare globale.

- Për hartimin e punimit janë përdorur literatura të ndryshme vendore dhe të huaja, poashtu hulumtime në internet, media elektronike dhe të shkruara. Metodatat e përdorura për të arritur qëllimin e punimit kryesisht janë: analitike, krahasuese, abstraksionit, etj.

## 1. DEFINIMI I KRIZËS FINANCIARE

- Një krizë financiare zakonisht është një situatë kur kërkesa për para rritet në mënyrë të shpejtë. Deri para disa dekadash, krizat financiare ishin ekuivalente me krizat e bankave. Sot ato mund të kenë formën e çfarëdo krize që ka të bëjë me paratë. Shumë ekonomistë kanë ngritur teoritë se si zhvillohet një krizë financiare dhe si mund të përballohet. Sidoqoftë nuk ka një vijë të përgjithshme parandaluese dhe krizat financiare mbeten akoma një fenomen i rregullt.

Ndër sistemet më të rrezikuara të ekonomisë nga kriza financiare është sistemi financiar.

- Sistemi financiar, si nënsistem ekonomik dhe politik i çdo vendi, shquhet me veçoritë e tij specifike të cilat rezultojnë nga klima politike, nga karakteri i të drejtave të pronësisë, nga niveli i zhvillimit ekonomik, nga korniza legjislative e cila e favorizon ose jo krijimin e institucioneve të mirëfillta të ekonomisë së tregut dhe nga shumë faktorë e indikatorë të tjerë.<sup>53</sup> Sistemin financiar e përbëjnë shumë elemente që nga institucionet financiare (bankat qendrore, bankat komerciale, bankat e kursimeve, asociacionet kreditore dhe të kursimit, kompanitë e sigurimeve, fondet e pensione – trustet, etj), ndërmjetësuesit financiar e deri tek tregjet dhe instrumentet financiare.<sup>54</sup>

- Në kushtet e sotme të globalizimit, efektet e krizave financiare transferohen shumë shpejt prej vendit në vend. Këtë e dëshmoi edhe ekonomisti i shquar *Paul Krugman*, i cili tha se *“globalizimi nuk duhet parë si një fenomen që sjellë vetëm mrekulli, dhe as si një demon që sanksionon disa vende e popuj në favor të disa të tjerëve”*.<sup>55</sup> Përkundrazi, është fakti se globalizimi duhet parë më tërë kompleksitetin e tij se bota e globalizuar është më e ekspozuar ndaj krizave.

## 2. LLOJET E KRIZAVE FINANCIARE DHE SHKAQET E TYRE

- Një krizë financiare në një vend ka shumë gjasa të shkaktojë kriza të tilla dhe në një vend tjetër. Në raste të këtilla investitorët janë në dilemë se në cilin vend t’i vendosin apo t’i tërheqin mjetet e tyre. Kjo shkakton një ndalesë të fondeve për shumë ekonomi. Fakt interesant është se kompanitë e vendeve me ekonomi të qëndrueshme nuk dëshirojnë të financojnë në ato vendet të cilat i ka kapluar kriza sepse frikohen se nuk do t’u mbulohen shpenzimet e tyre dhe njëkohësisht kjo është si pasojë nga frika se mos po kalon kriza edhe në vendin e tyre.

---

<sup>53</sup> Prof. Dr. Safet Meroci “Tregjet financiare”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2008, fq.25.

<sup>54</sup> Prof. Dr. Safet Meroci “Tregjet financiare”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2008, fq.25-26.

<sup>55</sup> Adrian Civici “Kriza financiare apo globale”, UET Press, Tiranë, 2010, fq. 128.

- Ka një list krizash që kanë kapluar botën që kanë ndodhur në hapësira të ndryshme kohore dhe që kanë tundur themelet jo vetëm të një shteti. Disa prej krizave më të mëdha financiare në botë janë:<sup>56</sup>

✓ *Paniku i vitit 1907*

“Paniku i vitit 1907” erdhi si pasojë e faktorëve të zakonshëm: ekspansioni i tepërt dhe arsyetimi i dobët. Tregu i bursës u rrënuar dhe kjo bëri që Banka Kombëtare e Amerikës së Veriut të falimentonte. Departamenti Amerikan i Thesarit u përpoq të dilte nga situata me paratë federale dhe me një riorganizmi krijues financiar. Tregu arriti të stabilizohej në shkurt të vitit 1908 dhe në maj Kongresi kaloi aktin “Aldrich-Vreeland”, i cili themeloi Komisionin Federal Monetar.

✓ *1912-’24: Superinflacioni gjerman*

Në vitin 1914 shkalla e këmbimit të dollarit amerikan me markën gjermane ishte 1 me 4. Në vitin 1923 shkalla e këmbimit kishte dalë aq shumë jashtë kontrollit sa që një dollar amerikan këmbuhej me 1 trilionë marka. Ideja e aq shumë parave nëpër duar duket e këndshme, por jo kur me to nuk blen dot as një bukë. Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore Gjermanisë iu kërkuar dëmshpërblim material për koston e luftës. Si pasojë valuta vendase humbi vlerën. Atëherë, Gjermania vazhdoi të shtypë para deri sa u prodhuan një mijë miliardë marka. Superinflacioni mbaroi, por jo para se t’u shkaktonte dëme e hidhërimë një gjenerate të tërë gjermane.

2. Cvjetičanin M., Kako čitati burzovna izvješća, Zagreb, 1996.
3. Hamzagić F., Vrijednosni papiri, Sarajevo, 1999.
4. Merovci S. Tregjet dhe instucionet financiare, Prishtinë, 2004
5. Mrkušić Ž. Burzovno poslovanje, Zagreb, 1990.
6. Murad A. Economics and problems, New Jersey, 1963.
7. Perović V. Berze-kako steći poverenje investitora, Miločer, 1997.
8. Schumacher M. Die Borse husse Lut fur Actionare, Rastalt, 1997.
9. Orsak S. Finansiranje emisijom vrednosnih papira, RI Gin, Zagreb, 1994
10. Perišin I. Svjetski finansijski vrtlog, Zagreb, 1988.

### **Ostali izvori :**

1. Agencija za registraciju biznisa MTI maj-2005 Encyclopedia Britanica,
2. Sordello- Text Books, Pg.417.
3. Encyclopedia Britanica, 21, Sordello- Text Books, Pg.417
4. Koncept efektnih berzi i kod nas ,Pravo i privreda, 3-6/95
5. Međunarodni Monetarni fond integraciona politika u postizanju razvoja Kosova.

## DOMOSDOSHMERIA E MARKETINGUT NË INTERNET

*Jahja Lataj, ass.  
jahja\_lataj@yahoo.com*

### Abstrakti

Rritja emergjente e internetit e shoqëruar kjo me teknologjinë përkatëse dhe atë të informacionit ka ka implikuar çdo aspekt të jetës sociale dhe ekonomike duke çuar në zhvillimin e një ere të re edhe për marketingun, e quajtur kjo marketingu në internet. Sot tre gjëra janë të qarta për bizneset: Interneti është shumë i rëndësishëm për marketingun, marketingu i suksesshëm duhet të bazohet në kuptimin se si duhet të integrojmë principet tradicionale dhe ato të biznesit të ri në një strategji koherente online dhe marketingu në internet është një përballje e ripërcaktimit të mënyrës nëpërmjet së cilës bizneset ndërveprojnë me konsumatorët e tyre. Në thelb misioni i marketingut është të tërheqë dhe të mbajë konsumatorët e tyre. Në marketingun tradicional roli konsumator ka qenë mjaft pasiv, sot mund të themi se www përdor konceptin hypermedia i cili koncept siguron një rol më aktiv të vizitorit në web. Hypermedia do të thotë llojllojshmëri përmbajtjesh të mediave që mund të aksesohen nëpërmjet superlidhjeve të cilat mund të përdoren mjaft mirë dhe me sukses në realizimin e marketingut në internet dhe sigurimin e avantazheve konkurruese në ekonominë e re.

**Fjalët kyçe:** marketing, internet, marketingu elektronik, online, konsumatorë, marketingu miks,

**JEL klasifikimi:** M, L86

### Hyrje

Kosova radhitet para disa vendeve të rajonit në përdorimin e Internetit. Sipas statistikave të revistës së specializuar "Internet World Stats", Kosova del në mesin e vendeve me rritje më të madhe në përdorimin e internetit. Edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare se sa është numri i atyre që kanë lidhje interneti, për shkak se shumë kompani, madje edhe të palicencuara, ofrojnë shërbime dhe lidhje të tilla, ofruesit e shërbimeve të internetit janë të kënaqur me nivelin e shfrytëzimit.

### Përdorimi i internetit

"Internet World Stats" ka publikuar numrin e përdoruesve që kanë lidhje të përhershme në internet, më poshtë do t'i paraqesim disa statistika rreth përdorimit të internetit në nivel botëror, evropian, në Shqipëri dhe Kosovë.

| WORLD INTERNET USAGE AND POPULATION STATISTICS |                        |                              |                            |                            |                  |                  |
|------------------------------------------------|------------------------|------------------------------|----------------------------|----------------------------|------------------|------------------|
| World Regions                                  | Population (2009 Est.) | Internet Users Dec. 31, 2000 | Internet Users Latest Data | Penetration (% Population) | Growth 2000-2009 | Users % of Table |
| <a href="#">Africa</a>                         | 991,002,342            | 4,514,400                    | 67,371,700                 | 6.8 %                      | 1,392.4 %        | 3.9 %            |
| <a href="#">Asia</a>                           | 3,808,070,503          | 114,304,000                  | 738,257,230                | 19.4 %                     | 545.9 %          | 42.6 %           |
| <a href="#">Europe</a>                         | 803,850,858            | 105,096,093                  | 418,029,796                | 52.0 %                     | 297.8 %          | 24.1 %           |
| <a href="#">Middle East</a>                    | 202,687,005            | 3,284,800                    | 57,425,046                 | 28.3 %                     | 1,648.2 %        | 3.3 %            |
| <a href="#">North America</a>                  | 340,831,831            | 108,096,800                  | 252,908,000                | 74.2 %                     | 134.0 %          | 14.6 %           |
| <a href="#">Latin America/Caribbean</a>        | 586,662,468            | 18,068,919                   | 179,031,479                | 30.5 %                     | 890.8 %          | 10.3 %           |
| <a href="#">Oceania / Australia</a>            | 34,700,201             | 7,620,480                    | 20,970,490                 | 60.4 %                     | 175.2 %          | 1.2 %            |
| <b>WORLD TOTAL</b>                             | <b>6,767,805,208</b>   | <b>360,985,492</b>           | <b>1,733,993,741</b>       | <b>25.6 %</b>              | <b>380.3 %</b>   | <b>100.0 %</b>   |

Përdorimi i internetit në botë (Burimi: Internet Usage World Stats)<sup>75</sup>

| Internet Usage in Europe      |                         |                 |                             |                            |                          |                |
|-------------------------------|-------------------------|-----------------|-----------------------------|----------------------------|--------------------------|----------------|
| EUROPE                        | Population (2009 Est. ) | % Pop. of World | Internet Users, Latest Data | Penetration (% Population) | User Growth (2000-2009 ) | Users % Table  |
| <a href="#">Europe</a>        | 803,850,858             | 11.9 %          | 418,029,796                 | 52.0 %                     | 297.8 %                  | 24.1 %         |
| <a href="#">Rest of World</a> | 5,963,954,350           | 88.1 %          | 1,315,963,945               | 22.1 %                     | 414.3 %                  | 75.9 %         |
| <b>TOTAL WORLD</b>            | <b>6,767,805,208</b>    | <b>100.0 %</b>  | <b>1,733,993,741</b>        | <b>25.6 %</b>              | <b>380.3 %</b>           | <b>100.0 %</b> |

Përdorimi i internetit në Evropë (Burimi: Internet Usage World Stats)<sup>76</sup>

| EUROPE                  | Population (2009 Est. ) | Internet Users, Latest Data | % Population (Penetration) | User Growth (2000-2009) | % Users Europe |
|-------------------------|-------------------------|-----------------------------|----------------------------|-------------------------|----------------|
| <a href="#">Albania</a> | 3,639,453               | 750,000                     | 20.6 %                     | 29,900.0 %              | 0.2 %          |
| <a href="#">Kosovo</a>  | 1,804,838               | 377,000                     | 20.9 %                     | 0.0 %                   | 0.1 %          |

Përdorimi i internetit në Shqipëri dhe Kosovë (Burimi: Internet Usage World Stats)<sup>77</sup>

Duke u bazuar në statistikat e lartëshënuara dhe rendësinë e marketingut në suksesin e ndërmarrjeve atëherë lind domosdoshmëria e aplikimit të marketingut në internet. Qëllimi i këtij punimi është shtjellimi i rendësisë dhe aplikimi i marketingut në internet në ndërmarrjet në Kosovë, çka rezulton me rritjen e suksesit në arritjen e objektivave.

<sup>75</sup> www.internetworldstats.com

<sup>76</sup> www.internetworldstats.com

<sup>77</sup> www.internetworldstats.com

## **Përkufizimi dhe kuptimi i marketingut**

Sipas AMA (American Marketing Association), Marketingu është procesi i planifikimit dhe ekzekutimit të nocionit të çmimit, promocionit, shpërndarjes së ideve, mallrave, shërbimeve për të krijuar shkëmbime të cilat kënaqin qëllimet individuale dhe organizacionale<sup>78</sup>.

## **Cfarë është e-marketingu?**

E-marketingu ose marketingu elektronik i referohet aplikimeve të principeve të marketingut dhe teknikave nëpërmjet mediave elektronike me specifikisht internetit. Marketingu në internet është produkt i bashkimit të teknologjisë së komunikimit modern dhe të principeve tradicionale të marketingut që organizatat kanë përdorur.

Marketingu në internet është një process i cili ndërton dhe ruan marrëdhëniet me konsumatorët nëpërmjet aktiviteteve online, për të lehtësuar shkëmbimin e ideve, produkteve, shërbimeve të cilat i kënaqin qëllimet e të dy palëve.

Ky përkufizim përfshinë pesë komponente bazë:

- Procesi
- Ndërtimi dhe mbajtja e marrëdhënieve me konsumatorë
- Online
- Shkëmbimi dhe
- Kënaqja e objektivave të dy palëve

**Procesi** – ashtu si e edhe një program marketingu tradicional edhe programi i marketingut në internet përfshin një process që detajohet në shtatë hapa si më poshtë:

- Përcaktimi i oportuniteteve të tregut
- Formulimi i strategjisë së marketingut
- Dizajnimi i eksperiencës së konsumatorëve
- Ndërtimi i ndërfaqësimit me konsumatorët
- Dizajnimi i programit të marketingut
- Shpërndarja e informacionit tek konsumatorët përmes teknologjisë
- Vlerësimi i rezultateve të programit të marketingut si një tërësi

**Ndërtimi dhe mbajtja e marrëdhënieve me konsumatorë** – qëllimi i marketingut është ndërtimi dhe mbajtja e marrëdhënieve me konsumatorë. Është e rëndësishme të konstatojmë se qëllimi i marketingut në internet nuk është vetëm të ndërtojë marrëdhëniet me konsumatorë online por të ndërtojë edhe marrëdhënie offline. Pra programi i marketingut në internet është pjesë e një fushate të gjerë për të kënaqur konsumatorët të cilët përdorin si shërbimet online dhe offline.

**Online** – nga vetë përkufizimi, marketingu në internet lidhet me ata persona që kanë akses në internet. Pavarësisht nga kjo ne mund të theksojmë se suksesi i

---

<sup>78</sup> [www.marketingpower.com](http://www.marketingpower.com)

një programi të marketingut në internet varet edhe nga mjetet e marketingut tradicional offline. P.sh. suksesi i monster.com (një agjensi punësimi) varet në një masë të konsiderueshme nga efektiviteti i reklamës së saj në television apo në mediat e tjera.

**Shkëmbimi** – në qendër të programit të marketingut online dhe marketingut offline është shkëmbimi. Lidhjet në ekonomi ndërmjet konsumatorëve dhe ndërmarrjeve janë shumë të ndjeshme kundrejt shkëmbimëve midis kanaleve.

**Kënaqja e qëllimeve të të dy palëve** – për shumë produkte interneti është bërë një component i rendësishëm i strategjisë së marketingut. P.sh. J.D. Power and Associates është një firmë e kërkimit konsumator tregoi se 62% të konsumatorëve kërkojnë makinat në internet përpara se t'i blejnë ato. BMW ka web faqen e saj në internet ku reklamon makinat e prodhuara. Web faqja e saj është vizituar nga 11 milion konsumatorë me një navigim prej 15000 konsumatorë në ditë. Volvo në bashkëpunim me AOL lancoi S60 Sedan ekskluzivisht online. Gjatë kohës tetor 2001 – shkurt 2002 me shumë se 250000 persona kërkuar informacion në bazën e të dhënave të Volvo, 45000 prej tyre konfiguruar makinat e tyre online dhe kërkuar një kuaotë nga shpërndarësit lokal. Kërkesa përfshinte emrin, adresën, telefonin, emailin, etj.. Volvo vlerësoi se promocioni në internet solli 27000 konsumatorë tek ambijentet e ekspozimit të shpërndarësve të lokalizuar në vende të ndryshme të botës, gjë e cila përforcon edhe njëherë faktin se marketingu në internet lidh së bashku prodhues, shpërndarës dhe konsumatorë të shpërndarë gjeografikisht dhe si rezultat i bshkëveprimit kënaqin nevojat e tyre.

### **Shtatë variablat e marketingut miks në internet**

Kur kemi trajtuar marketingun tradicional kemi identifikuar katër componentë të rendësishëm: produkti, cmimi, promocioni dhe shpërndarja.


Kur trajtojmë marketingun në internet konsiderojmë edhe tre elementë të tjerë të rinj: komuniteti, markëzimi dhe procesi.

Komuniteti është niveli i ndërveprimit i cili shpaloset midis përdoruesve.

Markëzimi është një component kritik për ndërtimin e mardhënieve në afat të gjatë në internet.

Procesi i referohet lehtësisë me anën e të cilës mund të përdoret website organizatës.

Le t'i trajtojmë më hollësisht këta komponentë dhe të shohim ndryshimet që këta kanë krahasuar me marketingun tradicional.



Marketingu mix në internet<sup>79</sup>

**Produkti** – është një e mirë fizike, një shërbim ose një ide që një kompani ofron për shkëmbim. Një rang i gjërë produktesh ofrohen në internet duke përfshirë:

- të mira fizike si: veshje , makina, libra, produkte kozmetike etj
- produkte informuese: si gazeta Ballkan, Koha Jonë, News 55, Shekulli online etj.


Ofertat e organizatave të biznesit zakonisht janë një këmbim i këtyre tre formave, sepse për ndërtimin e marrëdhënieve me konsumatorë ato duhet të sigurojnë një gamë të ndryshme niveli produkti. Lind pyetja: cili është ndikimi i internetit tek produktet e organizatave? Për të kuptuar se marketerët sigurojnë avantazh në internet dhe se si produktet online dhe offline ndryshojnë nga njëri tjetri është e rëndësishme ti ndajmë produktet në katër kategori bazë:

- produkte të dixhitalizuara,
- shërbimet
- shërbimet e shitjes me pakicë dhe shpërndarjes
- produktet shtesë

interneti i ofron kompanisë oportunitete unike për secilën kategori produkti në mënyrë që ajo të sigurojë një ofertë sa më të mirë në treg.

---

<sup>79</sup> Bazat e marketingut, fq. 414



Kategoritë e produkteve në internet<sup>80</sup>

**Çmimi** - është një element i një rëndësie në rritje të marketingut. Vendosja e çmimit përbën një sfidë për firmat dhe shpesh herë ai mund të vendoset në një mënyrë të pasrstrukturuar. Interneti ka influencuar mjaft strategjitë e çmimeve në ekonominë e vjetër duke ofruar kështu një tërësi mjetesesh në dispozicion të firmave për vendosjen e çmimeve në ekonominë e re. Është fjala për strategjitë ekonomike të vendosjes së çmimeve. çmimet dinamike kanë revolucionarizuar transaksionet biznes-biznes (B2B), konsumator-konsumator (C2C) apo biznes-konsumator (B2C).

**Komunikimi** – komunikimi në kuptimin e tij më të thjeshtë ka për qëllim të shpërndajë mesazhet. Kompanitë tradicionale kanë pasur mundësinë të transferojnë si mesazhet e personalizuar edhe interaktive tek konsumatori, kurse tani interneti iu krijon beizneseve jo vetëm të targetojnë reklamimet e tyre apo të personalizojnë komunikimet por edhe të përfshihen në një dialog konstant të dyanshëm me konsumatorët. Në këtë mënyrë firmat mund të ndërveprojnë dhe të komunikojnë personalisht me përdoruesit duke kaluar kështu nga vetëdija tek angazhimi në blerje me synim zgjidhjen e problemit.

Komunikimi në formën e reklamimit masiv perceptohet si i njëanshëm, pra mesazhet kalojnë nga firma tek konsumatori. Megjithatë komunikimi në internet ofron potenciale të reja përseri ne nuk mund të largohemi nga principet bazë të komunikimit marketing.

Komunikimi marketing është një aktivitet i cili informon një ose më shumë grupe të konsumatorëve të synuar në lidhje me organizatën dhe produktet e saj me qëllim që të stimulojnë blerjen.

<sup>80</sup> Bazat e marketingut, fq. 415



Shumë website përdorin informacionin e regjistruar me që ti bëjnë konsumatorët të ndihen mirë në këtë aspekt. P.sh. gazeta New York Times [www.nytimes.com](http://www.nytimes.com) përshendet të gjithë përdoruesit e saj sapo ata të navigojnë tek ajo. "Mirësevini" <emrin>.

**Shpërndarja** – Interneti mund të konsiderohet thjesht një kanal shpërndarjeje apo ai prezanton një revolucion në biznes?

Nga njëra anë mund të duket i pazakontë fakti që konsumatorët ndonjë ditë mund të blejnë kompjutera personal, veshje, liba apo produkte ushqimore nëpërmjet internetit. Disa prej tyre mund të jenë skeptikë dhe duan gjithmonë të prekin, të ndiejnë, të dëgjojnë, të provojnë produktet përpara se ti blejnë ato, pra kërkojnë një mjedis fizik blerjeje.

Nga ana tjetër nuk duhet të nënvleftësojnë impaktin që ka interneti në shpërndarjen e produkteve. Ai ka transformuar strukturën e industrisë të kompjuterave personal, veshjeve, librave, CD, udhëtimeve, shërbimeve për shëndetin apo produkteve ushqimore. Interneti siguron më shumë se sa thjeshtë kosto të ulta apo konsumatorë besnikë, ai mundëson organizatat të ndërveprojnë me miliona konsumator mbi baza individuale dhe në kohë ideale. Anjëherë më parë organizatat nuk kanë qenë kanë të lidhura me konsumatorë dhe furnizuesit e tyre.

**Komuniteti** – është një set marrëdhëniesh ndërvepruese të ndërtuar mbi bazën e interesave të përbashkëta të cilat kënaqin nevojat e anëtarëve të cilët nuk janë të arritshëm individualisht, psh Klubi i Rotarianëve. Pra komuniteti nuk është vetëm një set marrëdhëniesh por një set marrëdhëniesh ndërvepruese. Një grup individesh mund të jenë të përfshirë në marrëdhënie të forta besimi por, ata në qoftë se nuk komunikojnë me njëri tjetrin, nuk ndajnë interesat dhe eksperiencat nuk mund të flasim për komunitete. Një nga aspektet unike të internetit është shpejtësia me të cilën komunitetet mund të krijohen (formohen) por nuk duhet të anashkalojmë edhe rëndësinë që kanë këto komunitete për firmën. Lind pyetja cilat janë egzaktesisht këto interesa të përbashkëta midis anëtarëve të komunitetit?

çdo njeri mund të imagjinojë se interesat e përbashkët i referohen një numri infinit aktivitetesh, temash ose aspekte të përbashkëta të tjera. Duke i ndarë këto interesa në grupe të identifikojmë lehtësisht baza të ndryshme komunitetesh, kështu kemi përcaktuar tre grupe të gjërë komunitetesh:

- komunitete të orientuar nga informacioni
- komunitete të orientuar nga aktivitetet
- komunitete të orientuar nga atributet e përbashkëta

Tre bazat e interesave të përbashkët të komunitetit

- Komunitete të orientuar nga informacioni. Komunitetet e ndëruara për këtë qëllim tentojnë që të shkëmbejnë kryesisht fakte dhe opinione. Informacioni më tepër se sa përfshirja në aktivitetet është fokusi kryesor i komunitetit, psh studiuesit në fushën e mjekësisë.
- Komunitete të orientuara nga aktivitetet. Të ndash interesat do të thotë të jesh i interesuar në një aktivitet, në mënyrë specifike i përfshirë në një aktivitet. Interesat në aktivitet mund të variojnë nga blerja e produkteve antikë duke takuar edhe miq të rinj tek luajtja e rolit në një lojë online. eBay është një shembull i përkryer i

komuniteteve të orientuar nga aktivitetet ose Sony i ndëruar nga lojtarët e botës virtuale të video game e quajtur EverQuest.

- Komunitete të orientuar nga aktiveitetet e përbashkëta. Interesat e përbashkëta mund të arrijnë deri në attribute të përbashkëta, psh individët mund të kenë të njejtin profesion të njejtin origjinë ose mund të jenë anëtarë të të njëjtës grupmoshe. Psh komuniteti i moshës të tretë mund të veprojnë si një komunitet për baby boomers të interesuar në shëndet dhe mirëqenie.

Autor të tjerë si Artur Armstrong dhe John Hagel identifikojnë katër tipe komuniteti: komunitete e transaksioneve, komunitetet e interesit, komunitetet e fantazisë dhe komunitetet e marrëdhënieve. Këto klasifikime janë të domosdoshme për të identifikuar komunitetet në nivele më specifike.

**Marka** – roli i markës në ekonominë e internetit është mjaft e rëndësishme. Marka është terësisht e ndryshme nga dizajnimi i produktit, çmimi, komunikimi, komuniteti, shpërndarja. Lind pyetja se çfarë është një markë? Sipas Bashkimit Amerikan të Marketingut, një markë është një emër, term, simbol, shenjë, dizajn ose një kombinim i tyre që identifikon mallrat apo shërbimet e një organizate dhe i diferencon ato nga konkurrentët. Pra marka i referohet të gjitha aktivitetëve që lidhen me identifikimin e produktit apo organizatës.

**Procesi** – i referohet lehtësisë me të cilën konsumatorët navigojnë dhe ndërveprojnë në websitet e ndërmarrjeve. Procesi në vetvete përfshin elementet e mëposhtme: politikat, procedurat, mekanizmin, gjykimin e nënpunësve, përfshirjen konsumatore, drejtimin konsumator, rrjedhën e aktivitetëve. është e rëndësishme të theksojmë faktin se të gjithë elementet e marketingut mix në internet duhet të integrohen me njëri tejetrin për të siguruar arritjen e synimeve të përgjithshme dhe specifike të organizatave të shërbimeve.

### **Përfitimet e marketingut në internet kundrejt marketingut tradicional**



### Përfitimet e marketingut në internet<sup>81</sup>

**Arritshmëria** – nga veta natyra e tij marketingu në internet nënkupton faktin se bizneset kanë mundësi të sigurojnë një arritshmëri globale. Ndërkohë kostot e mediave tradicionale që përdorë marketingu tradicional limitojnë arritjen multinacionale, marketingu në internet hap mundësi të reja për bizneset e vogla me buxhet të kufizuar që të aksesojnë konsumatorë nëpërmjet worl wide web.

**Fusha e veprimit** – marketingu në internet i ofron mundësi marketerëve që të arrijnë konsumatorët në mënyra të ndryshme dhe i mundëson atë që të ofrojnë një rang të gjerë produktesh dhe shërbimesh. Fusha e marketingut në internet do të rritet gjithnjë e më tepër me rritjen e teknologjisë dhe ekonomisë së re.

**Ndërveprimi** – ndërkohë që marketingu tradicional në pjesën më të madhe të tij konsistonte në dërgimin e një mesazhi marke tek konsumatorët, marketingu në internet lehtëson komunikimin midis organizatave dhe konsumatorëve. Nëpërmjet kanaleve të komunikimit të dyanshëm organizatat mund t’iu përgjigjen me mire nevojave dhe kërkesave të konsumatorëve duke e bërë ndërveprimin më tepër dinamik dhe adaptiv.

**Përgjigjësia e menjëhershme** – marketingu në internet siguron një ndikim të menjëhershëm gjë e cila më parë nuk mund të imagjinohej. Imagjinoni sikur ju po lexoni gazetën tuaj të preferuar dhe shikoni disa produkte apo shërbime të reja në disa nga faqet e saj. Nëpërmjet këtij mediumi tradicional nuk është e mundur që konsumatori të marrë hapa të menjëhershëm që nga të mësuarit deri tek blerja e këtij produkti. Marketingu në internet e lehtëson këtë proces, thjesht e bën këtë të mundur. Nëpërmjet disa klik ju mund të kërkonit informacion ekstra ose ta porositni produktin.

**Demografite dhe targetimi** – në kuptimin e përgjithshëm demografite në internet mund të konsiderohen si ëndrra të marketerëve. Përdoruesit e internetit konsiderohen si një grup që kanë një fuqi blerëse të lartë dhe ndoshta të pozicionuar në shtresën e mesme.

**Adaptimi** – marketingu kërkon një matje dhe analizë konstante të rezultateve të iniciativave në marketing. Duke siguruar një përgjigjëje të vazhdueshme në lidhje me efektivitetin e fushatës marketerët do të jenë më dinamikë në adaptimin e nevojave dhe kërkesave ndaj konsumatorëve.

### Konkluzione dhe rekomandime

Duke u nisur nga ajo që është thenë më lartë atëherë lindin disa pyetje që duhet dhënë përgjigjëje me rastin e aplikimit të marketingut në internet në ndërmarrje.

A janë segmentet e dëshiruara të produktit online dhe nuk ka nevojë për një shqyrtim fizik të produktit?

A mundet që interneti të bëhet një kanal shitjeje i sukseshëm dhe një mjet i marketingut efektiv?

---

<sup>81</sup> Bazat e marketingut, fq. 428

A janë segmentet e dëshiruara të produktit online dhe a është produkti i identifikuar nëpërmjet markës?

A mundet që Interneti të përdoret për të ndërtuar dhe forcuar ekuitetin e markës dhe njëkohësisht të rrisë shitjet marginale?

### **Përfundim**

Duke u bazuar në statistikat botërore e veqanërisht në ato regjionale dhe lokale mund të vijmë në përfundim se marketing në internet është një veprimtari e domosdoshme për ndërmarrjet. Në dhjetë vitet e fundit kemi një rritje marramendëse të përdoruesve të internetit shkalla e rritjes është 380%. Ndërsa, në Shqipëri dhe Kosovë kemi një rritje prej 29,900%. Duke u bazuar në trendin e rritjes të përdoruesve të internetit atëherë ndërmarrjet duhet të fillojnë aplikimin e marketingut në internet në atë mnyrë që të sigurojnë:

- Produkti të jetë mirë i prezantuar në internet që konsumatori të jetë i bindur për karakteristikat e produktit në paraqitjen virtuale dhe mos të ketë nevojë për një paraqitje fizike.
- Që internet të jetë një kanal shitje shumë efektiv dhe i sukseshëm
- Përmes paraqitjes online të produktit të vije gjer të ndërtimi dhe forcimi i markës së produktit që do të ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e shitjeve

### **Referencat**

1. Billa, Liljana Elmazi & Panajoti, Vjollca Hysi, “Bazat e Marketingut”, Ideart, Tiranë, 2008, Jakupi, Ali, “Marketingu Ndërkombtar”, Universiteti AAB, Prishtinë, 2008, Jakupi, Ali, “Marketingu”, Universiteti AAB, Prishtinë, 2008,
2. Kotler, Philip & Wong, Veronica & Saunders, John & Armstrong, Gary “Principles of Marketing” Fourth European Edition, Prentice Hall, 2005,
3. Reshidi, Nail & Ceku, Bardhyl, “Marketingu”, Universiteti ILIRIA, Prishtinë, 2006
4. [www.internetworldstats.com](http://www.internetworldstats.com)

## **NDËRVARSHMËRIA NË MES MASES MONETARE, ÇMIMEVE DHE AKTIVITETIT EKONOMIK.**

*Mr.sc. Mehdi Gjakova, profesori i SHLE,  
mehdigjakova@hotmail.com*

### **Abstrakti**

Ekonomia e tregut bashkëkohor është ekonomia monetare, veprimet e së cilës bëhen përmes parave dhe surrogatëve të saj . sjellja e Jdo subjekti ekonomik varet nga vëllimi, mënyra e aplikimit të formave të ndryshme të parasë - surrogatëve të saj. Këto jo vetëm për arsye se përmes parasë shprehet edhe profiti, por pikërisht bëjnë shprehjen dhe sjelljet e të gjitha subjekteve ekonomike me qëllim të realizimit të të ardhurave, sigurimin e likuiditetit në procesin riprodhues, dhe siguron “fuqi” në marrëdhëniet në mes subjekteve ekonomike përmes së cilës sigurohen kushtet optimale për realizimin e rritjes, dhe zhvillimit ekonomik. Problemet në ekonomi mund të zgjidhen me definimin e parave, çmimeve dhe aktivitetit ekonomik në varshmërti të rrethanave specifike të marrëdhënieve shoqërore, dhe politikave zhvillimore, specifikat në të cilat subjektet ekonomike veprojnë. Përmes teorisë, parimeve, rregullave dhe ligjshmërive krijohen opinionet lidhur me procesin e marrjes së vendimeve për zgjidhjen e problemeve konkrete në ekonominë monetare.

**Fjalët kyqe:** masa monetare, çmimi, paraja,

**JEL klasifikimi:** G2, G21,

### **Hyrje**

Zhvillimin ekonomik e shoqërojnë faktorët të shumtë shoqëror-ekonomik, politik, social etj. të cilët përbëjnë një objektivë primare në hartimin dhe zbatimin e politikave ekonomike, duke mos lënë anash rrethanat natyrore dhe kohore në të cilat ekonomija reale tenton t'i realizon qëllimet e parashtruara.

Andaj, sistemi ekonomik dhe politika ekonomike duhet të jetë në funksion të arritjes zhvillimore që bënë parakushtin themelor në arritjen e objektivave të saja. Ekonomija aplikative përmes masave dhe instrumenteve të saja, si pjesë e ekonomisë së përgjithshme, duhet të krijojë parakushtet adekuate me qëllim të rritjes së ekuilibrit të marrëdhënieve në mes të ofertës dhe kërkesës pra faktorëve që kushtëzojnë këto ecuri.

Kuptimi i tillë i ekonomisë aplikative i shërben strukturave shoqërore në arritjen e qëllimeve zhvillimore makro-ekonomike. Mirëpo, na është e kurtë se politika ekonomike përbëhet nga nënsistemet e saja: politika monetare, politika fiskale, politika investive, politiken e punësimit dhe politiken e marrëdhënieve me vendet tjera. Të gjitha këto nënsisteme kanë rol dhe rëndësi në rritje dhe zhvillimin

ekonomik të ekonomisë kombëtare. Harmonizimi i këtyre nënsistemeve bën një nga detyrat më të rëndësishme të cilat mund të shprehen përmes rezultateve të arritura të produktit kombëtar bruto, dhe nvarshmërisë e cila kushtëzon funksionimin e ekonomisë së tregut. Pra, kjo bënë njëren nga parakushtet pa të cilat nuk mundemi t'i përgjigjemi zhvillimit harmonik dhe proqesit riprodhues i cili është mjaft i ndërlikuar dhe kërkon zgjedhjen adekuate të problemeve në të gjitha fazat e saja, duke i kushtuar vëmendje te veçan procesit të ndarjes dhe shpërndarjes të të ardhurave kombëtare dhe eliminimin të pozitave monopolistike, të cilat nuk mund të zgjidhen thjeshtë përmes funksionimit të tregut, por si modalitet i “etikës shoqërore” lidhur me sigurimin e likuiditetit në ekonomi posaqërisht të vet procesit të riprodhimit, dhe siguri “fuqisë” ekonomike si më të rëndësishëm në aspektin makroekonomik kursimi dhe investimi.

### **1. Paraja dhe ekonomia**

Mënyra se si po arrihet në realizimin e politikave makroekonomike, edhe përkundër përpjekjeve të organeve dhe institucioneve shoqërore në marrjen e masave dhe zbatueshmërinë e instrumenteve tregon qartë se pos faktorëve endogjenë, ndikim të madh kanë faktorët ekzogjen të cilët edhe përkundër përpjekjeve në parashikimin e tyre bëjnë rrethana të pavolitshme në realizimin e qëllimeve të parapara.

Prandaj si detyrë kryesore e çdo bashkësie shoqërore është krijimi i ambientit të përshtatshëm për prosperitetin në të gjitha fushat jetësore. Parakusht esencial në arritjen e qëllimit të tillë është funksionimi harmonik në ekonominë kombëtare, që nënkupton krijimin e barazpeshës në ekonomi reale. Në ekono mall para ku ekonomia e tregut barazpeshën e arrin në mes të krijimit të kushteve të barabarta të ofertës dhe kërkesës së mallrave dhe shërbimeve. Mirëpo, këtë barazpeshë nuk mund ta arrijmë vetëm përmes faktorëve që shkaktajnë ofertën dhe kërkesën të cilët paraqiten si madhësi të varura dhe të cilat përcaktojnë vëllimin dhe përbërjen e tyre që e shprehim përmes indikatorëve vleror-çmimeve.

Marrë parasysh se çmimet janë shprehje nominale e vlerës, e cila bëhet përmes njësisë monetare që e shpreh nominalitetin e vlerës e cila matet në njësi para-ari, apo letër që mundëson qarkullimin dhe këmbimin e mallrave dhe shërbimeve. Mirëpo, vlerën e paraqesim si sasi të punës së nevojshme shoqërore që përmbajnë të mirat ekonomike, dhe këtë mund ta masim vetëm përmes punës së pigëzuar, materializuar në mënyrë sa më të pranueshme nga të gjithë subjektet e konomisë kombëtare. Kjo tregon se si masa vlerore na shërben dicka që në mënyrë ideale shpreh punën e dobishme shoqërore e këtë më së miri e prezenton malli i caktuar-mall ari, i cili posedon vlerën e përdorimit dhe vlerën e këmbimit dhe njëherit ngeli si përfaqësues reprezentativ i punës abstrakte te njëriut.

Duke u bazuar me këtë se ai shërben si mjet këmbimi, duke marr parasysh vetit natyrore dhe cilësinë e tij në dobishmërinë e plotësimin e nevojave atëhere këmbimi bëhet sipas cilësisë së përbashkët që përcakton vlerën e tyre në treg apo vlerën në qarkullim-këmbim. Së këndejmi me ndarjen e një malli si ekuivalent i përgjithshëm prej mallrave të tjerë miret karakteri i parasë. Me zhvillimin e

shoqërisë dhe proceset e veçuara të punës, ky mall fitojë funksionin shoqëror-ekonomik, sepse asnjë mall nuk mund të jetë para nga natyra, mirëpo ai funksion i është dhënë nga ana e shoqërisë.<sup>82</sup>

Me qenëse në ekonomin e tregut transakcionet në mes të ofertës dhe kërkesës shprehen përmes njësisë monetare dhe duke marrë në konsideratë se në mes tyre nuk qendron një ekuilibër i plotë, qartë rezulton se ecuria ekonomike cilësohet përmes vlerës së parasë, si mjet qarkullimi tregon se këtu bëhet fjalë për fuqinë blerëse të parasë.

Në literaturën ekonomike hasim mendime të shumta lidhur me ecuritë ekonomike, si dhe nevojat e rregullimit të sajë, të cilat mbështeten mbi sasinë e masës monetare. Mirëpo, fuqia blerëse e parasë nuk mund të përcaktohet nga sasia e sajë, apo sasia e mallrave por duhet vënë në raport me shumën e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve në periudhën e caktuar. Këtë e theksojmë me qëllim që të kuptohet drejtë, kuptimi dhe përmbajtja shumë e rëndësishme e funksionit të parasë si masë vlerore dhe si masë e çmimeve. Së pari mendime të cilët mohojnë faktorët të cilat determinojnë karakteristikat e mallit, dhe qasen nga sasia e parave në qarkullim fitohet përshtypja e gabuar mbi pasojat e saja, të cilësuar si të veçuara nga proqesi qarkullues i pavarur, dhe krijon arsyeshmërin e paraqitjes të ideve reale mbi politiken monetare.

Me gjithëse edhe thjeshtëzimi i tepruar i parasë si masë monetare qarkulluese mund të sjellë edhe eliminimin e rëndësisë së parasë dhe ecurive monetare.

Prandaj, nëse thjeshtëzohet forma e parave si mall që shpreh procesin e këmbimit në mes të mallrave dhe parave, atëherë fjala bëhet për format e saja të cilat rrjedhin nga vetë procesi i qarkullimit. Në qarkullim gjinden mallra me çmime të ndryshme, andaj ai raport praktikisht tregon fuqinë blerëse të parave e cila nuk bënë të matet me sasinë e parave, por duhet të vihet në raport me shumën e mallrave dhe shërbimeve në periudhat e cekura kohore.

Vlenë të ceket, se edhe format e parave të cilat i përkasin nivelit më të lartë të procesit riprodhues bënë formën e parasë kredi. E meta e mendimeve mbi konceptet e të parëve duhet parasegjithash kërkuar në pamundësin e shpjegimit të drejtë mbi lidhmërinë në mes fazave të procesit riprodhues dhe mendimeve mbi politiken monetare kreditore, e kjo e dyta veqanarisht nuk qe në nivelin e duhur të arsyeshmërisë të rrjedhave ekonomike e me veqanti mospërcjellja adekvate e procesit të riprodhimit ku ecurit monetare nuk u përgjigjen arsyeshmërisë të zbatimit të treguesve makroekonomik që i shprehim përmes produktit kombëtar bruto dhe në bazë të tijë qart mund të tregohet ndërvashmëria në mes të variablave të rëndësishme të sektorit monetar dhe atijë real dhe njëherit mund të na tregon nivelin e pasigurisë. Më thjeshtë problemi kryesor nuk qendron vetëm në format dhe sasin monetare, por në raportin në mes të fazave në procesin riprodhues duke mos i rrespektuar propocionet e shpërndarjes në mënyrë të duhur dhe njëherit ndërvashmërinë në mes të tyre që qartë tregon nevojën aplikimit të masava dhe instrumenteve të politikës ffinanciare nga nan e organeve shtetërore. .

---

<sup>82</sup> Karl Marx: Kapitali, shtëpia botuese “Dituria”, faqe 98

Problemet e tilla organet e pushtetit mund ta rregullojnë përmes rregullimit të politikës monetare-kreditore që si detyrë e ka pushteti monetar-kreditor qendror e ky është akteri më i rëndësishëm në zbatueshmërinë e politikës monetare-kreditore si nënsistem i politikës ekonomike që së bashku me politiken fiskale mund të ndikon në stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik.

Njëri nga qështjet me rëndësi primare që definimi i sasisë optimale-sasisë së masës monetare. Mirëpo, nga aspekti teorik sasia e nevojshme e parasë qendron në lidhshmërinë e përgjithshme të qarkullimit të parasë: sasia e parasë-masës monetare në funksion si mjet qarkullimi, e cila cakton shumën e çmimeve të mallrave në qarkullim dhe shpejtësia e qarkullimit të parave me të njejtin emër. Po të marrim tani shumën e përgjithshme të parave që gjinden në qarkullim gjatë një përmase të caktuar kohore na del se ajo duke qenë e mbështetur në shpejtësinë e qarkullimit dhe mënyrës së pagesave është e barabartë me shumën e çmimeve të mallrave që janë të destinuar në realizim, plus shumën e pagesave të cilave u është rritur afati i maturimit, minus pagesat që kompenzohen reciprokisht dhe më në fund minus numri i rrotullimeve në të cilat të njejtat para funksionojnë herë si mjet i qarkullimit e herë si mjet pagese.<sup>83</sup>

Konstatimi i tillë ka të bëjë me parat reale, pra si mallra të cilat qenë të lidhura me monedhen ari. Ndërsa sot kemi të bëjmë me suruvatet e parasë në qarkullim dhe përcaktuesit e masës monetare të nevojshme që bënë një proces shumë të ndërlikuar. Pra, sasia e nevojshme e masës monetare paraqitet si rezultat i faktorëve të prodhimit.

Mendime teorike tregojnë qartë se masa monetare ka rëndësinë në procesin e riprodhimit, si dhe vetë struktura e sajë, teknika e pagesave, organizimi i ekonomisë, dhe niveli i arritur i zhvillimit të institucioneve monetare, si dhe faktorët psikologjik. Mirëpo, të gjitha problemet dhe pasojat të cilat mund të na paraqiten parashtrajnë qëllim në veti për tu zgjedhur e veqmas në përcaktimin e fuqisë blerëse, eliminimin e inflacionit, deflacioni, problemin e kursit devizor, aprecionin dhe deprecionin, si dhe dukuritë lidhur me multiplikatorin kreditorë dhe monetar që kanë lidhmëri dhe ndërvashmëri në mes të masës monetare dhe procesit riprodhues.

Lidhur me zgjedhjen e problemeve monetare do të shërbehem me një shembull, po qe se banka qendrore emiton sasi ma të madhe të parave primare nga nevoja, rrespektivisht mbi nivelin e produktit kombëtar nominal, kjo sjellë rritjen e kërkesës në raport me ofertën e mallrave, që bënë rritjen e çmimeve dhe si pasojë e sajë sjellë uljen e vlerës së valutes kombëtare që vështirëson marrëdhënjet e qarkullimit me vendet tjera. Me qenëse vëllimi i prodhimitarisë së mallrave për shkaqe të shumta mund të sjellë edhe në rritjen e kërkesave atëhere kjo mundëson që ekonomia kombëtare-subjektet ekonomike prodhuese të realizojnë produktet e tyre dhe kështu do të tregojnë zvogëlimin e efikasitetit prodhues ku prodhuesit joefiqient mund t'i arrijnë të mbulojnë shpenzimet përmes çmimeve të larta. Anasjelltas me sasi ma të vogël të parave krahasuar me nevojat mund të shkaktohet pengesa e këmbimit të produkteve kombëtare e me këtë edhe prodhimi, punësimi etj.

---

<sup>83</sup> Karl Marx: Kapitali, shtëpia botuese "Dituria", faqe 80



## 2. Identiteti kryesor makroekonomik

Njëra nga detyrat më kryesore është që të bëhet analiza ekonomike për interakcionet në mes të sasive të parave, çmimeve dhe aktivitetit ekonomik. Kjo ka të bëjë me studimin e sjelljeve të ekonomisë si një tërësi që arsyeton nevojën e analizës sa më të hollësishme variabla makroekonomike të cilat mund ti masim përmes treguesve agregat si që është: produkti kombëtar i brendshëm, inflacioni, që shprehin ndryshimet në nivelin e përgjithshëm të çmimeve, normës së punësimit etj.

Mënyra e llogaritjes së produktit të brendshëm bruto, si tregues kryesor i cili përfaqëson vlerën e të gjitha mallrave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara në vend brenda një periudhe të dhënë. Sipas fazave në të cilën kryhet matja ekzistojnë tri metoda të matjes së produktit kombëtar bruto:

- Në fazën e prodhimitarisë produkti kombëtar bruto llogaritet si shumë e produkteve përfundimtare, të çdo dege ose si shumë e vlerës së shtuar për çdo degë të ekonomisë kombatare.
- Në fazën e shpërndarjes produkti kombëtar bruto llogaritet si shumë e të ardhurave të faktorëve të prodhimit.
- Në fazën e konsumit produkti kombëtar bruto llogaritet në si shumë e shpenzimeve për konsum, investime, shpenzime qeveritare dhe eksport neto.

Si rregull, duke qenë se lëvizja e të njejtit aktivitet matet me faza të ndryshme, ato duhet të jenë të barabarta, por në varësi të teknikës së matjes së këtyre fazave, kushtëzon disa ndryshime që eliminohen duke bërë rregullimet përkatëse. Për shpjegimin e produktit të brendshëm bruto duhet të kemi parasysh shprehjen në nivele të çmimeve të periudhave të ndryshme kohore. Produkti kombëtar bruto nominal matet me vlerën e prodhimit në një periudhë kohore që tregon se prodhimi i mallrave të ndryshme fizikisht, si dhe çmimeve tregon se këtu përdorim çmimet e tanishme. Produkti kombëtar bruto real matë ndryshimin e prodhimit fizikë në ekonominë midis periudhave të ndryshme kohore duke vlerësuar të gjitha mallrat e prodhuara me çmimet nga viti bazë në vitin vijues. Megjithatë kuptimi i produktit kombëtar bruto përbën një cilësi arbitrare dhe pyetja bëhet se çdo rritje e produktit kombëtar bruto nuk do të thotë edhe zhvillim ekonomik psh. punësim më të madhë, zgjedhje të problemeve social ekonomin. Nëse i referohemi normës mesatare të rritjes së produktit kombëtar bruto nominal, dhe vëjmë re raportë me produktin bruto kombëtar real do të fitojmë deflatorin. Deflatori na tregon ndryshimet që ndodhen në mes të çmimeve të vitit bazë dhe të atyre korent, psh. të dhënat mbi normën mesatare të rritjes së produktit kombëtar në periudhën bazë dhe raportuese do të shofim sipas dinamikës të prezentuar si vijon:<sup>84</sup>

| Vitet | GDP | GDP | Deflatori i |
|-------|-----|-----|-------------|
|-------|-----|-----|-------------|

<sup>84</sup> Reudiger Berwbusch & Stanley Fisher: Makroekonomija, "Dituria" – Tiranë, fq. 27

|      | Nominal | Real | GDP |
|------|---------|------|-----|
| 1990 | 7.7     | 3.0  | 4.7 |
| 1991 | 8.8     | 1.6  | 7.2 |
| 1992 | 4.3     | 1.1  | 3.2 |
| 1993 | 0.3     | -0.5 | 0.8 |
| 1994 | 5.0     | 3.0  | 2.0 |
| 1995 | 3.9     | 2.4  | 1.5 |
| 1996 | 5.1     | 1.8  | 3.3 |
| 1997 | 5.4     | 2.7  | 2.7 |
| 1998 | 4.6     | 2.9  | 1.7 |
| 1999 | 4.6     | 2.1  | 2.5 |

*Tabela 1. Të dhënat mbi normën deflatore.*

Rritja e nivelit të çmimeve në ekonomi gjatë një perikudhe kohore tregon indeksin e çmimeve, në bazë të gjërë, që përdoret shpesh për të matur edhe inflacionin. Inflacioni në këtë rast e shprehë rritja e nivelit të çmimeve në ekonomin e një vendi. Ndërsa indeksi i çmimeve të konsumit mat koston e blerjes së një shporte të fiksuar mallrash dhe shërbimeve që përfaqësojnë blerjet e konsumatorëve, përmes së cilës vërtetohet fuqia blerëse e masës monetare.

Nëse ju referohemi çmimeve të mallrave dhe shërbimeve atëhere do të na ishte e kurtë se edhe interesi është çmim mbi paratë e huazuara. Përcaktimi dhe llogaritja e normave të interesit ka rëndësi teorike dhe praktike sepse përbën një ndër variablet më të përdorshme në botën monetare financiare. Për llogaritjen e normes së interesit fillimisht na është e dobishme njohja e konceptit të vlerës aktuale. Vlera aktuale përfaqëson shumën e vlerësimeve të sotme të të ardhurave të pritura në një kohë të ardhshme. Kjo është njëra nga shkaqët që shkakton ecurinë e masës monetare, rritja e masës monetare sjellë uljen e normës së interesit dhe anasjelltas. Sa më e ultë është norma e interesit subjektet ekonomike (familjet, ndërmarrjet) gjithnjë e më shumë është numri i tyre që huazojnë para për blerjen e mallrave, e kjo e bënë rritjen e kërkesave për konsum të gjërë dhe mjetet investuese që e mundëson angazhimin e faktorëve prodhues, punësim më të lartë dhe së fundi do të shënon rritjen e produktit kombëtar nominal. Nga ecurit e tilla shohim se rritja e sasisë në masën monetare bënë rritjen e produkteve kombëtare nominale e zvogëlimi do të sjellë ramje.

Me rëndësi është të shohim si produkti kombëtar nominal shprehet nëse rriten çmimet dhe rriten outputet. Përgjegjja do të nvaret nga niveli i arritur i ekonomisë kombëtare. Më parë konstatuam se rritja e sasisë së masës monetare sjell rritjen e konsumit. Nëse ekonomia është në gjendje të ulët të punësimit të faktorëve prodhues, atëhere çmimet e outputeve do të shënojnë rritje, por nëse ekonomia shënon rritje të faktorëve prodhues, rritja e kërkesave si rrjedhojë e rritjes së parave do të sjellë rritjen e çmimeve. Por nga ana tjetër zvogëlimi i sasisë së parave kushtëzon uljen e çmimeve që njëherit tregon aftësin blerëse të parave ( $1/p$ ), dhe nëse niveli i çmimeve është i lartë, fuqia blerëse e parave është më e vogël dhe anasjelltas.

Vlera funksionale e parasë si cilësi e parave të sotme, nvaret prej shumës së çmimeve të mallrave, përkatësisht prej vlerës së punës së materializuar në produktet kombëtare.

### **3. Instrumentet financiare**

Duke marrë parasysh rrethanat ekonomike dhe kohore, mendimet e shumëta teorike mbizotërojnë në arsyshmërinë në pengimin e emisionit të parave. Mirëpo është interesante se këto mendime shumë pak i kushtojnë kujdes mungesës monetare për qarkullim dhe pagasa, të cilat mund të krijohen nga rrethanat e qendrimeve, dhe masave të ndërmarrura nga pushteti monetar. Lidhur me emisionin primar dhe lejimin e kredive në sistemin bankar që më së miri dëshmon ekonomitë e vendeve në tranzicion dhe që bënë ramje relative të zhvillimit ekonomik dhe në mënyrë permanente tregon paaftësitë e shëndrimit të fondeve investive në ato të akumulimit. Tejkallimin e kësaj gjendje në ekonomin reale e shofim në mundësin e marrjes së kredive përmes instrumenteve financiare, obligacionit, akcionit, kambialit etj. të cilat subjektet ekonomike mund ti shfrytëzojnë si mjete pagese-sorogat të parave. Roli i tyre është i madhë, sepse kanë ndikim drejtpërsëdrejti në nivelin e pronësisë, si dhe në sjelljen e ecurive ekonomike të ekonomisë reale. Marëdhënjet në mes të huadhënësit dhe huamarrësit rregullohen përmes këtyre instrumenteve të cilat kanë karakteristika të ndryshme. Karakteristika kryesore lidhet me shkallën e ndryshme të rrishtit, që ato ofrojnë si për huamarrësit ashtu edhe për huadhënësit. Instrumente të ndryshme financiare përgjegjësisht dallohen njëri nga tjetri<sup>85</sup>:

- Nga preferenca për afate të ndryshme të maturimit që kanë huamarrësit dhe huadhënësit lidhur me nevojat e tyre.
- Nga lloji dhe nivelet e ndryshme të shpenzimeve dhe
- Nga shkalla e likuiditetit lidhur me shkallën e zhvillimit të tregut sekondar.

Në rregullimin e mardhënjeve në mes të huadhënësit dhe huamarrësit përdoren instrumentet e tilla financiare përmes së cilave jo vetëm që mundësohet qarkullimi relativisht i mirë, por njëherit bëhen edhe mjete për pagesa, që mundëson shëndrimin e mallrave në kredi dhe me eskontin e tyre paraqet shëndrimin e kredisë në para.

Monedha edhe në sistemet e hershme është paraqitur si sorogat apo zëvendësues i parave. Ajo shërbente si instrument i kreditimit dhe shëndrohet në një mjet qarkullues dhe si rrjedhim gjendja e qarkullimit tregonte nevojën gjithnjë më të madhe të parave. Sot ekonomija reale gjithnjë treogn nevojën për mjete monetare, siç e cekëm më parë shëndrimi i parave në depozitë, subjekteve ekonomike për mjete të tilla të deponuara ju lëshohet certifikata të cilat me rastin e blerjes së mallrave remitentët ndryshohen. Njëra nga instrumentet në formtë të titullit është

---

<sup>85</sup> Andan Rovcanin: Upravljanje financijame, "Jordan Studio"-Sarajevo, fq. 33

kambiali që zakonisht përdoret në qarkullimin e mallrave me kredi. Për rolin e tij të madhë është vendosur që çdo gjë që ka formën, përmbajtjen, emërtimin, eskontin dhe pagesat e tijë duhet të jetë e rregulluar përmes ligjeve të posaqme. Kur bëhet fjalë për sasinë e mallit të blerë nga blerësit i cili nuk mund të paguajë, shitësi i tyre emërton një letër me vlerë, kambial për vlerën e mallit, që nënshkruhet nga ana e blerësit i cili merr përsipër detyrimin e pagesës në shumën e caktuar, në një datë dhe vend të caktuar. Shitësi kambialin e nënshkruar mund ta paraqes në një bankë dhe të arkëtojë shumën e parave të shënuar me një zbritje-skont.

Me zhvillimin e sistemit kreditor, kredia e marr në rrethanat e tanishme nuk është e nevojshme që të kthehet në para të gatshme, por mjafton që të bëhen regjistrimet në librat e huadhënësit, që është i njoftur si sistem i pagesave pa para të gatshme e që bëhet në bazë të urdhëresës-çekut të bankës.

Nga aspekti ekonomik çeku bën instrument për tërheqjen e parave të depozituar në llogarin bankare, dhe bënë transfer nga kjo llogari në favor të vet emituesit. Emituesi i saj jep urdhër me shkrim bankes në të cilën është llogaria depozituese që të bënë pagesat për personat e tretë. Çeku rrallë herë shkon në pagesë te banka, por përmes tyre në llogari të remitentit do të shenon rritje, apo zvogëlim të mjeteve në llogarin e trasantit, kjo bartje e mjeteve tregon se në bankë bëhet cirkulimi i pagesave të obligushmërive.

Me qenëse ekonomija reale nuk mund të merr kredi drejtpërsëdrejti nga banka e nivelit të parë, praktika e vendeve të zhvilluara ekonomikisht krijon sistemin e parave bankare, në të njejtën mënyrë si monedhën dhe kambialin. Sistemi i tillë i parave bankare e njofim si para llogarie, para kredije, sepse krijohet kryesisht me lejimin e kredive në llogari të huamarrësit. Në rrethanat bashkëkohore parat depozitare bëjnë pjesën kryesore në përmbushjen e detyrimeve të procesit qarkullues, ndërsa parat emisionare-rrespektivisht parat e gatshme shumë pak janë në përdorim, por në veçanti në rrethanat ku ekonomija shenon recesion depozituesit e mjeteve shprehin dëshirë se pagesat e tyre të bëhen në para të gatshme.

Parat depozitare bëjnë formën më kryesore të kreditimit. Mirëpo, në ekonominë e tregut pos parave transakcionare (parat e gatshme dhe depozitat sipas shiqimit) përfshin edhe depozitat e mjeteve të kursimit, pavarësisht afatizimit që bëjnë mjetet likvide ku bëjnë pjesë edhe mjetet e depozitave të afatizuara nga ana e sektorit jo bankar, si dhe letrat me vlerë afatshkurte të cilat sjellin kosto të fitimit. Pjesëmarrja e mjeteve transakcionale në mjetet likuide është varur nga norma e interesit. Aktiviteti financiar mund ta klasifikojmë në bazë të lartësisë dhe shpejtësisë së shëndrimit në mjete qarkulluese. Për ta vërtetuar shkallën e likuiditetit të aktivave financiare, shërbehem përmes tri kriterëve. Sa lehtë dhe shpejtë këto aktiva mund ti shesim, sa janë shpenzimet e shitjes së tyre dhe cili është stabiliteti dhe parashikimi i çmimeve të tyre në treg. Nëse shërbehem me kriterët duhet pasur parasysh shpenzimet transakcionare dhe përkundër faktit se sa lehtë mund të shëndrohet një aktiv financiar në para transakcionare. Këtë mund ta shofim përmes ndryshimit që shenon çmimet e furnizimit dhe çmimet shitëse, psh. nëse bëjmë konvertimi e një fletëobligacioni dhe akcioneve si mjete në aktiven financiare do të shofim se ato nuk kanë likuiditet të njejtë, obligacionet janë relativisht mjete likvide, kurse akcionet janë më pakë likuide. Po kësajë vetia e çmimeve të

akcioneve më shumë ndryshon dhe shpenzimet e këtyre transakcioneve financiare shenojnë rritje.

Newmark's "Approaches to translation " and "A textbook of translation " have been widely used on translator training courses and combine a wealth of practical examples of linguistic theories of meaning with practical applications for translation. Yet Newmark departs from Nida's receptor-oriented line, feeling that the success of equivalent effect is "illusory" and that the conflict of loyalties , the gap between emphasis on source and target language will always remain as the overriding problem in translation theory and practice. Newmark suggests narrowing the gap by replacing the old terms with those of " semantic" and "communicative translation.

- **communicative translation** attempts to produce on its readers an effect as close as possible to that obtained on the readers of the original, The communicative translation resembles Nida's dybanic equivalence in the effect it is trying to create on the TT reader.

- **Semantic translation** attempts to render as closely as the semantic and syntactic structures of the second language allow, the exact contextual meaning of the original. Semantic translation has similarities to Nida's formal equivalence.

However Newmark distances himself from the full principles of equivalence effect , since that effect is inoperant if the text is out of TL space and time. The example would be a modern British English translation of Homer. The translator can not possibly hope or expect to produce the same effect on the TT reader as the ST had on listeners in ancient Greece..

Newmark indicates that semantic translation differs from literal translation in that it " respects context", interpretes and even explains – e.g. metaphors. In communicative as in semantic translation , provided that equivalent effect is secured , the literal word –for-word translation is not only the best, it is the only valid method of translation .

Thus, the term correspondence falls within the field of contrastive linguistics. Which compares two language systems and describes contrastively differences and similarities. Equivalence on the other hand, relates to equivalent, items in specific ST-TT pairs and context. Kollar describes five different types of equivalence:

- Denotative equivalence- is related to extralinguistic content of a text.
- Connotative equivalence -is related to the lexical choices, especially between near synonyms
- Text normative equivalence –is related to text types, with different types of text behaving in different ways.
- Pragmatic equivalence- or communicative equivalence-is oriented towards the receiver of the text or message.
- Formal equivalence- which is related form and aesthetics of the text , includes word place and the individual stylistic features of the ST.



## **Conclusion**

The comparison of texts in different languages inevitably involves a theory of translation. Equivalence is the central issue in translation and it has been elaborated in different ways by many theorists who have studied equivalence in translation process, using different approaches providing different ideas.

When a message is transferred from one language into another SL (source Language) to TL (Target Language), the translator deals with two different cultures at the same time so transferring a message from SC to TC.

If an original was written centuries ago and the language of that original is difficult to comprehend for modern readers, then a simplified translation may well have greater impact on its readers than the original had on the readers in the source culture. No translator would hinder the reader's comprehension by using absolute expressions in order to achieve equivalent effect.

Translation is a matter of subjective interpretation of translators of the source language text. Thus, producing an objective effect on the target text readers, which is the same as that on the source text readers is an unrealistic expectation. It may not be possible for translators to determine how audiences responded to the source text when it was first produced.

The equivalence problem emerges due to semantic, socio-cultural and grammatical differences between the source language and the target language. These three areas of equivalence problems are intertwined with one another. The meaning(s) that a word refers to are culturally bound, and in most cases the meaning(s) of a word can only be understood through its context of use.

The success of the translation depends above all on achieving response.

## **Bibliographical references**

1. Baker Mona - A course book on translation, London, Routledge
2. Catford, John C. (1965) – A Linguistic Theory of Translation: an essay on applied Linguistics, London: Oxford University Press
3. Kenny, Dorothy (1998) "Equivalence", in the Routledge Encyclopedia of translation studies, edited by Mona Baker, London and New York: Routledge, 77-80.
4. Jakobson Roman (1959) "On Linguistic Aspects of translation", in R.A. Brower. On Translation, Cambridge, MA; Harvard University Press, pp. 232-239.

## MENAXHIMI I STRESIT NË NDËRMARRJET KOSOVARE

*Shqiponja Nallbani, ass.  
shqiponjan@hotmail.com*

### **Abstrakti**

Studimi i stresit dhe stresorëve nga autorët e ndryshëm njihet që nga kohërat e lashta. Varësisht nga zhvillimi i jetës shoqërore ekonomike, botëkuptimet për fenomenin janë ndarë në klasike dhe bashkëkohore. Ato klasike lidhen me reagimin e trupit të njeriut ndaj ngacmuesve të jashtëm duke e trajtuar këtu edhe anën shpirtërore të njeriut. Botëkuptimet bashkëkohore e trajtojnë stresin pothuajse njëjtë sikurse teoria klasike por e ndajnë botën shpirtërore dhe fenomenin e analizojnë shumë thellë nga ana mjekësore. Proceset bashkëkohore ekonomike të karakterizuara me një shkallë të lartë të integritetit, përveç efekteve pozitive, karakterizohen edhe me rritjen e formave të ndryshme të stresit njerëzor të cilët nuk janë të gatshëm që t'u adaptohen mënyrave dhe formave të reja të jetës dhe punës. Është humane që çdo shoqëri racionale të ndërmerr masa që t'i parandalojnë dhe trajtojnë format e ndryshme të paraqitjes së stresit. Njëra nga sfidat me themelore është menaxhimi i stresit në ndërmarrje. Në vendin tonë ka një numër të madh ndërmarrjesh të cilat për shkak të problemeve me tranzicionin nuk po arrijnë që të ndërmarrin veprimtari për parandalimin dhe trajtimin e fenomenit stres.

**Fjalët kyçe:** Stres, ndërmarrje, menaxhim, stresorë, ekonomi, globalizim

**JEL klasiifikimi:** Z, Z 1, Z 10.

### **1. Hyrje**

Stresi dhe ndryshimet që sjell në personalitetin e njeriut tani më nuk janë çështje të reja sidomos kur ato shihen dhe analizohen nëpërmes kontekstit historik. Operimi funksional dhe menaxhimi në biznesin vendor dhe ndërkombëtar, për shkak të ndryshimeve të shpejta shoqërore të cilat po ndodhin në dobi të ekonomisë së tregut, po bëhen gjithnjë e më komplekse dhe mjaft të ndjeshme. Shikuar në planin ekonomik këto ndryshime doemos konsiderohen të nevojshme dhe pozitive mirëpo gjithsesi parashatrojnë edhe nevojën e identifikimit, analizimit dhe monitorimit të problemeve që lindin me perceptimin dhe pranimin e tyre nga ana e njerëzve. Jeta shoqërore – ekonomike në dekadën e fundit është karakterizuar me një zhvillim të madh që nuk e mban mend historia e njerëzimit dhe në këtë kontekst, përveç super – revolucionit teknik – teknologjik, përparime janë bërë edhe në sferën e doktrinës dhe praktikës menaxheriale. Komplexiteti i rregullimit të biznesit aktual dhe njëkohësisht menaxhimi adekuat i burimeve njerëzore del pikërisht si nevojë e zhvillimit të një ekonomie reale por duke e ruajtur gjithmonë anën humane të ndryshimeve. Andaj, në asnjë mënyrë nuk duhet konsideruar sukses zhvillimin ekonomik i cili është i bazuar në parimin “metoda e përdorur e arsyetimit

qëllimin". Stili modern i jetës shpesh karakterizohet me konkurrencë të fortë, padurim dhe me ndjenjën e urgjencës kohore. Aftësia për "*tu përballur*", e determinon suksesin apo dështimin individual në kontrollimin e situatave potenciale stresuese. Duke e analizuar literaturën shkencore mbi këtë çështje qartë shihet se fenomeni stres është shumë i fuqishëm, i paparashikuar, negativ dhe i rrezikshëm kur shoqëritë kalojnë faza të caktuara tranzicioni shoqërorë dhe ekonomike. Shoqëritë moderne e njohin dhe e kanë kuptuar kompleksitetin e fenomenit stres andaj që nga shteti deri të segmenti më i vogël i jetës shoqërore angazhohen që të krijojnë mënyra të menaxhimit të suksesshëm të tij.

## 2. Nevoja e menaxhimit të stresit në ndërmarrje e Kosovës

Menaxhimi i stresit si proces kompleks konsiston në eliminimin, minimizimin ose parandalimin e faktorëve që e shkaktojnë atë. Duke pasur parasysh se ky nuk është një proces i thjeshtë, por kompleks, menaxhimi i stresit kërkon ndërmarrjen e hapave me karakter teknik, organizativ dhe social, të parashikuara në planet e veprimit të çdo subjekti. Subjektet publike në tërësi dhe ato private, duhet të synojnë me prioritet të ndërmarrin hapa të tilla që e parandalojnë stresin, kjo ndodh për shkak se kostot dhe ndikimet përkatëse janë shumë më efikase. Është jetike që aksionarët, pronarët dhe menaxherët e niveleve të ndryshme në ndërmarrjet publike dhe private të Kosovës urgjentisht të vetëdijesohen me nevojën e identifikimit të formave të caktuara të stresit dhe varësisht nga specifikat që i karakterizojnë këto fenomene të kenë strategji për t'i parandaluar dhe qasur eliminimit të tyre. Duke e trajtuar stresin nga plani i angazhimit menaxheria në mjedisin biznesor kosovar kemi propozuar një seri masash të cilat i konsiderojmë të domosdoshme për zbatim. Ja disa nga kërkesat që nxisin parandalimin e stresit në punë dhe që duhet të konsiderohen nga çdo menaxher në ndërmarrjet tona:

- ☞ Sinkronizimi ose balancimi i ngarkesës në punë me kapacitetet.
- ☞ Organizimi i punës në mënyrë të tillë që të nxitet mendimi i punonjësve dhe të përdoren drejt aftësitë e tyre.
- ☞ Përcaktimi i qartë i rolit të çdo punonjësi në arritjen e objektivit të organizatës.
- ☞ Krijimi i mundësive që punonjësit të marrin pjesë në vendimmarrjet që kanë rëndësi për punën e tyre.
- ☞ Qartësimi i perspektivave të zhvillimit të karrierës dhe punësimit.
- ☞ Nxitja e mundësisë për ndërveprime dhe veprimtari sociale me punonjësit.

110

Rrejedhimisht procesi i parandalimit dhe menaxhimit të stresit te ne gjithsesi kërkon marrjen e disa hapave.

- ☞ **Hapi i parë:** Identifikimi i faktorëve potencialë që shkaktojnë stres. Kjo kërkon të merren parasysh disa rrethana, të cilat kanë të bëjnë me madhësinë e subjektit që do të ekzaminohet, si dhe me burimet potenciale në dispozicion të këtij qëllimi. Duke i njohur teorikisht faktorët që

---

<sup>110</sup> Matteson, M.T and Ivancevich 2000; "Managing job stress and health"

shkaktojnë stres, puna për identifikimin e tyre konsiston në përzgjedhjen e atyre faktorëve që kanë rrezik më të madh për subjektin ose janë më tipikë për të, duke lehtësuar kështu koston e identifikimit të faktorëve. Kështu p.sh., në një institucion qendror të administratës publike, vështirë se mund të zgjidhet si faktor stresi, niveli i ndotjes, ndërkohë që në një subjekt privat të konsoliduar nuk mund të përbëjnë faktor stresi, ndryshimet politike.<sup>111</sup>

✍ **Hapi i dytë:** Matja dhe shkalla e ndikimit të faktorëve. Ky hap mund të realizohet nëpërmes disa instrumenteve që bazohen në përcaktimin e shtrirjes së faktorëve në mjedisin e subjektit, si dhe në intensitetin e veprimit të tyre. Metoda të ndryshme përdoren për këtë qëllim, por ato që janë të rekomandueshme nga të gjithë, bazohen kryesisht në diskutimet me të punësuarit, intervistat dhe pyetësorët që duhet të plotësojnë të punësuarit, të cilat rekomandohet të jenë në mirëbesim, në mënyrë që të shpalosin pa rezervë shkallën e veprimit të faktorëve të stresit, edhe kur këto kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërpersonale ose me stilin e menaxhimit.<sup>112</sup>

✍ **Hapi i tretë:** Analizimi i të dhënave, klasifikimi i faktorëve, si dhe përcaktimi i prioriteteve dhe instrumenteve të ndërhyrjes. Pasi burimet e stresit janë identifikuar, janë klasifikuar faktorët parësorë që e shkaktojnë, është e rëndësishme të përcaktohen instrumentet e ndërhyrjes. Këto instrumente mund të jenë me karakter teknik e material, që kanë të bëjnë me shmangien e faktorëve që shkaktojnë stres, si ndotjet, zhurmat, krijimi i kushteve me të mira për punë apo furnizimi i pajisjeve që lehtësojnë punën. Ato mund të kenë edhe karakter organizativ, si shpërndarja më e drejtë e ngarkesës midis të punësuarve, ndërtimi i strukturave organizative, përshkrimi i qartë i vendit të punës dhe linjave të raportimit, si dhe promovimi e nxitja e karrierës.<sup>113</sup>

Në këtë mënyrë, menaxhimi i stresit është një çështje që duhet të jetë element i rëndësishëm i objektivave dhe planeve të subjekteve publike e private. Por deri tani, kjo është një dukuri që nuk e përfshin sferën e menaxhimit ose elemente të saj realizohen në mënyrë spontane. Menaxherët në përgjithësi janë më të pirur të zbatojnë masa të rrepta disiplinore sesa të minimizojnë ose eliminojnë faktorët që shkaktojnë stresin, duke rritur kështu në përgjithësi koston e punësimit.

### 3. Stresi në punë dhe rritja e kostos së punësimit

Bazuar në literaturën aktuale kohët e fundit në mjediset e menaxhimit është shtuar diskutimi mbi stresin në punë, faktorët që e shkaktojnë atë dhe mënyrat se si ai mund të menaxhohet. Intensiteti në punë, diferenca midis nevojave materiale dhe shpirtërore të punonjësve, me balancimin e tyre, janë faktorët më të përgjithshëm që shkaktojnë stresin në punë. Pra, stresi është rrjedhojë e bashkëveprimit të punonjësve me kushtet që i rrethojnë ata. Studimet tregojnë se në vendet e

---

<sup>111</sup> Newman, L.E and Beehr, T.A. 1999 "Personal and organizational strategies for handling job stress".

<sup>112</sup> Po aty

<sup>113</sup> Po aty

zhvilluara 25% e punonjësve janë të stresuar në punë, ndërsa rreth 75% besojnë se niveli aktual i stresit është më i lartë se sa i gjeneratave të mëparshme. Por përveç dëmeve shëndetësore, stresi është një faktor i rëndësishëm që dëmton ose ul edhe produktivitetin e punës.<sup>114</sup>

Përvoja ka treguar se ndërhyrja e faktorëve institucionale ose individuale mund të zbusin efektet e stresit dhe ta parandalojnë atë. Prej këndej del nevoja e menaxhimit të tij, si dhe minimizimit të faktorëve që e shkaktojnë atë. Në kushtet e vendeve të varfëra dhe atyre në tranzicion, për vetë dukuritë që i shoqërojnë këto procese, stresi ka një prani të shtuar dhe domosdoshmëria e menaxhimit të tij duhet të jetë një funksion i rëndësishëm i niveleve të menaxhimit dhe pjesë e pandarë e përgjegjësive funksionale të tyre.<sup>115</sup>

#### **4. Disa nga shkaqet e stresit në punë në ndërmarrjet e Kosovës**

Shkaqet që mund të prodhojnë stresin brenda ndërmarrjeve kosovare janë të shumëta dhe ato mund të lidhen me mjedisin e brendshëm në punë, si dhe me faktorë të tjerë të jashtëm, qofshin ata politikë, shëndetësorë, familjarë, etj. Përpjekja për të gjurmuar faktorët që shkaktojnë stresin ka sjell klasifikimin e mëposhtëm: Intensiteti i shtuar në punë, mungesa e faktorëve regjenerues gjatë punës, siç mund të jenë pushimet e shkurtra gjatë punës, mundësitë për t'u ushqyer ose për të pirë kafe. Ndonëse në përgjithësi nuk mund të flitet për një intensitet të lartë të punës në subjektet tona publike e private, padyshim që mund të flitet për poste të veçanta pune që mbartin intensitet të lartë, si dhe për mungesën e kushteve rigjeneruese të aftësive për punë brenda subjektit. Stili menaxhues është një element që shkakton stres në punë të punësuarit, veçanërisht dukuri të tilla që kanë të bëjnë me një komunikim të varfër, vendimmarrje të mbyllur, si dhe kufizimin e mundësive të punësuarve për të qenë pjesë e plotë e të gjithë procesit. Stili konfliktual i menaxherit, në vend të bashkëpunimit, përdorimi pa vend i masave disiplinore në vend të ofrimit të këshillave dhe masave që mënjanojnë thyerjen e disiplinës, janë burime të stresit. Ndryshimi i shpejtë i niveleve të drejtëpërdrejta të menaxhimit është një burim tjetër stresi për punonjësin, rrjedhojë e pamundësisë së tij në kohë, për t'iu përshtatur stilit të menaxherit. Marrëdhëniet ndërpersonale kur karakterizohen nga mungesa e frymës së bashkëpunimit ose e përjashtimit, nga thellimi i hierarkisë dhe autoritetit përtej kufijve të arsyeshëm, janë një element që sjell pa diskutim stres të punësuarit. Organizimi i dobët i vendit të punës, si dhe mungesa e linjave të qarta të raportimit, autoritetit dhe përgjegjësive, ose e thënë me fjalë të tjera, kërkesa e llogarisë nga shumë "shefa" kundrejt të njëjtit punonjës, sjellin stres, pasiguri dhe mungesë të orientimit të duhur.<sup>116</sup>

Pasiguria në punë, që reflektohet në mundësinë e vendimeve arbitrare të menaxhereve, lidhja e kontratave afatshkurtra me punonjësit, kritere të paqarta dhe

---

<sup>114</sup> Broshura "Posao. Ba. Stes na random mjestu" 2008, nëntor 2008 [www.amc.rs](http://www.amc.rs). Broshura "MMC Action Managment Consulting".

<sup>115</sup> Jeremy Stranks "Stress at work" 2005;

<sup>116</sup> Po aty

evazive punësimi, pamundësi për zhvillimin e karrierës, përparimin ose ngritjen në detyrë, cenonjë besimin e të punësuarve në të ardhmen e tyre dhe në kushtet e kësaj pasigurie, ata vihen në kërkim të punësimeve të reja, proces që shoqërohet me stres. Kushtet e pakënaqshme materiale për punë, si mungesa e pajisjeve të përshtatshme që mundësojnë dhe lehtësojnë realizimin e përgjegjësi, prania e faktorëve dëmtes të shëndetit, siç mund të jenë temperaturat, mungesa e ajrimit, zhurmat dhe ndotja, janë gjithashtu burime stresi. Mungesa e një motivimi për të kryer detyrën dhe realizuar përgjegjësitë, e shprehur në një nivel të ultë shpërblimi, një sistem pagash i papërshtatshëm dhe që nuk merr parasysh kontributet reale të secilit punonjës; reagimi i dobët i menaxhimit, si ndaj përkushtimit të disave dhe neglizhencës në punë të disa të tjerëve, transmetojnë elemente stresi te të punësuarit. Mundësia e ndikimeve politike në zhvillimin e karrierës dhe garancia e pamjaftueshme për vazhdimin e punës për shkak të një legjislacioni që nuk siguron një mbrojtje reale te të drejtave. Burimet e pamjaftueshme materiale e financiare për të përballuar jetesën e familjes reflektojnë një stres të përgjithshëm që e shoqëron punonjësën gjatë gjithë kohës. Ndryshimet politike, veçanërisht në vendet në tranzicion kur akoma roli i politikës ka një ndikim të drejtëpërdrejtë në ecurinë e punës dhe zhvillimin e karrierës së të punësuarit në sektorin publik, është faktor për praninë e stresit.<sup>117</sup>

#### **Disa faktorë që shkaktojnë stresin në punë**

- Intensiteti i punës;
- Mungesa e faktorëve rigjenerues gjatë punës, siç mund të jenë pushimet e shkurtra gjatë punës, mundësitë për t'u ushqyer ose për të pirë kafe;
- Stili konfliktual i menaxherit;
- Përdorimi pa vend i masave disiplinore;
- Thellimi i hierarkisë dhe autoritetit përtej kufijve të arsyeshëm;
- Pasiguria në punë;
- Strukturë e komplikuar organizative dhe raportimi;
- Një sistem pagash i papërshtatshëm dhe që nuk merr parasysh kontributet reale të secilit punonjës;
- Në kushtet e vendeve të varfra dhe atyre në tranzicion, stresi ka një prani të shtuar.<sup>118</sup>

#### **5. Si duhet të menaxhohet stresi në ndërmarrjet kosovare**

---

<sup>117</sup> Cunningham, J. Barton. *The Stress Management Sourcebook., Second Edition*, Los Angeles, USA 2000;

<sup>9</sup> Marrë nga internet:

<http://www.nakladaslap.com/PDF/Stres%20i%20tjeslesno%20zdravlje%20-%20poglavlje.pdf>,  
ne muajin mars 2010

Puna në ditët e sotme gjithnjë e më shumë po kthehet në burim stresi. Po çfarë është stresi në vetvete dhe si duhet ta menaxhojmë atë në punë?

Këto pyetje gjejnë përgjigje vetëm në jetën e ashtuquajtur moderne me të cilën ne përpiqemi të përshtatemi. Pasi me zhvillimin e kushteve teknologjike, dhe kushteve të jetesës ne vihem në presione të mëdha duke rritur kështu nivelin e stresit. Por stresi në vetvete është term që i referohet shumës së situatave fizike, mendore, tensioneve dhe emocioneve mbi një person. Dhe në mënyrë specifike stresi I një punonjësi është reagim psikologjik I ngjarjeve që janë perceptuar të jenë kërcënuese. Por ne duhet të dimë të menaxhojmë këto situata që shkaktojnë stres, duhet të mbajmë nën kontroll shkallën e stresimit në të cilën ndodhemi dhe ndikimin drejt zvogëlimit të tij. Por a mundemi ta krijojmë këtë balancë dhe a mund të mbajmë situatën nën kontroll?

Për këtë ne duhet të qartësohemi se: stresi është i pashmangshëm në jetë, por ajo të cilën ne mund të bëjmë është të përpiqemi ta menaxhojmë atë. Dhe menaxhimi i stresit është një domosdoshmëri, në mënyrë që të mos kemi efekte negative në shëndetin tonë dhe në jetën tonë. Por në ambientin e punës cdo gjë është relative pasi një situatë e cila është stresuese për dikë, nuk mund të jetë e tillë për dikë tjetër. Në këtë kontekst studiuesit kanë zbuluar se efektet e stresit klasifikohen në dy grupe të mëdha në: efekte pozitive dhe efekte negative të stresit. Po kush janë efektet pozitive të stresit?

- Ndërsa efektet negative janë Stimulimi dhe inkurajimi i njerëzve në punë;
- Shkalla e përqendrimit pasi njerëzit do të jenë më shumë të përqëndruar në punën e tyre, por kjo deri në masën e stresit ku nuk ka filluar akoma të bëhet shqetësues për individin.
- Përkushtimi, pra ata do të jenë dhe më të përkushtuar si rezultat i stimulimit;
- Rezultat financiar më i mirë i kompanisë. Si rezultat i një përqendrimi dhe përkushtimi më të madh të njerëzve në organizatë do të ndikonte pozitivisht në rezultatin financiar të saj.

Në të shumtën e rasteve kanë të bëjnë edhe me:

- Ndikimin në shëndet. Pra shfaqet në formën e frikës, mllëfit, rritjes së adrenalinës, rritjes së tensionit në gjak etj. Dhe në këtë mënyrë ai demton shëndetin e individit.
- Ulë rendimentin në punë. Stresi deri në një masë të caktuar ndikon pozitivisht në përkushtimin me të madh ndaj punës, por vjen një moment kur efektet e tij janë vetëm negative. Në këtë mënyrë stresi kthehet jo vetëm në element problematik për individin, por pasojat e tij mbi produktivitetin individual janë shumë të mëdha.<sup>119</sup>

Pra ka shumë efekte negative nëse do t'i listonim të gjithë por diçka është e sigurt, nëse ne do të ishim në një ambient fare pa stres atëherë ne nuk do mund të rrinim. Po të ishim jo produktiv, do ishim pasiv etj. Në këtë kontekst duhet të mendohejmë të gjejmë anë të pozitive në çdo aspekt të jetës tonë.<sup>120</sup>

---

<sup>119</sup> Po aty

<sup>120</sup> Broshura "Posao. Ba. Stes na random mjestu" 2008, nëntor 2008

[www.amc.rs](http://www.amc.rs). Broshura "MMC Action Management Consulting"

Po çfarë duhet të bëjnë punëdhënësit në mënyrë që kompanitë e tyre të kenë rezultate? Si duhet të menaxhojnë ata? Ata duhet të përmirësojnë përshtatjen në punë, të përmirësojnë trajnimin e punëtorëve dhe programet e orientimit. Ata duhet të eliminojnë menaxhimin e ndëshkimit dhe të zhvendosin kushtet e punës së rrezikshme.<sup>121</sup>

Ata duhet të punësojnë punëtorin në punën që më së shumti i përshtatet atij. Ata duhet të trajnojnë punëtorët për shkak të nivelit të lartë të stresit që shkaktohet nga mungesa e trajnimit. Ata duhet të stimulojnë punonjësit. Duhet të përmirësojnë komunikimin si një hap vendimtar drejt zvogëlimit të stresit të punëtorëve, sepse ndonjëherë është vetëm mungesë komunikimi në vetvete, qoftë ajo midis bashkëpunëtorëve apo punëdhënëseve që mund të krijojë një ambient stresues.<sup>122</sup>

### **Përfundimet**

Studimi i stresit dhe stresuesve daton që nga kohërat e lashta. Mirëpo me zhvillimin jetës shoqëror – ekonomike për shkak të interesit që ka treguar shoqëria trajtimi shkencor ka marrë përmasa shumë më të avancuara dhe sot një seri shkencash shoqërore dhe mjekësore i kushtojnë një vëmendje të posaçme. Menaxhmenti i burimeve njerëzore në fillim në heshtje e më vonë shumë intensivisht ka filluar që ta vrojtojë, identifikojë dhe të ndërmerr masa parandaluese ndaj formave të caktuara të stresit. Stresi si fenomen njerëzor dhe shoqëror dallon nga vendi në vend respektivisht apo nga një mjedis në mjedisin tjetër. Ndër detyra e shumta që ka menaxheri i burimeve njerëzore është njohja e kulturës, traditës dhe vetive psikike të punonjësve me të cilët zhvillon aktivitetin e caktuar ekonomik si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Në vendin tonë çdo ditë ndërmarrjet e caktuara po shënojnë rezultate inkurajuese në zhvillimin e biznesit vetanak dhe depërtim në mjedisin biznesor ndërkombëtar. Duke e pasur parasysh se vendi ynë po kalon një fazë të vështirë të tranzicionit është e lehtë të konstatohet se steresi është prezent në një masë të madhe. Menaxherët kosovar por edhe ata të huaj që janë të angazhuar në Kosovë gjithsesi duhet që t'i njohin shtresorët, natyrën e tyre dhe forcën e ndikimit që kanë ata në punonjësit e ndërmarrjeve kosovare. Në studimet që kemi zhvilluar shihet se është shumë vështirë që nëpërmjet intervistave ose anketave të sigurohen të dhëna të sigurta për fenomenin. Menaxheret kosovar duhet që të ndjejnë këtë fenomen dhe pasi që ta identifikojnë ta parandalojnë dhe të menaxhojnë duke bërë sinkronizimin respektivisht balancimin e ngarkesës në punë, organizimin e punës në formë të nxitjes së efektshmerisë, përmirësimin e vendim marrjes, qartësimin e perspektivës dhe karrierës dhe aktivitete tjera të rëndësishme.

Strategjia parandaluese realizohet në etapa që nënkupton identifikimin e shtresorëve, matjen e shkallës dhe forcës së tyre dhe analizimin e këtyre të dhënave. Stresi në punë e rritë koston e punësimit dhe kjo paraqet një rrezik më tepër për ndërmarrjen. Shkaqet që prodhojnë stresin janë të shumta dhe paraqiten si të

---

<sup>121</sup> Po aty

<sup>122</sup> Po aty



jashtëm ose të brendshëm. Po ashtu faktorët më të rëndësishëm që shkaktojnë stresin janë, intensiteti i punës, mungesa e faktorëve rigjenerues gjatë punës, siç mund të jenë pushimet e shkurtra gjatë punës, mundësitë për t'u ushqyer ose për të pirë kafe, stili konfliktual i menaxherit, përdorimi pa vend i masave disiplinore, thellimi i hierarkisë dhe autoritetit përtej kufijve të arsyeshëm, pasiguria në punë, struktura e komplikuar organizative dhe raportimi, një sistem pagash i papërshtatshëm dhe që nuk merr parasysh kontributet reale të secilit punonjës, në kushtet e vendeve të varfëra dhe atyre në tranzicion.

Në këtë punim argumentohet se menaxhimi i stresit në ndërmarrjet kosovare nuk është proces ose veprimtari e lehtë. Andaj, ky proces jo vetëm që duhet të jetë i mbështetur në të dhëna të sakta mbi stresin dhe stresorët por duhet vepruar në mënyrë efektive, të përqendruar me përkushtim për ta menaxhuar suksesshëm.

## Referencat

1. Cunningham, J. Barton. The Stress Management Sourcebook., *Second Edition*, Los Angeles, USA 2000;
2. Cartwright K, Lewis D, Roberts C, Bint A, Nichols T, Warburton F. Workload and stress in consultant medical microbiologists and virologists: a questionnaire survey. *J Clin Pathol* 2002;
3. Cousins R, Mackay CJ, Clarke SD, Kelly C, Kelly P, McCaig RH. Management Standards and work-related stress in the UK: Practical development. *Work & Stress* 2004;
4. Quick, James Campbell, U Texas, Arlington, TX, US. Quick, Jonathan D., Nelson, Debra L. Hurrell, Joseph J. Jr., "Preventive Stress Management in Organizations", Washington, DC, US: American Psychological Association, 1997.
5. Mirjana Arandelović & Ivana Ilić **"Stres in workplace – possible prevention"** FACTA UNIVERSITATIS Series: Medicine and Biology Vol.13, No 3, 2006,
6. Broshura "Posao. Ba. Stes na random mjestu" 2008, nëntor 2008 [www.amc.rs](http://www.amc.rs). Broshura "MMC Action Management Consulting"
7. Jeremy Stranks "Stress at work" 2005;
8. Kreitner B, Kinicki A; "Sjellja Organizative" 1995
9. Koli Z, Llaci Sh, ; "Menaxhimi i burimeve njerëzore" 2001
10. Kutllovci, Enver. "Menaxhimi i resurseve humane" 2004
11. Armstrong, Michael; "Human Resource Management- Practice" 2003
12. Cox, T; "Organizational culture, stress and stress management 1999
13. Kearns, J "Stress at Work" 2000;
14. Matteson, M. T and Ivancevich 2000 "Managing job stress and health"
15. Cox, T; "Stress research and stress management" 2003
16. T. Cox, A. Griffiths and S. Cox "Stress explosion- Managing stress at work"
17. Murphy, L. R 1997 "Published in: Journal of Occupational Behaviour Management, 8,"

18. Newman, L.E and Beehr, T.A. 1999 “Personal and organizational strategies for handling job stress”.

**ROLI DHE NDIKIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIKE NË  
PRODHIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E INFORMATAVE, NË FAVOR TË  
RRITJES SË EFIÇENCËS DHE EFEKTIVITETIT TË BIZNESEVE  
KOSOVARE**

*Msc. Sokol Domniku, ass.  
[sdomniku@gmail.com](mailto:sdomniku@gmail.com)*

**Abstrakt**

Përdorimi i teknologjisë informatike është në funksion të rritjes së efikasitetit të afarizmit dhe suksesit të tij. Madje, sot afarizmi nuk mund të paramendohet pa përdorimin e teknologjisë informatike (në tekstin e mëtejme TI). Shfrytëzimi i TI në afarizëm ka ndikim shumë pozitiv për shkak se i mundëson bizneseve të jenë më konkurrense në treg. Kur themi se bizneset të jenë më konkurrense në treg, atëherë ne mendojmë në shumë aspekte, p.sh., afarizmi realizohet me efikasitet më të lartë, sepse aplikimi i kësaj teknologjie mundëson që pothuajse të gjitha aktivitetet afariste të kryhen më shpejtë dhe më lehtë. Të gjitha aktivitetet e funksioneve afariste, duke përfshirë prodhimin, shitjen, financat, burimet njerëzore, marketingun, etj., nën ndikimin e TI funksionojnë shumë më mirë dhe më sigurt. Teknologjia informatike mundëson që të gjitha informatat afariste të regjistrohen dhe të përdoren me më efektivitet më të lartë, për shkak se procedura e ruajtjes, analizimit dhe gjetjes së këtyre informatave është shumë më e lehtë dhe më e shpejtë, dhe se kjo ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e përparësisë konkurruese të bizneseve. Rritja e aftësisë konkurruese nënkupton situatat kur ndërmarrja është në gjendje të furnizohet me informata më shpejtë sesa konkurrenca e tyre, dhe nga këto informata të krijojë strategji për oferta sa më të mira dhe më joshëse për konsumatorët, duke iu ofruar produkte kualitative, çmime dhe kushte më të mira të kreditimit, etj. TI ndihmojnë menaxhmentin në marrjen e vendimeve sa më të mira, në mënyrë që secili vendim i marrë të ndikojë pozitivisht në ndërmarrje.

**Fjalët kyçe:** teknologji informatike, informatë, vendim, efektivitet, afarizëm

**JEL Kualifikimi:** O, O030, O032

**1. Hyrje**

Në kushtet bashkëkohore të zhvillimit të afarizmit, përfshirë këtu edhe sektorin tregtar, teknologjia informatike është njëri nga faktorët kryesor të arritjes së suksesit dhe efikasitetit afarist. Prandaj, përcaktimi për të hulumtuar fushën e TI dhe ndikimin e saj në proceset afariste, është rezultat i njohurive, se zhvillimi i shpejtë dhe intensiv i teknologjisë informatike ka sjellë deri te ndryshimet e shumta në mënyrën se si sot zhvillohet afarizmi.

Bizneset të cilat konkurrojnë në tregje të ndryshme përfshirë ato lokale, regionale apo ndërkombëtare, domosdoshmërisht duhet të posedojnë një infrastrukturë të teknologjisë informatike, përfshirë së paku disa nga elementet kryesorë të saj. Inovacionet në fushën e teknologjisë informatike, zhvillohen me një ritëm shumë intensiv, sa që çdo inovacion i krijuar, i mundëson bizneseve që të realizojnë aktivitetin e tyre afarist në mënyra më eficiente dhe më efektive. Procesi i prodhimit qoftë të produkteve ose të shërbimeve në kohën bashkëkohore, nëpërmes të teknologjisë informatike, mundëson që shkalla e cilësisë së prodhimeve të jetë shumë më e lartë, pasi që përsosmëria teknologjike ndikon që kombinimet e ndryshme të lëndës së parë që shfrytëzohen për prodhimin e produkteve finale të i bëjë në mënyra më të sakta dhe më të duhura. Poashtu edhe në prodhimin e shërbimeve të ndryshme, kjo përsosmëri teknologjike ndikon që edhe shërbimet të realizohen në mënyrën më të shpejtë, më të sigurt dhe më të duhur, me ç'rast kjo ka ndikim shumë të madh që dobia e konsumatorëve nga konsumimi dhe shfrytëzimi i këtyre produkteve ose shërbimeve të e arrijë shkallën e kënaqësisë maksimale.

Teknologjia informatike i mundëson menaxhmentit të bizneseve që të furnizohen me informata të duhura në mënyrën më të shpejtë. Informatat të cilat procedohen dhe shfrytëzohen nga teknologjia informatike ndikojnë që bizneset të rrisin përparësinë konkurruese, të minimizojnë shpenzimet e operimit dhe njëkohësisht të sigurojnë një kontinuitet kohor për biznesin e tyre.

Në bazë të dhënave të hulumtuara nga literatura të ndryshme shkencore, përfshirë libra dhe artikuj të ndryshëm shkencor, është vërtetuar se secila ndërmarrje e cila vepron në një treg me konkurrencë të plotë, si pjesë të strategjisë së tyre duhet ta kenë edhe planifikimet e duhura për investimet në teknologjinë informatike dhe komponentët e saj të caktuar.

## **2. Kuptimi i të dhënave dhe i informatave**

Në kohën bashkëkohore të zhvillimit të shoqërisë njerëzore dhe të ekonomisë globale për zhvillimin e veprimtarive afariste, sidomos në sektorin tregtar, informatat kanë një rëndësi esenciale për arritjen e suksesit. Në të shumtën shprehjet “e dhënë” dhe “informatë” nënkuptohen si të njëjta, mirëpo ekziston një dallim thelbësor në mes tyre, p.sh. e dhënë mund të jetë çmimi i një produkti, mosha e punonjësi etj., ndërsa për dallim nga e dhëna informata përbëhet prej të dhëne të konvertuar dhe të proceduar ashtu që të ketë një kuptim më specifik<sup>123</sup>. E dhëna është një pasqyrim i koduar i ndonjë atributi të sistemit

---

<sup>123</sup> Brien James & Maracas George (2005): “*Management Information Systems*”, fq. 29

apo elementeve të tij. E dhënë mund të jetë një fjalë, numër apo ndonjë shenjë speciale e cila sistemohet dhe përpunohet informata. Të dhënat përbëhen nga shënimet të cilat prezantojnë fakte ose detale lidhur me gjërat, aktivitetet, transaksionet, etj. Në mënyrë që të bëhet dallimi i plotë dhe të kuptohen konceptet “e dhëna” dhe “informata” mund të konkludojmë se “*informata është e dhënë e cila e merr formën e kuptueshme dhe të vlefshme për shfrytëzuesin e saj*<sup>124</sup>”. Për zhvillimin e proceseve afariste, e posaçërisht për menaxhmentin, informatat janë të dobishme vetëm nëse janë relevante në aspektin e pranimit brenda kohës së caktuar dhe qëllimit për të cilin shfrytëzohen. Njëkohësisht, është e domosdoshme që edhe qasja në informata, sepse nëse nuk ka qasje në informatë atëherë secila informatë është e padobishme. Kjo d.m.th. që duke marrë parasysh lokacionin, qasja në informata duhet të ekzistojë dhe funksionojë. Gjithashtu, informatat mund të kenë karakter të ndryshëm, me ç’rast mund të jenë informata të karakterit të brendshëm dhe informata të karakterit të jashtëm. Informatat e jashtme janë ato informata të cilat shpjegojnë ambientin e jashtëm dhe rrethinën afariste e cila e rrethon organizatën, kurse informatat e brendshme janë informatat të cilat shpjegojnë një apo disa aktivitete specifike në organizatë.

Procesi i krijimit të informatave relevante dhe të dobishme për biznese dhe për menaxhmentin e saj kalon nëpër disa faza<sup>125</sup>:

- a) **Inputi** – nënkuptohet si e dhënë e përpunuar ose disa të dhëna të përpunuara nga brenda dhe jashtë organizatës.
- b) **Procedimi** – nënkupton procesin e konvertimit të të dhënave (inputeve) në informata të cilat janë të përdorshme dhe të kuptueshme për shfrytëzuesin.
- c) **Outputi** – nënkupton transferimin e informatës së proceduar, d.m.th. krijimin e informatës e cila i dërgohet shfrytëzuesit për përdorim ose merr pjesë në aktivitete të caktuara që do të realizohen.



Figura 1. Procesi i përpunimit i të dhënave në informata

Nga aspekti i shfrytëzuesit, informatat dallojnë dhe mund të klasifikohen në forma të ndryshme. Ne do të trajtojmë disa nga ato<sup>126</sup>:

<sup>124</sup> Philips Haag Baltzar (2007): “*Business Driven Technology*”, fq. 58

<sup>125</sup> Po aty, fq. 73

<sup>126</sup> Kremington Bob & Silver Mark (2000): “*System that support decision makers*”, fq. 163

- a) **Informata e transaksionit** përbën informatën që ka të bëjë me një proces të vetëm të biznesit, dhe ka për detyrë të mbështesë aktivitetet ditore, p.sh. tërheqja e parave nga ATM-ja<sup>127</sup>, rezervim i biletave online, blerjen e produkteve, etj. Në këtë rast organizata regjistron informatat e transaksionit në bazën e të dhënave dhe me këtë iu mundësohet shfrytëzuesve që dëshirojnë të shohin se si është rrjedha e aktiviteteve ditore dhe të marrin ndonjë vendim eventual.
- b) **Informatat analitike** nënkuptojnë informatat që kanë të bëjnë me trendët e shitjes, statistikën e produkteve dhe projeksionet e mundshme në të ardhmen lidhur me sasinë e produkteve të prodhuara ose të shitura.

Karakteristikë e informatës së saktë është që mund të ndikojë dhe të ndryshojë vendimin e menaxhmentit dhe të biznesit. Karakteristikat e informatës janë<sup>128</sup>:

- *informata duhet të jetë e saktë*
- *informata duhet të jetë relevante*
- *informata duhet të jetë azhure dhe koherente*

Disa vendime në afarizëm kërkojnë informata të karakterit javor ose edhe mujor, por disa vendime kërkojnë informacione të karakterit ditor, p.sh. disa organizata si shërbimi 911, bankat, etj., ju nevojiten informata të përditësuara (ang. update), në çdo sekondë, minutë, 24/h dhe 7 ditë në javë. Në disa organizata si p.sh. në ndërmarrjet e sigurimit dhe në ndërmarrjet ndërtimore, këto kanë nevojë vetëm për informata të përditësuara në periudha ditore ose javore. Vendimet në biznes mund të jenë të suksesshme vetëm nëse kanë për bazë informata të sakta dhe të plota. Informata e saktë përbëhet prej disa faktorëve të cilët krijojnë informatë relevante për marrjen e vendimeve në biznes. Informata duhet të jetë e saktë në aspektin e vendosjes së të dhënave, duhet të jetë e kompletuar, duhet të jetë unike në aspektin e qasjes dhe shfrytëzimit të saj, si dhe të jetë koherente që do të thotë se informatat kanë nevojë që të freskohen ose të përtërihen në mënyrë që të jenë të vlefshme për menaxhmentin në mënyrë që ti ofrojnë një bazë solide gjatë procesit të marrjes së vendimeve.

Tabela 1. Karakteristikat e informatës së saktë

| Disa nga karakteristikat e informatës |                                                                                                      |
|---------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Saktësia</b>                       | A janë të vendosura të gjitha të dhënat në mënyrë të saktë, p.sh., a është emri i shënuar saktësisht |

<sup>127</sup> ATM: nga gjuha angleze *Automatic Teller Transaction*, arkë automatike për tërheqje parash

<sup>128</sup> Berisha Mihane (2007): “*Informatika e biznesit*”, fq. 48 – 52

|                   |                                                                                                                                                    |
|-------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Kompletimi</b> | A mos mungon ndonjë e dhënë, p.sh., a është shënuar adresa në mënyrë të saktë duke përfshirë; rrugën, qytetin, shtetin, ZIP kodin, etj.            |
| <b>Unifikimi</b>  | A është secili transaksion i regjistruar në mënyrë unike, p.sh., a mos është shënuar një klientë dy apo më shumë herë radhazi                      |
| <b>Koherenca</b>  | A përkon informata e regjistruar në kërkesat dhe nevojat e biznesit, p.sh., a është informata e përditësuar në periudha javore, ditore ose në orë. |

(Tabela është shfrytëzuar nga libri “Business Driven Technology”, të autorit Philips Haag Baltzan)

### 3. Komponentët e teknologjisë informatike

Mbështetur në definicion e Asociacionit Amerikan për Teknologji Informatike (angl. Information Technology Association of America) “teknologjia informatike është studim, dizajn, implementim dhe mbështetje e menaxhmentit mbi bazën kompjuterike, përkatësisht përbërjen e elementeve softuerike dhe harduerike”. Komponentët të cilët e përbëjnë infrastrukturën e teknologjisë informatike janë:

- a) *Pajisjet harduerike*, me ç’rast këtu bëjnë pjesë; kompjuterët, instrumentet dhe pajisjet e tjera të prekshme siç mund të jenë bankomatet, skanerët, etj, që njëkohësisht përfshijnë të gjitha pajisjet për mbledhje, përpunim dhe ruajtje të informatave<sup>129</sup>.
- b) *Softuerët kompjuterik*, me ç’rast këtu bëjnë pjesë: programet dhe aplikacionet e ndryshme që mundësojnë operimin e këtyre harduerëve dhe vënien e tyre në funksion.
- c) *Teknologjia komunikuese dhe rrjetat kompjuterike*, të cilat përfshijnë rrjetin kompjuterik; atë të brendshmin (angl. Intranet), rrjetin e jashtëm (angl. Extranet), dhe rrjetin ndërkombëtar (angl. Internet) si rrjet ndërkombëtar i të gjitha rrjetave kompjuterike.
- d) *Memoria ose vendi në të cilët ruhen informatat.*

### 4. Diskutime dhe analizë

<sup>129</sup> Beqiri Edmond (2002): “Bazat e informatikës”, fq. 24

Në bazë të shumë hulumtimeve që janë bërë në kuadër të identifikimit të ndikimit që e ka teknologjia informatike në proceset vendimmarrëse, në bizneset e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, janë arritur rezultate të ndryshme që mbështesin rëndësinë e domosdoshme të shfrytëzimit dhe aplikimit të teknologjisë informatike në kuadër të funksioneve dhe aktiviteteve biznesore. Pajisjet e teknologjisë informatike kanë mundësuar që procesi i kryerjes së punëve dhe detyrave që kërkohen brenda një biznesi, të kryhen me efikasitet dhe efektivitet më të lartë, pasi që informatat që gjenerohen nga TI janë shumë esenciale dhe të domosdoshme që të merren vendimet më të duhura në kohën dhe vendin e duhur. Kompani të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare shfrytëzimin e teknologjisë informatike e shohin si të domosdoshëm në të gjitha funksionet e biznesit, përfshirë financat dhe kontabilitetin, prodhimin, burimet njerëzore, marketingun.

Në vijim do i marrim disa shembuj se si disa kompani vendore dhe ndërkombëtare e përdorin teknologjinë informatike në shërbim të prodhimit dhe shfrytëzimit të informatave të cilat gjenerohen nëpërmes teknologjisë informatike:

- Kompania “ETC”, e posedon rrjetin virtual privat (angl. Virtual Private Network), me ç’rast nëpërmes këtij rrjeti, menaxherët dhe punonjësit e shërbimit, kanë mundësi të qasjeje nga një pikë e shitjes në një tjetër, p.sh. një menaxherë i qendrës së “ETC” në Pejë mund të qaset në serverin e “ETC” në Klinë, dhe të shoh se si është gjendja e shitjeve, stokeve ose edhe informatave të tjera që mund të jenë në interes të menaxhmentit<sup>130</sup>.
- Kompania “Devolli”, posedon regjistruer elektronik të ardhjes dhe shkuarjes nga puna të punonjësve të saj (angl. Work Detector), me ç’rast të gjithë punonjësit, përfshirë këtu edhe menaxhmentin operativ, duhet të identifikohen me kartelën e tyre të posaçme, në kohën kur vijnë dhe dalin nga puna, ku kjo pajisje teknologjike, regjistron kohën e saktë të respektimit të orarit të punës nga punonjësit e saj.
- Shumë kompani vendore shfrytëzojnë edhe programe të ndryshme për zhvillimin afarizmit të tyre, p.sh. një ndër më të dalluarit është programi i kontabilitetit ClickSoft, që është një zgjedhje ideale për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha të cilat kanë nevojë për një sistem komplet për udhëheqjen e suksesshme të afarizmit.
- Kompania e mirënjohur amerikane “Lilian Vernon Corporation”, në bazë të informatave që ka marrë lidhur me shfrytëzimin e ueb faqes, ku përmes ueb analizës, ka zbuluar që klientët e gjinisë mashkullore kanë preferuar që të zhvillojnë

---

<sup>130</sup> Domniku Sokol (2009): Punim Master “Ndikimi i sistemit informatik në proceset vendimmarrëse në sektorin tregtar, me theks të veçantë në kompaninë “ETC”, fq. 72

transaksionet online më tepër sesa të realizojnë transaksione nëpërmjet katalogëve të shtypur të firmës. Nga ky hulumtim dhe analizë, kompania ka siguruar informata në bazë të së cilave ka ndryshuar politikën e saj të shitjes së produkteve përmes ueb faqes, gjë që ka rezultuar me rritjen e shitjes së produkteve për meshkuj për 15%<sup>131</sup>.

Ekzistojnë shumë shembuj që në mënyrë shumë të qartë tregojnë për rëndësinë dhe rolin e teknologjisë informatike në krijimin, prodhimin dhe shfrytëzimin e informatave nga ana e menaxhmentit të bizneseve të ndryshme. Informatat të cilat gjenerohen nëpërmes ndikimit të teknologjisë informatike në njërin anë, racionalizojnë kohën për të menduar dhe për të vepruar, dhe në anën tjetër minimizojnë edhe shpenzimet e operimit. Kur bizneset arrijnë të jenë më efikente dhe më efektive në realizimin e procesit prodhues, atëherë kjo bizneseve u jep automatikisht një përparësi të dukshme konkurruese, që nënkupton edhe arritjen e qëllimeve afariste, që ndërlidhen me rritjen e shitjeve dhe të profitit.

## 5. Konkluzë

Mund të konstatohet se zhvillimi i afarizmit, pa aplikimin dhe shfrytëzimin e teknologjisë informatike është pothuajse i pamundur në kohën dhe rrethanat bashkëkohore. Nga hulumtimet e bëra qoftë në literaturën bashkëkohore dhe në hulumtimet e ndryshme empirike të karaktereve shkencore dhe akademike, vërtetohet se teknologjia informatike është faktor kryesor i arritjes së suksesit afarist dhe arritjes së qëllimeve të organizatës nëpërmjet marrjes së vendimeve të shpejta dhe efektive. Në shekulli XXI bizneset tradicionale po transferohen me të madhe në bizneset bashkëkohore, ku si pjesë integrale e kuptimit të afarizmit bashkëkohor është aplikimi dhe shfrytëzimi i teknologjisë informatike. Të gjithë sektorët ekonomikë të Kosovës e në veçanti sektori tregtar, duhet të ketë parasysh këtë fakt, për shkak se vendi ynë, është vend në tranzicion, dhe nëse mendojmë për një zhvillim ekonomik të vendit në periudhat e ardhshme kohore, atëherë duhet ta kemi parasysh që të kemi sa më shumë njohuri rreth rëndësisë së teknologjisë informatike, e në mënyrë të veçantë për rëndësinë dhe rolin e kësaj teknologjie në sektorin tregtar të ekonomisë, pasi që shërbimet, edhe janë një nga karakteristikat kryesore të ekonomisë së zhvilluar.

Përfundimisht si konkluzione mund të përfshihen:

- teknologjia informatike ndihmon në prodhimin e informatave dhe mundëson shfrytëzimin e tyre në mënyrën sa më racionale të mundshme, d.m.th. shpejt, saktë dhe mirë.
- teknologjia informatike ndihmon në rritjen e produktivitetit të firmave, pasi që minimizon kohën dhe koston e prodhimit.

---

<sup>131</sup> Laudon Kenneth (2009): “*Management Information Systems*”, fq. 462



- teknologjia informatike ndikon në rritjen e përparësisë konkurruese të firmave, pasi që procesi i prodhimit dhe i ofrimit të shërbimeve bëhet në mënyrë më të shpejtë dhe më efektive, po ashtu ndihmon në identifikimin nevojave të konsumatorëve dhe njëkohësisht mundëson edhe përmbushjen e këtyre nevojave.
- teknologjia informatike ndikon në organizimin dhe udhëheqjen sa më të mirë të resurseve të organizatës, pasi që procesi i komunikimit dhe i koordinimit bëhet në mënyrën më të shpejtë dhe më efektive të mundshme.

### **Referencat**

1. Beqiri, Edmon. “Bazat e informatikës” Shtëpia botuese “Dukagjini”, Pejë, 2002
2. Berisha, Mihane. “Informatika e biznesit”, Grafo-Print, Prishtinë, 2004
3. Brien James & Maracas George, “Management Information Systems”, McGraw Hill, New York, 2005
4. Domniku, Sokol. “Ndikimi i sistemit informatik në proceset vendimmarrëse në sektorin tregtar, me theks të veçantë në kompaninë ETC” Punim Master, Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës, 2009
5. Laudon, Kenneth. “Management Information Systems”, Prentice Hall, Washington, 2009
6. Kremington Bob & Silver Mark, “System that support decision makers”, McGraw Hill, New York, 2000
7. Philips Baltzar, “Business Driven Technology”, Prentice Hall, New York, 2007

## **TË KUPTUARIT E PAGESËS – SHPËRBLIMIT NË BAZË TË PËRFORMANCËS NE SEKTORIN PUBLIK E PRIVAT**

*Msc.Ujkan Bajra,ass.  
ujkibajra@gmail.com*

### **Abstrakti**

Sot gjithnjë e më tepër në institucione të shumta, qofshin të sektorit privat apo publik, kanë shfaqur dilemën nëse pagesa-shpërblimi në bazë të performancës së treguar në punë është më e drejt dhe më pranueshme për palët në proces (punëdhënësit dhe punëmarrësit). Që ndërmarrja apo organizata të jetë efikase në arritjen e objektivave dhe të fitoj profitabilitetit të lartë, ajo kërkon nga të punësuarit që të konfirmojnë që të punojnë në mënyrë të efektshme sipas objektivave që synon kompania. Në bazë të këtyre objektivave, menaxhmenti i organizatës apo ndërmarrjes, do të drejtojë të ardhmen e saj për të arritur këto synime që përkojnë me administrimin e biznesit dhe qëllimin. Si do që të jetë ne kemi bërë një hulumtim të bazuar në të dhëna primare e sekondare të cilat kanë dhënë rezultatet e duhura për punën e bërë nga nëpunësit apo punëtorët kundër përfitimit një pagese. Në kontekst të kësaj, është vërejtur se teoria tradicionale e kontrollit, e orientuar drejt sistemit matës të performancës në epokën industriale po humb rëndësinë e saj për shkak të ndryshimeve të shpejta në mjediset ku organizatat janë krijuar sipas funksioneve hierarkike të tyre. Matja e performancës po bëhet gjithnjë e më vështirë me globalizimin dhe kompleksitetin në rritje të organizatave mbi modelet biznesore, rolet e punonjësve si dhe përgjegjësitë e tyre ndaj punës.

**Fjalet kyqe:** performancë, sistem nxitës, hierarki, globalizim, kompani, nepunës, page, rroge, motivim, shpërblim.

**JEL kualifikimi:** M, M1, M12

### **Hyrje**

Një numër i madh i organizatave të ndryshme që ekzistojnë sot kanë probleme të ndryshme që të bëjnë matjen e saktë të performancës, kundër pagesës. E kjo sidomos po shfaqet në sektorin publik qeveritar, në arsim, shërbime financiare, prodhim, sektorin privat etj. Sistemi i pagesave i bazuar në baze të performancës ka peripecitë e veta, mirëpo që gjithsesi që mund të jetë efikent, nëse maten rezultatet e secilit punonjës.

Situatat në këto njësi organizative sjellin dilemën nëse pagesa në bazë të performancës pranohet dhe nuk shkakton zhurma të dy anshme qoftë për punëdhënësin apo punëmarrësin. Menaxhimi i organizatës dhe njerëzve, i ka efektet e veta anësore në kohezionin grupor të organizatës (bashkimin e punëtorëve kundër menaxhmentit), që në një formë zbatimi eventual i sistemit matës mund të

ballafaqohet në veçanti në rezistencën e madhe burokratike të organizatave. Së pari, askujt nuk i pëlqen të jetë i matur, mirëpo në fakt kjo duhet të behet nëse aplikohet sistemi i pagesës në bazë të performancës.

Sot, sido që të jetë gjërat veç sa kanë lëvizur përpara dhe punonjësit në organizatë që përbëjnë kompaninë, janë të shtyre që të punojnë me kushte të tjera, që konsiderohen shumë me të avancuara. Që ndërmarrja të jetë efikase dhe për të fituar profitabilitetit të lartë, ajo kërkon nga të punësuarit që konfirmojnë që do të punojnë në mënyrë të efektshme sipas objektivave që kompania synon. Në bazë të këtyre objektivave menaxhmenti, do të drejtojë të ardhmen e kompanisë për të arritur këto synime që përkon me administrimin e biznesit. Është karakteristikë fakti se të punësuarit në një nivel më të ulët në shkallë hierarkike që përbëjnë thelbin e kompanisë, rëndësia e kësaj është edhe me e madhe nëse për të ekzistojnë nivele të duhura ekzekutive që në esencë e drejtojnë punëtorin në drejtim të arritjes së objektivave të dëshirueshme të kompanisë.

Një mënyrë e drejtimit të punëtorëve në cakun e dëshiruar, konsiderohet edhe krijimi i një sistemi të nxitjes, që kryesisht konsiston në punëtorët të cilët marrin udhëzime të qarta për objektivat dhe qëllimet, që në rast se arrihen, do të çojë në një shpërblim. Prandaj, është e rëndësishë së madhe që objektivat e kompanisë të janë të arritshme, ngase këto janë të dëshirueshme edhe për individin si punëtor. Në qoftë se sistemi stimulues i plotëson këto kushte ajo do të çojë të punëtorëve në drejtim të drejt, duke e kuptuar se çka do të përmbush kompania/institucioni, si kundra shpërblime për performancën tonë.

Për qëllime të këtij studimi janë përdorur, **metodat e analizës**, e cila ka mundësuar që të analizojmë gjendjen aktuale të procesit të rekrutimit të burimeve njerëzore, në administratën publike dhe sektorin privat. Ndërsa përmes **metodës hulumtuese/empirike**, janë analizuar faktorët e brendshëm që ndikojnë në procesin vendimmarrës për rritje pagave në bazë të performancës, dhe faktorëve të jashtëm që ndikojnë në këtë aspekt siç mund të jenë kufizimet buxhetore. Në vazhdimësi është shfrytëzuar edhe **metoda e sintezës** më të cilin është sintetizuar materiali nga burime dhe dokumente të ndryshme të cilat kanë mundësuar të japim rekomandime, që kanë quar nga vërtetimi i hipotezës lidhur me pagese në baze të performancës, të cilat janë zgjedhur në bazë të kriterëve të pranuar dhe shkencërisht të njohura.

## 1. Definimi i problemit

Të gjithë punëtorët kanë objektiva personale, të cilat përpiqen që t'i arrijnë përmes mjeteve të veta të konkretizimit. Kështu, ka një dozë të rrezikut të punëtorët që kanë qëllime personale dhe që nuk janë në përputhje me objektivat e menaxhimit të biznesit. Si rezultat i kësaj, mospërputhje mund të çojë në një konflikt, pasi punonjësit de motivohen për të shtuar vlerën e tyre më shumë se sa ato që janë paraparë me objektivat e kompanisë. Për të parandaluar një zhvillim të këtij lloji, menaxhmentit duhet të projektoj një sistem nxitës, i cili do të motivojë individët që qëllimet personale të përkojnë me objektivat ekzistuese. Këto objektiva duhet të jenë të tilla që të mund të lidhen me punonjësit e tyre dhe kështu të rezultojë në

personel të motivuar, që më pas të marrin atë që dëshirojnë si një rezultat më të mirë të ndërmarrjes. Sistemi nxitës mund të jetë projektuar në mënyra të ndryshme. Nuk ka asnjë sistem nxitje përfundimtare dhe gjithëpërfshirës që do të vlej njëjtë për sektorin privat apo publik, prandaj çdo organizatë ka për të dizajnuar sistemin e vet, në mënyrë që të bashkërendoj më kushtet e ndërmarrjes ku punohet. Kjo tregon që kompania ka për të marrë në konsideratë çfarë lloj i njerëzve do të punojnë në kuadër të kompanisë dhe nëse interesat që kanë njerëzit, janë të përbashkëta me ato të ndërmarrjes. Kështu, sistemet e nxitjes duhet të rregullohen, duke i marrë në konsideratë këta faktorë.

Duke marrë parasysh llojet e ndryshme të individëve se për çfarë ata kanë nevojë, e bëjnë të ekuilibruar rrezikun e përbuzjes ndaj kompanisë. Shumica dërmuese e të punësuarve janë rrezik përbuzës - neglizhues, por kjo ndryshon nga qasja individuale në raport me atë grupore. Sipas **Merchant-it** rreziku vjen nga përbuzja/neglizhenca e të punësuarve, çka do të thotë se të punësuarit si shpërblime marrin vetëm atë që varet nga performanca e tyre që tregojnë/arrin, por kurrësi në tejkalimin e saj.

Në përgjithësi, për të bërë një punë të veçantë për të njëjtat qëllime si kompani, menaxhmenti duhet të eksplorojnë rregullisht për punonjësit sa i përket nevojave individuale dhe faktorëve të motivimit. Këto mund të bëhen sipas formulimeve të ndryshme prej nga shpërblimet e dhëna mund të marrin forma të ndryshme në varësi të individëve 'faktorëve motivues'. Këto forma duhet të jenë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e ndryshme dhe sjelljet e individëve. Ndërsa njerëzit janë të ndryshëm ata gjithashtu kanë nivele të ndryshme të rrezikut përbuzës, që do të thotë se jo të gjithë individët për punën e tyre marrin të njëjtin shpërblim.

Që një sistem i tillë nxitës (forcat lëvizëse) të jetësohet, është menaxhmenti i lartë, ai që vendos. Por nganjëherë marrja e vendimeve të tilla mund të jetë e vështirë, pavarësisht se kjo paraqet formën më të drejtë dhe më të mirë të vlerësimit të një nëpunësi, punëtori apo të ngjashëm.

## 2. Marrja e vendimit si dhe ekspozimi ndaj rreziqeve

Vendosja e objektivave në kuadër të organizatave është një pjesë e pandashme e punës, që në instancën e fundit konsiston me zbatimin e një sistemi matjeje. Në rast se një organizatë që është vendosur për të matur performancën e saj, mund të përcaktohet të themi në numrin e klientëve të shërbyer në një vit dhe njëkohësisht të vendosë këtë objektiv "për të siguruar shërbim 50000 klientëve në 2010 ose që të rritet inkasimi i të hyrave në 20% në raportit me vitin paraprak". Ky objektiv (së bashku me sa duket, një numër të tjerëve) do të bëhet në bazë të vlerësimit të cilësisë së punës së organizatës si një e tërë, ose të një njësie brenda organizatës, ose madje edhe të punonjësve të veçantë, por ajo çfarë është e rëndësishme, performanca duhet të matët. Pamundësia për të përmbushur objektivin nënkupton rëndom performancë të dobët, përveç nëse kemi një shpjegim të kënaqshëm se pse objektivi nuk ishte përmbushur.

Synimi pas krijimit/parashtrimit të objektivave sa i përket performancës organizative është për të përqendruar vëmendjen në veçanti në arritjen e rezultateve, e cila lidhet drejtpërdrejt me sjelljen e individëve, me qëllimet e përgjithshme organizative dhe pritjet e palëve të interesuara, që në rastin konkret korrespondon me shpërblimin apo kundër pagesë.

I terë ky proces, paraprihet nga marrja e vendimeve nga menaxhmenti i lartë i një organizate apo ndërmarrje. Rëndësia e vendimmarrjes, është faktori kyç në matjen e objektivave në organizatë. Pa vendim nuk ka zhvillime të mëtejme, nuk ka efikasitet publike të kënaqshme dhe vihen në dyshim nëse objektivat mund të arrihen apo jo. Shmangia e vendimeve shpesh duket më e lehtë. Megjithatë, duhet pasur parasysh se suksesi dhe garancia për të realizuar profit të lartë apo efikasitet të lartë publike, është në varshmëri të plot nga cilësia e marrjes së vendimeve. Marrja e vendimeve i ekspozohet një doze të caktuar të pasigurisë, që manifestohet në rrezik të organizatës. Rreziku kryesor që mund të parashihet këtu është kryekëput i lidhur me mos përbushjen objektivave të organizatës sipas planit të paraparë si dhe kostos aktuale të projekteve. Për shkak të kostove të tilla dhe të analizës “kosto-përfitim”, projektet e punëve publike, kanë provuar të jenë shumë të pasigurta. P.sh rasti i ndërtimit të rrugëve në Kosovë. Rritja e çmimit të karburanteve djegëse si në vëren e viti 2008, ( 1 lt. naftë = 1.2€) do të ndikojë në mospërbushjen e objektivave sipas planit, në reduktimin e efikasitetit publike. Në kontekst të kësaj edhe marrja e vendimit do të jetë më e rezervuar karshi rrezikut potencial. Masat më të mira për të identifikuar këtë lloji rreziku i gjejmë te qeverisja e mirë në bazë të performancës.

Përvoja e shumë njerëzve të cilët mbështeten në sistemin e shpërblimit për përkrahje të njeriut i trajtuar nga këndvështrimi i kostos financiare, shpesh është përdorur si një arsye për të parandaluar pagesën në bazë të performancës së treguar në punë.

Që rreziku të menaxhohet me efektivitet të lartë, punonjësit duhet të jenë të motivuar, andaj jo rastësisht motivimi quhet si një lloj makine e brendshme e cila shtyn dikë për të bërë gjërat në mënyrë që si rezultat të fundit të marrë diçka të dëshirueshme. Motivimi gjithashtu mund të konsiderohet si element thelbësor për suksesin apo dështimin për çdo lloj detyrë komplekse që konsiderohet të jenë faktorë bazë i cili është përgjegjës për procesin e vendimmarrjes.

## **2.1 Aspektet e rreziqeve, përparësitë dhe të metat**

Duke u nisur nga dëshira e madhe që organizatat të arrijnë cakun e dëshiruar të bazuar në objektiva reale e të matshme në kohe (SMART), më konkretisht duke aluduar në maksimalizimin e profitit të ndërmarrjeve private si dhe rritjen e efikasitetit publike, procesi i marrjes së vendimeve për rritje të pagave përcillet më një doze të caktuar të rreziqeve, përparësive dhe të metave të tjera, të cilat mund të shmangin objektivin e dëshiruar. Sipas studimit tonë, mirëpo duke u bazuar edhe në literaturën tjetër dytësore, rreziqet që më së shumti mund të paraqesin konflikte në mes menaxhmentit dhe punëdhënësit kategorizohen në:

**Hierarkik:** rasti mund të paraqitet te mosmarrëveshjet midis eprorëve dhe vartësve, ulja e rrogave do te ishte kundër vullnetit te punëtorëve qe si rezultat do të çonte në konflikte hierarkikë.

**Konflikti FunkSIONAL:** midis specialistëve të departamenteve, p.sh dep. i cilësisë kundër dep. të prodhimit për shitjen, etj.


**Konflikti Zyrtar/jozyrtar:** kur vendimi merret thjesht për të qenë konform rregullave zyrtare dhe jo siç është praktike të merret.

**I institucionalizuar:** paraqitet atëherë kur ndodhin konflikte te interesave midis palëve, që si rezultat i fundit kërkohet që të krijohen procedura te shkruara siç janë ankesat, ose kur krijohen politika dhe praktika për të mundësuar zgjidhjen e një drejte të palëve në konflikt. etj

**Konfliktet për status:** kur punonjësit janë te interesuar për prestigj dhe respekt nga te tjerët. P.sh. vendimi për ndryshimin e orarit të punës mund të perceptohet si cenim i statusit etj.

**Konflikti Politik:** vendimet mund të kenë pasoja në pushtetin e një individi apo grupi nëse ka një dimension politik të vendimeve. P.sh zvogëlim i buxhetit të kërkim zhvillimit, mund të duket si dobësim i influencës se departamentit, dhe problemi politizohet.


Për të qenë më e kuptueshme kjo, në mënyrë më të detajizuar studimi ka përfshirë të gjitha llojet e këtyre e konflikteve/rreziqeve, të cilat janë paraqitur më poshtë në formë grafike sipas përgjigjeve të marra nga respondentët.



1. Paraqitja e rrezikut dhe shfaqja e llojeve të konfliktit në mes të punëdhënësit dhe punëmarresit shprehur në % ne sektorin privat.

Në bazë të grafikut shihet që në kuadër të sektorit privat nuk ekzistojnë konflikte të theksuar në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit, mirëpo ajo që bje në sy është përqindja shumë e lartë “pa koment”, që janë përgjigjur të anketuarit tanë. Sipas studimit në prapavijë është kuptuar që të gjithë punëtoret po thuajë kanë presione politike ose të paktën kanë pasur presione politike, mirëpo një gjë e tillë është pranuar më lehtësi dhe vetëm një pjesë e shumë vogël rreth 12% e të anketuarve janë deklaruar se kanë pas konflikte të tilla por jo me konsekuenca tjera prapavepruese, të cilat i kam listuar në nivelin e mesëm.

Për dallim nga sektori privat situata pak sa më e theksuar qëndron në atë publik e sidomos në sektorin qeveritar kur konfliktet e paraqitura në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit variojnë nga më të ndryshmet. Në bazë të grafikut shihet shumë qartë se elementi politik dominon në mbi 50 % të rasteve, duke u përcjell nga ai statusit, zyrtar, institucional e më radhe.



## *2. Paraqitja e rrezikut dhe shfaqja e llojeve të konfliktit në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit shprehur në % në sektorin publik*

Sipas anketave të realizuara vërehet se konflikti politik është më i përhapuri në institucionet qeveritare dhe ndërmarrjet publike në përgjithësi.

Ka shumë arsye dhe elemente të cilat ndikojnë në ngritjen e cilësisë dhe përmbushjen e objektivave të punës. Sipas rezultateve të dalta nga studimi, vërehet se pjesa më e madhe e të anketuarve janë të demotivuar nga aspekti politik, si rezultat i ndryshimeve në skenën politike. Kjo situatë duhet ndryshuar në favor të një sistemi nxitës të mirëfilltë, i bazuar në vlera dhe në performance. Pa u thelluar në rrethana të tjera në mënyrë absolute në sektorin publik, menaxhmenti i lartë nuk ka të krijuar një sistem nxitës, mbi të cilin do të viheshin në lëvizje nëpunësit dhe

zyrtarët e tjerë brenda organizatave buxhetore apo qeveritare. Mos aplikimi i sistemeve nxitëse shkon edhe më tej i cili përkundër përparësive të shumta që mund të ketë, prapë nga disa të anketuar vë në dyshim mundësinë e aplikimit apo zbatimit në praktikë, për shkak të reperkusioneve të tjera që mund të lindin ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Anët pozitive të një sistemi nxitës do të ishin në numër, por që mund të ndryshojnë varësisht nga përcaktimet strategjike të organizatës në drejtim të përmbushjes së objektivave dhe shfaqjes së një performancë të kënaqshme, mbi bazën e të cilave do të pasonte pagesa apo shpërblimi për punëtorin.

### 3. Matje e performancës në sektorin privat dhe publikë

Pagesa/shpërblimi në bazë të performancës, në literaturën angleze mund të haset e dhe me termin P4P (pay for performance), i cili konsiderohet koncept i motivimit të burimeve njerëzore, në të cilin proces punëtorët marrin kompensim të kënaqshëm për punën e tyre që bëjnë në grup, departament ose kompani. Në vitin 2005 në SHBA 75% e të gjitha kompanive pagesën e punëtorëve e lidhen me vlerësimin dhe matjen e performancës së treguar në punë. Njëra ndër çështjet më të vështira për menaxhmentin në organizatat publike apo ndërmarrjet private është vlerësimi dhe matja e performancës.


Sido që të jetë ekzistojnë metoda të cilët ndikojnë në matjen e saj, me çka po veçojmë: Indeksi operativ i performancës, është metodë e matjes i cili krahasohet kryesisht me performancën e brendshme financiare të organizatës apo kompanive të tjera të barabarta (e ashtuquajtura *peers* or *peer companies*).

Për të kuptuar më mirë në mënyrë të detajizuar faktorët e motivimit që i shtyn punëtorët për të përmbushur dhe tejkaluar detyrat më të cilat ngarkohen në do të trajtojmë veç e veç sektorin privat dhe atë publik.

**a) Sektori privat** – në kuadër të kësaj kategorie veçohen të gjitha bizneset afariste të cilat operojnë më kapital privat, përkatësisht më aksione private. Sipas studimit që kemi realizuar, puna jonë më tepër është fokusuar në linjën e agentëve tregtarë, e bankarë të cilët në disa prej rasteve janë të motivuar që të punojnë duke u bazuar në sistemin e pagesës në bazë të performancës.

Situata më e favorshme qëndron në sektorin bankar e sidomos në pjesën e kredive e cila zbatohet mbi një limit të caktuar të kredidhënies. Bije fjala të gjithë ata agentë bankarë – kreditorë të cilët arrijnë pragun mbi 250 000 Euro (dhënies së kredive), paguhet në bazë të përqindjes mbi pragun e kreditimit. Në sektorin privat në mënyrë të qartë dominon mendimi se pagesa në bazë të performancës dhe meritës në punë është çështje që kryekëput ndikon në motivimin punëtorëve, për dallim nga format e tjera të motivimit siç janë promovimet, bonuset etj.





3. *Format e pagesës - shpërblimeve kundraj punës së bërë nga puntoret në sektorin privat shprehur ne %.*

Motivimi i punëtorëve në bazë **të P4P**, është vërejtur së më tepër është karakteristike atyre punëtorëve të cilët e çmojnë punën kreative, gjithnjë duke u bazuar në rezultate të kënaqshme, në drejtim të përmbushjes së detyrave dhe qëllimeve të ndërmarrjes. Kjo kategori e punëtorëve më tepër vlerëson shpërblimin individual se sa kolektiv, dhe i eliminon pasivet dhe pa punëtorët të cilët nuk presin që të “shtyhen” nga menaxhmenti i lartë. Në bazë të grafikonit të cekur më lartë mund të kuptohet se 38% e të anketuarve e pranojnë që të kenë një shpërblim në formë të pagesës mbi performancën e treguar në punë, pasi që mendojnë se janë të dobishëm dhe në funksion të ndërmarrjeve ku punojnë.


Për dallim nga motivimi i punëtorëve në bazë të performancës, pagesa në bazë **të meritës në punë**, në parim nuk ndryshon në masë të madhe nga ajo paraprake. Merita në punë vjen në shprehje kur menaxhmenti i lartë instalon një sistem të mirëfillt të meritokracisë në punë pa dallim. Pak a shumë ky sistem i nxitjes apo motivimit është i ngjashëm atë në bazë të performancës, mirëpo që nuk është i lidhur me ekonomizimin, efikasitetin dhe efektivitetin. Si do që të jetë rreth 36% e të anketuarve janë deklaruar se do të kishin pranuar që të paguheshin në bazë të meritës që kanë në punë, por pa specifikuar se në cilën pjesë të hierarkisë së tyre organizative. Gjatë zbatimit të këtij sistemi nxitës, duhet pasur kujdes që punonjësit, duke qenë të motivuar për të punuar më me intensitet, për ta mbaruar para afatit detyrën e tyre të mos ndikojnë në uljen e cilësisë së produktit apo shërbimit.

Motivimi i punëtorëve duke u **bazuar në politiken promovimeve**, nuk është pritur me dashamirësi të të anketuarit ku një pjesë e vogël tyre në vetëm 12% konsiderojnë apo me mirë të themi besojnë një praktike të tillë. E tëra ajo çfarë është reflektuar nga ane e tyre përqendrohet në atë se biznesi privat në Kosovë më tepër është i natyrës familjare dhe promovimi në kompani është shumë i vështirë. Situata paksa më ndryshe qëndron në sistemin bankar, mirëpo e tërë kjo varet nga

“lidhje” dhe mundësia që të jepen nga të tjerët, sistem ky i bazuar pjesërisht në meritë dhe performancë të kënaqshme në mjedisin ku punohet.

**b) Sektori Publik** – Situatë aspak më e mirë qëndron në sektorin publik për shkak të mos funksionimit të kontrollit të brendshëm në organizatat ku punohet. Parimisht çështja qëndron tek politizimi dhe ndikimi i njerëzve me influencë që nga procesi i rekrutimit e deri tek ngritja profesionale e punonjësve. Situatë më e mirë qëndron në disa prej ndërmarrjeve publike si PTK, aeroport, KEK por prapëseprapë mbeten larg një sistemi të mirëfilltë të motivimit. Në bazë të studimit që kemi bërë vërehet madje se shumica absolute e sektorëve qeveritarë nuk posedojnë as edhe një plan të thjeshtë mbi bazën e të cilëve do të ndikohej në motivimin e punëtorëve. Sido që të jetë aplikimi i një sistemi pagesës/shpërblimit mbi bazën e të cilëve do paguheshin punëtorët në sektorin publik, mbetet për t’u dëshiruar. Sipas të anketuarve ata ishin në gjendje që t’i nënshtroheshin një gare fer dhe konkurruese brenda vetë punëtorëve, mirëpo tendenca për të zbatuar diçka nga menaxhmenti i lartë është shumë e vogël.

Edhe në sektorin publik në bazë të anketave të realizuar del që afër 37% e punonjësve të pranojnë një sistem pagese në bazë të performancës duke vazhduar me 38.5% në bazë të meritës, ndërsa pjesa tjetër që përfshin promovimet dhe bonuset tjera marrin pjesë më 27%.



4. *Format e pagesës - shpërblimeve kundraj punës së bërë nga punëtorët në sektorin publik shprehur në %.*

Ajo që ishte me brengosëse nga ana e punëtorëve nuk do të trajtohet si diçka e veçantë, mirëpo ndërhyrjet e njerëzve të politikës në shërbyesit civilë të sektorit publik, vërtet ul mundësinë e përmbushjes së objektivave për secilën organizatë buxhetore. Kjo do të ndikojë në masë të madhe në performancë jo të mirë, në humbje të imazhit dhe suksesit të punonjësit (meritës) si dhe pamundësi të

promovimit në vendin ku punon, pavarësisht përvojës dhe kualifikimeve profesionale më të cilat disponon.

### **Konkluzione**

Sipas praktikës së ndërmarrjeve private apo organizatave të tjera publike, sistemi nxitës në Kosovës mund të thuhet se nuk ekziston fare, pasi që nga shumica e të intervistuarve as që di ose janë në dijeni për ekzistimin e ndonjë plani nxitës që vë në lëvizje punonjësit në arritjen apo përmbushjen e objektivave. Sistemi nxitës në ndërmarrjet në Kosovës apo organizatat publike/buxhetore i vendosur nga ana e menaxhmentit të lartë nuk njihet pagesë në bazë të performancës në punë apo në bazë të meritës, por si do që të jetë ekzistojnë disa forma të tjera të ofruar në aspektin financiar siç janë: shpenzimet për shujta, shpenzime për mbushje telefonike, shpenzime udhëtimi etj.

**Falënderim:** Te gjithë personat (punëtorët e nëpunësit) që punojnë më përkushtim në sektorin privat dhe publik më të cilët pata rastin të kontaktoja dhe të merrja opinionet e tyre të cilët bënë të mundur që ky studim të arrijë nivelin e pranueshëm për autorin.

### **Referencat**

1. Vaitilingam, Romesh “Human Resources, the Labour Market and Economic Performance”, London School of Economics and Political Science, UK, 2006.
2. Koli, Zana, Llaci Shyqeri “Manaxhimi i Burimeve Njerëzore”, albPAPAER, Tiranë 2003.
3. Goxhaj, Andi “Administrimi i Sektorit Publik”, Tetor 2002, Tiranë,
4. Bratton, John & Gold Jeffry “*Human Resource Management: Theory and Practice*”, UK Palgrave Macmillan, 2003
5. Condrey Stephen E., Handbook of Human Resources Management in Government,
6. Drucker, Peter F. *The Effective Executive*, US, 2002
7. The School of Public and Environmental Affairs “Salary Coverage Incentive Plan” (Orig. 5/12/2006), Indiana University-Purdue University Indianapolis, 2006

8. Kettl, Donald F. & Kelman, Steven “Reflections on 21st Century Government Management” University of Pennsylvania & Harvard University, US 2008
9. Kume, Vasilika “Marrja e Vendimeve Manaxheriale”, shblu Tiranë, 2002.
10. Pyetësori i dizajnuar për mbledhjen e te dhënave



## NEVOJA E MËSIMIT TË LËNDËS „SHKRIMI AKADEMIK“

*Dr.sc.Xhavit Aliçkaj prof. ass.<sup>132</sup>  
xhavitlickaj@hotmail.com*

### Abstrakti

Pavarësisht profilit mësimor nëpër fakultete të ndryshme ku normalisht dominojnë lëndët profesionale, kohëve të fundit është shtruar nevoja e aplikimit të një lënde të re ( në fakultetet tona e jo edhe në ato evropiane ) e emërtuar „ Shkrimi akademik “, e cila ndihmon në zhvillimin e kulturës letrare ( shkrimore ), gjuhësore ( stilistike e drejtshkrimore ) dhe shkencore, duke u ofruar studentëve edhe njohuritë e para metodologjike. Prandaj në këtë numër të parë të kësaj reviste shkencore - profesionale, të cilën do ta kenë në duar edhe studentët tanë, po edhe studentët e studiues të tjerë, ua ofrojmë një punim me informacione të duhura rreth kësaj lënde relativisht të re.

Lënda në fjalë bart më vete çështje që lidhen drejtpërdrejt me interesa të studentëve dhe me format shkrimore me të cilat ata merren gjatë studimeve, si me eseje, seminare, punim diplome, por edhe me shkrime të nivelit studimor, e që nga kjo lëndë marrin njohuritë themelore. Kjo lëndë ua ofron të gjitha të dhënat për punën studimore që nga zgjedhja e temës deri te përfundimi i saj.

**Fjalët kyçe :** shkrim akademik, stil i të shkruarit, metodologji e kërkimit, ese, punim seminarik, punim diplome etj.

**JEL klasifikimi :** A, A2,

### Hyrja

Është e nevojshme që njeriu kur kryen nivelin e studimeve themelore, të quajtura bachelor, krahas dijes profesionale të ketë edhe një kulturë më të gjerë shkrimore, e cila e arsyeton dijen e përgjithshme të studimeve.

Ndonëse të rinjtë marrin një dije mesatare rreth kulturës së shkrimit nga gjuha shqipe, edhe pse vërehet se nuk është e mjaftueshme, po edhe përmes esejeve që janë bërë pjesë programore për të vlersuar dijen e tyre, ata kanë nevojë për njohuri më të thella rreth shkrimit.

Në disa fakultete, si në atë të Filologjisë, apo të Edukimit marrin dije më të thella gjuhësore e letrare, por e kanë edhe shkrimin akademik, në fakultet të tjera studentët kanë nevojë më të madhe të nxënë njohuri të duhura nga kjo lëndë pasi që të tjerat lëndë nuk u ofrojnë këtë mundësi.

---

<sup>132</sup> Autori është pedagog i lëndëve : Shkrimi akademik dhe gjuha shqipe, FSHAB në Pejë,UP i Prishtinës

Vetë emërtimi “ Shkrimi Akademik” tregon se kemi të bëjmë me një status më të lartë shkrimor, i cili do të dallohet nga të gjitha format shkrimore të deritashme dhe që u shkon për shtati pikërisht studimeve universitare. Ky shkrim është më i ngritur, më i begatshëm në kuptimin e të shprehurit të bukur gjuhësor e stilistik.

Ndonëse në universitete të njohura botërore kjo lëndë është futur shumë më herët në programe mësimore, që mund të verifikohen përmes internetit, te ne është aplikuar pak më vonë. Kemi dëshmi që kjo lëndë ka traditë mbi tridhjetëvjeçare në disa universitete evropiane, që do të thotë se e kanë parë të nevojshme aplikimin e saj si lëndë të veçantë për formimin intelektual të studentëve.

Në një mënyrë kjo lëndë është mësuar që më parë në nivel të mësimeve pasuniversitare, si pjesë programore e të gjithë lëmenjve shkencorë, dhe të gjithë ata që kanë kryer studime të këtij niveli dhe janë marrë me punë shkencore, kush më shumë e kush më pak, kanë njohuri rreth kësaj lënde, për metodologjinë e punës kërkimore-shkencore, por është e nevojshme që bazat fillestare t’i mësojnë edhe studentët e nivelit universitar.

Futja e kësaj lënde në kuadër të programit mësimor nëpër fakultete, sipas Deklaratës së Bolonjës, ka arsyeshmërinë e vet, sepse ka plot raste që edhe pa i kryer studimet pasuniversitare dhe pa tituj shkencorë, intelektualët të merren me kërkime shkencore dhe profesionale dhe të shkruajnë vepra me vlera të qëndrueshme dhe të pranuar. Prandaj me të mësuar të bazave të para të shkrimit akademik me metodologji të punës kërkimore-shkencore, do të formojnë kulturën e të shkruarit dhe rrugën për t’u futur në botën e shkencës.

Arsye tjetër e mësimit të kësaj lënde është edhe një e dhënë tjetër: nga përvoja me studentë vërehet se ata nuk kanë njohuri të duhura, të mos themi elementare, rreth kulturës së të shkruarit në përgjithësi e aq më pak rreth llojeve të shkrimit akademik dhe mënyrës së të shkruarit.

Studentët e këtij niveli arsimor, ndonëse nuk merren aq me kërkime të mirëfillita shkencore, nuk mund të përjashtohet ndonjë rast, kanë për obligim të merren me lloje të ndryshme shkrimesh siç janë : esejet, seminarët, raportet, ndonjë referat i rastit, ndonjë kumtesë e mundshme, por secili prej tyre duhet ta punojë temën e diplomës, që është kurorë e studimeve universitare, apo dëshmi për ta marrë thirrjen e duhur profesionale. Për këtë arsye studentët duhet të dinë për këto lloje shkrimesh, që janë të nivelit akademik dhe duhet të ndjekin një ecure pune, një metodologji kërkimore sado që e thjeshtë të jetë ajo.

Çdo student duhet të dijë se si bëhet zgjedhja e temës, si përcaktohet ajo, cilat janë pjesët përbërëse të çdo punimi, si bëhet kërkimi i materialit, si duhet të lexohen e të shfrytëzohen veprat e nevojshme, si bëhet plani i punimit, mbarështrimi i lëndës dhe dokumentimi i saj. Prandaj këto janë objekt i shkrimit akademik.

Jo vetëm kaq. Ka plot raste që studenti të mos dijë t’i shkruajë as format më të thjeshta shkrimore që i duhen në jetën e përditshme si: letra personale, shkresa të karakterit administrativ-juridik, kërkesë, ankesë, deklaratë; të mos dijë ta organizojë një mbledhje, të caktojë një rend të ditës, të mos dijë të mbajë një procesverbal e të

tjera, gjithnjë duke u arsyetuar se nuk i ka mësuar gjatë shkollimit fillor as të mesëm. Dhe është e vërtetë se nuk kanë mësuar.

Në një mënyrë si nxënës të rangjeve të tjera shkollore, si ai fillor dhe i mesëm, janë marrë me disa forma elementare të të shkruarit që përkufizohen me ushtrime, diktime, hartime, lekturë shtëpiake, ose me ndonjë ese të rrallë e të thjeshtë, por këto nuk kanë mjaftuar për të krijuar një kulturë të mirëfilltë shkrimore, ose për të formuar një dije më të qëndrueshme. Për këtë përmes shkrimit akademik synohet të arrihet një nivel tjetër më i lartë i kulturës shkrimore në nivel akademik. Prandaj për studentë është një lëndë e re, interesante dhe e dobishme që do t'u ndihmojë në praktikën e përditshme shkrimore.

Studentët që do t'i vazhdojnë studimet pasuniversitare, ku do të mësojnë metodologjinë e kërkimit shkencor më gjerësisht dhe me specifikat studimore sipas lëmenjëve shkencorë, mësimet e marra në studimet universitare nga kjo lëndë, sado që më të thjeshta e më të përgjithshme, do t'u shërbejnë si një bazë e mirë diturie për ta përvetësuar më lehtë e më thellë.

Kohëve të fundit janë botuar vepra për këtë lëndë dhe ndonëse kanë ngapak dallime në mënyrën e interpretimit të përmbajtjes dhe gjithësi specifikat e veta, kanë të njëjtin qëllim : t'i aftësojnë studentët për të shkruar bukur dhe drejt shkencërisht.

Duke i shikuar shumicën e këtyre veprave dhe duke i pasur si literaturë ndihmëse si : Si shkruhet një punim diplome, Si shkruhet vepra shkencore, Shkrimi akademik, Procesi i të shkruarit, Si të shkruajmë, etj., na bie në sy emëruesi i përbashkët i të gjithave, që është fjala shkrim, që ngërthen në vete shkrimin profesional.

Por shkrimi akademik nuk është mësim gramatike, është më shumë, është dije dhe kulturë gjuhe, dije dhe kulturë profesionale, që nuk mund të merret vetëm më mësimin e lëndës, as dëgjimin e ligjëratave. Këto ndihmojnë, por pjesa tjetër përvetësohet me leximin e veprave të stilistëve të njohur dhe me përvetësimin e gjuhës standarde dhe rregullave të drejtshkrimit.

Vetë ligjëruesi i kësaj lënde duhet patjetër të jetë njohës i mirë i saj dhe njohës i mirë gjuhës letrare.

Duke i konsultuar disa vepra që merren me këtë çështje e sidomos disa dispensa të pabotuara, por të autorizuara nga profesorët, kemi konstatuar se shumica e kanë për bazë metodologjinë e punës kërkimore – shkencore. Mirëpo mendojmë se në kuadër të shkrimit akademik duhet të përfshihen edhe çështje të tjera, si shpjegimi dhe komentimi edhe i llojeve të ndryshme shkrimore, si studimi, recension, referati, punimi i magjistraturës, doktoratës, shkrimi i monografive e të tjera. Dhe gjithësi të shpjegohen çështjet parimore e qenësore të metodologjisë.

Studentët duhet ta kenë të qartë se shkrimi akademik është i një niveli më të lartë, që i tejkalon shkrimet paraprake. Prandaj edhe kërkon respektim të disa normave shkencore, gjuhësore e stilistike dhe metodologjike. Të gjitha llojet e shkrimeve me të cilat merren studentët në këtë nivel arsimor, u paraprijnë shkrimeve shkencore, ku thellohen dituritë dhe bëhen parashikime për punën e ardhshme. Këndeji studenti i provon forcat e veta dhe bën krahasime me të tjerët se a



është i aftë për t'u marrë më tej me punë kërkimore-shkencore. Ai duhet të dijë se për t'u marrë me këtë punë të vështirë duhet të mbështetet në forcat e veta.

Ekzistojnë dy forma, apo rrugë ku studenti mund të merret me shkrime. E para, kur ka për qëllim t'i kryejë studimet universitare, me ç'rast i mjafton një njohje sipërfaqësore e metodologjisë sa për të ditur të shkruajë punime seminarike, eseje dhe temën e diplomës. Për kategorinë tjetër, që duan të merren seriozisht me çështje shkencore dhe t'i avansojnë njohuritë e tyre, është e nevojshme njohja më e thellë e metodologjisë së punës kërkimore-shkencore.

Shkrimi akademik, pos çështjeve që përmendëm, nga zgjedhja e temës e tutje, udhëzon edhe si duhet lexuar materiali i grumbulluar nga libra të ndryshëm, nga bibliotekat, institutet, arkivat etj. Dhe sikurse shkrimi edhe leximi është një aktivitet intelektual që kërkon angazhim të vëmendshëm në materialin që lexohet.

Që në fillim duhet caktuar qëllimet e leximit: a do ta shfrytëzojmë një vepër për informacione, apo për të dhëna e argumente që na nevojiten për punimin tonë.

Leximi i parë mund të jetë i thjeshtë, më i shpejtë dhe më sipërfaqësor, ndërkaq leximi i dytë është më i thellë dhe më i vëmendshëm e që ofron mundësi të kuptohet çdo njësi shkrimore, nga fjala deri te fraza. Kjo është një formë e leximit kritik që i mundëson lexuesit të krijojë një gjykim personal mbi veprën e lexuar pavarësisht nga fama e autorit.

Format e leximit varen nga natyra e tekstit. Bie fjala, ndryshe lexohen veprat e karakterit letrar e ndryshe veprat shkencore. Në të parat ndodh që shkrimtari ta fshehë idenë kryesore që është edhe qëllimi i tij për ta provokuar lexuesin. Dhe nëse lexuesi nuk ka ndonjë informacion ose burim sqarimi, shtrëngohet të japë mendimin personal dhe në bazë të atij teksti të nxjerrë kontekstin.

Veprat shkencore lexohen pak më ndryshe. Në to nuk preferohen mendime të fshehura, por të dhëna konkrete e të argumentuara, që mund të shfrytëzohen për punën kërkimore-shkencore dhe për t'i parë lidhjet tona me ato vepra.

Këndeje leximi nuk kërkon vetëm shprehi pune, që rregullisht të lexojmë vepra të ndryshme, por edhe shkathtësi për t'i gjetur dhe shfrytëzuar pjesët më të kërkuara.

Gjithsesi pjesë e shkrimit akademik është edhe të shkruarit bukur dhe mirë në kuptimin gjuhësor. Për të gjitha këto çështje me rëndësi bëhet fjalë në kapitullin "Gjuha e veprës shkencore". Prandaj si studentët edhe vetë mësimdhënësi i shkrimit akademik, janë të obliguar ta njohin mirë gjuhën standarde dhe rregullat e drejtshkrimit. Nuk mjafton të njihen llojet e shkrimit akademik dhe metodologjia e punës kërkimore-shkencore, e të mos kemi njohuri të duhura mbi anën gjuhësore e stilistike të të shkruarit.

Dhe në fund mund të themi se sado që jetojmë në botën e shkencës e të teknikës, në epokën e internetit, asgjë nuk mund ta zëvendësojë procesin e të menduarit dhe nevojën për të shkruar. Asnjë mjet teknologjik sado i përkryer të jetë nuk ka atë mundësi ta zëvendësojë të menduarit personal dhe të diktojë se çka do të shkruash, prandaj shkrimi mbetet proces intelektual shumë kompleks, pjesë e kulturës përgjithshme, ndërkaq shkrimi akademik edhe pjesë e kulturës profesionale.

## **Përfundim**

Duke u mbështetur në strukturën përmbajtësore të punimit „ Nevojat e mësimit të lëndës **Shkrimi Akademik** “, na duket se e kemi mbërthyer në mënyrë të përmbledhur qëllimin, rolin dhe rëndësinë e kësaj lënde. Kemi dhënë informacione të duhura për format e shkrimit më të cilat do të merren studentët, me mënyrën e mbarështimit të tyre dhe me gjuhën e veprës shkencore.

Tani kjo lëndë, edhe pse me vonesë, mësohet në të gjitha fakultetet dhe është bërë tërheqëse dhe e dobishme për studentë. Për të tani ka literaturë të bollshme ku studentët mund të orientohen për të fituar dije më të zgjeruar, një pjesë të së cilës do ta japim në fund të punimit.

## **Referencat**

1. Abazi, Hajdin. Hyrje në shkrimin akademik. Kolegji universitar „Victory” Prishtinë, 2008
2. Eko, Umberto. Si bëhet një punim diplome. Botime përpjekja, Tiranë, 1997
3. Si të shkruajmë – procesi dhe shkrimet profesionale, përgatiti Majlinda Nishku, Tiranë 2004
4. Sylvian, Barnet ; Pat, Bellanca ; Marcias, Stubbs. Shkrimi akademik ( perktheu Stavri Pone ), Dita, Tiranë, 2000
5. Shamiq, Midhat. Si shkruhet vepra shkencore, Logos, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2006
6. Shkrimi akademik, cikël leksionesh, universiteti U.F.O., Tiranë, 2006



## MENAXHIMI I OBJEKTEVE HOTELIERE NË BAZË TË PLANIT TË ASETEVE

MSc. Valdete Rexhepi

### Abstrakti

Menaxhimi i aseteve, përkatësisht menaxhimi i pasurisë së një ndërmarrje hoteliere, më së shpeshti definohet si proces në të cilin pronarit të pasurisë i sigurohen të dhëna me qëllim të marrjes së vendimeve si dhe i garantohet se pasuria e tij do të menaxhohet si nga aspekti i krijimit dhe ruajtjes së vlerave të pasurisë së tij, po ashtu edhe nga zvogëlimi i riskut financiar. Menaxheri i aseteve është personi të cilin e emëron pronari i ndërmarrjes që në emër dhe llogari të tij të menaxhojë me pasurinë e tij. Ndërsa plani për menaxhimin e aseteve është instrumenti më bashkëkohor për menaxhimin e pasurisë dhe investimeve në një objekt hotelier. Në fakt ky është një ndër shërbimet më të reja që ofrohet në industrinë hoteliere, për të ndihmuar pronarët e hoteleve në realizimin e qëllimeve të tyre<sup>133</sup>.

**Fjalët kryesore:** plani i pasurisë, ndërmarrjet (objektet) hoteliere, menaxheri i pasurisë

**JEL kualifiki:** L, L5, L59.

### Hyrje

Menaxhimi i aseteve ( në vazhdim menaxhimi i pasurisë) në industrinë hoteliere nënkupton menaxhimin e pasurisë së tërësishme të një ndërmarrje hoteliere, dhe konsiderohet si produkt bazë në industrinë hoteliere të viteve të fundit i cili ka pasuar nga transformimi i hotelerisë tradicionale në kompanitë hoteliere të cilat i kanë kushtuar rëndësi të veçantë kualitetit të produkteve të tyre. Industria hoteliere është një ndër industritë më të ndieshme ndaj ndryshimeve të cilat ndodhin në ambientin e jashtëm, e në veçanti ndaj kërkesave shumë komplekse për produkte kualitative. Sot kualiteti i produkteve hoteliere është shëndërruar në armën më të fortë konkurruese në mes të ndërmarrjeve hoteliere. Mirëpo, karakteristikë tjetër sipas të cilës dallojnë ndërmarrjet hoteliere, është pikërisht mënyra e menaxhimit të pasurisë, sepse jo çdo kush që ka një ndërmarrje apo objekt hotelier, mund të posedojë njohuri dhe aftësi për ta menaxhuar atë pasuri. Prandaj, menaxhimi i pasurisë në industrinë hoteliere dhe në veçanti plani i pasurisë, preferohet të aplikohet në vendet në tranzicion.

### 1. Roli i menaxherëve në menaxhimin e pasurisë hoteliere

Roli i menaxherëve të pasurisë është gjithnjë e më i madh në aspekt të ndryshimit të qasjes tradicionale ndaj pasurisë. Prandaj, duke u bazuar në këtë,

---

<sup>133</sup> Beals P., Denton G. Hotel Asset Management- Principles & Practices, (2004) , fq. 5

enaxherët përveq funksionit të tyre menaxhues kanë dhe funksion strategjik, që nënkupton krijimin dhe menaxhimin afatgjatë të planit të pasurisë për një ndërmarrje hoteliere, duke u bazuar në kërkesat dhe qëllimet e pronarit. Këta menaxherë sigurojnë të dhëna kur duhet blerë apo shitur pasurinë, çfarë performanse financiare pritet nga një investim i caktuar në afat të shkurtër dhe të gjatë, apo çfarë investimesh dhe ku duhet bërë për të aktualizuar ndërmarrjen. Detyrat më të rëndësishme të menaxherëve të pasurisë mund të përkufizohen në katër elemente kryesore: identifikimin e qëllimeve të pronarit, blerjen (investimin) e pasurisë, kontrollin e performacës aktuale të afarizmit apo shitjen e pasurisë. Këto komponente në fakt përbëjnë ciklin e menaxhimit të pasurisë si proces<sup>134</sup>.




Fig.1. Procesi i menaxhimit të pasurisë

Nga figura shihet se është shumë e rëndësishme që të krijohen kanalet komunikuese në mes të pronarit të pasurisë, menaxherit të pasurisë dhe menaxhmentit të ndërmarrjes apo objektit, me qëllim të identifikimit dhe distribuimit të të dhënave të domosdoshme për të krijuar planin adekuat për menaxhimin e pasurisë dhe marrjen e vendimeve.

### 1.1. Plani për menaxhimin e pasurisë

Plani për menaxhimin e pasurisë, bazohet në analizën e fakteve dhe të shifrave. Për të krijuar një plan të këtillë duhet hulumtuar dhe mbledhur një numër shumë të madh të informacioneve të detajizuara, edhe pse shumica prej tyre nuk

<sup>134</sup> Po aty, fq 19

prezantohen fare , por të cilat janë të domosdoshme për të krijuar një pasqyrë reale dhe të kuptueshme që përkon me kërkesat dhe synimet e pronarit .

Aplikimi i planit të këtillë në vendet e tranzicionit , përkatësisht në Kosovë qoftë për investimet e reja në industrinë hoteliere, apo për ndërmarrjet ekzistuese hoteliere, do të ndryshonte mënyrën tradicionale të menaxhimit të pasurisë, duke krijuar një model bashkohor të menaxhimit.

### **1.1.1.Qëllimi dhe përmbajtja**

Si instrumenti më bashkëkohor në industrinë hoteliere, plani për menaxhimin e pasurisë ka për qëllim ngritjen e atraktivitetit të pasurisë hoteliere në treg si dhe rritjen e vlerës së pasurisë së përgjithshme të ndërmarrjes.

Plani për menaxhimin e pasurisë për një ndërmarrje hoteliere duhet të përmbajë :

1. Identifikimin e gjendjes ekzistuese të pasurisë, përkatësisht objektit hotelier, dhe performancës financiare të ndërmarrjes apo objektit hotelier.
2. Analizën e tregut dhe konkurrencës, me qëllim të identifikimit të trendeve aktuale në treg dhe pozicionimin e ndërmarrjes në treg.
3. Propozimin për pozicionimin e ardhshëm të objektit dhe zhvillimin e produktit.
4. Konceptin për shfrytëzimin më të mirë të pasurisë, apo konceptin bazë për ristrukturimin e pasurisë ekzistuese (planin për zhvillimin e produktit) si dhe propozimin për projekte të reja.
5. Propozimin e planit për investime i cili duhet të jetë në funksion të koncepteve të propozuara për zhvillimin e ardhshëm të ndërmarrjes.
6. Duke u bazuar në konceptet e propozuara për ristrukturim apo zhvillim të produktit të ri, duhet të bëhet parashikimi financiar për afarizmin e ardhshëm të ndërmarrjes.
7. Në bazë të të gjitha këtyre, të përcaktohet vlera e pasurisë së përgjithshme të ndërmarrjes apo objektit hotelier.

Diagnosticimi përfundimtar i ndërmarrjes apo objektit, përfshin vlerën aktuale të pasurisë, pozitën në treg, modelin e organizimit të punës, gjendjen financiare, duke i identifikuar kështu anët e forta dhe të dobëta të pasurisë së analizuar. Ndërsa analiza e tregut nënkupton identifikimin e mundësive dhe rreziqeve të cilat mund të kenë ndikim në zhvillimin e ardhshëm të secilit prej objekteve hoteliere. Prandaj, duhet përdorur metoda dhe analiza të ndryshme hulumtuese dhe krahasuese (SWOT analiza, Benchmarking analiza) si dhe metodën USALI (Uniform System of Accounts for the Lodging Industry) si një ndër metodat më të avancuara dhe praktike për përcjelljen , përlllogaritjen dhe raportimin e rezultateve financiare të punës në industrinë hoteliere. Këto rezultate duhet të përmbajnë të gjitha të dhënat e periudhave të kaluara (nëse kemi të bëjmë me objekt ekzistues) duke përfshirë shfrytëzimin e kapaciteteve akomoduese brenda një periudhe të caktuar apo bilancin e gjendjes sipas treguesve<sup>135</sup> të metodës

---

<sup>135</sup> ARR (Average Room Rate) – të hyrat mesatare nga dhomat sipas çmimit, RevPAR ( Revenue Per Available Room) – të hyrat mestare sipas dhomave të disponueshme, janë disa nga të dhënat bazë të cilat llogariten në bazë të formulave të caktuara

USALI, të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme, periudhën e kthimit të investimeve, apo qëllimi është të tregohen rezultatet e afarizmit dhe trendet për zhvillim në të ardhmen.

## **2. Menaxhimi i pasurisë hoteliere në vendet në tranzicion**

Në vendet në tranzicion në nivelin në të cilin gjendet edhe Kosova, ende mbizotëron mënyra tradicionale e të menduarit dhe menaxhimit të një objekti apo ndërmarrje hoteliere.

Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve të dikushme hoteliere, ka mundësuar privatizimin e atyre objekteve nga individë të pa përvojë dhe joprofesional për menaxhimin hotelier, si dhe janë ndërtuar objekte hoteliere në çdo vend ku ka pasur mundësi apo pasuri një person i caktuar, pa bërë ndonjë analizë paraprake për mundësinë e pozicionimit të ardhshëm në treg të atij objekti. Prandaj mungesa e kuadrove profesionale për menaxhim, zhvillimi i procesit të punës pa ndonjë planifikim afatgjatë, zgjidhja momentale dhe e përkohëshme e problemeve të cilat shfaqen si pjesë dhe pasojë e procesit të punës, janë disa nga faktorët të cilët tregojnë se transformimi nga mënyra e menaxhimit tradicional në atë bashkëkohor, kërkon që menaxhimi i një ndërmarrje apo objekti hotelier të bëhet në bazë të planit të aseteve.

Produktet apo shërbimet hoteliere me kualitet të dobët krijojnë shpenzime, i dëshpërojnë mysafirët, sjellin deri te humbja e vendeve të punës për të punësuarit dhe e zvogëlojnë profitin e ndërmarrjes. Prandaj, aplikimi i planit për menaxhimin e pasurisë, preferohet, për investimet e reja që para destinimit të sipërfaqes tokësore për një objekt të tillë, si dhe për pasuritë ekzistuese, me qëllim të menaxhimit bashkëkohor të atyre ndërmarrjeve.

Njëra ndër karakteristikat sipas të cilës dallojnë ndërmarrjet hoteliere nga njëra tjetra është mënyra e menaxhimit të pasurisë. Prandaj, menaxhimi i pasurisë është proces i krijimit dhe qëndrueshmërisë së vlerave, përmes rritjes më të madhe të mundshme të të hyrave, kontrollit të shpenzimeve, menaxhimit të riskut dhe qëndrueshmërisë fizike të pasurisë.

### **Përfundim**

Menaxhimi i pasurisë së ndërmarrjeve hoteliere në vendet në tranzicion e në veçanti në Kosovë është e domosdoshme, për arsye se me shumicën prej këtyre ndërmarrjeve menaxhojnë njerëzit joprofesional, dhe mungesa e kuadrove profesionale dhe e aftësive menaxhuese sjell deri te rezultatet e dobëta në këtë veprimtari, të cilat shkaktojnë jo qëndrueshmëri afatgjatë në treg.

Plan për menaxhimin e pasurisë paraqet ndihmën e parë për menaxhmentin e një ndërmarrje hoteliere, nga aspekti i planifikimit për investim, organizimit të procesit të punës, kontrollit të shpenzimeve dhe planifikimit të buxhetit, avansimit të sistemit informativ, si dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.

Përfundimisht, mund të thuhet se plani për menaxhimin e pasurisë, ndërmarrjeve hoteliere ju ofron mundësinë që të jenë në trend me ndërmarrjet

hoteliere të vendeve të zhvilluara përmes zhvillimit të produktit hotelier duke modifikuar dhe avansuar produktet e verifikuara nga ndërmarrjet e suksesshme hoteliere.

### **Referencat**

1. Bardi A. James, (2003). Hotel front office management, The Pennsylvania State University, USA
2. Beals Paul & Denton Greg (2003). Hotel Asset Management Principles & Practices, Educational Institute of the American Hotel & Lodging Association, Denver USA
3. Cerović, Z.(2003). Hotelski menadžment, Fakultet za hotelski i turistički menadžment Opatija
4. Hayes, K.David, & Ninemeier, D.Jack (2005).Upravljanje hotelskim poslovanjem, Zagreb
5. Inwent Internationale Weiterbildung und Entwicklung gGmbH, Priručnik za hoteljerstvo,.Serbiche Version (2004)
6. Stutts, A. (2001). Hotel and Lodging Management, John Wiley & Sons, New York